Ky sistem është një sistem i pazakontë i cili kryesisht përdoret në Australi. Votuesit rradhisin kandidatët e tyre me numër rendor nga më i preferuari deri tek ai më pak i preferuar[17]. Nëse një kandidat merr 50+1% të votave zgjidhet menjëherë. Sidoqoftë, nëse asnjë kandidat nuk ka shumicë absolutekandidati me numrin më të vogël të preferencave të para "eliminohet" nga numërimi, dhe fletëvotimet e tij ose të saj shqyrtohen për preferencat e tyre të dyta. Këto pastaj u caktohen kandidatëve të mbetur në renditje siç shënohen në fletëvotim. Kandidati për të fituar mandatin ka nevojë të arrijë një shumicë absolute të votave). Në parim në këtë sistem përdoret preferenca e dytë e votuesve për të krijuar një fitues me shumicë absolute nëse nuk del nga raundi i parë i votimi Procesi i numërimit të votave mund të marrë disa faza dhe vazhdon derisa një kandidat të këtë një shumicë absolute të votave. Në rast se asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të zgjedhjeve të para të votuesve, numërimi vazhdon duke eliminuar kandidatin me më pak vota dhe votat e tij i transferohen kandidatëve në përputhje me preferencën e dytë të shënuar në secilën fletë votim [18]. Ky proces përsëritet derisa një kandidat të ketë shumicën absolute dhe të shpallet i zgjedhur si duhet. [19]

1.2. SISTEMI PROPORCIONAL

Ky lloj sistemi bazohet në parimin e përfaqësimit dhe tenton të garantoj përfaqësim poltik të niveleve të ndryshme të shoqërisë, duke i përfaqësuar në mënyrë proporcionale në pushtet. Sistemi proporcional përdoret kryesisht në Europën Përëndimore, në shtete me demokraci të konsoliduara, por edhe në vendet që aspirojmë demokracinë për konsolidimin e demokracisë.

Sistemi proporcional nënkupton, se përqindja e votave që fiton një parti politike në nivel shtetëror, përkthehet proporcionalisht në përqindje të vendeve të fituara në parlament.

Në këtë sistem kandidatët renditen në listën e partisë në një numër rendor, dhe futja e tij në kuvend varet pikërisht nga numri që ai mban në listë. Vendi ndahet në zona zgjedhore, dhe nëse partia si logo, fiton 50 përqind të votave në rang vendi, atëherë ajo do të marrë 50% të vendeve.

Sistemi proporcional shmang të gjitha të metat e sistemit mazhoritar, si rezultatet e pandershme,

të kandidatëve apo dhe në shpërndarjen e vendeve shtesë.[20] Partitë e vogla përfaqësohen në parlament pasi çdo votë, në çdo zonë elektorale ka vlerë pasi ato mblidhen në në rang kombëtar. Gjithashtu, në sistemin proporcional nxiten partitë të hartojnë lista të balancuara kandidatësh që i përgjigjen dhe interesave të të gjitha shtresave. [21]

Elementët kryesorë që ndikojnë në sistemin proporcional janë pragu zgjedhor i përcaktuar për përfaqësimin e partive politike si dhe formula zgjedhore e përdorurr për llogaritjen e votave dhe përkthimin e tyre në mandate.

Në shumicën e sistemeve të proporcionale, caktohet pragu zgjedhor minimal në mënyrë që numri i votave që ka fituar një listë zgjedhore të pjesëtohet me numrin e mandateve. Kështu që pragu zgjedhore variojnë nga 0.67 % në Holandë, deri në 10 % në Turqi. Partitë që fitojnë më pak se kjo përqindje nuk do të përfitojnë asnjë vend në parlament.

Formula zgjedhore ndryshon midis sistemeve të ndryshme, por dy mënyrat kryesore të këtij sistemi që përdorin metodat mesatare më të larta, një ndarës (pjesëtues) dhe metodat më të mëdha të mbetjeve, të cilat përdorin kuota[22]. Sipas metodës mesatare më të lartë numri i votave për secilën parti ndahet në mënyrë të suksesshme nga një proces ndarje. Më pas mandatet ndahen për partitë që sigurojnë koeficientin më të lartë që rezulton, deri në numrin e përgjithshëm të vendeve në dispozicion [23].

Rezultatet e sakta të metodës mesatare më të lartë varen nga sekuenca e numrave të përdorur si ndarës. Sekuenca më e përdorur gjerësisht është formula d'Hondt, duke përdorur pjesëtues të tillë si 1, 2, 3, 4, 5, dhe kështu me radhë në ndarjen e mandateve [24].

Metoda tjetër kryesore është formula Sainte-Laguw e cila pjesëton votën me numra të rastësishëm . Kjo formulë vështirë të përdoret në formën e saj të pastër, por formula e modifikuar e Sainte-Laguw, e cila zëvendëson pjesëtuesin e parë me 1.4, është më e zakonshmja. Nga këto tri metoda më të larta mesatare, formula e d "Hondt është prirur të favorizojë partitë më të mëdha dhe formula e pastër Saint-Laguw është metoda më e paanshme që prodhon rezultatet më proporcionale [25]. Secilës parti i ndahen aq vende sa ka kuota të plota, dhe nëse kjo i lë disa vende të paplotësuara, ato vende të mbetura u shpërndahen partive me më shumë vota të mbetura[26], apo me mesatare më të lartë se sa listat e tjera.

Parimi i përbashkët i modelit të Përfaqësimit proporcional është zvogëlimi i pabarazisë midis një pjese të votës kombëtare dhe pjesës së saj në vendet e parlamentit[27].Sistemet proporcionale priren të jenë më të pranueshme, duke rezultuar në një kolorit më të madh të partive politike të përfaqësuara[28]. Sistemi proporcional ka edhe dy nëndarje të tjera.

A. *Sistemi proporcional me listë*: Sistemi proporcional me listë është një sistem zgjedhor kur partia politike rendit vetë kandidatët dhe i prezanton ato sipas dëshirës së saj. Në fletën e votimit votuesit votojnë, partinë politike. Specifikë e veçantë e këtij sistemi është se shtetet vendosin një prag elektoral. Në këtë sistem, mund të arrihet edhe marrëveshje që listat të jenë të hapura ose të mbyllura. Në rastin e listave të mbyllura, nëse në një zonë zgjedhore do të dalin 10 deputetë, partia i rendit 10 kandidatë nga 1 deri tek 10, ndërsa zgjedhësit votojnë vetëm partinë. Ndërsa në rastin e listave të hapura, partia vendos 10 kandidatë, por zgjedhësit, votojnë partinë ndërsa ata kanë mundësinë që mes 10 kandidatësh të vendosin vetë renditjen e kandidatëve për deputetë.

Sistemi proporcional me lista identifikon dhe përkthen saktë votat e hedhura në vendet e fituara, duke u dhënë mundësi përfaqësimi edhe partive të vogla. Ka më pak humbje votash, siç ndodh te maxhoritari, sidomos kur pragu zgjedhor është i ulët në masë 1 apo 2 % [29].

Ulja e pragut elektoral ndikon drejtëpëdrejtë në numrin e partive politike që përfaqësohen, sa më i ulët pragu elektoral aq më i madh numri i partive që do të arrijnë të sigurojnë mandate për përfaqësimin. Por, numri i madh i partive përkthehet në uljen e shanceve për qeverisje vetëm nga një forcë politike dhe rrit shancet e krijimit të koalicioneve qeverisëse. Qeveritë e koalicionit shpesh çojnë në bllokim legjislativ dhe paaftësi të mëvonshme për të kryer politika koherente në një kohë me nevojë të madhe. Koalicionet qeverisëse mund të krijohen midis partive që nuk kanë baza të mjaftueshme të përbashkëta. Këto "koalicione lehtësie" nganjëherë kundërshtohen me "koalicione angazhimi" më të fortë të prodhuara nga sisteme të tjera, në të cilat partitë kanë tendencë të varen

reciprokisht nga votat e mbështetësve të partive të tjera për zgjedhjen e tyre.[30]

Në formën e sistemit proporcional por me lista të mbyllura, partitë janë "fuqiplote" për përcaktimin e kandidatëve dhe zgjedhjen e tyre. Pozicioni i një kandidati në listën e partive, dhe zgjedhja e tij, varet nga kreu dhe strukturat drejtuese të partisë. Votuesit përgjithësisht priren të votojnë partinë duke mos marr parasysh emrat e kandidatëve, sidomos në listat e mbyllura.[31]

B. Sistemi proporcional i votës së vetme të transferueshme:

Sistemi proporcional i votës së vetme të transferueshme, është sistemi ku zgjedhësi bën renditjen preferenciale të kandidatëve në zonën e tyre zgjedhore. Zgjedhësi, mund të rendisë sipas dëshirës së tij kandidatët.

Ajo që e dallon këtë sistem është numrimi i votave dhe formula nga e cila kandidati fiton mandatin e tij.

Kështu, pas përfundimit të numërimit të votave sipas preferencave të para, del numri total i votave për secilin kandidat. Nëse kandidati, ka fituar një numër X votash më shumë ose barazim, me një kuotë të papërcaktuar, ai do të fitojë mandatin.Kuota në këtë rast llogaritet sipas një formule të quajtur Droop[32], si më poshtë:

Kuota=[votat e vlefshme në zonën zgjedhore/ (numrin e vendeve +1)]+1

Pasi kalohet kjo procedurë, vijon numërimi i votave për të gjithë kandidatët që nuk e kanë kaluar kuotën[33]. Në këtë proces të dytë të numërimit, merren votat shtesë të kandidatit i cili tanimë ka fituar mandatin, dhe i kalohen preferencave të dyta të zgjedhësve. Por, edhe në këtë rast, procesi është i ndërlikuar, pasi numërimi i votave shtesë bëhet sipas një përqindje funksionale të një vote.Nësë asnjëri nga kandidatët e një partie nuk ka arritur të kalojë kuotën, atëherë eliminohet kandidati që ka më pak vota, dhe votat e tij shpërndahen tek kandidatët e tjerë[34].

C. *Proporcional Miks (I përzier):* Ky system është një kombinim I aspekteve positive të sistemeve elektorale maxhoritare dhe proporcionale. Një përqindje e parlamentit (afërsisht gjysma në Gjermani) zgjidhet me metodat e shumicës shumicë, zakonisht nga zonat një emërore ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga listat e proporcionale.

Ky system mund të shfaqi strukturë të ngjashme me atë të sistemeve paralele të përshkruara; por dallimi thelbësor është që te sistemi proporcional miks listat e vendeve proporcionale të kompensojnë çdo disproporcionalitet të prodhuar nga rezultatet e vendeve të zonës.

Sistemi i proporcionalit miks ruan përfitimet e proporcionalitetit por, gjithashtu siguron votuesit të kenë përfaqësim gjeografik. Ata gjithashtu kanë luksin e dy votave, një për partinë dhe një për përfaqësuesin. Sidoqoftë, një problem është se vota për përfaqësuesin e tyre vendor është shumë më pak e rëndësishme sesa vota e partisë në përcaktimin e alokimit të përgjithshëm të vendeve.

1.3.SISTEMI I PËRZIER

Sistemi elektoral përkthen votat e hedhura në zgjedhjet e përgjithshme në vende në parlament për partitë politike. Ajo çka duhet patur parasysh në dpërcaktimin e sistemit elektoral është formula zgjedhore e përdorur, struktura e fletës së votimit dhe madhësia e zonës zgjedhore.

Sistemi elektoral i perzier, është një bashkim i disa karakertistikave të të dy sistemeve, në këtë rast zgjedhësit votojnë mbi dy fletë votimi,ku deputeti zgjidhet me dy të tretat me sistemin mazhoritar e tjetrën fletë deputeti zgjidhet me një të tretën me sistemin proporzional, gjithmonë duke perdorur kufirin në përqindje[35].

Sistemet e përziera elektorale përpiqen të ndërthurin atributet pozitive si të sistemit mazhoritar ashtu edhe të atij proporcional. Në një sistem të përzier, ekzistojnë dy sisteme zgjedhore që përdorin formula të ndryshme që shkojnë përkrah njëra-tjetrës[36]. Votat hidhen nga të njëjtët votues dhe kontribuojnë në zgjedhjen e përfaqësuesve në të dy sistemet. Njëri prej këtyre sistemeve është një sistem maxhoritar, zakonisht një sistem zone me një anëtar të vetëm, dhe tjetri një sistem proporcional [37].

Ekzistojnë dy forma të sistemit të përzier.

- *Sistemi i votës të vetme të patransferueshme:* Kur rezultatet e dy llojeve të zgjedhjeve janë të lidhura, me ndarjet e vendeve në nivelin proporcional varet nga ajo që ndodh në shumicën e vendeve të zonave duke

kompensuar çdo disproporcionalitet që ndodh atje.

- *Sistem paralel:* Kur të dy grupet e zgjedhjeve janë të shkëputura dhe të dallueshme dhe nuk janë të varura nga njëra-tjetra për ndarjet e vendeve.

Këto modele janë ato sisteme që i shndërrojnë votat e fituara në një mënyrë të tillë që janë midis sistemeve proporcionale dhe sistemeve mazhoritare[38]. Nga sistemi mazhoritar ai përvetëson parimin e shumicës, për të fituar mandate, ndërsa nga sistemi proporcional merr metodën e fitimit të vendeve për në parlament, në proporcion me numrin e votave të hedhura në kutitë e votimit. Ndarja e mandateve parlamentare në bazë të këtij sistemi bëhet me aplikimin e kombinuar të sistemit mazhoritar dhe të sistemit proporcional. Procesi i kombinimit të këtyre dy modeleve bën që përfaqësuesit të zgjidhen për në parlament sipas dy mënyrave:

- në bazë të votave që kanë fituar kandidatët individualisht në zgjedhje
- në bazë të numrit të votave që ka fituar partia politike[39].

Ky proces miks i kandidatëve që i kanë humbur zgjedhjet sipas parimit të shumicës mundëson që përsëri të fitojnë mandate parlamentare, në qofte se lista zgjedhore e partisë së tyre politike ka fituar përqindje të caktuar të votave të trupit elektoral, që do të thotë se jo më pak se përqindja e pragut elektoral[40].

Sistemet paralele dhe ai i votës nsferueshme zbatohen gjerësisht nga demokracitë e reja në Afrikë dhe vndet e ish-Bashkimin Sovjetik.

1.3.1.VOTA E VETME E PATRANSFERUESHME

Njëri prej modeleve më të rralla që përdoret në zgjedhjet parlamentare, është sistemi i votës të vetme të patransferueshme. Sipas këtij sistemi, zonat elektorale janë shumëkandidatëshe dhe secili zgjedhës ka një votë. Kandidati me numrin më të madh të votave, konsiderohet i zgjedhur.

Një sistem elektoral në të cilin secili votues merr dy vota: një për një kandidat në një zonë elektorale lokale dhe një tjetër për parti. Një pjesë e vendeve zgjidhen duke përdorur shumësinë dhe pjesën tjetër nga sistemet proporcionale të listës. Vendet e listës janë shpërndarë në përpjesëtim me votën e partisë kombëtare, por vetë legjislatura nuk ka nevojë të pasqyrojë votën e partisë në të gjithë vendin [41].

Në qoftë se bëhet fjalë për një zonë që ka katër kandidatë, që të fitojë kadidatit I duhhen jo më pak se 20% të votave.

Për këtë arsye thuhet se sistemi I votës të vetme të transferueshme është një sistem gjysmëproporcional, që i kombinon zonat shumë kandidatëshe me metodën e numërimit të sistemit proporcional.[42]

Dallimi më i rëndësishëm midis këtyre dy sistemeve qëndron në faktin se sistemi proporcional ka më shumë mundësi të lehtësojë përfaqësimin e partive të vogla, për t'u përfaqësuar në parlament. Prandaj, sa më e madhe të jetë një zonë elektorale, aq më proporcional bëhet sistemi. [43]

Ky sistem ka një aplikim shumë të rrallë në praktikën parlamentare. Aplikimi i tij nuk mund të garantojë që rezultatet e përgjithshme të jenë proporcionale, edhe pse partitë e vogla janë mjaft të favorizuara në bazë të këtij sistemi, që aplikon zona shumëkandidatëshe, por në qoftë se ato nuk i udhëzojnë zgjedhësit se si dhe cili kandidat duhet votuar, mund të mos e fitojë mandatin asnjë kandidat.

Kjo do të thotë së partitë e vogla, me një përkrahje, rreth 10%, por që i kanë votat e shpërndara gjithandej vendit, mund të mos fitojnë asnjë vend në parlament

Ndër përparësitë që ka ky sistem është fakti se bën seleksionimin e kandidatëve në kuadër të partisë, sepse votuesi ka vetëm një votë dhe zona është shumëkandidatëshe. Kjo është mënyra më e mirë e reformës brendapërbrenda partisë drejt demokratizimit të saj.

Ky system ka edhe disavantazhe. Partitë, votat e të cilave janë shpërndarë gjerësisht, fitojnë më pak vende se në sistemet e tjera, dhe partitë më të mëdha mund të marrin një bonus të konsiderueshëm vendesh i cili shndërron një shumicë votash në shkallë vendi në një shumicë absolute në mandate përfaqësimi.[44]

Ashtu si për çdo sistem ku kandidatë të shumtë të së njëjtës parti konkurrojnë për një votë, fragmentimi i partisë së brendshme dhe mosmarrëveshja mund të theksohen. Kjo mund të shërbejë për të promovuar politikën klienteliste ku politikanët ofrojnë ryshfete elektorale grupeve të votuesve të përcaktuar[45].

Palët duhet të marrin në konsideratë pyetje komplekse strategjike si për nominimet ashtu edhe për menaxhimin e votave; vendosja e shumë kandidatëve mund të jetë po aq e padobishme sa të vendosësh shumë pak, dhe nevoja për një parti të disiplinojë votuesit e saj për të përhapur votat e tyre në mënyrë të barabartë në të gjithë kandidatët e një partie është thelbësore.

Ky sistem zakonisht shkakton shumë vota të humbura, veçanërisht nëse kërkesat për nominim janë gjithëpërfshirëse, duke u dhënë mundësi shumë kandidatëve të paraqesin vetë.

1.3.2. SISTEMI PARALEL OSE I PËRZER

Sistemet paralele japin rezultate që bien diku midis sistemeve mazhoritare dhe sistemeve proporcionale, por në të shumtën e herëve i japin zgjedhësit mundësinë e përzgjedhjes në nivel zone elektorale dhe parti në rrafshin kombëtar, meqenëse këto sisteme kërkojnë dy fletëvotime. [46]

Sipas këtij sistemi zgjedhor, për në parlament zgjidhen dy kategori deputetësh. Kategoria e parë e deputetëve zgjidhen nëpër zonat elektorale, ndërsa, kategoria tjetër e deputetëve zgjidhen sipas listës partiake të dominuar në zgjedhje. Deputetët që zgjidhen nga zona elektorale i përgjigjen zonës së tyre prej nga janë zgjedhur, kurse ata që zgjidhen nga listat partiake, që nuk i detyrohen zonës elektorale, shtrëngohen t'u përgjigjen l iderëve partiakë, të cilët i kanë radhitur në listat partiake për kandidatë të mundshëm për në parlament. Megjithatë, ky sistem determinon një parlament përfaqësues gjithëpërfshirës, politik dhe gjeografik.

Përparësitë janë sepse për sa i përket disproporcionalitetit, sistemet paralele zakonisht japin rezultate të cilat bien diku midis shumicës së pastër dhe sistemeve të pastra proporcionale. Një avantazh është se, kur ka vende të mjaftueshme për proporcionalitet, partitë e vogla minoritare që kanë qenë të pasuksesshme në zgjedhjet e mazhorancës mund të shpërblehen për votat e tyre duke fituar vendet në ndarjen proporcionale [47]. Për më tepër, një sistem paralel duhet, në teori, të copëzojë sistemin e partive më pak se një sistem zgjedhor të pastër proporcional.

Por, ky system ka edhe disavantazhe. Në këtë sistem ka të ngjarë që të krijohen dy klasa të përfaqësuesve. Gjithashtu, sistemet paralele nuk garantojnë proporcionalitetin e përgjithshëm, dhe disa parti mund të mbeten ende jashtë përfaqësimit pavarësisht se fitojnë një numër të konsiderueshëm votash. Sistemet paralele janë gjithashtu relativisht komplekse dhe mund t'i lënë votuesit të hutuar në lidhje me natyrën dhe funksionimin e sistemit zgjedhor.[48]

References

[1] Kenneth Benoit, Electoral Laws as Political Consequences: Explaining The Origins and Change Of Electoral Institutions. Publikuar në Annual Review Political Social më 5 mars 2007.

[2] Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[3] Po aty.

[4] Kenneth Benoit, Electoral Laws as Political Consequences: Explaining The Origins and Change Of Electoral Institutions. Publikuar në Annual Review Political Social më 5 mars 2007.

[5] Luan Omari,Aurela Anastasi, E drejta Kushtetuese,Tiranë 2010. Fq. 6-7.

[6] Pippa Norris, Choosing Electoral Systems: Proportional, Majoritarian and Mixed Systems, International Political Science Review / Revue internationale de science politique, Vol. 18, Nr. 3, fq. 300.

[7] Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[8] Pippa Norris, Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior (Cambridge: Cambridge University Press, 2004. Fq. 250.

[9] Po aty.

[10] Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[11] Giampiero Buonomo, sul diritto elettorale, l'europa ci guarda. Publikuar në Revistën Diritto Pubblico Europeo Rassegna online, prill 2015.

[12] Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore. Udhezime dhe raporti shpjegues. Miratuar nga

Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij 52-të Plenare (Venecia, 18-19 Tetor 2002)

[13]Pippa Norris, Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior (Cambridge: Cambridge University Press, 2004. Fq. 9.

[14]Henri Çili, "Shumica që na mund", ESSE 3/2002, Tiranë. Fq.10.

[15] Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[16]International Institute for Democracy and Electoral Assistance, (2005) Electoral System Design: the New International IDEA Handbook Stockholm. Fq.44.

[17]International Institute for Democracy and Electoral Assistance, (2005) Electoral System Design: the New International IDEA Handbook Stockholm. Fq.37.

[18] Gallagher, M.&P. Mitchell, 2005: 580

[19]Pippa Norris, Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior (Cambridge: Cambridge University Press, 2004. Fq. 50

[20]https://www.ndi.org/sites/default/files/1890_al_politika ni_050105_alb_0.pdf

[21] Po aty.

[22] André Blais dhe Louis Massicotte, "Electoral Systems", në Elections and Voting in Global Perspective (Thousand Oaks: Sage Publications), fq.57.

[23]Pippa Norris, Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior (Cambridge: Cambridge University Press, 2004. Fq. 51

[24]Kurtesh Salihu, E drejta Kushtetuese, Prishtinë 2005, fq.255.

[25] André Blais dhe Louis Massicotte, "Electoral Systems", në Elections and Voting in Global Perspective (Thousand Oaks: Sage Publications), fq.59.

[26]Gallagher dhe Mitchell, The Politics of Electoral Systems, Oxford 2005: Oxford University Press, fq.586.

[27]International Institute for Democracy and Electoral Assistance, (2005) Electoral System Design: the New International IDEA Handbook Stockholm. Fq.29.

[28] Arend Lijphart, Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries (New Haven: Yale University Press, fq.27.

[29] International Institute for Democracy and Electoral Assistance, (2005) Electoral System Design: the New International IDEA Handbook Stockholm. Fq.30.

[30]Po aty.

[31] Sarah Birch, Electoral Systems and Political Transformation in Post-Communist Europe, viti 2003, fq.158.

[32]Pippa Norris, Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior (Cambridge: Cambridge University Press, 2004. Fq. 55

[33]Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[34]Po aty

[35]Giampiero Buonomo, sul diritto elettorale, l'europa ci guarda. Publikuar në Revistën Diritto Pubblico Europeo Rassegna online, prill 2015.

[36]http://aceproject.org/ace-en/topics/es/esd esd03/def ault

[37]Po aty.

[38]Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[39]Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[40]Giampiero Buonomo, sul diritto elettorale, l'europa ci guarda. Publikuar në Revistën Diritto Pubblico Europeo Rassegna online, prill 2015.

[41]Electoral Systems, https://www.fairvote.org/electoral_systems#research_electoralsystems101

[42]Giampiero Buonomo, sul diritto elettorale, l'europa ci guarda. Publikuar në Revistën Diritto Pubblico Europeo Rassegna online, prill 2015.

[43]Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[44]http://aceproject.org/ace-en/topics/es/esd/esd04/esd0 4a/esd04a01

[45] http://aceproject.org/ace-en/topics/es/esd/esd04/esd0 4a/esd04a01

[46]Andrew Reynolds and Ben Reilly, The International IDEA Handbook of Electoral System Design. Stockholm, Sweden, ISSN 1402-6759. ISBN 91-89098-00-5.

[47]http://aceproject.org/ace-en/topics/es/esd/esd04/esd0 4a/esd04a01

[48]Giampiero Buonomo, sul diritto elettorale, l'europa ci guarda. Publikuar në Revistën Diritto Pubblico Europeo Rassegna online, prill 2015.

PUSHTETI I "FAKE NEWS" PËRBALLË NJË LEGJISLACIONI TË BRISHTË

Dr. Oljana Hoxhaj
oljana.hoxhaj@gmail.com

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Drejtësisë

Abstrakt

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, shtetet demokratike, konsoliduan gjerësisht qëndrimin se një media e lirë dhe pluraliste ishte mbrojtja më e mire kundër lajmeve të rreme. Në këtë kontekst, të gjitha kushtetutat u formatuan në funksion të garantimit të hapësirës maksimale të lirisë së shprehjes. Tashmë që "fake news" është shndërruar në një fenomen global, në sajë të shtimit të platformave dhe rrjeteve online, shtetet janë në dilemë mbi marrjen e iniciativave legjislative me qëllim kufizimin e "pushtetit" të tyre. Punimi synon të analizojë impaktin dhe kompleksitetin e "fake news", duke reflektuar ndikimin e teknologjisë në përhapjen e tyre. Mediat sociale janë terreni më i volitshëm për "lundrimin" e lajmeve të rreme, pasi ato nuk i referohen burimeve tradicionale, cënojnë standardet e etikës në gazetari dhe keqinformojnë publikun. Titujt sensacionalë kanë zëvendësuar lajmin e vërtetë dhe cilësor, duke prodhuar një krizë besimi mbi informimin në tërësi. Pyetja që shtrohet është: A mund të jetë zgjidhja e problemit rishikimi i kornizës ligjore dhe ashpërsimi i ligjit? Legjislatorët duhet të tregojnë maturi dhe një qasje të moderuar në vlerësimin e propozimeve ligjore që kanë për qëllim kornizimin ose kufizimin e veprimtarisë së medias, pasi mund të jenë premisa që çojnë drejt censurës.

Fjalë kyçe: "fake news", rrjet social, digjitalizim, kufizim, censurë

Abstract

After World War II, democracies countries widely consolidated the view that a free and pluralistic media was the best defense against fake news. In this context, all constitutions were formulated in order to guarantee the maximum space of freedom of expression. Nowdays the "fake news" has become a global phenomenon, due to the addition of online platforms and networks. The countries are in the dilemma of taking over legislative initiatives to limit their "power". This paper aims to analyze the impact and complexity of "fake news", reflecting the impact of technology on their spread. Social media is the most convenient ground for "navigating" fake news, as they do not refer to traditional sources, violate ethical standards in journalism and misinform the public. Sensational headlines have replaced the real and quality news, producing a crisis of confidence over information as a whole. The question that arises is: Could the solution of this problem be the review of the legal framework and the tightening of the law? Legislators need to show prudence and a moderate approach to evaluating legal proposals aimed at framing or restricting media activity, as they may be premises leading to censorship.

Key words: "fake news", social network, digitalization, limitation, censorship

1. Hyrje

Shekulli i XXI-të karakterizohet nga përparimi teknologjik, për rrjedhojë nga aksesueshmëria më e shpejtë në kohë, si dhe lehtësi të konsiderueshme në ushtrimin e të drejtës për informim përmes portaleve informative. Këto zhvillime në kuadrin e digjitalizimit, janë shoqëruar me probleme të reja, të cilat kanë tërhequr vëmendjen e politikbërësve kryesisht pas daljes në dritë të skandaleve mediatike. Në këtë kontekst, një prej sfidave më të mëdha është cilësia dhe vërtetësia e informacionit të transmetuar. Burimet përmes së cilave njerëzit zgjedhin të informohen janë të larmishme, por në shumë raste ngrihen dilema mbi saktësinë e informacionit që ato shpërndajnë. Koncepti "fake news" ka tërhequr vëmendjen vitet e

fundit, duke u shndërruar në një fenomen me shtrirje globale. Si i tillë, "fake news" përfshin lajme të rreme, deklarata faktike qëllimisht të rreme, të cilat shpërndahen përmes kanaleve të lajmeve (1). Situata pandemike e dy viteve të fundit, gjatë së cilës për muaj me radhë qytetarëve iu kufizua e drejta për të lëvizur, si dhe një sërë të drejtash të tjera, nxorri në pah nevojën e medias, si një hallkë lidhëse përmes së cilës autoritetet shtetërore komunikonin periodikisht me publikun. Në përballjen me fenomene të tilla, qëllimi kryesor i çdo shteti, përpos ofrimit të kujdesit dhe infrastrukturës së duhur shëndetësore, është shmangia për aq sa është e mundur, e propagandës që lidhet me shpërndarjen e informacioneve të gabuara, të rreme ose të sajuara nga gazetat ose mediat sociale online.

Shoqeritë, pavarësisht zhvillimit të tyre, përballen me "fake news" kudo dhe në çdo kohë. Pak vite më parë, në qendër të debatit politik dhe publik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ishte besueshmëria mbi rrjetet sociale, pas pretendimeve të ndikimit rus në zgjedhjet presidenciale. Pas hetimit të miliona postimeve në Twitter, Facebook videove në YouTube, fotografive në Instagram dhe pjesës tjetër të përmbajtjes në rrjetet sociale, raportet rezultuan të një rëndësie të veçantë në procesin e identifikimit të mënyrave të aplikuara nga rusët, në keqpërdorimin e teknologjisë për të shpërndarë dezinformimin te publiku amerikan. Për pasojë, në sajë të hakimit të kompjuterëve dhe propogandës në rrjetet sociale, ata kanë ndikuar në ndjenjat e votuesve amerikanë (2).

Kjo situatë, e cila vendos në pikëpyetje stabilitetin e një prej demokracive më të konsoliduara në botë, solli jo vetëm lëkundje të besimit në këto platforma, por në të njëjtën kohë shënoi fillimin e një epoke të re, ndoshta më të errtën në marrëdhëniet mes qeverisë dhe gjigandëve të teknologjisë. Gjithsesi, në vlerësimin e këtij raporti, pjesa më sensitive janë bindjet dhe ndjenjat e qytetarëve amerikanë, të cilët në një masë të madhe janë instrumentalizuar, duke çuar në deformimin e vullnetin të tyre gjatë proçesit të votimit. Këmbana e alarmit të "fake news" gradualisht filloi të ndihej edhe në shumë shtete të tjerë, të cilët ishin të pafuqishëm për të "luftuar" me instrumente ligjorë presionin, shtrirjen e gjerë dhe ndikimin gjithnjë e më të madh të kanaleve online në shoqëri.

Rritja e vazhdueshme e platformave dhe rrjeteve online, është produkt i mungesës së një kuadri ligjor të mirëfilltë që duhet të përcaktojë mbajtjen e përgjegjësisë për kontrollin editorial dhe për vërtetësinë e informacioneve të publikuara. Një tjetër çështje që duhet të sjellim në vëmendje lidhet me kontrollin e cilësisë së lajmit. Nëse bëjmë një retrospektivë në median e epokës së para-internet, konstatojmë se transmetimi i informacioneve buronte vetëm nga mediat me resurse të mjaftueshme, të cilat pasi i ishin nënshtruar kontrollit të cilësisë, kishin akses të komunikonin me një audiencë të gjerë. E kundërta ndodh në ditët tona, ku çdokush mund të jetë një botues me shtrirje globale.

Në këtë aspekt, shihet se interesi dhe iniciativa për të investuar në gazetarinë e mirëfilltë është duke u zbehur, pasi duke mos patur filtra kontrolli të cilësisë së informacionit, i lihet "barra" përdoruesit për të përzgjedhur dhe renditur cilësinë e burimit të informimit. Për më tepër, lidhja mes përmbajtjes së lajmeve dhe mjeteve të komunikimit është shkëputur, duke nënkuptuar se "fake news" nxitin më tepër interes dhe rrjedhimisht sjellin më tepër përfitime si pasojë e reklamave. Nisur nga fakti që portalet mediatike janë të "privilegjuara" financiarisht, këto të fundit nuk janë të interesuara të ndërmarrin iniciativa konkrete kundër keqnformimit (3).

2. Materiali dhe metodat

Metodologjia e përdorur në këtë punim konsiston në një kombinim të metodologjive përshkruese, hulumtuese dhe analitike. Në mënyrë përshkruese u trajtua koncepti "fake news" dhe më tej u analizuan çështjet kryesore dhe problematikat që lidhen me të në varësi të kontekstit social-politik të legjislacioneve të marra në analizë. Analiza u mbështet përgjithësisht në literaturën e huaj, në funksion të paraqitjes së dinamikave dhe impaktit të "fake news" në shoqëritë perëndimore, të cilat lirinë e shprehjes dhe të medias e konsiderojnë si themelin e demokracisë. Një hapësirë të konsiderueshme në punim, zë trajtimi i paketës ligjore anti-shpifje, si një risi në legjislacionin shqiptar, në funksion të kufizimit të përhapjes së lajmeve të rreme. Kërkimet për realizimin e punimit, u shtrinë në trajtimin e legjislacionit dhe doktrinës shqiptare e ndërkombëtare, duke e vendosur theksin te perspektiva ligjore e "fake news" si në planin kombëtar edhe në atë ndërkombëtar.

3. "Fake news" – një fenomen kompleks

Komponentët që identifikojnë kategorizimet e lajmeve të rreme konsistojnë në shkallën e pavërtetësisë dhe qëllimit që synon të përcjellë

lajmi te audienca. Impakti i një lajmi lidhet ngushtësisht me tërësinë e ekosistemit informativ. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të nënvizojmë faktin se termi "lajm i rremë" është kompleks, pasi vija ndarëse është shumë e hollë mes keqinformimit, që nënkupton shpërndarjen padashje të një lajmi të rremë dhe konceptit të dezinformimit, qëllimi i të cilit është të krijojë dhe të shpërndajë një informacion që dihet se është i rremë. Për të patur një panoramë të qartë të strukturës së informacionit, është e nevojshme të zbërthehen dhe analizohen tre elementë komplementarë: lloji i përmbajtjes së informacionit që krijohet dhe shperndahet, arsyet e krijimit të saj dhe mënyrat përmes së cilave realizohet shpërndarja. (4)

Përpjekjet për të parandaluar përhapjen e lajmeve të rreme janë sfiduese, pasi përparimi teknologjik mundëson forma të ndryshme të shfaqjes së tyre, si grafikë, imazhe ose video, duke krijuar vështirësi në identifikimin e përmbajtjes së tyre. Shpesh herë, projektuesit e "fake news" janë shumë krijues dhe bindës në publikimin e tyre, saqë përdoruesit e kanaleve online nuk kanë asnjë indicie për të vendosur në dyshim vërtetësinë e tyre, për pasojë evitojnë çdo filtër kontrolli mbi përmbajtjen e lajmit. Ilustrimi më konkret është qarkullimi i imazheve në internet, pak kohë përpara zhvillimit të zgjedhjeve presidenciale në SHBA, të cilat në mënyrë të gabuar transmetonin se qytetarët mund të qëndronin në shtëpi dhe t'a kryenin votimin përmes mesazhit (5). Lajmet e rreme që përhapen në mënyrë të qëllimshme janë shndërruar në një kërcënim në rritje në internet, ndaj tashmë shkencëtarët socialë po krijojnë mënyra të reja për të luftuar përmes "vaksinës" abuzuesit në rrjet (6).

4. "Fake news" dhe sfidat drejt së vërtetës

Në një botë digjitale, "fake news" rrugëtojnë së bashku me shoqërinë. Pavarësisht këtij normaliteti të ri, të gjithë janë në kërkim të instrumenteve të duhur për të luftuar "fake news", duke theksuar veçanërisht rolin e juristëve. Në këtë kuadër, duhet të kuptojmë se përpara hartimit të strategjive konkrete ose implementimit të programeve të caktuara, një profesionist i së drejtës duhet të thellohet sa mbi karakteristikat e lajmeve të rreme aq edhe mbi kontekstin e zhvillimit historik të tyre. Për më tepër, duhet të jetë i hapur për t'iu referuar edhe fushave të tjera të ekspertizes, pasi fenomeni ka shtrirje në çdo sektor dhe është në interesin e të gjithëve t'a parandalojnë përhapjen e tij. Përgjithësisht studiuesit e fushave të ndryshme ndajnë përkufizime të përafërta mbi konceptin e "fake news", ndërsa studiuesit e gazetarisë kanë identifikuar disa karakteristika të përgjithshme të lajmeve të rreme. Nëse i referohemi përkufizimit të profesores së asociuar në Universitetin e Karolinës së Veriut Barbara Friedman, lajmet e rreme përcaktohen si gënjeshtra të ndërtuara qëllimisht dhe në mënyrë strategjike, që paraqiten si artikuj lajmesh me synim që të mashtrojnë publikun. Përveçse janë krijuar për të manipuluar opinionin publik, një tjetër karakteristikë e lajmeve të rreme është fakti se ato kanë tendencë të jenë sensacionale, duke krijuar një interes të jashtëzakonshëm të shoqërisë.

Për shkak të titujve të tyre, të cilët shpesh herë janë të pabesueshëm, artikujt e lajmeve të rreme klikohen më tepër se lajmet e zaknoshme dhe shpërndahen nga miliona njerëz (7). Në dallim nga lajmet e tjera, të cilat filtrohen përpara se të depërtojnë në audiencën e gjerë, një element karakterizues i lajmeve të rreme është fakti se ato nuk prodhohen nga burime tradicionale ose të konsoliduara të medias dhe përmbajtja e tyre nuk është në përputhje me standardet e etikës në gazetari. Për të kuptuar mungesën e etikës, mjafton të përmendim faktin se lajmet e rreme kanë qëllim të përhapin informacione të pavërteta, sepse nuk iu referohen burimeve të sigurta dhe reporterët nuk e ndjejnë peshën e përgjegjësisë për pasaktësinë e lajmit të publikuar. Qasje të tilla janë tërësisht në kundërshtim me frymën që reflektohet në dispozitat e Kodit Etik të Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë, të cilët misionin e tyrë kryesor kanë kërkimin e të vërtetës dhe raportimin e saj.

Në funksion të këtij qëllimi, gazetërët duhet të mbajnë përgjegjësi për saktësinë e punës së tyre, pasi paraprakisht duhet t'a verifikojnë informacionin përpara se ta publikojnë, duke përdorur, për aq sa është e mundur, burime origjinale. Një rëndësi e veçantë i kushtohet kontekstit dhe përmbajtjes së informacionit, elementë mbi të cilët gazetarët nuk duhet të bëjnë kompromis, pasi as shpejtësia dhe as formati, nuk e justifikojnë shpërndarjen ose botimin e një lajmi të pasaktë. Gazetaria etike ka një lidhje të drejtpërdrejtë me marrjen përsipër të përgjegjësisë për punën e kryer nga gazetari dhe detyrimin e tij për të qenë transparent me publikun dhe i disponueshëm për të shpjeguar përmbajtjen e informacioneve. Në rastet kur lajmi është i pasaktë ose i rremë, gazetari së pari duhet të pranojë gabimin dhe më pas duhet t'a korrigjojë përmbajtjen menjëherë dhe në

mënyrë të dukshme. Ai ka detyrim ndaj publikut ta shpjegojë me kujdes dhe sa më qartë korrigjimin e kryer (8).

Intensiteti i përhapjes dhe shtrirjes së lajmeve të rreme është i pakufijshëm, ndaj të gjithë janë njëlloj të rrezikuar. Pavarësisht këtij fakti, në disa fusha impakti është më i ndjeshëm. Qëllimi i përhapjes së një lajmi të rremë, veçanërisht në fushën politike, nuk lidhet me nxjerrjen në pah të këndvështrimeve të ndryshme ideologjike, por me servirjen e deklarimeve të rreme në funksion të diskreditimit të fakteve reale. Edhe pse fluksi informativ ndihmon në pasurimin e njohurive mbi çështje të caktuara, të gjithë duhet të jemi vigjilentë gjatë kohës që qëndrojmë përpara rrjeteve online. Përgjithësisht, rrjete të tilla janë potencialisht më të prirura për të qarkulluar lajme të rreme.

Këto të fundit mbajnë autorësinë e personave apo grupeve që kanë interesa të drejtpërdrejtë në rritjen e përfitimeve financiare ose në ndikimin mbi vullnetin politik të zgjedhësve. Për realizimin e këtyre qëllimeve, mediat sociale ofrojnë lehtësirat e nevojshme dhe shërbejnë si terrene të përshtatshme për të provokuar zëmërim, si dhe për të nxitur e konsoliduar paragjykimet. Në këtë drejtim, autorët e lajmeve të rreme i përmbushim pritshmëritë e tyre, pasi përmes mediave online, të cilat vijnë gjithnjë duke u rritur në aspektin sasior, kanë mundësi efektive për të ndikuar te opinioni publik, por edhe për të gjeneruar të ardhura financiare nga reklamat (9).

5. Perspektiva ligjore mbi "fake news" në planin kombëtar dhe ndërkombëtar

Koncepti i "fake news" është relativisht i gjerë, ndaj praktika juridike është në pasurim e sipër me raste, të cilat kanë për qëllim rivendosjen e të drejtës së shkelur. Një ndër format më të zakonshme të përhapjes së lajmeve të rreme është shpifja. Për pasojë, kjo është arsyeja pse përgjithësisht, pretendimet ligjore më të shpeshta drejtohen ndaj botuesve të cilët kanë shpifur në përmbajtjen e lajmeve të publikuara. Në këtë kuptim, shpifja është komunikimi i një deklarate të rremë të faktit që sjell dëmtimin e reputacionionit ose karakterit të një personi tjetër. Gjithsesi, vlen të përmendim dallimin mes shpifjes së paregjistruar dhe deklaratave shpifëse, të cilat janë shkruar ose regjistruar. Këto të fundit e cënojnë në masë më të madhe reputacionin dhe persoanlitetit e personit. Të gjithë shtetet janë në një dilemë të madhe në ruajtjen e balancës mes të drejtës për t'u shprehur dhe mbrojtjes së karakterit dhe imazhit të personit, përgjithësisht me profil publik.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në respekt të Amendamentit të Pare, përmes së cilit garantohet liria e shprehjes, ia lënë barrën e provës për të vertetuar shpifjen paditësit. Kjo nënkupton se është personi që pretendon se është dëmtuar nga shpifja, subjekti që duhet të provojë së deklaratat shpifëse janë botuar me qëllim për të cënuar integritetin e tij në publik. Publikime të dëmshme dhe të rreme të fakteve në lidhje me një figurë publike p.sh., shpifja ndaj një njeriu të famshëm ose ndaj një zyrtari të lartë në qeveri, janë të dënueshme vetëm nëse provohet se botuesi i lajmit ka vepruar me "keqdashje të vullnetshme", domethënë, ka bërë publikimin e lajmit edhe pse ka qënë në dijeni të faktit se deklarimi është i rreme ose i pamatur.

Në këtë kontekst, subjekti që përhap shpifjen përbën elementin kyç në përcaktimin e shkeljes së kryer. Lajmet e rreme karakterizohen nga qëllimi dhe përhapja me vetëdije e deklaratave të rreme (10). Nëse analizën e shtrijmë në kontekstin amerikan, evidentojmë një mbrojtje thuajse me fanatizëm të amendamentit të parë, por gjithsesi mbrojtja kushtetuese dhe aq më pak garancitë ligjore, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të "shpëtuar" botuesit e lajmeve, të cilët rregullisht paditen për shpifje. Një shembull ilustrues është padia për shpifje e ngritur në shtator të vitit 2016 në gjykatën e shtetit Maryland nga ish-zonja e parë në SHBA, Melania Trump kundër blogerit Webster Tarpley. Blogeri kishte botuar një artikull në internet dhe i referohej zonjës Trump si "shoqëruese (eskortë) e nivelit të lartë".

Në mbrojtjen e tij, blogeri i mohoi pretendimet për dëmtimin e paditëses dhe e përshkroi përmbajtjen e padisë si një fyerje të drejtpërdrejtë ndaj parimeve të parashikuara në Amendamentin e Parë dhe si një sulm ndaj fjalës së lire. Blogeri e zgjidhi mosmarrëveshjen me zonjën Trump përmes përgënjeshtrimit zyrtar dhe ndjesës ndaj saj, si dhe pagesës së një shumë të konsiderueshme monetare (11). Sikundër e kemi theksuar më sipër, media sociale është hapësira ideale për prodhimin dhe qarkullimin e lajmeve të rreme. Përmes platformave të mediave sociale, botuesit mund të shpërndajnë në mënyrë virale lajme të rreme përballë një audience masive. Publiku i gjerë e ka më të lehtë këtë mënyrë informimi, pasi rezulton më efikase dhe më e përballueshme në raport me metodat e tjera të informimit. Në këtë drejtim, vitet e fundit Facebook ka berë një hap

të rëndësishëm në funksion të intensifikimit të "luftës" me fake news. Në sajë të ndryshimeve mbi politikat e reklamimit, Facebook ka si qëllim të ndalojë përmbajtjen e reklamave që mbartin informacion të rremë. Për botuesit e lajmeve të rreme që shkelin këtë politikë, penalitetet që merren nga Facebook janë pezullim ose fshirje e llogarive të tyre (12). Edhe pse ky duket një mision i vështirë, avantazhi i këtij rrjeti është lehtësia në përcjelljen e mesazhit te një komunitetet i gjerë. Mekanizmat e aplikuar nga facebook në funksion të përmbushjes së këtij synimi konsistojnë në ndërprerjen e iniciativave ekonomike, duke konsideruar faktin se shumica e lajmeve të rreme janë të motivuara financiarisht; ndërtimi i produkteve të reja për të frenuar përhapjen e lajmeve të rreme; dhe ofrimi i ndihmës së duhur që njerëzit të marrin vendime më të informuara kur hasin lajme të rreme (13). Tashmë janë të shumta rrjetet sociale, të cilat shohin krijimin e algoritmeve si zgjidhjen e problemit.

Gjithsesi, kjo nuk mjafton. Në shoqëritë demokratike, ku vlera e lirisë së shprehjes është guri i themelit, iniciatiativat që mund të ndërmerren për të luftuar tejkalimet e kësaj lirie duhet të jenë të kujdesshme dhe të tilla, që në thelb të mos e cënojnë bazën e vetë të drejtës. Vitet e fundit, në Shqipëri "fake news" i fabrikuar në mediat online mori një vëmendje të konsiderueshme, të tillë që solli nevojën për të ndryshuar kuadrin ligjor. Ligji i hartuar në fundvitin 2019, ndër të tjera parashikonte *"nxitjen e përmbajtjes së përgjegjshme në publikimet elektronike dhe nxitjen e zbatimit të një Kodi Etike ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve në këtë drejtim"* (14). Impakti i ndryshimeve ligjore që do të kornizonin në vazhdim veprimtarinë e mediave online, e njohur si paketa anti shpifje, pati një zinxhir reagimesh jo vetëm nga portalet mediatike, por edhe nga përfaqësues të OSBE, në qëndrimin e të cilëve u kërkuan reflektime në konceptimin e ligjit, pasi nocioni respekti i privatësisë dhe mbrojtja e dinjitetit të qytetarëve", është relativisht i gjerë, kësisoj i zgjeron rishtazi fuqitë e Autoritetit të Mediave Audiovizive, në një masë të tillë sa që mund të ndikojë në lirinë e shprehjes.

Për më tepër, përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, Harlem Désir artikuloi qartësisht se AMA ose çdo organ tjetër administrativ ose rregullator nuk duhet të merret me çështjet e shpifjes, të cilat duhet të mbeten kompetencë e gjykatave"(15). Kjo qasje, në të cilën reflektohet dukshëm përparësia që merr liria e shprehjes në raport me të drejtën për t'u mbrojtur ndaj fenomenit "fake news", frenon çdo iniciativë ligjore të së ardhmes që do të ketë për qëllim të vendosë në një balancë të drejtë vlerësimin e interesave respektivë. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, mediat në Shqipëri rregullohen me një ligj të posaçëm, në përmbajtjen e së cilit parashikohet se *"veprimtaria e transmetimeve audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit"* (16). Kjo përbën një prej parimeve thelbësore, e cila shkelet periodikisht nga mediat online, të cilat jo gjithmonë i paraqesin saktë faktet dhe ngjarjet.
Po ashtu, përmes një sërë instrumentesh, ndikojnë në formimin e opinionit publik, duke mos inkurajuar vullnetin e qytetarëve për t'i perceptuar situatat dhe qëndrimin rreth tyre, në mënyrë të lirë dhe të natyrshme.

Në praktikë, thelbi i ligjit injorohet në mënyrë sistematike. Nëse marrim në analizë një tjetër dispozitë të tij, konstatojmë mospërmbushje të detyrimeve ligjore nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive në kuadrin e transmetimit të lajmeve të vërteta, të paanshme dhe objektive, po ashtu edhe në trajtimin e drejtë, të vërtetë dhe të paanshëm të të gjitha çështjeve, të cilat janë tema të debatit publik (17). Propozimet legjislative të paketës anti shpifje ishin në vëmendje të veçantë të Komisionit të Venecias. Ligji i propozuar nga qeveria, në opinionin final të Komisionit u kritikua se mund të sillte efekt frikësues për gazetarët dhe ndrydhje të debatit të lirë në internet. Komisioni këshilloi kufizimin e autoritetit dhe mandatit të AMA-s mbi median online, pasi hapi i parë që duhet të merrej ishte forcimi i pavarësisë dhe profesionalizmit të këtij organi. Në optikën e Komisionit të Venecias, autoritetet shqiptare duhet të inkurajojnë krijimin e organeve vetë-rregulluese të medias, në funksion të zbatimit me efikasitet të legjislacionit aktual në luftën kundër shpifjes dhe gjuhës së urrejtjes (18). Nga ana tjetër, në praktikën ndërkombëtare, vendosja e disa kornizave për të ligjëruar kufijtë e shtrirjes së "fake news", nënkupton shmangien me çdo kusht të standardit të dyfishtë sipas së cilit, një lajm i rremë është i paligjshëm vetëm nëse përdoret nga 'të tjerët'.

Çdo standard ligjor në lidhje me lajmet e rreme duhet të jetë formalisht dhe potencialisht universal, në mënyrë që të jetë i zbatueshëm pa iu referuar prirjeve dhe qasjeve gjeopolitike apo vlerave kompromentuese. Ky qëndrim është një garanci për të evituar çdo përpjekje të

ndërmarrë ndaj mediave opozitare. Për pasojë, regjimet autoritare nuk mund të krijojnë precedentë të rrezikshëm në funksion të kontrollit dhe monopolizimit të rrjeteve informative (19). Iniciativat politike aktuale të miratuara nga Komisioni Evropian janë të rëndësishme, por ende të paplota. Politika duhet t'i përgjigjet keqinformimit në internet duke nxitur sjelljen e përgjegjshme në përcjelljen e informacionit. Efektive do të rezultonte edhe miratimi i një politike proaktive mediatike që synon promovimin e pluralizmit dhe përmirësimin e ekspozimit të materialeve me përmbajtje të larmishme. Në optikën e Komisionit Evropian zgjidhjet ligjore të ngurta janë premisa që të çojnë drejt censurës (20).
Në mbështetje të analizës së mësipërme, është e domosdoshme të sjellim në vëmendje se çdo shtet është i lirë për t'a rregulluar sipas vullnetit dhe dinamikave të brendshme raportin me lajmet e rreme. Shtetet, në ushtrim të lirë të sovranitetit të tyre, pasi vlerësojnë kontekstin social-juridik, zgjedhin nëse do të mbajnë qëndrim të moderuar, apo do të intensifikojnë politikat dhe strategjitë ligjore për të parandaluar përhapjen e fenomenit "fake news".

6. Përfundime

Gjatë dekadës së fundit, shoqëritë në mbarë botën janë përballur më shumë se kurrë më parë me "fake news". Kjo ka bërë që të gjithë të bëhen nostalgjikë për median e vjetër, atë tradicionale, e cila prirej të gjurmontë të vërtetën, mbronte me fanatizëm burimin e informacionit dhe karakterizohej nga etika dhe profesionalizmi në mënyrën si e përcillte lajmin te publiku. Ajo kohë duket e largët, po aq e largët sa koha kur rrjetet sociale shërbenin si infrastruktura lidhëse mes njerëzve, duke ndërtuar ura komunikimi dhe hapësira alternative, në të cilat bashkëjetonin më së miri diversiteti i qasjeve dhe larmia e kanaleve të informimit. Në ditët tona nuk mungojnë ekosistemet mediatike, por përmbajtja dhe përgjegjësia e medias në raport me publikun ka nevojë të ridimensionohet. Shpesh herë publiku instrumentalizohet, pajiset me lajme të rreme dhe me mungesë të theksuar në përmbajtje. Dallimi i shpejtë i lajmeve të rreme është një sfidë për masën që lundron në internet. Sidoqoftë ka disa metoda, me anë të cilave mund të identifikohen të ashtuquajturat "Fakes".

Lajmet e rreme më së shumti shpërndahen përmes rrjeteve sociale. Keqinformimi nuk bëhet vetëm me anë të lajmeve të pavërteta, por edhe një foto mund të cilësohet si "Fake" (21). Lajmet e rreme janë gjithmonë të padëshiruara, por veçanërisht në kontekste të caktuara ato mund të bëhen jo vetëm të dëmshme, por edhe të rrezikshme. Dy vitet e fundit, mbarë bota është duke u përballur me një situatë pandemike, ku përveç kërkimeve për vaksinën ndaj virusit, po aq e vështirë ka qenë edhe gjetja e "vaksinës për mosinfektimin e publikut nga fake news". Në këtë përiudhe kanë qënë të shumta publikimet në mediat sociale me përmbajtje të çuditshme, kontradiktore ose të dëmshme. Në këtë aspekt, janë ndërmarrë një sërë fushatash ndërgjegjësimi ndaj publikut, për të evituar keqinformimin.

Gjithsesi, edhe pse mediat sociale kanë kontribuar në moslejimin e përhapjes së lajmeve të rreme, shoqeria krahas luftës ndaj virusit, duhet të ndërgjegjësohet edhe ndaj valës së lajmeve të rreme (22). Impakti i "fake news", veçanërisht i titullit të lajmit mbetet në kujtesë për një kohë të gjatë, pavarësisht përmbajtjes (23). Shpesh politikbërësit zgjedhin të ashpërsojnë ligjet, si rrugën më të shkurtër në luftën me "fake news", por kjo strategji nuk mund të rezultojë efektive në një shoqëri digjitale që udhëhiqet nga liria e shprehjes. Një fenomen kaq kompleks kërkon kombinimin e një sërë qasjeve, duke filluar nga edukimi i publikut në përzgjedhjen e burimeve të sigurta të informimit (24). Në këtë drejtim, një iniciativë interesante është ndërmarrë nga ligjvënësit e Kalifornisë, të cilët kanë përfshirë në kurrikulat e shkollave të mesme programe mbi literaturën e medias për të ndihmuar të rinjtë të dallojnë lajmet e rreme dhe të kultivojnë njohuritë e duhura në këtë fushë (25). Si përfundim, vlen në theksojmë se një ligj i ashpër nuk e parandalon dot pushtetin gjithnjë e në rritje të "fake news". Kjo mund të realizohet efektivisht përmes investimit të vazhdueshëm në edukim dhe inkurajimit të të rinjve për t'iu drejtuar bibliotekave.

Literatura

1. *M. Verstraete et al., Identifying and Countering Fake News, Arizona Legal Studies Discussion Paper No. 17-15 (2017), faqe 5 Available from:*
2. *Available from: https://www.intelligence.senate.gov/sites/default/files/documents/Report_Volume1.pdf*
3. *Andrea Renda - CEPS - Centre for European Policy Studies and College of Europe, "The legal framework to address "fake news": possible policy actions at the EU level" PE 619.013- June (2018), faqe 5*

4. *Claire Wardle, Fake News. It's Complicated, FIRST DRAFT NEWS, February. 16, 2017 Available from: https://medium.com/1stdraft/fake-news-its-complicated-d0f773766c79*
5. *Claire Wardle, Fake News isn't New, Columbia Journalism Review, November 2016 Available from: https://www.cjr.org/tow_center/6_types_election_fake_news.php*
6. *Gayathri Vaidyanathan, Finding a vaccine for misinformation, Proceedings of the National Academy of Sciences of Unitet States of America, 2020 Available from:https://www.pnas.org/content/117/32/18902?utm_source=TrendMD&utm_medium=cpc&utm_campaign=Proc_Natl_Acad_Sci_U_S_A_TrendMD_0*
7. *Robinson Meyer, The Grim Conclusions of the Largest -Ever Study of Fake News, The Atlantic Daily, March 2019 Available from: https://www.theatlantic.com/technology/archive/2018/03/largest-study-ever-fake-news-mit-twitter/555104/*
8. *Society of Professional Journalists Code of Ethics. Available from: https://www.spj.org/ethicscode.asp*
9. *Carol A. Watson, Information Literacy in a Fake/False News World: An Overview of the Characteristics of Fake News and its Historical Development, International Journal of Legal Information" , Volume 46 , Issue 2 , July 2018 , faqe 93 Available from: https://www.cambridge.org/core/journals/international-journal-of-legalinformation/article/information-literacy-in-a-fakefalse-news-world-an-overview-of-the-characteristics-of-fake-news-and-its-historical-development/674B5DCB6A3106FC50B5DE1CCF0646AA*
10. *David O. Klein and Joshua R. Wueller, "Fake News: A Legal Perspective"; Journal of Internet Law, Volumi 20, 2017, faqe 7*
11. *Dan Morse, "Melania Trump Reaches Settlement in Libel Lawsuit Against Maryland Blogger," Wash. Post (7 Shkurt 2017) Available from: http://bit.ly/trumplibel*
12. *Advertising Policies, Facebook, Available from: http://bit.ly/FBadpolicies*
13. *Available from: https://www.facebook.com/formedia/blog/working-to-stop-misinformation-and-false-news*
14. *Ligji nr. 91/2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 13/pika (e)*
15. *Available from: https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/425453*
16. *Ligj nr. 97/2013 Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, neni 4, pika ç*
17. *Ligj nr. 97/2013 Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, neni 33*
18. *Available from: https://www.reporter.al/opinioni-final-i-venecias-rrezon-ligjin-e-qeverise-per-mediat-online/*
19. *Baade, Björnstjern, Fake News and International Law, KFG Working Paper Series, No. 18, Berlin Potsdam Research Group "The International Rule of Law – Rise or Decline?", Berlin, Gusht 2018, faqe 20*
20. *Andrea Renda - CEPS - Centre for European Policy Studies and College of Europe, "The legal framework to address "fake news": possible policy actions at the EU level" PE 619.013- June (2018), faqe 32*
21. *Adelheid Feilcke, Procesi i verifikimit të lajmeve në mediat gjermane për t'u mbrojtur nga FakeNews, botim i Autoritetit te Medias Audiovizive (AMA) 2018, faqe 8 Available from: http://ama.gov.al/wpcontent/uploads/2018/10/Fakenews.pdf*
22. *David Shaw, Coronavirus and our duty to fight fake news: 10 simple rules, Journal of Medical Ethics, 2020 Available from: https://blogs.bmj.com/medicalethics/2020/04/15/coronavirus-and-our-duty-to-fight-fake-news-10simplerules/?fbclid=IwAR03zLOHu5AHDk0ril5jIoVlFctgs3ptvT9kXMOCs8UAl_Y98X2bkbO1Bac&utm_campaign=jme&utm_content=consumer&utm_medium=cpc&utm_source=trendmd&utm_term=usage-042019*
23. *Nadia M. Brashier, Gordon Pennycook, Adam J. Berinsky and David G. Rand, Timing matters when correcting fake news, (2021), Proceeding of the National Academy of Sciences of Unitet States of America Available from: https://www.pnas.org/content/118/5/e2020043118*
24. *Gordon Pennycook and David G. Rand, Fighting misinformation on social media*

using crowdsourced judgments of news source quality, Proceedings of the National Academy of Sciences of Unitet States of America (2019) Available from: https://www.pnas.org/content/116/7/2521

25. *Melanie Mason, "Fake News 101? Lawmakers Want California Schools to Teach Students How to Evaluate What They Read on the Web," Los Angeles Times (11 Janar, 2017) Available from: http://bit.ly/fakenewslaw*

Politikat evropiane mbi lejimin e ndërprerjes të jetës së fëmijës të palindur.

Dr. Belinda HALILAJ
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Vlorë/Shqipëri
belinda2012halilaj@gmail.com

Abstrakt

Prej shekujsh të shumtë kanë qënë ata që kanë kundërshtuar ndërprerjen e jetës të fëmijës së palindur: abortin, si teolog, mjekë, avokat. Një ndër shkaqet e kundërshtimit të abortit kanë qënë dhe politikat për riprodhimin e popullësisë (1).

Punim është i përqëndruar në trajtimin e politikave evropiane që lejojnë ndërprerjen e jetës të fëmijës të palindur, por disa vende të Europës kanë mbajtur qëndrim kundër tij. Në punim trajtohet roli dhe qëndrimi që mban Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbi këtë çështje. Në Konventë nuk përcaktohet ndonjë nen i vaçantë mbi abortin si të drejtë (1). Aborti është një rast unik që gëzon mbrojtje nga më shumë se një nen i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Trajtimi në lidhje me këtë nen konsiston në përcaktimin nëse aborti është një cënim i të drejtës së jetës për fëmijën e pa lindur. E drejta e jetës, në të njëtën kohë përbënë si detyrim pozitiv, por edhe negative për shtetin (1). Në lidhje me detyrimin negativ shteti është i detyruar të përcaktoj se në cilat raste mund të cënohet e drejta e jetës e fëmijës të palindur.

Fjalët kyçe: *fëmijë, politika evropiane, e drejta e jetës, etj.*

Abstract

For century has been many people which had objected the termination of life for the unborn child: abortion, as a theolog, doctors, lawyer. One of the reason to opposition of abortion has been the policy of population reproduction.

Paper is focuses in European policy which allow termination of life of unborn child. but some European countries had taken position against. In paper treated the role and position of European Convention of Human Rights in this case. Convention not defined any special article on abortion as a right. Abortion is unique case which enjoy protection from some article of European Convention of Human Right.

The treatment in relation with this article consists in determination whether abortion is an affected of the right to life for the unborn child.

The right to life, in the same time is positive and negative obligation for state. In relation with negative obligation the state is obliged to determine the cases when can affected the right to life.

Key words: *child, European policy, the right to life etc.*

Hyrje

Në kohët e lashta, ndërprerja e jetës të fëmijës së palindur: aborti, është konsideruar si çështje e planifikimit familjar, përzgjedhjes gjinore, kontrollin e popullsisë, dhe të drejtat pronësore të patriarkut. Rrallë ishin të drejtat e nënës ardhshëm qe merreshin në konsiderat, e shumë më pak ato te fëmijës së ardhshëm. Në ditët e sotme aborti është një nga temat më të diskutushme që ka hapur debate të herë pasë hershme, që si rrjedhojë kanë sjellë ndarjen e njerëzve në dy grupe: pro dhe kundër abortit. Shkaqet për të ndaluar dhe kufizuar abortin kanë qënë të ndryshme, vlenë këtu të theksojmë ato politike dhe fetare e nëse do t'i referohemi planit ndërkombëtar duhet të nënvizojmë rolin e organizatave ndërkombëtare, përfshirë Këshillin

e Evropës. Debati për abortin i referohet polemikave të vazhdueshme lidhur me statusin moral dhe ligjor të abortit. "Dy grupet kryesore të përfshira në debatin e abortit janë lëvizja vetë-përshkruar "pro-zgjedhje" (duke theksuar të drejtën e gruas për të zgjedhur nëse ata dëshirojnë të sjellin një embrion ose fetusin në afat) dhe vetë-përshkruar "pro-jetës" lëvizje (duke theksuar të drejtën e embrionit ose fetusit për të lindur)" (1). Sipas Dr. Sreqko Boshnjak: Të abortosh do të thotë ta mbytësh fëmijen e ngjizur në barkun e nënës.

Autorë të ndryshëm kanë mbajtur qëndrime të ndryshme rreth kësaj çështjeje, në përgjithësi ata i rreferohen njërës prej këtyre rasteve:

1. aborti është i gabuar dhe nuk duhet lejuar në asnjë kohë dhe për asnjë arsye,

2. aborti mund të aplikohet në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye,

3. aborti duhet lejuar vetëm deri në një fazë të caktuar të shtatzanisë.

Autorët e grupit të parë veprojnë sipas mësimeve të kishës Romake Katolike, e cila thotë: "*Nuk mund të jemi absolutisht të sigurtë se kur jeta zë vend, apo kur fetusi është personalitet njerëzor; por ndoshta kjo mund të jetë saktësisht në momentin e fekondimit. Sipas kësaj, do te ishte gabim serioz të shkatërrohet qeliza vezë e fekonduar kurdoqoftë, përshkak se kjo do të thotë vrasje e krijesës njerëzore*" (2).

Sipas këtij qëndrimi, aborti është i ndaluar edhe atëherë kur jeta e nënës është në rrezik, apo kur shtatëzania eshte rezultat i ndonjë ngjarjeje të padëshiruar, si për shembull dhunimi apo incesti. Avokatët argumentojnë se lejimi i abortit rrit rastet e aborteve të pasigurta. Sipas një studimi të kryer në bashkëpunim global nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Instituti Guttmacher, shumica e aborteve të pasigurta ndodhin ku aborti është i paligjshëm.

Efekti mbi krimin e abortit të lejuar është një subjekt i debatit, me ithtarët e teorisë në përgjithësi duke argumentuar se "fëmijët e padëshiruar" kanë më shumë gjasa të bëhen kriminelë dhe se një korrelacion inversi është vënë re ndërmjet disponueshmërisë së abortit dhe krimit të mëvonshëm.

Gruaja duhet të ketë të drejtë të zgjedhë vetë në mënyrë të lirë nëse do abortoj ose jo, pavarësisht arsyes. Argumentat që përkrahin të drejtën që nëna të vendosi vetë janë:

1. Nëna duhet të vendosi vetë për trupin e saj;

2. çdo fëmijë ka të drejtë për kujdesin e duhur dhe dashuri; nëse kjo nuk është e mundur, aborti duhet të lejohet;

3. nëse fëmija është i sëmurë rëndë, vetëm nëna mund të vendosë nëse ajo mund të kujdeset për fëmijën;

4. në rastin e shtatzënisë nën moshën 18 vjeç vajza nuk duhet të humbasi të drejtën e arsimit dhe karrierës si pasojë e një gabimi

Grupi i tretë i cili mund të cilësohet si "i moderuar" thotë se aborti nuk duhet lejuar pas një stadi të caktuar të shtatëzanisë dhe vetëm nëse rrethana të caktuara e justifikojnë atë, si për shembull kur jeta e nënës është në rrezik dhe shtatëzania do ta rëndojë më shumë gjëndjen e saj. Grupe të ndryshme përkrahin idenë se aborti është moralisht i justifikueshëm kur shtatzënia është rezultat i dhunimit apo incestit, por dhe kur janë diagnostifikuar anormalitete të fetusit në zhvillim. Madje disa sugjeroinë se perfundimi i shtatëzanisë mund të jetë i lejueshëm edhe nëse nëna potenciale është tepër e re.

Metodologjia

Për zhvillimin e këtij punimi shkencor kam përdorur disa metoda kërkimi si: historike, përshkruese, shpjeguese, analitike. Këto metoda gjenden të përziera në punim.

Evoluimi i politikave evropiane

Aborti është i ligjshëm në pothuajse çdo vend evropian edhe pse ka një variacion të gjerë në lidhje me kufizimet në të cilat ajo është lejuar. Praktika që po ndiqet nga shtete është lejimi i abortit deri në muajin e tretë të shtatëzanisë. Kufizimet e abortit janë më të rrepta në vendet që është me i madhe ndikimi i kishës katolike. Shumica e vendeve në Bashkimin Evropian lejojnë abortin gjatë tremujorit të parë. Pas tremujorit të parë, aborti lejohet vetëm në rrethana të caktuara, të tilla si raste që paraqesin një rrezik për jetën e gruas, defekte të fetusit apo situata të tjera të veçanta që mund të kenë lidhje me rrethanat e konceptimin ose moshën e gruas. Për shembull, në Austri (3), abortet në tremujorin e dytë lejohen vetëm nëse ekziston një rrezik serioz për shëndetin fizik të; rrezik për

shëndetin mendor të gruas; rrezik të menjëhershëm për jetën e gruas; dëmtim të rëndë fetusit; ose në qoftë se gruaja është nën 14 vjeç. Danimarka, e lejonë abortin pas tremujorit të parë për një sërë arsyesh, duke përfshirë edhe ato social-ekonomike, por një grua ka nevojë për një autorizim për të pasur një abort të tillë. Duhet të theksohet se aborti në shumë vende të Evropës nuk varet aq shumë nga ligji, por nga pikëpamjet mbizotëruese shoqërore të cilat çojnë në menyren e interpretimit te ligjit. Malta është i vetmi vend i Europës që ndalon abortin në të gjitha rastet, dhe nuk ka asnjë përjashtim për situatat, kur jeta e gruas është në rrezik. Ligji megjithatë nuk është zbatuar në mënyrë rigoroze në lidhje me rastet kur një shtatëzani rrezikon jetën e gruas. Në Irlandë aborti u lejua ne Korrik te vitit 2013. Gratë shpeshë herë udhëtonin drejtë Anglisë dhe Uellsit për të abortuar, të dhëna sipas departamentit britanik për Statistikat e Shëndetësisë se Irlandës për gratë në shërbimin e abortit në Angli dhe Uells 1980 – 1990.

Në Britanin e Madhe, aborti lejohet deri në javën e 24. Nëse vazhdimi i shtatzënisë do të përbënte rrezik, duke sjellë si pasojë dëmtimin e shëndetit fizik dhe mendor të gruas shtatzanë apo ndonjë fëmijë ekzistuese të familjes së saj, aborti eshte i lejushëm (4). Në Belgjikë aborti lejohet deri në javën e 12-të (ose 14 javë pas Periudhës së fundit menstrual) nëse shtatzënia shkakton një 'gjendje të afektit / emergjencës "për gruan. Nuk ka limit: rrezik 'serioz' për shëndetin e gruas ose "sëmundje shumë e rëndë dhe të pashërueshme "të fetusit (5). Ligji është interpretuar mjaft lirisht. Që nga dhjetori 2001, aborti rimbursohet nëse kryhet në një klinikë aborti që ka nënshkruar një marrëveshje me Institutin Kombëtar të sigurimeve shoqërore. Ne Zvicër gruaja duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim ku thuhet se ajo është në një gjendje të dëshpëruar. Mjeku është i detyruar për t'i dhënë gruas informacion të plotë. Ai ka për të diskutuar vendimin me të në mënyrë të detajuar. Sigurimi shëndetësor mbulon kostot e përfundimit të ligjshëm, në të njëjtat kushte si sëmundje. Shumica aborte janë kryer për arsye psiko-sociale. Pas 14 javësh të shtatzanisë, është e vështirë për të lejuar një abort përveç në raste shumë të rënda shendetsore te gruas (6).

Në Norvegji të gjitha spitalet kryejnë aborte në qoftë se kanë një departament të gjinekologjisë. Nëse ata janë qytetarë të BE-së ose të kanë një sigurim spitalor në Norvegji kanë të drejtë të kërkojnë të marrni paratë mbrapa nga kompanitë e sigurimeve dhe formën E111 (7).

Këshilli i Evropës nëpërmjet Komitetit të saj për të Drejtat Sociale ka deklaruar Italin fajtore për dështimin për të respektuar *të drejtën* e abortit. Një e drejtë e njohur qysh prej vitit 1978, kur ligji 194 sanksionuar ligjshmërinë si dhe ndëshkimin e të ndërprerjes vullnetare të shtatzënisë, të përcaktuar si vepër penale. Historia filloi në gusht të vitit 2012, kur Shoqata Ndërkombëtare Planifikuar Parenthood Federata Rrjeti Evropian (IPPFEN) ka paraqitur një ankesë në Komitet. Në mbështetje të ankesave kanë ardhur edhe vërejtjet e Luca Coscioni, qe u bë i njohur sepse mbrojti një grua të re të detyruar për të ndërprer shtatzëninë e vetme në një banjë të spitalit në Romë në vitin 2010 (8). Problemi lind nga natyra e Aktit 194, pasi ai kombinon dy parime, mbrojtjen e zgjedhjes së gruas dhe zgjedhjen e lirë të mjekut. Vendimi i Komitetit është historike sepse ishte denimi i parë që Italia merr nga hyrja në fuqi e Ligjit 194. Për herë të parë në fakt Evropa e vë në qendër të vëmendjes rreziqet e vendimeve të arbitrazhit që rezultojnë në standardet për qëllim për të bërë një gje te vdekur në një zonë kaq delikate si privatësia.

Në janar 2012, Instituti Guttmacher OBSH ka dhënë një studim që tregonte një pamje globale të tendencës së abortit, duke treguar se gratë nuk janë të ndikuara nga ligji në vendimin e tyre për të pasur një abort. Në vitin 2008, numri vjetor i vdekjeve nga abortit i pasigurt në mbarë botën ka rënë nga 56.000 në vitin 2003 në 47,000 në vitin 2008 (9).

Burimet ligjore në nivel Evropian

Dispozita të instrumenteve evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ofrojnë mbrojtje të fëmijës së palindur duke i'u referuar fazave e tij / saj të ndryshme të zhvillimit (p.sh. embrionit dhe fetusit). Shumë instrumentet evropiane për të drejtat e njeriut kanë të bëjnë me norma qe përmbajnë dispozita për jetën para lindjes, të tilla si Konventa Oviedo për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësisë, Protokollit Shtesë mbi Ndalimin e Klonimit te Qenieve Njerëzore. Këto instrumente ligjore nuk përcaktojne në mënyrë të qartë termin "njeri" dhe se termi "të gjithë", është i vlefshëm edhe për fëmijën e palindur, në mënyrë që të sigurojë atyre mbrojtje ligjore.

Gjykata e theksuar shumë herë, se Konventa duhet të interpretohet në perputhje me kushtet në të cilat jetojmë. Interpretimi i Konventës duhet të marrë parasysh, *inter alia*, instrumentet më të fundit ligjore që mbrojnë dinjitetin

njerëzor dhe embrionin, si dhe evoluimin e njohurive dhe praktikave shkencore.

Direktiva 98/44/EC Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike, përcakton se embrioni gëzon mbrojtje edhe në fazën e fekondimit, me qëllim respektimin e parimeve themelore per të ruajtur dinjitetin dhe integritetin e personit.

Të gjitha traktatet moderne për të drejtat e njeriut, duke përfshirë dhe Konventën Evropiane, e kanë origjinën nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948, në bazë të Nenit 3 "çdokush ka të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë së personit". Asgjë nuk ishte e specifikuar si në fillim ose në fund të jetës.

Konventa ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike në hartimin e tij ka patur si qëllim zbatimin e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. "Çdo qënie njerëzore ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Asnjeri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga jeta e tij" (10). Konventa në nenin 6/5 ndalon dhënien e dënimit me vdekje, ku denim nuk duhet të jepen për krimet e kryera nga persona nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare dhe nuk do të kryhen në gratë shtatzëna. Kur teksti i konventes u miratua në vitin 1966, dënimi me vdekje ishte i ligjshme në shumë vende, ndërsa kërkesa për abort ishte një krim në shumë vende të botës.

Në Preambulën e Konventës së vitit 1989 mbi të Drejtat e Fëmijës përsëritet një dispozitë e Deklaratës për të Drejtat e Fëmijëve e vitit 1959, duke deklaruar se "fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe mendore, ka nevojë të veçantë per mbrojtje dhe kujdes, duke përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore, si para dhe pas lindjes ". Midis traktateve rajonale, Konventa Amerikane 1969 për të Drejtat e Njeriut shprehimisht mbron jetën nga ngjizja. Në bazë të nenit 4 /1 cdo person ka të drejtë të ketë mbrojtje te jetës. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj dhe, në përgjithësi, që nga momenti i konceptimit të fëmijës. Asnjë njeri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga jeta e tij ". Neni 2 i Konventës, nuk e ka përcaktuar momentin se kur fillon mbrojtja e jetës. Në çështjen *Brugermann and Scheuten kundër Republikës Federale Gjermane (11),* ku nje grua ankohej se ndërhyrja e bërë nga Gjykata Kushtetuese Gjermane për limitimin e mundësive të aborit, sipas saj rezultonte në shkelje të *Nenit 8* mbi të drejtën e jetës private. Komisioni u shpreh se shtatëzania është një rast unik që nuk mund të konsiderohet vetëm brenda jetës private, jeta e nënës është e lidhur ngushtësisht me atë të foshnjës. Aborti është një rast që gëzon mbrojtje si nga Neni 2 dhe nga Neni 8 i Konventës në varësi të interesave të personit që cënohet.

Kushtet për lejimin e ndërprerjes të jetës të fëmijës së palindur: aborti

Pas shumë sugjerimeve dhe alternativave duket se aborti do të mbetet dilemë siç ka qënë ndërë shekuj. Sidoqoftë, duhet të kemi parasysh faktin thelbësor se aborti është përfundim i jetës së qënies së gjallë. Çështja e abortit ka qënë dhe vazhdon të mbetet një çështje me rëndësi jo vetëm për të gjitha gratë por edhe për politikat që lidhen me riprodhimin në shoqërinë tonë. Në vendin tonë akti i ndërprerjes së vullnetshme të shtatëzanisë është i garantuar me ligj.

Ligji nr. 8045, datë 7.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatzënisë" mbron e garanton respektimin e çdo qënie njerëzore që në fillim të jetës, parashikon rastet se kur mund të kryhet ndërprerja e shtatzënisë dhe sanksionet në rastet e shkeljes së këtyre dispozitave. Në bazë të Nenit 1, ligji garanton respektimin e çdo qënie njerëzore që në fillim të jetës. Ky parim nuk shkelet, përveç rasteve kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë ligj (12). Ndërprerja e shtatëzënësisë nuk do të konsiderohet në asnjë rast si metodë e planifikim familjar. Gruaja ka të drejtën e informacionit të saktë dhe këshillimit përpara ndërprerjes së shtatëzënësisë (12). Ndërprerja e shtatëzënësisë lejohet vetëm kur vërtetohen rrethana të padëshiruara në këtë ligj dhe në çdo rast me pëlqimin e gruas (12).

Sipas studimeve të kryera, në Evropë, 30% e shtatëzanive përfundojnë në abort (12). Disa vende të Evropës kanë mbajtur qëndrim kundër abortit, një ndër to ka qënë dhe Irlanda. Irlanda e legalizoi abortin në Korrik 2013, nisma u bë e domosdoshme nga rasti i Savita Halappanavar. 31 vjeçarja nga India punonte si dentiste. Ajo u pranua në spital në vitin 2012 në gjendje të rëndë shëndetësore, ku dhe vdiq një javë më vonë. Kërkesa e saj për abort u refuzua. Fillimisht mjekët patën konkluduar se jeta e saj nuk qe në rrezik nga shtatzënia, por në kohën kur jeta e saj u vu në rrezik, qe shumë vonë për abort, humbi jetën në spital, pasi i'u refuzua aborti. Për ta kjo nuk është vetëm çështje fetare pasi argumentojnë se e drejta e foshnjës për jetë është e barabartë me atë të nënës. Të tjerë argumentojnë se ligji është tepër i kufizuar dhe nuk lejon abortin as në rastet e përdhunimit apo incestit, apo në rastet kur vërehet një deformim i

fetusit. Rastet e paraqitura në Gjykatë pasqyrojë gjithnjë shumëllojshmërinë dhe kompleksitetin për situatat që kanë të bëjnë me abortin. Këto raste nuk janë të kufizuara si një kërkesë abstrakte për të patur të drejtën për të abortuat, por përbëjnë çështje të ndryshme të tilla si aborti i të miturave, aborti nga nëna të sëmura, pëlqimi dhe informacione nga njerëz të ndryshëm në fjalë. Një "Babai i mundshëm", u ankua pa sukses për shkak se partneria e tij kishte ndërprerë shtatezanine pa pelqimin e tij, ndërsa një gjyshe potencial i'u drejtua Gjykatëse se vajza e saj nuk mund të realizonte abortin në kushte të duhura.

Një nga vështirësitë kryesore për Gjykatën është për të përcaktuar se si të merren ligjërisht me çështjen e abortit: për të futur praktikën e abortit në praktiken e brendshme të Konventës si dhe jurisprudencën e saj. Në kohën kur u hartua Konventa, aborti u kundërshtua nga shumë shtete, disa shtete si për shembull Irlanda e barazonte abortin me krimin, sepse aborti është konsideruar si një shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtës për jetë të fëmijës të palindur. Vetëm aborti i detyruar në mënyrë për të shpëtuar jetën e nënës ishte e mundur. Pyetja që shtrohet është nëse fëmija i palindur është një "person" brenda kuptimit të nenit 2? Duke i'u referuar praktikës gjyqësore vëmë re se Gjykata nuk jep një përgjigje të prerë për këtë çështje, me qëllim për të lejuar vetë Shtetet për të përcaktuar se kur fillon jeta, dhe për këtë arsye kur fillon mbrojtja ligjore. Kur një shtet miraton ligje pro abortit, nuk duhet në asnjë rast të shkeli detyrimen që vijnë nga Konventa.

Në rastet kur aborti është i ligjshëm, Gjykata ka vendosur të marrë në konsideratë interesat e ligjshme të përfshira për të perligjur abortin. Kur Gjykata përmend "të drejtën e mundësinë për një abort të ligjshme", ajo mund t'i referohet vetëm një "e drejtë", të dhënë nga legjislacioni kombëtar dhe jo nga Konventa. Gjykata tashmë ka percaktuar një sere rastesh për të përcaktuar se kur lejohet aborti, në të gjitha këto raste primare janë:

a. interesi më i lartë dhe të drejtat e nënës;

b. të fëmijës së palindur;

c. të babait;

d. të shoqërisë.

Në lejimin e të drejtës së nënës për abort përmëndet se nëna e ardhshme ka të drejtën e abortit kur kjo e drejtë perligjet, por jo gjithmonë e drejta e nënës për abort është e lejueshme. Në të gjitha ato raste kur nëna ka një vullnet të plotë dhe të lirë nga ana e saj për të kryer aboritn, por që nuk ka një interes të ligjshëm, si për shëmbull: sëmundje etj…Gjykata është shprehur se vetëm vullneti i nënës nuk është një element i mjaftushem për të kryer abortin dhe e perjashton mundësin për t'u mbrojtur nënë Nenin 8 të Konventës. Mungesa e kushteve ekonomike është një nga faktorët kryesor që e con nënë në abort. Nëna ka të drejtën të gëzoj mbrojtje si para dhe pas shtatëzanisë. Shteti ka per detyrim "të marrë hapat e duhura për të siguruar barazinë e të drejtave dhe përgjegjësive të bashkëshortëve si ne martesën, gjatë martesës dhe pas zgjidhjes së saj"(13).

Aborti në lidhje me Nenin 2 të Konventës

Në Nenin 2 të Konventës nuk përcaktohet në mënyrë të qartë se kur është momenti që fillon mbrojtja e të drejtës së jetës. Në preambulënë e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës thuhet se: "fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes" (14). Në çeshtjen për gjykim të *Vo kundër Francës*, Gjykata Europiane e të të Drejtave të Njeriut konfirmoi se momenti kur fillon e drejta për jetë, është një çështje që do të vendoset në nivel kombëtar (15) nga cdo shtet. Aplikantia, një grua franceze me origjinë vietnameze, është detyruar të abortojë, pas një mjek gaboi kur ajo ishte gjashtë muajshe shtatzënë. aplikantia mori pjesë në një kontroll mjekësor të planifikuar gjatë shtatzënisë së saj, ku mjeku ngateroi pacientet për shkak të mbiemrit të njëjtë. Mjeku u dënua për vrasje nga pakujedisa, por Gjykata Franceze e Kasacionit e ktheu çështjen me arsyetimin se fetusi nuk kanë qenë ende një qënie njerëzore, e për këtë motiv nuk ka të drejtë për mbrojtje nga e drejta penale. Nga praktika e Gjykatës Evropiane, shtetet kanë për detyrim në bazë të Nenit 2 të Konventes për të mbrojtur të drejtën e jetës nga veprat e ndryshme penale, por ky nen nuk gjenë zbatim në rastin e fëmijës së palindur.

Në Nenin 1 të Konventës për të drejtat e fëmijës nuk është përcaktuar momenti se kur fillon fëmijëria, kjo gjë u është lënë shteteve në kompetencë të vendosin në bazë të interesave të tyre, për çeshtje që përfshijnë aboritin si dhe planifikimin familjar.

Mbretëria e Bashkuar ka deklaruar se ajo e interpreton Nenin 1 të KDF si të zbatueshme vetëm pasi femija lind. Argjentina, në kontrast

me këtë, ka deklaruar se Neni 1 i KDF duhet të interpretohen se "një fëmijë" (16) do të thotë çdo qenie njerëzore që nga momenti i konceptimit deri në moshën që mbush 18 vjeç. Disa shtete kanë miratuar Deklarata të ndryshme për shkak të rezervave që kanë në këtë pikë. Komiteti i të Drejtave të Femijëve (17) ka sugjeruar në mënyrë të përsëritur se rezervimet për të ruajtur ligjet e shtetit mbi abortin dhe planifikimit familjar janë të panevojshme, sepse KDF këtë çështje e lë në diskrecion të shteteve. Në të njëjtën kohë, Komiteti ka komentuar negativisht për përdorimin e abortit si një metodë për planifikimin familjar, kjo ka inkurajuar shtetet, të tilla si p.sh Rumania për të zvogëluar numrin e lartë të abortit. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave e vitit 1979, në Rekomandimin e përgjithshëm mbi gratë dhe shëndetin u kërkon Shteteve të bëjnë ndryshimet përkatëse në legjislacion që ndalon ushtrimin e të drejtës për abort.

Politikat e ndërmarra nga shtete palë duhet "të kenë perspektivën gjinore në qëndër të të gjitha politikave dhe programeve që ndikojnë në shëndetin e gruas dhe duhet të përfshijnë gratë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe programeve dhe në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për gratë.

Nje çështje e diskutueshme për abortin është se Komiteti KDF, Komitetin për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përcaktojnë se detyrimi i Shteteve për të mbrojtur të drejtën e jetës në bazë të së drejtës penale nuk do të gjejë zbatim për fëmijët e palindur dhe se Shtetet palë janë të lira për të vendosur nëse ato dëshirojnë të ndalojnë abortin, me kusht se nuk duhet te shkelin të drejtat e nënës, të tilla si:

1. e drejtate privatësisë;
2. e barazisë
3. dhe shëndetin riprodhues.

Gjykata nuk e ka interpretuar Nenin 2 në mënyrë që të lejojë një përjashtim të nënkuptuar të të drejtës për jetë në lidhje me jetën para lindjes, por ajo u lë një liriveprimi shteteve në këtë pikë.

Gjatë zbatimit të saj, Konventa duhet të gjejë interpretim në bazë të interesit më të lartë, ajo duhet të sigurojë dhe garantojë një mbrojtje të të drejtave të njeriut, pa perjashtuar këtu të drejtat e fëmijës së palindur. Fëmija i palindur duhet të gezoje mbrojtje për të drejtën e jetës në bazë të Nenit 2 të Konventes, por dhe të drejtën për të mos i'u nënshtruar abortit selektiv. Në vendimin e datës 18 tetor 2011 Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në rastin e *Oliver Brüstle kundër. Greenpeace e.V*, të Dhomës së Madhe, është shprehur për interpretimin e Direktivës 98/44/EC Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike, se embrioni gëzon mbrojtje edhe në fazën e fekondimit, me qëllim respektimin e parimeve themelore për të ruajtur dinjitetin dhe integritetin e personit.

Në Konventë nuk ka në mënyrë të përcaktuar ndonjë nen të veçantë për abortin, kjo e drejtë na vjenë si një e drejtë e derivuar nga interpretimim i Nenit 2 dhe dhe Nenit 8 te Konventës. Mos përcaktimi i kësaj të drejte në mënyrë taksative në Konventë nuk sjellë shmangien nga përgjegjësia në rastin e abortit të paligjshëm si në rastin *Jerzy Tokarczyk kundër Polonisë.* Mjekët nuk mund të kërkojnë një të drejtë të tillë dhe të ankohen për të praktikuar abortin e paligjshëm. Komisioni dhe Gjykata kanë refuzuar aplikimet e sjella nga mjekët që janë shpallur fajtorë për ndihmë që kanë dhënë apo kur kanë praktikuar abortin ilegal.

Aborti, duke qënë një shmangie e të drejtës për jetë, nuk mund të përbëjnë një të drejtë në vetvete; ajo nuk mund të bëhet një e drejtë autonome. Si rrjedhim, fusha e saj është e kufizuar. Disa autor e barazojnë abortin me vrasjen e femijës së palindur.

Një fenomen i cili përbën një problematikë është edhe aborti selektiv, aborti selektiv është praktika e ndërprerjes së shtatzanis të bazuar mbi gjininë e parashikuar të foshnjës. Vetë e drejta e jetës, në të njëtën kohë përbënë si detyrim pozitiv por edhe negative për Shtetin (18). Në lidhje me detyrimin negative Shteti është i detyruar të përcaktoj se në cilat raste mund të cënohet e drejta e jetës. Ndërkohë, duke marrë parasysh detyrimin pozitiv, Shteti gëzon liri për të vendosur në përcaktimin e mjeteve me të cilat jeta e këtyre personave do të mbrohet. Këto detyrime e shtrijnë efektin e tyre dhe në rastin e femijës së palindur.

Aborti në lidhje me Neni 8 të Konventës

Çdo Shtet në bazë të normave të brëndshme dhe intersesave mund të lejoj ose jo abortin. Në qoftë se shteti vendos për të lejuar abortin, mbetet subjekt i detyrimit për të mbrojtur e respektuar të drejtat dhe interesat konkurruese. Prandaj, fakti që një Shtet lejon një shmangie nga një e drejtë nuk do të thotë se heq dorë nga detyrimet që ka në bazë të Konventës. Në rastet e lejimit të abortit, Shteti duhet të përcaktoj ratet e lejimit të

abortit, me qëllim për të shmangur konfliktin e të drejtës së nënës me jetën e fëmijës së pa lindur, por duke mbrojtur dhe të drejtën e bashkëshortit për të qënë një baba potencial. Kur aborti është ligjor, raporti mes abortit për të siguruar jetën dhe shëndetin e nënës dhe të drejtat dhe interesat e tjera konkurruese, ndër të cilat mbrojtja e fëmijës së palindur, bëhet parimi kryesor në rastet e abortit, e përcaktuar kjo nga Gjykata. Në rastin e çështjes *Boso kundër Italis*ë, Gjykata u shpreh se nuk ka shkelje të Nenit 2 të Konventës përsa i përketë të drejtës së jetës së fëmijës së palindur. Aborti në këtë rast është lejuar për të mbrojtur si interest e nënës nga njëra anë dhe mbrojtjen e fetusit nga ana tjetër. Në këtë çështje nuk kemi shkelje të Nenit 8, për cënim të jetës private të babait potencial, por dhe as të Nenit 2 për cënimin e jetës së fëmijës së palindur. Kryerja e abortit nuk duhet të jetë e detyruar. Aborti i detyruar nuk mund të justifikohet në bazë të Konventës dhe kjo është një shkelje e dy të drejtave, të nënës dhe të fëmijës. Sipas Institutit Guttmacher, 75% e grave pësojn abort sepse ato nuk mund të përballojnë një fëmijë; 75% thonë se të lindesh fëmijë do të pengoje në punë, shkollë; dhe 50% thonë se nuk duan të jetë prind i vetëm ose të kenë problem me burrat ose partnerët (19).

Kur vazhdimi i shtatzënisë e vë jetën e nënës në rrezik, balancimi i interesave është i mundur. Për fat të mirë, raste të tilla ndodhin shumë rrallë. Kryerja e abortit për të shpëtuar jetën e nënës, nuk duhet te merret si "e drejtë" ndaj abortit. Ndalimi i abortit nuk është një pengesë për ofrimin e trajtimeve të nevojshme mjekësore që duhet të ndërmerren për të shpëtuar jetën e një gruaje shtatzënë, edhe në qoftë se rezultatet sjellin përfundimin te paparamenduara të shtatzënisë.

Nëna e ardhshme ka të drejtën për të kryer abort, kur shtatëzania rëndon dhe vendos në rrezik jetën e saj. Në çështjen *A, B dhe C kundër Irlandës,* Gjykata u shpreh se:"Neni 8 nuk mund të interpretohet si konfirmim i të drejtës për abort, ndalimi i abortit i kërkuar për arsye të gjendjes shëndetësore apo të mirëqenies, bën pjesë në hapësirën e së drejtës për të respektuar jetën private sikurse sanksionohet në Nenin 8" (20). Tri rezidente në Irlandë, A-ja dhe B-ja me kombësi irlandeze dhe C-ja me kombësi lituaneze udhëtuan për në Angli për të kryer ndërprerje të shtatzënisë, çka ato mendonin se nuk kishin të drejtë ta bënin në Irlandë. Ligji irlandez i ndalon gratë të kryejnë ndërprerje të shtatzënisë me përjashtim të rasteve kur shtatzënia paraqet "një rrezik real dhe substancial për jetën "e nënës dhe nuk lejon abortin për arsye të tjera shëndetësore apo që lidhen më standardin e jetesës. Ligji irlandez i lejon gratë të udhëtojnë në shtete të tjera për të kryer një abort dhe lejon propogandimin e informacionit mbi shërbimet e abortit, që janë ligjërisht të mundshme në shtete të tjera. A-ja ngeli shtatzënë padashur dhe e vetme udhëtoi drejt Anglisë për të kryer abort. A-ja kishte tashmë katër fëmijë të vegjël, të gjithë në kujdestari pasi kishte qenë e alkolizuar. A- ja mendoi se një fëmijë tjetër (duke patur parasysh rrezikun e një depresioni pas lindjes) do të vinte në rrezik shëndetin e saj si dhe ribashkimin e suksesshëm të familjes së saj. B-ja ngeli shtatzënë padashur dhe udhëtoi e vetme drejt Anglisë për të abortuar. B-ja kishte marrë në mëngjes një tabletë kontraceptive për prishje barre, dhe pas një këshillimi që kishte pasur, i kishin thënë se tableta që kishte marrë do të rriste rrezikun për të patur një shtatzëni ektopike (jashtë mitre). Megjithatë, para se të nisej për në Londër asaj i kishin konfirmuar se nuk kishte shtatzëni jashtë-mitre. C-ja e kishte kryer abortin në Angli, pasi mendonte se në Irlandë nuk do t'i jepej e drejta për të abortuar. Për një periudhë tri vjeçare C-ja ishte kuruar me kimio-terapi kundër kancerit dhe mjekët e kishin këshilluar se do të kishte qenë shumë e rrezikshme për fetusin nëse ajo do të kryente kimio-terapi në tremujorin e parë të shtatzënisë. Kanceri ishte shëruar dhe C-ja pa dashje kishte ngelur shtatzënë. C-ja kreu një numër analizash për kancerin gjatë periudhës së shtatzënisë. C-ja kërkoi të ndërpriste barrën por nuk mundi të gjente ndonjë klinikë ku mund ta bënte këtë, pasi C-ja nuk ishte rezidente në Irlandë. A-ja dhe B-ja iu drejtuan GJEDNJ-së me një padi, ku pretendonin se ligji irlandez që pengonte abortin për arsye shëndetësore apo për shkak të standardit të jetesës, shkelte nenet 3, 8, 13 dhe 14 të KEDNJ-së. A-ja dhe B-ja parashtruan se të drejtat kombëtare për abortim ishin tepër të përgjithshme dhe se nëse gjykatat e vendit do të shpreheshin në favor të tyre, ato me sa duket nuk do të mund të urdhëronin qeverinë dhe / ose një mjek për t'u krijuar atyre lehtësi për të kryer një abort në Irlandë, në kohën e duhur. Padia që C-ja i drejtoi GJEDNJ-së lidhej me nenet 2, 3, 8, 13 dhe 14 të KEDNJ-së, sipas të cilave ligji irlandez nuk e pajiste atë me mjetet për të ushtruar të drejtën e saj për një abort të ligjshëm pasi rrezikonte jetën. C-ja deklaroi se nuk ekzistonte asnjë procedurë që mund të ndiqej nga një grua apo nga një mjek për të vendosur se kur duhet të kryhej një abort për të shpëtuar jetën e nënës. C-ja pretendonte se mungesa e procedurave të tilla përbënte "rrethana të veçanta" për ta shfajësuar C-në nga ndonjë detyrim ndaj mungesës së mjeteve juridike në vend.

Aborti është një çështje shëndetësore. Ajo që është e rëndësishme është qasja e grave në një shumëllojshmëri të procedurave mjekësore per te qene te sigurta. Nuk është se aborti shkon larg kur e paligjshme e tij; statistikat në mbarë botën tregojnë këtë (21). Kryerja e abortit ose për çfarëdo çështje në lidhje ma zgjedhjet riprodhuese është më shumë se një çështje e të drejtave individuale, dhe më shumë se një çështje e zgjedhjes individuale. Këto nuk janë opsione që mund të shihen në mënyrë të izoluar nga shoqëria. Këto janë pyetje sociale dhe ato i takojnë të drejtave sociale të cilat janë themelore dhe të nevojshme për gratë që të jenë në gjendje për të marrë vendime për jetën e tyre. Mundësia për abort pa shërbime mjekësore dhe këshillimit të sigurta, të përballueshme dhe të arritshme, është po aq diskriminuese sa për të patur fëmijë pa mbështetje ekonomike dhe të përballueshme, me qellim kujdesin për fëmijët. Kjo do të thotë i pasur mund të përballojë për të zgjedhur dhe të varfërit duhet të kënaqen. E drejta formale duhet të jetë një e drejtë substanciale, e te ushtrohet nga të gjitha gratë. Burimet ekonomike dhe sociale duhet të jenë të garantuara nga shoqëria që të sigurojë qasjen dhe zgjedhje të informuar. Kjo është baza për autonominë e grave në këto çështje (21).

Të gjitha gratë duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë *të drejtën* e abortit pa kualifikimi, faji, falje, rrezik apo sherr. Për aq kohë sa kjo *e drejtë* është vënë në dyshim, duke mbrojtur atë - në rrugë, në parlament, në komunitetet, në sistemin shëndetësor, dhe në diskutim publik – paraqet nje rëndësi të lartë për shëndetin e përgjithshme e grave dhe mirëqenien e tyre.

Babai është i vetimi person i cili mund t'i drejtohet Gjykatës për t'u cilesua si viktimë nga ndërprerja e shtatëzanisë, kur kjo është kryer nga partnerja pa pëlqimin e tij. Në çështjen *Boso kundër Italis*ë (22), Gjykata vlerëson se çdo interpretim i të drejtave të një babai potencial sipas Nenit 8 të Konventës, kur nëna ka për qëllim që të ketë një abort duhet mbi të gjitha të marrë parasysh të drejtat e saj, e duke qënë që jeta e nënës ka qënë në rrezik, aplikimi është rrëzuar si i pa bazuar në bazë të nenit 35/3 të Konventës.

Në çështjen *H kundër Norvegjise (23)*, aborti i bërë nga nëna kur nuk është kryer për arësye shëndetësore, si dhe kundër pelqimit të babait potencial, Komisioni u shpreh se në të tilla raste shtete duhet të marrin masa dhe se foshnja e palindur të gëzojë mbrojtje nga Neni 2 i Konventës. Shtete anëtare në këtë çështje duhet të kënë një hapësirë tolerimi për mënyrën sesi ato e rregullojnë abortin.

Ndërprerja e jetës të fëmijes së palindur a përbën shkelje të të drejtave të njeriut?

Të drejtat e njeriut sigurojnë që qeveritë mos të bëjnë dallim në bazë të gjinisë, racës, gjendjes ekonomike ose karakteristika të tjera në përpjekjet e tyre për të përmirësuar ose të ndikojnë në shëndetin dhe jetën e njerëzve. Aborti është i lidhur me të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit, e drejta e privatësisë, të drejtën për të qenë të lirë nga trajtimit çnjerëzor apo poshtërues e mizor dhe të drejtën për të marrë vendime në lidhje me shëndetin riprodhues dhe jetën, si për të siguruar mbrojtje nga marrëveshjet ndërkombëtare. Mënyra e të kuptuarit drejtë te një gruaje në bazë të të drejtave të njeriut, për të vendosur kur dhe në qoftë se dëshiron të ketë fëmijë ka evoluar dhe ka pesuar rritje gjatë 40 viteve të fundit.

Konventa e vitit 1979 për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), ishte traktati i parë ndërkombëtar i të drejtave te njeriut që përmend në mënyrë eksplicite planifikimin familjar. Në vitin 1999, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ra dakord se, "*ku aborti nuk është kundër ligjit, sistemet shëndetësore duhet ... të sigurojë që aborti i tillë është i sigurt dhe i arritshëm"(24).*

Shërbime e sigurta te abortit janë të nevojshme për të siguruar që gratë mund të arrijnë standarde më të larta të arritshme të shëndetit. Disa traktatet të drejtave të njeriut, përfshijnë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të mbeshtetura në të drejtën për shëndet. Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore garanton të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor, me barazi dhe mos-diskriminim.

Në pothuajse çdo vend, aborti është i ligjshëm në disa rrethana. Por nuk ka ligj aborti apo traktat ndërkombëtar në vetvete qe mund të siguroj që një grua mund të ndërpresë në mënyrë të sigurtë një shtatëzani që është e padëshiruar, të dëmshme për shëndetin e saj ose të rrezikshme për jetën e saj. Shëndeti i këtyre grave, dhe madje edhe jetën e tyre, mund të varet nga aftësia e tyre për të patur perparesi në shërbimet e sigurta të aborteve. Nuk ka traktat që përmban fjalën "abort," dhe as mund të kete një "të drejtë" për abortin që nxirret nga "kuptimit të zakonshëm" i fjalëve të çdo traktai (25).

Konkluzione

Në ditët e sotme aborti është një nga temat më të diskutushme që ka hapur debate të herë pasë hershme. Sot, aborti është i ligjshëm në pothuajse çdo vend evropian edhe pse ka një variacion të gjerë në lidhje me kufizimet në të cilat ajo është lejuar. Praktika që po ndiqet nga shtete është lejimi i abortit deri në muajin e tretë të shtatëzanisë. Dispozita të instrumenteve evropiane për të drejtat e njeriut ofrojnë mbrojtje të fëmijës së palindur duke i'u referuar fazave të zhvillimit të tij. Në rastet kur aborti është i ligjshëm, Gjykata ka vendosur të marrë në konsideratë interesat e ligjshme të përfshira për të perligjur abortin. Gjykata tashmë ka përcaktuar një sërë rastesh për të përcaktuar se kur lejohet aborti, në të gjitha këto raste primare janë: interesi më i lartë dhe të drejtat e nënës; të fëmijës së palindur; të babait; të shoqërisë. Në Konventë nuk ka në mënyrë të përcaktuar ndonjë nen të veçantë për abortin, kjo e drejtë na vjenë si një e drejtë e derivuar nga interpretimim i Nenit 2 dhe dhe Nenit 8 te Konventës. Aborti, duke qënë një shmangie e të drejtës për jetë, nuk mund të përbëjnë një të drejtë në vetvete; ajo nuk mund të bëhet një e drejtë autonome. Si rrjedhim, fusha e saj është e kufizuar.

Vetë e drejta e jetës, në të njëtën kohë përbënë si detyrim pozitiv por edhe negative për Shtetin. Në qoftë se shteti vendos për të lejuar abortin, mbetet subjekt i detyrimit për të mbrojtur e respektuar të drejtat dhe interesat konkurruese. Në rastet e lejimit të abortit, Shteti duhet të përcaktoj ratet e lejimit të abortit, me qëllim për të shmangur konfliktin e të drejtës së nënës me jetën e fëmijës së pa lindur, por duke mbrojtur dhe të drejtën e bashkëshortit për të qënë një baba potencial. Kryerja e abortit nuk duhet të jetë e detyruar. Aborti i detyruar është identifikuar si një krim kundër njerëzimit.

Literatura

1. Halilaj B., "Abortion and Europian Convention of Human Rights", International Conference, Albania Institute of Sociology, ISBN 978-9928-208-99-6

2.http://forumi.shqiperia.com/threads/aborti-meshire-apo-vrasje.28399/

3.http://www.abortion-clinics.eu/abortion-europe/

4. Abortion Act, 17 October 1967, Amended with Human Fertilization and Embryology Act, 24 April 1990.

5. Law on termination of pregnancy on April 3, 1990. Fédération Laïque de Centres de Planning Familial (FLCPF)

6. Penal Code Act, articles 118-121, January 1942, was modified on 23 March 2001 and adopted after 2 June 2002 referendum. The new law (Penal Code Act, articles 118-120) has become effective on 1 October 2002

7. Act N° 50, 13 June 1975, Relating to the Termination of Pregnancy,

Law N° 66, Sec 1-4, 16 June 1978

8.http://www.rivistaeuropae.eu/diritto/diritto-allaborto-italia-condannata-dal-consiglio-deuropa/

9.http://www.infoplease.com/science/health/global-abortion-rates.html

10.Konventa nderkombetare për të Drejtat Civile dhe Politike, 23 Mars 1966, Neni 6/1.

11. Brugermann and Scheuten kundër Republikës Federale Gjermane, Raport i Komisionit, 12 Qershor 1977.

12. Ligji nr.8045, dt 7.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatëzanisë".

13. International Covenant on Civil and Political Rights, Neni 23/4.

14. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 Nëntor 1989.

15. Vo kuder France, [G.C.], no. 53924/00, 8 July 2004, paragrafi 75.

16.Nowak M., A Commentary on the United Nations Convention on the Rights of the Child, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden • Boston 2005, fq. 28.

17.http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Pages/CRCIndex.aspx

18. H. kundër. Norvegjisë

19.http://www.guttmacher.org/pubs/fb_induced_abortion.html

20. A, B dhe C kundër Irlandës, Vendimi i GJEDNJ-së (Dhomës së Lartë) , 16 Dhjetor 2010

21. Holt C., Hinman P., Abortion: A woman's right to choose — The case for law repeal, Resistance Books, 23 Abercrombie St, Chippendale NSW 2008, fq. 6.

22. Boso kundër Italisë, 5 Shtator 2002.

23. H kundër Norvegjisë, 19 Maj 1992

24. www.NYR_HR_Abortion.org

25. A. Tozzi P., J.D., International Lawand the Right to Abortion, Catholic Family and Human Rights Institute, 2010, fq. 5.

SHKENCAT MJEKËSORE DHE SHËNDETËSORE

Mental health kills COVID-19 patients; a wake-up call from Albania

Majlinda Zahaj[4], Aurela Saliaj[2], Krenar Malaj[3], Denada Selfo[4], Jorgjia Bucaj[2] ,Enkeleint A. Mechili[1,2]

[1] Clinic of Social and Family Medicine, School of Medicine, University of Crete, Crete, Greece
[2] Department of Healthcare, Faculty of Health, University of Vlora, Vlora, Albania
[3] Research Center of Public Health, Faculty of Health, University of Vlora, Vlora, Albania
[4] Department of Nursing, Faculty of Health, University of Vlora, Vlora, Albania

Para pandemisë globale, jeta për këtë brez zakonisht përbëhej nga ore të kaluara me detyrat e shtëpisë, shqetësime të pafundme për notat, aktivitete sportive e kulturore si dhe fundjava të mbushura me detyrime familjare. Tani, ndërsa vazhdojmë të përballemi me krizën shëndetësore COVID-19, shumica e këtyre faktorëve të stresit janë sërish prezentë së bashku me frikën për sigurinë e jetës , stabilitetin dhe të panjohurën.[1]

Përhapja e COVID-19 ka paralizuar të gjithë botën. Për të gjithë , jo vetëm për adoleshentët, masat kufizuese të ndërmarra të shëndetit publik si distancimi social dhe mbyllja e institucioneve arsimore kanë qenë një nga sfidat më të vështira të paraqitura nga shpërthimi i COVID-19. Duke qenë se adoleshentët janë veçanërisht të prekshëm ndaj problemeve të shëndetit mendor, është e mundur që këto ndryshime drastike në jetën e përditshme të tyre gjatë COVID-19 mund të kenë efekte të dëmshme në funksionimin psikosocial të adoleshentëve. [1, 2]

Edhe pse shumë adoleshentë arrijnë ta menaxhojnë me sukses kalimin në moshën e rritur adoleshenca zakonisht konsiderohet si një periudhë ku rreziku për probleme psikosociale dhe çrregullime psikiatrike është i lartë. [3] Përjetimi i periudhave të krizës gjatë një periudhe kaq të rëndësishme zhvillimore të jetës mund të sjellë probleme në funksionimin e tyre psikosocial, gjë e cila, nga ana tjetër, mund të jetë e dëmshme për zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Në të vërtetë, masa paraprake të ndërmarra për shkak të pandemisë duket se prekin adoleshentët në mënyra të ndryshme.

Megjithëse këto masa paraprake vlerësohen të nevojshme, studiuesit shqetësohen se shkollimi në distancë, [4] së bashku me distancën sociale , [5] mund të ketë ndikime negative në funksionimin psikosocial të adoleshentëve. Specifikisht adoleshentët në gjimnaze kanë manifestuar një sërë shqetësimesh sesi do të jetë e ardhmja e tyre për shkak të largësisë nga bankat e shkollës dhe nga bashkëmoshatarët. [6].

Studime të tjera kanë treguar se mbylljet e shkollave mund të lidhen me uljen e aktivitetit fizik, probleme me gjumin , dieta ushqimore më pak të shëndetshme dhe rritjen e kohës në televizor, celular , faktorë që mund të çojnë shpesh në probleme të shëndetit mendor, përfshirë depresionin. Studiuesit gjithashtu shqetësohen se pandemia mund të çojë gjithashtu në rritje të përfshirjes në sjellje të rrezikshme, të tilla si përdorimi i substancave narkotike , si dhe në rritjen e viktimave të bullizmit kibernetik.

Adoleshenca konsiderohet si një nga periudhat më kritike të zhvillimit në jetën njerëzore. Gjatë kësaj periudhe të jetës , adoleshentët përpiqen të kenë autonomi nga prindërit dhe kërkojnë të kalojnë më shumë kohë me miqtë, prandaj shoqërimi me bashkëmoshatarët dhe përfshirja në aktivitete sociale është thelbësore për zhvillimin e tyre psikosocial. [7,8]

Një ndryshim i papritur i rutinës së tyre, gjatë së cilës adoleshentët janë të detyruar të kalojnë më shumë kohë me familjen dhe më pak kohë me bashkëmoshatarët, mund të ketë rezultate pozitive dhe negative në lidhje me funksionimin psikosocial të tyre.

Për shembull, qëndrimi në shtëpi mund të krijojë më shumë mundësi për të bërë gjëra argëtuese dhe të këndshme me familjen, të cilat mund të rezultojnë në marrëdhënie më të mira prind-fëmijë. Për më tepër, prindërit mund të kenë një mundësi më të mirë për të monitoruar fëmijët e tyre, gjë që mund të zvogëlojë rrezikun që fëmijët të përfshihen në veprimtari të dëmshme siç është përdorimi i substancave narkotike , veprimtari e cila zakonisht rritet gjatë adoleshencës.

Por nga ana tjetër shpenzimi i më tepër orëve në shtëpi me familjen mund të çojë gjithashtu në më shumë konflikte midis të rinjve dhe prindërve të tyre dhe në masa më të ashpra disiplinore dhe kontroll nga prindërit, të cilat mund të kenë një efekt negativ në funksionimin psikosocial të adoleshentëve. [9]

Qëllimi

Qëllimi i shqyrtimit të kësaj literature është të eksploroj dhe të vlerësoj ndikimin negativ të

pandemisë covid-19 në mirëqënien psikologjike të adoleshentëve.

Metodologjia

Ky rishikim i literaturës u krye bazuar në një studim të rregullt elektronik sistematik, i cili përfshin botime aktuale të realizuara gjatë periudhës së pandemisë.

U kërkuan artikuj me tekst të plotë.

Hulumtimi u krye në përputhje me udhëzimet e rishikimit sistematik të literaturës.

7 studime janë përmbledhur për shkak të ngjashmërisë në disa kritere.

Kriteret e përfshirjes dhe përjashtimit	
Kriteret e Përfshirjes	Kriteret e Përjashtimit
Studime sasiore, cilësore, ndërthurje të metodave	Jo në anglisht
Punime të vlerësuara nga kolegët	Studime që përfshinin vetëm adoleshent 18 vjeç ose më të rritur
Studime të lidhura me COVID-19	Studime që nuk raportonin moshën
Çrregullimet mendore	

Rezultatet

Studimet e përfshira në rishikimin e literaturës janë përmbledhur në Tabelën 1

Autori i pare Viti	Metodologjia	Konkluzione
Shweta Singh.,et al.(2020) [10]	Një shqyrtim i artikujve dhe këshilla mbi ato aspekte të shëndetit mendor të adoleshentëve që duhet patur parasysh gjatë pandesimisë Covid-19	Ekziston një nevojë për të përmirësuar aksesin e fëmijëve dhe adoleshentëve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor për të përballuar në mënyrë të shëndetshmë krizën aktuale.
Gilbert Sterling Octavius.,et al.(2020) [11]	Shqyrtim literature, një kërkim sistematik Cochrane, Google Scholar, Scielo dhe	Covid-19 ka ndikime dhe në mirëqënien psikologjike të adoleshentëve prandaj menaxhimi i kësaj krize duhet të fokusohet edhe në

	PubMed. Kriteret e përfshirjes përfshinin të gjitha llojet e studimeve të cilat vëzhguan ndikimin e COVID-19 ,shkaqet e lidhura me të, nëshëndetin mendor të adoleshentëve.	këtë drejtim.
World Vision Albania. (May, 2020) [12]	Metodologjia e vlerësimit ka një qasje eksploruese që përfshinte mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike në lidhje me familjet shqiptare gjatë periudhës së karantinës . Të dhënat u mblodhën përmes metodës së intervistës telefonike nga 28 Prill deri më 8 Maj 2020. Sondazhi mblodhi të dhëna kryesisht sasiore, duke mos i kufizuar pjesëmarrësit për të shprehur mendimet e tyre përtej opsioneve të paracaktuara në pyetje	Përveç efekteve në aspektin ekonomik, karantina ka pasur një efekt në jetën familjare. Edhe pse prindërit po kalonin më shumë kohë në shtëpi, rezultatet treguan se praktikat e shëndetshme të prindërimit përdoren shpesh vetëm në gjysmën e familjeve në këtë studim gjatë karantinës. Prezenca e dhunës është raportuar nga pjesëmarrësit, me 48.6% të tyre që raportuan praninë e abuzimit verbal dhe 19.9% raportuan pranine e abuzimit fizik. Studimet e mëparshme mbi pandeminë kanë sjellë në vëmendje efektet si abuzimi emocional, verbal dhe fizik brenda familjes (Peterman, et al., 2020). Krahasimi me të dhënat e dy viteve të fundit tregoi një rritje të abuzimit verbal brenda familjes, dhe rënie të praktikave pozitive të prindërimit. Efektet e tjera të vëzhguara ishin përvoja e ankthit gjatë karantinës. Rreth 35% e pjesëmarrësve raportuan simptoma të nivelit të lartë të ankthit. OBSH (2020) dhe studime të tjera të kryera gjatë atyre muajve përshkruajnë shëndetin mendor dhe pasojat psikosociale të pandemisë. Gratë dhe banorët në zonat jo-urbane po përjetonin një nivel më të lartë ankthi. Rezultatet treguan se nivelet e larta të simptomave të ankthit shoqëroheshin me praktika negative të prindërimit që përfshinin praninë e abuzimit psikologjik në familje. Për më tepër, gjendja e papunësisë dhe pasiguria ekonomike ishin të lidhura me një nivel më të lartë ankthi.
Yolande Piganiani .,et al.(9 November , 2020) [13]	Një studim sasior, adoleshentët italianë të moshës 15-21 vjeç plotësuan një pyetësor në internet i përbërë nga 33 pyetje që hulumtonin karakteristikat socio-demografike, sjelljet e stilit të jetës, strategjitë e përballimit dhe mirëqenien psikologjike.	Si personaliteti i një të riu por edhe faktorët mjedisorë dhe duhet të merren parasysh për parandalimin dhe ndërhyrjen e hershme në shëndetin mendor të tyre.

Finiki Nearchou.'et al(16November 2020) [14]	Ky hulumtim synonte të siguronte një rishikim sistematik literature mbi ndikimin e pandemisë COVID-19 në shëndetin mendor të të rinjve.	Gjetjet tregojnë se COVID-19 ka një ndikim në shëndetin mendor të të rinjve dhe është veçanërisht i lidhur me depresionin dhe ankthin në grupet e adoleshencës. Vlerësimi i cilësisë tregoi që të gjitha studimet ishin me cilësi të ulët ose të moderuar metodologjike Pandemia COVID-19 po prek jetën e të rinjve, dhe kështu gjenerimi i provave të pakontestueshme kërkimore është thelbësore për të ndikuar vendimet e politikave.
Sabina Kapetanovic.,et al.(15 January 2021) [15]	Një studim sasior, analiza përshkruese u kryen për të treguar frekuencat e mendimeve dhe sjelljeve të adoleshentëve rreth situatës COVID-19 si dhe ndryshimet në funksionimin e tyre psikosocial.	Rezultatet treguan se (a) shumica e adoleshentëve kanë qenë në përputhje me rregullat e vendosura të qeverisë; (b) megjithëse shumica e adoleshentëve nuk raportuan ndryshime në funksionimin e tyre psikosocial një numër kritik raportoi përdorim të substancave narkotike , konflikte me prindërit, më pak kohë të kaluar me moshatarët dhe kontroll më të dobët mbi jetën e tyre të përditshme; dhe (c) shëndet më të dobët mendor, gjatë shpërthimit të COVID-19. Vajzat për shkak të shkollimit në distance kishin të ngjarë të raportonin ndryshime negative në funksionimin e tyre psikosocial gjatë shpërthimit të COVID-19.
Ulrike Ravens-Sieberer.,et al.(16 January 2021) [16]	Studim sasior, për të hetuar ndikimin e pandemisë COVID-19 në cilësinë e jetës dhe shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve në Gjermani nga këndvështrimi i vetë fëmijëve.	Dy të tretat e fëmijëve dhe adoleshentëve raportuan se ishin shumë të ngarkuar nga pandemia e COVID-19. Ata përjetuan ndjeshëm HRQoL më të ulët (40.2% kundrejt 15.3%), më shumë probleme të shëndetit mendor (17.8% vs 9.9%) dhe nivele më të larta ankthi (24.1% vs 14.9%) sesa para pandemisë. Fëmijët me status të ulët socio-ekonomik, emigrant u prekën më shumë. Strategjitë e promovimit dhe parandalimit të shëndetit duhet të zbatohen për të ruajtur shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, për të përmirësuar HRQoL e tyre dhe për të zbutur barrën e shkaktuar nga COVID-19, veçanërisht për fëmijët që janë më në rrezik.

Tabela 1

Diskutime

Adoleshenca përfaqëson një periudhë kritike me ndryshime të shpejta fizike, sociale, kognitive dhe emocionale, me pasoja të rëndësishme në shëndetin dhe mirëqenien psikologjike të të rinjve në të ardhmen .

COVID-19 është zbuluar se shoqërohet me ndryshime të shëndetit mendor të adoleshentëve, veçanërisht frika nga COVID-19 u provua të krijonte gjendje të pafavorshme të shëndetit mendor duke shfaqur çrregullime të tilla si ankthi dhe depresioni.

Adoleshentët që kishin përjetuar trauma të mëparshme me shtimin e izolimit shoqëror / karantinës dhe vetmisë ishin më të prirur drejt ankthit dhe depresionit gjatë dhe madje edhe pas përfundimit të izolimit të detyruar.

Fëmijët gjithashtu mund të shprehin stresin e tyre përmes ankesave psikosomatike, të cilat u rritën gjatë pandemisë në krahasim me më parë, gjë e cila duhet ti bëjë prindërit dhe mjekët vigjilentë që ti marrin parasysh fëmijët kur ankohen për simptomat trupore.

Fëmijët dhe adoleshentët me status të ulët socio-ekonomik, me prindër me arsim të ulët dhe me statusin e emigrantit janë veçanërisht më të prekur nga efektet e pandemisë COVID-19. [16]

Femrat për shkak të shkollimit në distancë (mësim online) kishin të ngjarë të raportonin ndryshime negative në funksionimin e tyre psikosocial gjatë shpërthimit të Covid-19.

Në një studim u raportua gjithashtu se femrat kishin më shumë të ngjarë të raportonin nivele më të larta depresioni dhe ankthi. [14]

Studimet tregojnë se shëndeti mendor dhe stresi i prindërve dhe fëmijëve janë të ndërthurura ngushtë.

Në kohë vështirësish, është treguar se shëndeti mendor përkeqësohet dhe agresiviteti rritet. Studimet tona tregojnë një përkeqësim të klimës familjare, dhe konflikte më të përshkallëzuara në shtëpi gjatë pandemisë. [12,16]

Gjithashtu në studimet tona u gjetën disa faktorë mbrojtës për të ndihmuar adoleshentët të qëndrojnë larg çdo ndikimi negativ të shëndetit mendor për shkak të COVID-19. Sigurimi i mbështetjes psikologjike , informacioni i duhur dhe i saktë nga burime të besueshme në lidhje me COVID-19, dhe motivimi i mirë për t'iu bindur distancimit social ka treguar se ulin gjasat e ndryshimeve negative të shëndetit mendor te adoleshentët.

Konkluzione

Bazuar në këtë përmbledhje të literaturës, ne sugjerojmë që shoqëria duhet t'i kushtojë vëmendje të madhe ndryshimeve në funksionimin psikosocial të adoleshentëve gjatë periudhave të krizës siç është pandemia Covid-19.

Ekziston një nevojë e ngutshme për planifikimin e studimeve longitudinale , dhe zbatimin e një plani veprues për të përmbushur nevojat psiko-sociale të fëmijëve dhe adoleshentëve gjatë pandemisë, si dhe pas saj.

Ekziston një nevojë për të përmirësuar aksesin e fëmijëve dhe adoleshentëve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor për të përballuar në mënyrë të shëndetshmë krizën aktuale. Për këtë arsye psikologë, pediatër , psikiatër duhet të bashkëpunojmë për tu ofruar një shërbim sa më cilësor fëmijëve.

Referenca

1. *Paus, T.; Keshavan, M.; Giedd, J.N. Why do many psychiatric disorders emerge during adolescence? Nat. Rev. Neurosci. 2008, 9, 947–957.*

2. *Kipping, R.R.; Campbell, R.M.; MacArthur, G.J.; Gunnell, D.J.; Hickman, M. Multiple risk behaviour in adolescence. J. Public Health 2012, 34, 1–2*

3. *Guessoum, S.B.; Lachal, J.; Radjack, R.; Carretier, E.; Minassian, S.; Benoit, L.; Moro, M.R. Adolescent psychiatric disorders during the covid-19 pandemic and lockdown. Psychiatry Res. 2020, 291, 113264.*

4. *Lee, J. Reflections feature mental health effects of school closures during COVID-19. Lancet Child. Adolesc. Health 2020, 4, 421.*

5. *Liu, J.J.; Bao, Y.; Huang, X.; Shi, J.; Lu, L. Mental health considerations for children quarantined because of covid-19. Lancet Child. Adolesc. Health 2020, 4, 347–349.*

6. *Ellis, W.E.; Dumas, T.M.; Forbes, L.M. Physically isolated but socially connected: Psychological adjustment and stress among adolescents during the initial COVID-19 crisis. Can. J. Behav. Sci. 2020, 52, 177–187.*

7. *Brooks, S.K.; Webster, R.K.; Smith, L.E.; Woodland, L.; Wessely, S.; Greenberg, N.; Rubin, G.J. The psychological impact of quarantine and how to reduce it: Rapid review of the evidence. Lancet 2020, 395, 912–920.*

8. *Wang, G.; Zhang, Y.; Zhao, J.; Zhang, J.; Jiang, F. Mitigate the effects of home confinement on children during the COVID-19 outbreak. Lancet 2020, 395, 945–947.*

9. *Keles, B.; McCrae, N.; Grealish, A. A systematic review: The influence of social media on depression, anxiety and psychological distress in adolescents. Int. J. Adolesc. Youth 2020, 25, 79–93.*

10. *Singh Sh , Roy D, Sinha K , Parveen Sh , Sharma G ,Joshi G. Impact of COVID-19 and lockdown on mental health of children and adolescents: A narrative review with recommendations (2020).*

11. *Octavius G, Silviani F , Lesmandjaja A , Juliansen A. Impact of COVID-19 on adolescents' mental health: a systematic review(2020).*

12. *World Vision Albania. Impact assessment of the COVID-19 outbreak on wellbeing of children and families in Albania, May (2020).*

13. *Pigaiani Y , Zoccante L , Zocca A , Arzenton A , Menegolli M , Fadel S , Ruggeri M, Colizzi M. Adolescent Lifestyle Behaviors, Coping Strategies and Subjective Wellbeing during the COVID-19 Pandemic: An Online Student Survey (2020).*

14. *Nearchou F, Flinn C , Niland R, Subramaniam Sh, Hennessy E. Exploring the Impact of COVID-19 on Mental Health Outcomes in Children and Adolescents: A Systematic Review, 16 November (2020).*

15. *Capetanovis S, Gurdal S, Ander B, Sorbing E. Reported Changes in Adolescent Psychosocial Functioning during the COVID-19 Outbreak, 15 January (2021).*

16. *Sieberer U, Kaman A, Erhart M, Devine J, Schlack R, Otto Ch. Impact of the COVID-19 pandemic on quality of life and mental health in children and adolescents in Germany, 16 January(2021).*

Roli i Infermierit në vaksinimin kundër gripit - Zbatime të rëndësishme në praktikën klinike

Jerina Jaho
Haxhire Çuçaj
Denada Kreshpaj
jerina.celaj@univlora.edu.al

Abstrakt

Hyrje

Gripi është një çështje e rëndësishme e shëndetit publik dhe sjell një kosto të konsiderueshme për të gjitha shtetet në botë, qofshin këto kosto në shëndet, në aspektin social e atë financiar. Roli i infermierit në skuadrën kundër influenzës fillon me njohuritë e tij të mirëpërforcuara rreth influenzës dhe vaksinimit, po ashtu edhe me ndërhyrjet konkrete në promovimin e vaksinës në popullatë.

Qëllimi

Rishikimi i literaturës kishte si qëllim evidentimin e rolit të infermierëve lidhur me mënyrat se si ata mund të reduktojnë barrën e influenzës për sistemin shëndetësor.

Metodologjia

Ky studim u realizua bazuar në një hulumtim sistematik të literaturës. Kërkimi online përfshiu faqe të tilla të botimeve shkencore si PubMed, Cochrane dhe Hinary. U kërkuan artikuj të formatit "full text". Gjatë kërkimit online të artikujve përkatës, u morën në konsideratë udhëzimet e rishikimit sistematik të literaturës.

Rezultatet

78 artikuj u identifikuan pasi u vendosën fjalët kyçe përkatëse, por vetëm 13 prej tyre u përfshinë në analizën e artikullit. Strategjitë e ndërgjegjësimit për vaksinimin ishin në shumicën e artikujve qëllimi i studimit dhe synonin të promovonin vaksinimin në popullatë bazuar në strategji të provuara mirë.

Konkluzione

Në rast se infermierët marrin pjesë në trajnime dhe sesione informative rreth gripit, edhe niveli i vaksinimit tek ata vetë, por edhe puna që ata bëjnë në drejtim të ndërgjegjësimit të popullatës, do të jetë më efektive.

Fjalë kyç: *vaksina e gripit, roli i infermierit, ndërgjegjësimi mbi vaksinën e gripit, barrierat e vaksinimit, grupe në risk.*

Abstract

Introduction

Influenza is an important issue of public health and brings a significant cost to all countries in the world, be they health costs, socially or financially. The role of the nurse in the anti-influenza team begins with his well-reinforced knowledge about influenza and vaccination, as well as concrete interventions in promoting the vaccine in the population.

Purpose of the study

The literature review aimed to highlight the role of nurses in ways they can reduce the burden of influencing the health system.

Methodology

This study was conducted based on a systematic research of the literature. Online search included sites of scientific publications such as PubMed, Cochrane and Hinary. Full text articles were requested. When searching for relevant articles online, guidelines for systematic literature review were considered.

Results

78 articles were identified after the relevant keywords were placed, but only 13 of them

were included in the article analysis. Vaccination awareness raising strategies were in most of the articles the aim of the study and tended to promote vaccination in the population based on well-proven strategies.

Conclusions

If nurses participate in trainings and information sessions about the flu, the level of vaccination themselves, but also the work they do in terms of raising public awareness, will be more effective.

Key words: *influenza vaccine, nurse role, influenza vaccine aëareness, vaccination barriers, groups at risk.*

Hyrja

Gripi (Influenza) është një sëmundje respiratore shumë kontagioze që shfaqet në epidemitë sezonale dhe manifestohet si një sëmundje akute febrile me shkallë të ndryshueshme të simptomave sistemike. Gripi shkakton humbje të konsiderueshme të ditëve të punës, vuajtje njerëzore dhe vdekshmëri. Mënyra më e mirë për të parandaluar gripin është duke marrë një vaksinë kundër gripit çdo vit [1].

Viruset e gripit vazhdimisht pësojnë mutacione dhe ndryshime. Kur një virus i ndryshuar hyn në organizëm antitrupat e vjetër që ka krijuar trupi si rezultat i përgjigjes së sistemit imunitar të organizmit, do të njohin plotësisht virusete reja që kanë pësuar mutacion dhe veprojnë kundër tyre. Kështu që një person mund të sëmuret nga gripi disa herë. Megjithatë, antitrupat e vjetër mundësojnë vetëm mbrojtje të pjesshme dhe të shkurtër nga ri-infektimi nga gripi. Monitorimi i vazhdueshëm i ndryshimeve në viruset qarkullues është i rëndësishëm për ruajtjen e efikasitetit të vaksinave të gripit në luftën kundër sëmundjeve, prandajçdo vit përgatitet lloj i ri i vaksinës e cila përmban lloje të tipeve të virusit që priten të shkaktojnë epidemi gjatë atij viti [2].

Sipas CDC, nga 1 tetori 2019 deri në 4 prill 2020 u shënuan 39 milionë-56 milionë të sëmurë me grip, 18 milionë deri në 26 milionë vizita mjekësore për gripin, 410 mijë deri në 740 mijë hospitalizime për shkak të gripit dhe 24 mijë deri në 62 mijë vdekje. Kishte 179 vdekje pediatrike të shoqëruara nga gripi gjatë këtij sezoni të kaluar. Krahasimisht, sezonet e gripit 2016-17, 2017-18 dhe 2018-19 ishin përgjegjëse për 110, 188 dhe 144 vdekje të gripit pediatrik, përkatësisht. Raportet e laboratorit të shëndetit publik tregojnë se virusi i gripit A (H3) ishte i spikatur në të gjitha grupmoshat, përfshirë pacientët e moshës 0-4 vjeç, 5-24 vjeç, 25-64 vjeç dhe 65 vjeç ose më të vjetër. Për sezonin 2019-2020 piku në kontinentin Europian u arrit në javën 05 ku pozitiviteti i mostrave arriti ne 55%. Në javën 09/2020 8 vende raportuan intensitet bazal të gripit, 15 vende raportuan intensitet të ulët, 14 vende intensitet mesatar dhe 7 vende intensitet të lartë. Në lidhje me përhapjen gjeografike 3 vende nuk raportuan aktivitet, 5 vende raportuan përhapje sporadike, 2 vende përhapje lokale, 6 vende përhapje rajonale dhe 27 vende aktivitet të përhapur. Që nga fillimi i sezonit mbizotëruan viruset e tipit A (65%) krahasuar me viruset e tipit B (35%). Nga nëntipizimi i viruseve të tipit A, (60%) ishin A(H1N1) pdm09 dhe (40%) ishin A (H3N2). Nga genotipizimi i viruseve të tipit B, te gjithë ishin të linjës B / Victoria. Sa i përket vendit tonë, sipas të dhënave të ISHP-së, në javën e 09 të vitit 2020 vërehet një prirje në rënie e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme dhe ky numër është 25% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.Prej javës 43 (21-27 Tetor 2019) deri në javën 09 (24 Shkurt – 1 Mars 2020) janë grumbulluar 1135 mostra nazofaringeale nga qendrat e survejancës dhe nga testimi i tyre në 438 (8.6%) mostra janë identifikuar viruset e gripit, nga të cilat: 226 (19.9%) virusi i tipit A dhe 212 (18.7%) virusi i tipit B. Lidhur me vaksinimin nga 80 mijë vaksina në dispozicion gjatë këtij sezoni të gripit, u aplikuan pothuaj 99,9 % e tyre (79.906), ku 51.7% e atyre që ju administrua vaksina ishin me sëmundje kardiovaskulare, 17.3% me diabet, 7.5% me astmë bronkiale etj. Po ashtu, mbulesa vaksinale në total tek personeli shëndetësor mjekësor dhe jo mjekësor në qendrat shëndetësore është rreth 80%, ndërsa mbulesa vaksinale në total tek personeli shëndetësor mjekësor dhe jo mjekësor në spitale është rreth 46%. Në total mbulesa vaksinale në spitale për personelin shëndetësor mjek është rreth 40% ndërsa për atë infermier është 53%. Deri vonë, OBSH vlerësonte se barra vjetore e vdekshmërisë së gripit ishte 250 mijë deri 500 mijë vdekje të shkaqeve globale; megjithatë, një studim i vitit 2017 tregoi një ngarkesë vdekshmërie dukshëm më të lartë, në 290 mijë-650 mijë vdekje të lidhurame gripin vetëm nga shkaqe të frymëmarrjes dhe një studim i vitit 2019 vlerësoi 99 mijë-200 mijë vdekje nga infeksione të traktit të poshtëm të frymëmarrjes të shkaktuara drejtpërdrejt nga gripi. Duhen marrë në konsideratë vlerësimet globale dhe rajonale të barrës së vdekshmërisë nga gripi dhe të

hulumtohen tendencat e vdekshmërisë me kalimin e kohës dhe gjeografisë [3].

Infermieri ka një rol tërëndësishëm në ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e vaksinës kundër gripit. Fillimisht, infermieri duhet të jetë i mirëinformuar rreth vaksinës së gripit në mënyrë që informacioni që ai do shpërndajë në popullatët jetë i saktë, i qartë dhe i kuptueshëm nga të gjithë. Infermierët mund të bëjnë takime të vogla në kopshte, shkolla, gjimnaze, universitete, vende pune të ndryshme për të folur mbi vaksinën e gripit.

Në klinikat shëndetësore duhet të ketë broshura që flasin për rritjen e aksesit të vaksinave.

Infermieri duhet të flas rrjedhshëm, të japë siguri tek pacienti dhe ta bëjë të ndihet mire për çdo diskutim që ata kanë.

Nga hulumtime të mëparshme është treguar se nëse njerëzit informohen me tepër për pasojat nga mos vaksinimi, do të kenë më pak mundësi për ta neglizhuar pasi kanë frikë për atë çfarë mund t'iu ndodh.

Në vende me të zhvilluara, klinikat shëndetësore dhe infermierët nisin email-e të posaçme ku në të shkruhet informacioni që duhet të dinë rreth vaksinës, kohës së kryerjes së vaksinës si dhe shoqërohet me një hartë të klinikave që ndodhen afër vendit të tyre të shtëpise apo punës. Në këtë mënyrë ata nuk do të harrojnë për ta bërë vaksinën.

Sipas nje studimi, sigurimi i një harte të klinikave që ndodheshin afër njerëzve rriti probabilitetin e kryerjes së vaksinimit në përgjithësi me rreth 2% duke rezultuar në rreth 600 vaksina shtesëb [4]. Pjesa më e madhe e njerëzve neglizhojnë vaksinën për shkak të çmimit financiar që ka vaksina, por infermieri i informon se kostot më të mëdha janë në situatë kur ata sëmurëen me grip dhe tanimë duhet të mjekohen. Po ashtu ka vende të cilat u japin individëve kupona që ata merrnin çdo vit nga fondi i tyre kombëtar i sigurimeve shëndetësore për të marrë vaksinën falas, kështu ata motivohen për ta bërë vaksinën. Kujdes iveçantë tregohet dhe të personat që janë në punë, infermieri u bën me dije gjithë kostot që do të kenë nëse ata preken nga virusi dhe do ju duhet të shkëputen nga puna duke sjellë dëme në ekonominë e tyre. Por më kryesorja e këtyre personave është se do të jenë të pafuqishem dhe jo produktive për një kohë të gjatë kështu do të kenë nje pauzë në karrierën e tyre. Pjesa më e madhe e njerëzve kanë frikë, janë të shqetësuar dhe kanë emocione të tjera në lidhje me kryerjen e vaksinës. Por këtu luan rol infermieri duke i informuar dhe u treguar fakte se kryerja e vaksinës sjell vetëm të mira siç është parandalimi i virusit dhe asnjë efekt tjetër anësor. Besimet e shpeshta të gabuara të pacientëve dhe bindjet shëndetësore kompensuese në lidhje me vaksinën e gripit janë arsyeja kryesore pse profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të bëjnë një edukim më të mirë shëndetësor për pacientët, duhet të trajnohen më mirë për ta siguruar atë [4].

Metodologjia, qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i rishkimit të literaturës, lidhet me rolin që ka infermieri në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të popullatës sa i përket vaksinimit kundër gripit. Ndërhyrjet e infermierit në praktikën klinike, gjatë vaksinimit të gripit, janë mjaft të rëndësishme dhe rrisin nivelin e mbulimit vaksinal për të gjitha kategoritë e populatës, jo vetëm për ato në risk.

Objektivi i përgjithshëm

Evidentimi i rolit të infermierit, si pjesë e rëndësishme e kujdesit shëndetësor, në informimin mbi rëndësine e kryerjes së vaksinës kundër gripit.

Objektivat specifikë

- Të njihet mirë sëmundja e influenzës me gjithë karakteristikat e saj, si një sëmundje në dinamikë.
- Të realizohet çdo vit informimi i stafit shëndetësor dhe trajnimi i tyre lidhur me karakterin e gripit qarkullues në një sezon të caktuar.
- Të njihet infermieri me barrierat që hasen gjatë vaksinimit të gripit dhe të zotërohen metodat efektive, për shmangien e këtyre barrierave.
- Të përgatitet infermieri për të shtrirë punën e tij mbi ndërgjegjësimin rreth vaksinimit, jo vetëm në institucionet e kujdesit shëndetësor, por edhe më gjerë në komunitet.

Ky studim u realizua bazuar në një hulumtim sistematik të literaturës, lidhur me rolin e infermierit në vaksinimin kundër gripit. Kërkimi online përfshiu faqe të tilla të botimeve shkencore si PubMed, Cochrane dhe Hinary. U kërkuan artikuj të formatit "full text" dhe jo kapituj librash apo paragrafe prej tyre. Artikujt e përzgjedhur ishin vetëm në gjuhën angleze. U përdorën disa fjalë kyçe:vaksina e gripit, roli i infermierit, ndërgjegjësimi mbi vaksinën e gripit, barrierat e vaksinimit, grupe në risk.Gjatë

kërkimit online të artikujve përkatës, u morën në konsideratë udhëzimet e rishikimit sistematik të literaturës [5].

Kërkimi sistematik online, konkludoi në një numër të konsiderueshëm artikujsh që kishin ngjashmëri me tematikën e interest. U evidentuan 78 artikuj pasi u vendosën fjalët kyçe përkatëse, por vetëm 13 prej tyre u përfshinë në rishqyrtim dhe u vlerësuan duke përdorur kriteret e cilësisë [50]. Studimet e përfshira në rishikim u kategorizuan sipas autorit të parë, titullit të artikullit, vitit të botimit, metodologjisë së përdorur, qëllimit dhe rezultatit të studimit. Artikujt e përfshirë në këtë rishikim literature i përkasin viteve 2010-2020. Renditja u bë në mënyrë rastësore.

Në analizën e rishikimit të literaturës u përfshinë 13 artikuj, të cilët u organizuan sipas kategorizimeve më poshtë në Tabelën 1:

Tabela 1: Kategorizimi i artikujve në rishikimin e literaturës

Autori, viti, Titulli	Metodologjia	Qëllimi	Rezultatet
1.Sarah Smith et. al., 2016 **Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e infermierëve në lidhje me vaksinimin e gripit [6]**	Rishikim integrativ i literaturës	Analizimi në mënyrë kritike i literaturës që përshkruan njohuritë, qëndrimet e infermierit dhe praktikat në lidhje me vaksinimin e gripit.	Pavarësisht provave për efektet mbrojtëse të vaksinimit të gripit, normat e vaksinimit midis infermierëve mbeten nën-optimale. Vaksinimi i infermierëve ndaj gripit dhe praktikat lidhen me nivelin e tyre të njohurive dhe perceptimin e rrezikut.
2.Emilia Prosperoet. al., 2018 **Faktorët që ndikojnë në refuzimin e vaksinimit të gripit te gratë shtatzëna, Itali: Roli i punonjësve të shëndetësisë [7]**	Studim kros-seksional i realizuar në Tetor 2016-Janar 2017 Një pyetësor i vetëadministruarështë shpërndarëte gratë shtatzëna	Qëllimi i këtij studimi ishte të hetojë përcaktuesit e lidhur me mosrespektimin e rekomandimeve mbi vaksinimin e gripit në gratë shtatzëna në Itali.	366 gra iu përgjigjën sondazhit dhe 96.1% (348) deklaruan se janë të pavaksinuar kundër gripit gjatë sezonit të gripit 2016-2017. Njohuritë për gripin ishin të ulta në grup. Për më tepër, analizatregoi se niveli i ulët i vaksinimit shoqërohej me mungesë të promovimittë vaksinimit për gratë shtatzëna të kryera nga punonjësit e kujdesit shëndetësor.
3.A. J. Santos et. al., 2018 **Besimet dhe qëndrimet ndaj vaksinës së gripit në individë me rrezik të lartë [8]**	Studim ndër-sektorial në familjet portugeze. U zbatua modeli i besimit në shëndet (HBM) për të vlerësuar besimet dhe qëndrimet ndaj gripit dhe vaksinës në individë me rrezik të lartë që jetojnë në komunitet (të moshës 65 vjeç e sipër, që ka një sëmundje kronike).	Vlerësimi i njohurive dhe qëndrimet ndaj pranimit të vaksinave të gripit dhe marrja e vaksinës tek individët me rrezik të lartë dhe për të matur arsyet e tyre lidhur me mos-marrjen e vaksinës.	Rezultatet e studimit tregojnë se mbulesa vaksinale e gripit tek individët me rrezik të lartë (të moshës 65 vjeç ose më shumë dhe me një sëmundje kronike) është e ulët (31 · 3%).

4.Laura J Dexter et. al., 2012 **Strategjitë për rritjen e nivelit të vaksinimit: rezultatet e një sondazh ndër-sektorial në të gjithë vendin. Praktika e përgjithshme e Anglisë [9]**	Analizë logjistike e të dhenavë nga një pyetësor kros-seksional online.	Për të identifikuar strategjitë e praktikës të shoqëruara me nivele më të larta të vaksinimit të gripit në kujdesin parësor.	U identifikuan 7 faktorë të pavarur lidhur me nivelin më të lartë të vaksinimit. Nëse zbatohet gjerësisht nga praktikat e përgjithshme klinike, norma mesatare e vaksinimit do të parashikohet të rritet me 7% e 8% (duke tejkaluar objektivin e OBSH-së te pacientët e moshës> 65 vjeç).
5.Lixia Yeet. al., 2012 **Përcaktuesit e gatishmërisë së punonjësve të kujdesit shëndetësor për të rekomanduar vaksinën sezonale të gripit te pacientët diabetikë: Një sondazh kros-seksional në Ningbo, Kinë [10]**	Gjatë dhjetorit 2016-janar 2017, një pyetësor i vetëadministruar mbi perceptimet, qëndrimet dhe praktikat në lidhje me vaksinimin e gripit për pacientët diabetikë u shpërnda në 1370 punonjës të kujdesit shëndetësor në 20 spitalet dhe 20 qendra shëndetësore të komunitetit në Ningbo.	Hetimi i perceptimeve dhe gatishmërisë së stafit shëndetësor lidhur me rekomandimet e tyre mbi vaksinimin sezonal të gripit tek pacientët diabetikë në Kinë.	Studimi demonstron se njohuritë rreth udhëzuesit kombëtar dhe politikave të rimbursimit, programet e trajnimit, perceptimet rreth efektivitetit dhe sigurisë së vaksinës së gripit rrisin gatishmërinë e stafit shëndetësor për të rekomanduar vaksinimin e gripit për pacientët diabetikë. Duhet të merren këto masa që sigurojnë rolin stafit në administrimin e vaksinimit të gripit tek pacientët diabetikë.
6.Roni Bitterman et. al., 2012 **Vaksinat e gripit në të rriturit imunosupresiv me kancer [11]**	Rishikim literature	Vlerësimii efektivitetittë vaksinës së gripit në të rriturit imunosupresiv me malinjanca	Të dhënat vëzhguese sugjerojnë vdekshmëri më të ulët dhe rezultate më të mira lidhur me vaksinimin e gripit. Fuqia e provave është e kufizuarnga numri i vogël i studimeve dhe shkalla e ulët e provave. Duket se provat, megjithëse të dobëta, tregojnë se përfitimet tejkalojnë rreziqet e mundshme kur vaksinohen kundër gripit të rriturit me kancer.

7.Anina Plesset. et al., 2016 **Qëndrimet e infermierëve ndaj masave të zbatuara në rritjen e vaksinimit ndaj gripit: Një studim cilësor [12]**	Intervista cilësore gjysmë të strukturuara me një mostër të qëllimshme të 18 infermierëve jo të vaksinuar, që punojnë në njësi me pacientëme rrezik të lartë në dy spitale në Zvicër.	Shqyrtimi i qëndrimeve të personelit infermieror jo të vaksinuar përmes zbatimit të masave të ndryshmeqë synojnë rritjen e niveleve të vaksinimit të gripit.	Vaksinimi i detyrueshëm i gripit si kusht i punësimit të ri (dhe mbase në vazhdim) mund të jetë një masë e realizueshme, efektive dhe etike për të rritur normat e vaksinimit midis infermierëve që kundërshtojnë vaksinimin. Infermierët ishin kritikë ndaj masave të zbatuara. Megjithatë, masat që përfshijnë një element të zgjedhjes u perceptuan si më të pranueshëm.
8.Philipp Schmid et.al , 2017 **Pengesat e synimit të vaksinimit të gripit dhe sjellja. [13]**	Një përmbledhje sistematike hezitimit të vaksinave të gripit, 2005 ± 2016	Ky rishikim synon të identifikojë studimet përkatëse dhe të nxjerrë pengesat individuale të vaksinimit sezonal pandemik të gripit për grupet e rrezikut dhe publikun e gjerë dhe harta e boshllëqevetënjohuriv e në kuptimin e hezitimit të vaksinave të gripit për të nxjerrë udhëzime për më tej, hulumtimi dhe informimi i ndërhyrjeve në këtë fushë.	Shumë pengesa të ndryshme psikologjike, kontekstuale, sociodemografike dhe fizike janë identifikuar lidhur me hezitimin ndaj vaksinimit të gripit.
9.Mohammed S. Abalkhail, et.al., 2017 **Marrja e vaksinëssë gripit, ndërgjegjësimi dhe pengesat e shoqëruese midis studentëve të mjekësisë të një Spitali Universitar në Arabinë Saudite Qendrore [14]**	Studimi kros-seksional u përdor për të përmbushur objektivat e studimit në 421 studentë të mjekësisë të regjistruar në një spital mësimor të kujdesit terciar duke përdorur metodën e kampionimit të rastësishëm në periudhën e studimit midis shkurtit dhe marsit 2015.	Studimi synon të vlerësojë shkallën e marrjes së vaksinës mes studentëve të mjekësisë, pengesat e lidhura me të dhe nivelet e ndërgjegjësimit.	Burimet kryesore që ndikuan në vendimin e marrjes së vaksinave ishin udhëzimet e departamentit shëndetësor, trajnimi mjekësor, ndikimi social dhe mediatik. Pengesat e vaksinimit lidhen me supozimin për të mos qenë në rrezik të gripit (37.9%), efektet anësore të vaksinës (28.9%), efikasiteti i vaksinës në dyshim (14.5%), dhe paaftësia për të caktuar kohën (11%). Nivelet e njohurive ishin të pakënaqshme dhe meshkujt rezultuan më pak (5.4 ± 1.7) sesa femrat (6.5 ± 1.4).. Të dy njohuritë dhe marrja e vaksinimit vjetor të gripit ishte joadekuate. Politikëbërësit mund të formulojnë

			strategjitë me fokus në një mbulim më të madh të studentëve të mjekësisë.
10.Coleen Toronto et.al, 2010 Infermierëte regjistruar dhe vaksinimi i gripit-Një rishikim integrues [15]	Një rishikim integrues u krye duke përdorur Indeksin Kumulative për Infermierinë dhe CINAHL dhe bazat e të dhënave në PubMed.	Hulumtimi ndërkombëtar për botimet e viteve 2003-2006 mbi eksplorimin e faktorëve që ndikojnë në vendimine infermierëve për të marrë apo refuzuar vaksinimin e gripit.	Rishikimi konfirmon se shqetësimi mbi reagimet e padëshiruara në lidhje me vaksinimin e gripit të shoqëruar me pyetje në lidhje me efektivitetin e vaksinës vazhdojnë të jenë të lidhura fuqimisht me mosvaksinimin. Infermierët më të rinj besojnë se ata janë më pak të rrezikuar sesa infermierët e moshuar, të cilët janë më të prirur të ndjekin rekomandimet për vaksinimin vjetor të gripit. Këto zbulime konfirmojnë nevojën për edukim gjithëpërfshirës që mbulon efikasitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e vaksinave dhe sqaron konceptimet gabim mbi vaksinimin.
11.Byung-Këang Yoo et.al., 2011 **Si të përmirësohennivelet e vaksinimit të gripit në Sh.B.A.[16]**	Rishikim literature	Synon të përshkruajë një kornizë të gjerë konceptuale të vaksinimit dhe të ilustrojë katër përcaktuesit potencialë të vaksinimit të gripit bazuar në analizat empirike të popullatave përfaqësuese kombëtare	Përcaktuesit e nivelit të vaksinimit përfshijnë vazhdimesinëe epidemisë së gripit, raportimin e mediave masive mbi temat e lidhura me gripin,shkalla e rimbursimit për ofruesit e për administrimin e vaksinimittë gripit dhe furnizimin me vaksinë.
12.Eleftheria Vasileiou, 2017 **Efektiviteti i vaksinave të gripit tek astmatikët [17]**	Një Rishikim Sistematik dhe Meta-Analizë	Qëllimi lidhet me identifikimin e rëndësisë që ka vaksinimi i gripit te të sëmurët me astmë dhe mënyra si ndikon kjo vaksinë në prognozën e këtyrë pacientëve.	Gjetjet tregojnë se vaksinimi i gripit parandalon gripin dhe pasoja të tjera të rëndësishme shëndetësore klinike te personat me astmë.

13.Eun Young Kim et.al, 2019 **Prevalenca dhe faktorët e mbulimit vaksinal të gripit tek adultët koreanë me SKV [18]**	Studim kros-seksional	Vlerësimi i faktorëve lidhur me mbulesën vaksinale të gripit në pacientët koreanë me SKV.	U demonstrua se vaksinimi i gripit ishte dukshëm më i lartë në subjektet me SKV sesa në ato pa SKV. Nivelet e vaksinimit në individë të rinj (19–49 vjeç) dhe të moshës së mesme (50–64 vjeç) me SKV ishin përkatësisht vetëm 20.3% dhe 39.6%. Për pacientët jo të moshuar me SKV, parashikues të rëndësishëm për vaksinimin e gripit janë prania e sigurimeve private dhe kontrolli i fundit shëndetësor. Ky zbulim mund të ndihmojë në krijimin e politikave të shëndetit publik për të promovuar nivelet e marrjes së vaksinave të gripit në këtë popullatë për të ulur vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë nga gripi.

Diskutimi

Artikujt e përfshirë në rishikimin e literaturës kishin fokus tematikën e vaksinimit kundër influenzës, e parë në disa këndvështrime. Strategjitë e rritjes së ndërgjegjësimit mbi vaksinimin ishin në pjesën më të madhe të artikujve qëllimi i studimit dhe tentonin që të nxisnin vaksinimin në popullatë bazuar në strategji të mirëprovuara. Studimi i Laura.J. Dexter et. al., 2012 evidentoi se për të identifikuar strategjitë e praktikës të shoqëruara me nivele më të larta të vaksinimit të gripit në kujdesin parësor ka rëndësi që të pyetet stafi shëndetësor i kujdesit parësor, pasi kjo parashikon që norma mesatare e vaksinimit të rritet me 7% e 8% (duke tejkaluar objektivin e OBSH-së te pacientët e moshës > 65 vjeç).

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ai lidhur me njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e infermierëve lidhur me vaksinimin. Studimi i Sarah Smith et. al., 2016 vuri në dukje se normat e vaksinimit midis infermierëve mbeten nën-optimale. Vaksinimi i infermierëve ndaj gripit dhe praktikat lidhen me nivelin e tyre të njohurive dhe perceptimin e rrezikut.

Vaksinimi i grupeve në risk apo kategorive më të riskuara për të shfaqur komplikacione të rënda nga gripi ka marrë një vëmendje të veçantë dhe nga studimet e përfshirë në rishikim, gjashtë prej tyre kishin për qëllim pikërisht identifikimin e mbulesës vaskinale te këto grupe risku dhe njohjen me barrierat apo shkaqet e mosvaksinimit kundër influenzës. Eleftheria Vasileiou et.al, 2017 me studimin e tyre vunë në dukje ndikimin direct që kishte aplikimi I vaksinës në një prognozë më të favorshme për pacientët me astmë bronkiale. Në studimin e Emilia Prospero et. al., 2018 lidhur me faktorët që ndikojnë në refuzimin e vaksinimit të gripit te gratë shtatzëna, në Itali, u konkludua që niveli i ulët i vaksinimit shoqërohej me mungesë të promovimit të vaksinimit për gratë shtatzëna të kryera nga punonjësit e kujdesit shëndetësor, pra gratë ishin pak të informuara nga punonjësit e shëndetësisë lidhur me rëndësinë e vaksinës së gripit.

Sa i përket pengesave të lidhura me vaksinimin e gripit Philipp Schmid et.al, 2017 realizuan njëpërmbledhje sistematike mbi hezitiminndaj vaksinave të gripit dhe barrierat bazoheshin në aspekte psiko-sociale apo demografike, të cilat kishin nevojë për ndërhyrje nga specialist të shëndetit që ato të tejkalonin.

Një problem tjetër aktual dhe i vënë re në shumë vende të botës, vazhdon të mbetet refuzimi i vaksinës së gripit nga stafi shëndetësor, edhe pse nga viti në vit ka rritje të mbulesë vaksinale në këtë grup, që cilësohet edhe kategori në risk për gripin. Studimi Coleen Toronto et.al, 2010 konfirmon se faktorët e lidhur fuqimisht me mosvaksinimin tek stafi shëndetësor janë ato të lidhura me efektivitetin e vaksinës dhe ato me

efektet e padëshiruara. Infermierët më të rinj besojnë se ata janë më pak të rrezikuar sesa infermierët e moshuar, të cilët janë më të prirur të ndjekin rekomandimet për vaksinimin vjetor të gripit dhe kanë nivelin më të lartë të vaksinimit.

Konkluzione

Influenza është një sëmundje në dinamikë dhe kërkon një angazhim të plotë të të gjithë strukturave që ofrojnë kujdes shëndetësor, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve në risk.

Virusi i gripit i nënshtrohet mutacioneve gjenetike spontane, ose lëvizjes antigjenike, e cila shkakton epidemi sezonale dhe lejon që shtame të reja virale të përhapen me shpejtësi në popullatë, duke e bërë gripin një sfidë të vazhdueshme për sistemet e kujdesit shëndetësor dhe koordinatorët e vaksinimit në të gjithë botën.

Vaksinimi i gripit është mënyra më efektive për të parandaluar infeksionin megjithatë, pavarësisht ngarekomandimet e OBSH-së që të gjithë punonjësit e kujdesit shëndetësor të vaksinohen kundër gripit, nivelet e marrjes së vaksinës mbeten nënoptimale ndërkombëtarisht.

Infermierët kanë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e gripit. Si punonjës tëshëndetit të vijës së parë, ata kanë potencial për të përhapur virusin në edhe tek pacientët e tyre,prandaj ka rëndësi që të vaksinohen rregullisht kundër gripit.

Për më tepër, infermierët kanë një rol kryesor në edukimin e komunitetit dhe sigurimin e këshillave mbi përfitimet që sjell vaksina e gripit në shëndet.

Në rast se infermierët marrin pjesë në trajnime dhe sesione informative rreth gripit, edhe niveli i vaksinimit tek ata vetë, por edhe puna që ata bëjnë në drejtim të ndërgjegjësimit të popullatës, do të jetë më efektive.

Rekomandime

Vaksnimi i gripit është një nga mënyrat më të mira për të shmangur efektet negative që sjell gripi, në aspektin e shëndetit dhe në atë social e financiar.

Duhet implementuar një plan gjithëpërfshirës i parandalimit të gripit që të përfshijë zbatimin e masave parandaluese, menaxhimin e duhur të rasteve me infeksione të traktit respirator, imunizimin në popullatëbazuar në "Strategjitë e Parandalimit të Gripit Sezonal", sipas rekomandimeve të OBSH-së.

Është e rëndësishme që të njihen strategjitë për përmirësim lidhur me atë se çfarë i ndalon punonjësit e kujdesit shëndetësor të bëjnë një vaksinim vjetor të rregullt ndaj gripit. Kjo ofron mundësi për të zhvilluar strategji për të kapërcyer barrierat. Rritja e aksesit në vaksina, ulja e kostos dhe ofrimi i edukimit mund të ndihmojë në përmirësimin e niveleve të vaksinimit.

Po ashtu, rritja e mundësisë së edukimit të stafit shëndetësor në lidhje me efektivitetin e vaksinës së gripit, efektet anësore dhe opsionet e vaksinave mund të rrisë shkallët e vaksinimit.

Imunizimi është një nga ndërhyrjet më të sigurta dhe me kosto më të efektshme shëndetësore dhe në dispozicion të stafit shëndetësor që ka një ndikim të fuqishëm në rezultatet e shëndetit, prandaj mbetet "arma" më e fortë që zotërojmë në luftën kundër influenzës dhe duhet vënë në përdorim çdo sezon gripi.

Roli aktiv i infermierit lidhur me vaksinimin ndaj gripit, duhet të evidentohet jo vetëm në institucionet shëndetësore, por edhe në komunitet, ku infermieri të zhvillojë takime informuese dhe educative, veçanërisht me të moshuarit, gratë shtatzëna, prindërit e fëmijëve deri në 5 vjeç dhe me të sëmurët kronikë.

Referencat

1. *https://emedicine.medscape.com/article/219557-overview*
2. *Hall CB. The spread of influenza and other respiratory viruses: complexities and conjectures. Clin Infect Dis. 2007;45(3):353-359. doi:10.1086/519433.*
3. *Paget J, Spreeuëenberg P, Charu V, et al. Global mortality associated ëith seasonal influenza epidemics: New burden estimates and predictors from the GLaMOR Project. J Glob Health. 2019;9(2):020421. doi:10.7189/jogh.09.020421*
4. *Baskin E (2018) Increasing influenza vaccination rates via low cost messaging interventions. PLoS ONE 13(2): e0192594..https://journals.plos.org/plosone/article?id=10.1371/journal.pone.0192594*

5. *Higgins J, Green S.(2008). Cochrane handbook for systematic reviews of interventions. Wiley, Chichester (UK) 2008.*
6. *Smith, S., Sim, J. & Halcomb, E. (2016). Nurses' knowledge, attitudes and practices regarding influenza vaccination: an integrative revieë. Journal of Clinical Nursing, 25 (19-20), 2730-2744.*
7. *Prospero E, Galmozzi S, Paris V, et al. Factors influencing refusing of flu vaccination among pregnant women in Italy: Healthcare workers' role. Influenza Other Respi Viruses. 2019;13:201–207.*
8. *Santos AJ, Kislaya I, Machado A, Nunes B. Beliefs and attitudes towards the influenza vaccine in high-risk individuals. Epidemiol Infect. 2017;145(9):1786-1796. doi:10.1017/S0950268817000814*
9. *Dexter LJ, Teare MD, Dexter M, et al. Strategies to increase influenza vaccination rates: outcomesof a nationwide cross-sectional survey of UK general practice. BMJ Open 2012;2:e000851. doi:10.1136/ bmjopen-2011-000851*
10. *Ye L, Chen J, Fang T, et al. Determinants of healthcare workers' willingness to recommend the seasonal influenza vaccine to diabetic patients: A cross-sectional survey in Ningbo, China. Hum Vaccin Immunother. 2018;14(12):2979-2986. doi:10.1080/21645515.2018.1496767*
11. *Bitterman R, Eliakim-Raz N, Vinograd I, Zalmanovici Trestioreanu A, Leibovici L, Paul M. Influenza vaccines in immunosuppressed adults with cancer. Cochrane Database Syst Rev. 2018;2(2):CD008983. Published 2018 Feb 1. doi:10.1002/14651858.CD008983.pub3*
12. *Pless A, Shaw D, McLennan S, Elger BS. Nurses' attitudes toëards enforced measures to increase influenza vaccination: A qualitative study. Influenza Other Respir Viruses. 2017;11(3):247-253. doi:10.1111/irv.12441*
13. *Schmid P, Rauber D, Betsch C, Lidolt G, Denker ML. Barriers of Influenza Vaccination Intention and Behavior - A Systematic Review of Influenza Vaccine Hesitancy, 2005 - 2016. PLoS One. 2017;12(1):e0170550. Published 2017 Jan 26. doi:10.1371/journal.pone.0170550*
14. *Abalkhail MS, Alzahrany MS, Alghamdi KA, et al. Uptake of influenza vaccination, awareness and its associated barriers among medical students of a University Hospital in Central Saudi Arabia. J Infect Public Health. 2017;10(5):644-648. doi:10.1016/j.jiph.2017.05.001*
15. *Toronto CE, Mullaney SM. Registered nurses and influenza vaccination. An integrative review. AAOHN J. 2010;58(11):463-471. doi:10.3928/08910162-20101027-01*
16. *Yoo BK. How to improve influenza vaccination rates in the U.S. J Prev Med Public Health. 2011;44(4):141-148. doi:10.3961/jpmph.2011.44.4.141*
17. *Vasileiou E, Sheikh A, Butler C, et al. Effectiveness of Influenza Vaccines in Asthma: A Systematic Review and Meta-Analysis. Clin Infect Dis. 2017;65(8):1388-1395. doi:10.1093/cid/cix524*
18. *Kim EY, Ko JH, Kim YS, Oh PC. Prevalence and associated factors of influenza vaccination coverage in Korean adults with cardiovascular disease. Medicine 2020;99:1(e18540).*

Pijet energjike dhe përdorimi i tyre tek studentët e Universitetit"Ismail Qemali" Vlorë

Msc. Rudina Çerçizaj
Msc.Emirjona Kiçaj
Bsc Fiona Dalipaj
MP. Neritan Qirici
Msc. Stiliana Brokaj
Departamenti i Kujdesit Shëndetësor,
Universiteti Ismail Qemali Vlorë
Spitali Rajonal Vlorë

Abstrakti

Hyrja: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte nivelin e konsumimit të pijeve energjike dhe frekuencën e efekteve anësore nga përdorimi i tyre.Nëpërmjet këtij studimi u vlerësua gjithashtu niveli i studentëvë konsumatorë të pijeve energjike dhe prezenca e efekteve anësore tek studentët në bazë të fakulteteve.

Metodologjia: Ky është një studim cross-seksional i realizuar tek 250 studentë të katër fakulteve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë,të cilët u përzgjodhën në mënyrë të rastësishme..Për mbledhjen e të dhënave të këtij studimi u përdor një pyetësor i vetadministruar,i cili përbëhej nga 20 pyetje.

Rezultatet: Shpërndarja e studentëve në bazë të gjinisë ishte femra 79.20% dhe meshkuj (20.80%) me moshë mesatare 21.5 vjec.Nga studimi rezultoi se vetëm 32% e studentëve ishin përdorues aktual të pijeve energjike.Rastet kryesore gjatë të cilave studentët konsumonin pije energjike ishin jo në ndonjë rast të vecantë 40%,në festa dhe kur studiojnë gjatë provimeve me një përqindje të barabartë 20%.Efektet anësore më të shpeshta që kishin hasur studentët konsumatorë të pijeve energjike ishin pagjumësia 33.33%,takikardia 23.80%,dridhjet dhe nervozizmi 19%.

Konkluzionet: Nga studimi rezultoi se studentët konsumatorë të pijeve energjike përbëjnë pakicën e totalit të studentëve të përfshirë në studim.Njihuritë e studentëve në lidhje me përbërësit e pijeve energjike në përgjithësi ishin të mira. Dy efektet anësore më të shpeshta të studentëve konsumatorë të pijeve energjike ishin pagjumësia dhe takikardia.

Fjalë kyce: pije energjike, efekte anësore,pyetësor,studentët,konsumatorë

Abstract

Introduction: The purpose of this study was to assess the level of consumption of energy drinks and the frequency of side effects from their use. Through this study was also assessed the level of students consuming energy drinks and the presence of side effects in students based on faculties.

Methodology: This is a cross-sectional study conducted on 250 students of four faculties of the University "Ismail Qemali" Vlora, who were randomly selected. A self-administered questionnaire was used to collect data for this study which consisted of 20 questions.

Results: The distribution of students by gender was 79.20% female and male (20.80%) with an average age of 21.5 years. The study showed that only 32% of students were current users of energy drinks. The main cases during which students consumed energy drinks were not in any special case 40%, on holidays and when studying during exams with an equal percentage of 20%. The most common side effects encountered by students consuming energy

drinks were insomnia 33.33%, tachycardia 23.80%, tremors and nervousness 19%.

Conclusions: The study showed that students consuming energy drinks constitute the minority of the total number of students included in the study. Students' knowledge about the components of energy drinks was generally good. The two most common side effects of students consuming energy drinks were insomnia and tachycardia.

Keywords: energy drinks, side effects, questionnaire, students, consumers

Hyrje

Pijet energjike janë pije që përmbajnë kafeinë (prej 50 deri në 550 mg për kanaçe ose shishe), taurinë, l-karnitinë, karbohidrate, glukuronolaktone, vitamina dhe shtesa bimore si ginseng dhe guarana.[1]Ato janë të njohura përgjithësisht për të stimuluar funksionet njohëse dhe vigjilencën.[2]

Kafeina, nëse konsumohet me tepricë, mund të shkaktojë pagjumësi, rrit presionin arterial dhe më vonë mund të rris rrezikun për osteoporozë dhe sëmundje kardiovaskulare.[10]

Taurina - një aminoacid që gjendet me bollëk në trurin e njeriut, retinë, zemrën dhe organet riprodhuese, si edhe në mish dhe produktet e detit - është gjithashtu një përbërës i rëndësishëm i "pijeve energjetike".[17]

Përdorimi i pijeve energjike jep efekte anësore në shëndetin e konsumatorëve si në sistemin kardiovaskular, sistemin nervor, aspektin psikologjik, sistemin gastrointestinal, sistemin urinar [3], [4], [5], [6], [7]. Gjithashtu përdorimi i madh i pijeve energjike sjlle problematika dhe në shëndetin dentar [8].

Pijet energjike mund të shkaktojnë arrest kardiak te të rinjtë e shëndetshëm [3]. Kafeina është përdorur gjerësisht, dhe janë raportuar efekte serioze negative, sidomos kur konsumohet në doza të mëdha. Adoleshentët dhe të rinjtë mund të kalojnë lehtë në mbidozë. [9]

Qëllimi i studimit:Vlerësimi i nivelit të studentëve konsumatorëve të pijeve energjike dhe frekuencës së efekteve anësore nga përdorimi i tyre.

Objektivat specifikë

1.Të vlerësohet niveli i konsumimit të pijeve energjike tek studentët.

2.Të vlerësohen njohuritë e studentëve për përmbajtjen e pijeve energjike.

3.Të vlerësohet varësia e studentëve ndaj pijeve energjike.

4.Të vlerësohen efektet anësore si edhe frekuenca e tyre nga përdorimi i pijeve energjike.

5.Të vlerësohet arsyeja e moskonsumimit të pijeve energjike nga ata student që nuk i konsumojnë

Metodologjia e studimit: Ky është një studim kros-seksional i realizuar në periudhën kohore Mars-Prill 2019 tek studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Pjesë e këtij studimi u bënë 250 studentë të katër fakulteteve të Universitetit "Ismail Qemali"Vlore,të cilët u përkisnin 10 degëve te ndryshme:

1. Fakulteti i Ekonomikut me degët:

Administrim Publik

Ekonomiks

Financë

Kontabilitet

2. Fakulteti i Shkencave Humane me degët:

Gjuhe-shqipe dhe Letërsi

Drejtësi

3.Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore me degët:

Inxhinieri Navale

Shkenca Kompjuterike

4.Fakulteti i Shëndetit Publik me degët:

Infermieri e Përgjithshme

Infermieri Mami

Studentët pjesëmarrës u përzgjodhën në mënyre të rastësishme dhe përkisnin ciklit të parë të studimeve. Në secilën prej10 degëve ku u shpërnda, pyetësori u plotësua nga 25 studentë.

Instrumenti që u përdor për realizimin e këtij studimi ishte një pyetësor i vetadministuar i përbërë nga 20 pyetje. Pyetësori u realizua në kushtet e anonimitetit të plotë.Ai përbëhej nga disa grupe pyetjesh të cilat siguronin informacion për:

- të dhënat personale të studentëve të përfshirë në studim:mosha,gjinia,viti i studimit,dega e studimit;
- njohuritë e tyre në lidhje me përbërësit e pijeve energjike;
- konsumimin e pijeve energjike:frekuenca e përdorimit të tyre,rastet dhe arsyeja e konsumimit,vëzhgimi i rezultateve tëpritshme pas konsumimit të tyre si dhe mendimi i studentëve për efikasitetin e pijeve energjike;
- efektet anësore pas konsumimit të pijeve energjike:prania dhe frekuenca e tyre;
- pijet energjike të konsumuara së fundi,varësinë e studenteve ndaj tyre,cmimin e përshtatshëm sipas tyre për një kanace;
- dy pijet e preferuara nga studentët dhe vlerësimin e tyre për këto dy pije;
- arsyet e moskonsumimit te pijeve energjike nga studentet jo-konsumatorë, efektet anësore që kanë patur dhe frekuenca e tyre.

Pyetësori përmbante vetëm pyetje të mbyllyra duke eleminuar në këtë mënyrë mundësinë e mosplotësimit të tij dhe hasjen e vështirësive nga dhënia e informacionit shtesë prej studentëve.Gjithashtu disa pyetje përmbanin një sqarim të vogël në rast të ndonjë paqartësie të mundshme.

Konsideratat Etike: Për realizimin e pyetësorit është kërkuar leje nga dekanët e katër fakulteteve,gjithashtu është kërkuar bashkëpunim nga pedagogët përkatës që kanë qenë në sallat e leksionit apo në laboratore gjatë shpërndarjes së pyetësorit.Në secilën prej klasave ku është shpërndarë pyetësori në fillim studenteve u është shpjeguar qëllimi i pyetësorit dhe u është lënë e drejta e lirë e zgjedhjes për ta plotësuar pyetësorin.

Prezantimi i rezultateve të studimit

Mosha mesatare e pjesmarësve në studim ishte 21.5 vjeç. Pjesa më e madhe e pjesmarësve ishin student femra (79.2%). 56% e studentëve të anketuar i përkasin vitit të parë, 29.2% jane studentë të vitit të tretë,ndërsa pjesa e mbetur prej 14.8% janë studentë të vitit të dytë. Përsa I përket degës së studimit kishim një shpërndarje të njëtrajtshme të studentëve.

Tabela 1.Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës në varësi të përdorimit të pijeve energjike

Variablat	Numri	Përqindja
1-A konsumoni pije energjike?		
Po	80	32%
Jo	170	68%
2-Sa shpesh konsumoni pije energjike?		
Çdo ditë	35	43.75%
1-2 herë në javë	23	28.75%
2-4 herë në muaj	17	21.25%

1 herë në muaj	5	6.25%
3-Në cilat raste konsumoni pije energjike?		
Kur luani një lloj sporti	4	5%
Kur ngisni makinën	5	6.25%
Kur studioni gjatë provimeve	16	20%
Në festa	16	20%
Jo ne ndonjë rast të veçantë	32	40%
Tjetër	7	8.75%
4-Cila është arsyeja që ju konsumoni pije energjike?		
Për të patur një përqëndrim më të mirë	14	17.5%
Për të marrë më shumë energji	17	21.25%
Më pëlqen shija e tyre	46	57.5%
E përdorin të gjithë (moda)	3	3.75%
Tjetër	0	0%
5-Pasi konsumoni një pije energjike, i vezhgoni rezultatet që prisnit të merrnit nga përdorimi i saj?		
Gjithmonë	8	10%
Shpesh herë	11	13.75%
Ndonjëherë	35	43.75%
Kurrë	26	32.5%
6-Çfarë mendoni për efikasitetin e pijeve energjike?		
Janë efektive	15	18.75%
Eshtë thjesht një çështje psikologjike	52	65%
Nuk funksionojnë	13	16.25%

Grafiku 1



Pjesa më e madhe e studentëve pjesëmarrës në studim 68% nuk janë konsumatorë të pijeve energjike,ndërsa 32% e studentëve i konsumojne rregullisht pijet energjike.

Grafiku 2



43.75% e studentëve i konsumojnë pijet energjike çdo ditë. 28.75% e studentëve i konsumojnë pijet energjike 1-2 herë në javë,21.25% e tyre i konsumojnë 2-4 herë në muaj,ndërsa 6.25% e studentëve i konsumojnë vetëm i herë në muaj.

Grafiku 3.



Në varësi të rasteve të konsumimit të pijeve energjike vihet re se 40% e studentëve i konsumojnë pijet energjike pa patur nevojë për ndonjë rast të veçantë. 20% e studentëve i konsumojne pijet energjike kur studiojne gjate provimeve,ndërsa 20% të tjerë i përdorin në festa. 8.75% e studentëve referon se i konsumon në raste të tjera. 6.25% i konsumon kur ngasin makinën.Rasti më rralle i konsumimit të pijeve energjike prej studentëve është kur luajnë ndonjë lloj sporti (5%).

Grafiku 4.



Arsyeja kryesore e konsumimit të pijeve energjike nga studentët është se u pëlqen shija e tyre (57.50%).Arsyeja e dytë më e përzgjedhur është ajo për të marrë më shumë energji me 21.25%.Më poshte tyre renditen me 17.50% alternativa për të patur një përqëndrim më të mirë dhe me 3.75% ajo që i përdorin të gjithë (moda).Kategoria "tjetër" nuk është përzgjedhur nga asnjë prej studentëve.

Grafiku 5



Pjesa më madhe e studentëve të përshirë në studim (43.75%)i vëzhgojnë ndonjëherë rezultatet që prisnin të merrnin pas konsumimit të pijeve energjike.32.50% e studentëve nuk i vëzhgojnë kurrë rezultatet pas konsumimit te tyre.Studentët që i vëzhgojnë shpesh herë rezultatet e pritshme zënë një përqindje prej

13.75%,ndërsa ata që i vëzhgojnë gjithmonë përbëjnë vetëm 10% te totalit të studentëve.

Grafiku 6



65% e studentëve konsumatorë në lidhje me efikasitetin e pijeve energjike mendojnë se përbën thjesht një çështje psikologjike. 18.75% e tyre mendojnë se janë efektive, ndërsa 16.25% mendojnë se nuk funksionojne

Grafiku 7



Duke ditur që përdorim i pijeve energjike jep efekte anësore sidomos kur përdoret në mënyrë të shpeshtë, iu kërkuam studentëve nëse ata kishin paraqitur ndonjë efekt anësore. Vetëm 26.25% pohuan për prani të efekteve anësore nga kosumimi i këtyre pijeve.

Grafiku 8. Efektet anësore dhe shpështësia e tyre tek studentët konsumatorë të pijeve energjike



Studentët konsumatorë të pijeve energjike raportojnë për efekte anësore nga konsumimi i tyre.Dy efektet anësore më të shpeshta qe kane raportuar janë pagjumësia 33.33% dhe takikardia 23.80%.Më tej renditen dridhjet 19 dhe nervozizmi me 19% secila prej tyre,ankthi 14.28% dhe në fund dhimbja e kokes me 9.52%.

Grafiku 9



Dy markat e pijeve energjike më të konsumuara nga studentët gjatë vitit të fundit janë B52 e konsumuar nga 77.50% e studentëve dhe Red Bull e konsumuar nga 68.75% e tyre.Pija energjike e tretë më e konsumuar është Golden Eagle nga 27.50% e studentëve . Më tej renditen Rockstar me 8.75%,Monster me 7.50%,kategoria "tjetër" me 3.75%,Dar Dog me 2.50% dhe në fund renditet Burn e pakonsumuar nga asnjë student (0%).

Grafiku 10



Në rastet kur nuk arrijne të gjejnë pijen e tyre energjike të preferuar 48.75% e studentëve,ve shkojne tyre ka një preferencë të dytë. 26.25% e studentëve e blen te njejtën pije energjike në një dyqan tjetër,ndërsa 18.75% e tyre blen një pije të rastësishme.Përqindja më e vogel e studentëve,6.25% e tyre nuk blen asnjë lloj pije tjetër.

Grafiku 11. Dy pijet energjike më të përdorura nga studentët



Dy pijet energjike më të konsumuara nga studentët jane B52 dhe Redbull,ku midis të dyjave kryeson B52 me 83.75% kundrejt Red Bullit me 76.25%.

Grafiku 12. Arsyet e moskonsumimit të pijeve energjike



Arsyeja kryesore e moskonsumimit te pijeve energjike prej studenteve eshte se nuk i pelqejne (48.8%). referojneArsyet e dyte eshte se e dine qe konsumimi i tyre mund te shkaktoje efekte anesore (32.3%) referojne .Arsyet e tjera jane qe kane patur efekte anesore nga konsumimi i tyre (13.5%) dhe arsyet te tjera specifike (5.2%).

Grafiku.13



Studentët e Fakultetit te Shëndetit Publik (70%) kanë njohuri më të mira në lidhje me substancat përbërëse të pijeve energjike. Të dytët për njohuri të mira të elementëve përbërës të P.E renditen studentët e Fakultetit të Ekonomikut me 54%.Fakulteti i Shkencave Humane renditet i treti me 42%,ndërsa më pak njohuri për përmbajtjen e tyre kanë studentët e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore,vetëm 38% e studentëve e dinë se cfarë substancash përmban një pije energjike.

Grafiku 14.Niveli i konsumimit të pijeve sipas fakulteteteve



Pijet energjike janë më tepër te konsumuara tek studentët e Fakultetit te Ekonomikut nga 60% e tyre.Në vendin e dytë për nivelin e konsumimit renditet Fakulteti i Shkencave Humane me 38% të studentëve konsumatorë të P.E.Nën vendin e tretë me vetëm 6% më pak se i dyti (32%) renditet Fakulteti i Shkencave Teknike.Nivelin më të ulët të konsumimit të pijeve energjike e zënë studentët e Fakulteti te Shëndetit Publik me 28% studentë konsumues nga totali i studentëve pjesëmarrës në studim.

Grafiku .16

Prania e efekteve anësore gjatë konsumimit të pijeve energjike sipas fakulteteve



Për sa i përket pranisë së efekteve anësore gjatë konsumimit të pijeve enegjike 65.50% e studenteve të "Fakulteti te Ekonomikut" mohojnë të kenë patur efekte anësore,ndërsa 36.20% e tyre mohojnë praninë e efekteve anësore nga konsumimi i P.E.Pjesa më e madhe e studentëve të "Fakultetit të Shkencave Humane" (73.60%) nuk pranojnë te kenë patur efekte anësore nga konsumimi i pijeve energjike,kurse pjesa tjetër (26.30%) raportojnë per prani të efekteve anësore.Studentët e "Fakultetit të Shkencave Teknike" në pjesën më të madhe të tyre (64.20%) nuk kane patur efekte anësore nga konsumimi i pijeve energjike,ndërsa 35.70% e tyre pranojnë të kenë patur efekte anësore.Tek studentët e "Fakultetit të Shëndetit Publik" ekziston një diferencë prej 60% midis studentëve që e mohojnë të kenë patur efekte anësore (80%) nga konsumimi i pijeve energjike dhe atyre që pohojne praninë e efekteve anësore (20%).

Grafiku 13.Efektet anësore të pijeve energjike dhe shpeshtësia e tyre tek studentët jo konsumatorë të pijeve energjike



Një pjesë e studentëve jo-konsumatorë të pijeve energjike nuk i konsumonin këto pije për shkak të efekteve anësore që kishin patur prej tyre.Efekti më i shpeshtë anësor i raportuar nga studentët është pagjumësia (45.45%).raportojne Efektet e tjera variojnë me nervozizmin (40.90%),dridhjet (36.36%),takikardinë (31.81%),ankthin (27.27%),dhe në fund renditet dhimbja e kokës (22.72%).

Diskutimi

Me anë të këtij studimi u përcaktuan nivelin e studentëve konsumatorë të pijeve energjike dhe efektet anësore më të shpeshta të hasura prej tyre.Pjesë e studimit u bënë 250 studentë të katër fakulteteve të Universitetit "Ismail Qemali"Vlorë,të cilët u përzgjodhën në mënyrë rastësore.Mosha mesatare e studentëve ishte 21.5 vjec,një sihifër e përafërt me moshën e studentëve të një studimi të kryer në Tajvan (23.1vjec) dhe thuajse e njëjtë me moshën e studentëvë të një studimi të realizuar tej një universitet në Amerikë ku mosha mesatare ishte 21.5+/- 3.7 vjec..Pjesa më e madhe e studentëve në studimin e realizuar tek studentët e universitetit "Ismail Qemali'ishin femra (79.2%),ndërsa pjesa e mbetur meshkuj (20.8%).Në studimin e realizuar në Tajvan gjithashtu meshkujt zinin përqindjen më të vogël (48.0%) krahasuar me femrat (52%),por në krahasim me studimin e kryer tek studentët e Universitetit "Ismail Qemali" meshkujt përbënin një përqindje më të madhe në numrin total të studentëve.Studentët e Universitetit "Isamil Qemali" që konsumonin pije energjike aktualisht përbënin 32% te studentëve,ndërsa pjesa tjetër 68% nuk i konsumonte pijet energjike.Krahasuar me një studim të realizuar tek studentët e Universitetit të Puerto Rikos,përqindja e studentëve konsumues të pijeve energjike ishte pak më e lartë se (47.1%) në universitetin tonë,ndërsa në krahasim me studimin e realizuar në Nigeri studentët konsumatorë të pijeve energjike në universitetin tonë përbëjnë një shifër më të vogël ,pasi në universitetin e Nigerisë pijet energjike konsumoheshin aktualisht nga 87.8% e studentëve. Në lidhje me njohuritë për përmbajtjen e pijeve energjike më shume se gjysma e studentëve të universitetit tonë (58.80%) pohojnë se kane njohuri për përmbajten e pijeve energjike.20.40%,70% dhe 73.20% e studentëve vërtetuan se kane njohuri për përbërësit kryesorë të pijeve energjike,ndërsa 2.80%,3.60%,4.80%,6.40% dhe 12% e tyre njihnin përbërësit e tjerë plotësues të pijeve energjike.Në studimin e realizuar në Sicili midis 70% dhe 90% e të anketuarve deklaruan se i njihnin përbërësit kryesorë të pijeve energjike (kafeinë,taurinë,sheqer),ndërsa 7% dhe 20% e tyre njihnin përbërësit më pak të mundshëm (vitaminat,glucuronolactone,aspartam,karnitinë dhe guarana)Në krahasim me studentët e universitetit "Ismail Qemali" njohuritë e studentëve në Nigeri për përbërësit e pijeve energjike ishin të ulta,ku vetëm 26.5% e studentëve kishin njohuri për elementët përbërës të këtyre pijeve.Studentët e universitetit "Ismail Qemali" për sa i përket frekuencës së përdorimit të pijeve energjike në pjesën më të madhe të tyre i konsumojnë këto pije cdo ditë (43.75% e tyre), duke rezultuar se i përdorin pak më shpesh se studentët e një studimi të realizur në Ganë ku 62.2% e studentëve të anketuar i konsumonin pijet energjike të paktën një herë në javë, gjithashtu studentët e universitetit tonë i konsumonin akoma më tepër se studentët e studimit të realizuar në Amerikë ku 51% e tyre raportuan se konsumonin më shumë se një pije energjike në muaj dhe se studentët e universitetit të Puerto Rikos ku 48.1% konsumonin pije energjike cdo 2-3 herë në muaj në mënyrë rastësore.Përsa i përket rasteve të konsumimit të pijeve energjike pjesa me e madhe e studentëve (40%) të universitetit tonë i konsumonin ato jo në ndonjë rast të vecantë,po ashtu edhe ne studimin e realizuar në Sicili pjesa më e madhe e të anketuarve 50% e tyre i konsumonin pijet energjike pa ndonjë arsye të vecantë.

Raste të tjera te konsumimt të pijeve energjike tek studentët e Universitetit "Ismail Qemali'ishin në festa 20% e studentëve , 20% gjithshtu i konsumonin kur studionin gjatë provimeve,të raste të tjera 8.75% e tyre,kur ngisnin makinën i konsumojnë 6.25% e studentëve dhe kur luajnë ndonjë lloj sporti i përdorin 5% e tyre.Në Sicili rastet e tjera te konsumimit te P.E renditeshin:për kënaqësi 34% e të anketuarve,për sporte 17% dhe kur studiojnë gjatë provimeve rreth 8% e tyre. Ndërsa tek studentët e universitetit të Puerto Rikos arsyeja kryesore e konsumimittë pijeve energjike ishte gjatë studimit (72.1%),e cila gjithashu është një nga arsyet më të përzgjedhura nga studentët e universitetit "Ismail Qemali" për konsumimin e pjeve energjike,por tek këta të fundit përdindja e studentëve është dukshëm më e vogël (20%)

se te studentët në Puerto Riko.Një nga rastet gjatë të cilit studentët i përdornin më pak pijet energjike ishte gjatë kryerjes së aktiviteteve sportive përkatësisht përdoreshinnga 6.25% e studentëve të universitetit "Ismail Qemali" dhe nga 18.3% e studentëve në universitetin e Puerto Rikos,ku midis dyve përdoren më tepër nga ai i Puerto Rikos.Në lidhje me efektet anëore 26.25% e studentëve të universitetit tonë pohojnë se kanë patur efekte anësore nga konsumimi i pijeve energjike si pagjumeëi (33.33%),takikardi (23.80%), dridhje (19%),nervozizëm (19%),ankth (14.28%),dhimbje koke (9.52%).Në studimin e Sicilisë 21% e konsumatorëve pohuan se kishin patur crregullime si rezultat i pirjes se P.E,duke përfshirë nervozizëm (46%),palpitacione (43%),pagjumësia (37%),dridhje (34%),dhimbje koke (20%),ose ankth (17%).

Konkluzionet

Rezultatet e këtij studimi konfirmuan se pjesa më e madhe e studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë nuk ishin konsumatorë te pijeve energjike.Studentët kishin njohuri të mira për përbërësit e pijeve energjike,sidomos për ata me kryesoret si:kafeina,sheqeri dhe taurina.Pjesa e studentëve qe i konsumonte pijet energjike ishte tepër e varur prej,per arsye se në rastet kur nuk arrinin te gjenin pijen e tyre te preferuar ata në përqindjen më të madhe e blinin në një dyqan tjetër ose kishin një preferencë të dytë,e cila gjithashtu ishte pije energjike.Efektet anësore më të shpeshta që kishin përjetuar studentët përfshinin pagjumësinë dhe takikardinë,të ndjekura më pas nga nervozizmi,dridhjet,ankthi dhe në fund dhimbja e kokës. Arsyeja kryesore e moskonsumimit të pijeve energjike nga studentët jo konsumatorë ishte se nuk i pëlqenin ato.

Literature

[1]. Ishak Ww, Ugochukwu C, Bagot K, Khalili D, Zaky C. Energy drinks: psychological effects and impact on well-being and quality of life - a literature review. Innov Clin Neurosci 2012;9(1):25-34. [PMC free article] [PubMed] [Google Scholar]

[2]. Malik VS, Popkin BM, Bray GA, Després JP, Hu FB. Sugar-sweetened beverages, obesity, type 2 diabetes mellitus, and cardiovascular disease risk. Circulation 2010;121(11):1356-64. doi: 10.1161/CIRCULATIONAHA.109.876185. [PMC free article] [PubMed] [Google Scholar]

[3]. Goldfarb M, Tellier C, Thanassoulis G. Review of published cases of adverse cardiovascular events after ingestion of energy drinks. The American journal of cardiology. 2014;113(1):168–172. [PubMed] [Google Scholar]

[4]. Juliano LM, Evatt DP, Richards BD, Griffiths RR. Characterization of individuals seeking treatment for caffeine dependence. Psychology of Addictive Behaviors. 2012;26(4):948. [PMC free article] [PubMed] [Google Scholar]

[5]. Kristjansson AL, Sigfusdottir ID, Frost SS, James JE. Adolescent caffeine consumption and self-reported violence and conduct disorder. Journal of youth and adolescence. 2013;42(7):1053–1062.[PubMed] [Google Scholar]

[6]. Greenblum S, Turnbaugh PJ, Borenstein E. Metagenomic systems biology of the human gut microbiome reveals topological shifts associated with obesity and inflammatory bowel disease. Proceedings of the National Academy of Sciences. 2012;109(2):594–599. [PMC free article] [PubMed] [Google Scholar]

[7]. Montain SJ, Coyle EF. Influence of graded dehydration on hyperthermia and cardiovascular drift during exercise. Journal of Applied Physiology. 1992;73(4):1340–1350. [PubMed] [Google Scholar]

[8]. Marshall TA, Levy SM, Broffitt B, Warren JJ, Eichenberger-Gilmore JM, Burns TL, et al. Dental caries and beverage consumption in young children. Pediatrics. 2003;112(3):e184–e191. [PubMed] [Google Scholar]

[9]. Dr. Sanchis-Gomar and his co-investigators, Dr. Pareja-Galeano (Universidad Europea de Madrid), Dr. Cervellin, Dr. Lippi (Academic Hospital of Parma), and Dr. Earnest (Texas A&M University),2015Energy Drinks Have Serious Implications for Cardiac Health, Claim Researchers

[10]. Temple J.L. Caffeine use in children: What we know, what we have left to learn, and why we should worry. Neurosci. Biobehav. Rev. 2009;33:793–806. doi: 10.1016/j.neubiorev.2009.01.001.[PMC free article] [PubMed] [CrossRef] [Google Scholar]

Roli mediator i perceptimeve pozitive mbi stresin e prindërimit te nënat e fëmijëve me çrregullimin e spektrit të autizmit

Erjona Dervishaliaj
Departamenti i Edukimit
Fakultetit i Shkencave Humane
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
erjona.dervishaliaj@univlora.edu.al
erjonadervishaliaj@gmail.com

Abstract

This study examined parenting stress and positive perceptions among mothers of children with Autism Spectrum Disorder. The aim was to examine whether positive perceptions mediate the relationships between parenting stress and child aberrant behavior among mothers. A convenience sample of 105 mothers completed the Parenting Stress Index Short Form (PSI-SF),the Kansas Inventory of Parental Perceptions (KIPP), and the Aberrant Behavior Checklist-Community (ABC-C). PSI-SF scores reflected high levels of stress for 58% of mother and clinically significant levels of stress for 25.7% of mothers. Positive perceptions were found to have a partial mediating effect on the relationship between child behavior difficulties and parenting stress.

***Key words**: autism, parenting stress, aberrant behaviors, perceptions*

Ky studim hulumtoi stresin e prindërimit dhe perceptimet pozitive mbi fëmijën, mes nënave të fëmijëve të diagnostikuar me çrregullimin e spektrit të autizmit. Qëllimi tij ishte të ekzaminohej nëse perceptimet pozitive mbi fëmijën luajnë rol mediator në marrëdhënien midis stresit të prindërimit dhe sjelljeve të vështira të shfaqura nga fëmijët me autizëm. Në studim u përfshi një kampion i qëllimshëm, i përbërë prej 105 nënash të fëmijëve të diagnostikuar me autizëm. Instrumentet e përdorura në studim ishin Parenting Stress Index Short Form (PSI-SF), Kansas Inventory of Parental Perceptions (KIPP), dhe Aberrant Behavior Checklist-Community (ABC-C). Pikët e përftuara nga PSI-SF treguan se 58% e nënave përjetojnë stres në nivel të lartë, dhe 25.7% e tyre përjetojnë stres në nivel domethënës klinik. Analiza e mediacionit tregoi se perceptimet pozitive luajnë rol të pjesshëm mediator në marrëdhënien midis sjelljeve të vështira të shfaqura nga fëmijët me autizëm dhe stresit të prindërimit.

***Fjalët kyçe**: autizëm, stresi i prindërimit, sjellje të vështira/të pazakonta, perceptime*

1. Hyrje

Çrregullimii spektrit të autizmit është një çrregullim neurozhvillimor, i cili manifestohet me vështirësi në një sërë fushash: probleme të komunikimit, të ndërverprimit social, të koordinimit motorik, të fleksibilitetit të sjelljes, procesime sensore atipike, ku të gjitha këto vështirësi variojnë shumë nga një individ te tjetri (Castejon et al., 2019). Studimet kanë treguar tashmë, në mënyrë të qëndrueshme, se prindërit e fëmijëve me autizëm përjetojnë nivele më të larta të stresit të prindërimit sesa prindërit e fëmijëve me zhvillim tipik (Pozo & Sarria, 2014; Davis & Carter, 2008; Kring, Greenberg & Seltzer, 2008; Saloviita, Itälinna & Leinonen, 2003; Sanders & Morgan, 1997) e madje, edhe krahasur me prindërit e fëmijëve të diagnosituar me çrregullime të tjera si: sindroma down, vonesa mendore, etj. (Hayes & Watston, 2012). Studimet sugjerojnë se nënat raportojnë nivele më të larta të stresit të prindërimit krahasuar me baballarët (Tehee, Honan & Hevey , 2009) si edhe janë më të predispozuara të shfaqin shqetësime psikoemocionale (Zablotsky, Bradshaw, & Stuart, 2013) çka mund të lidhet me përfshirjen më të lartë të tyre në përkujdesjen për fëmijën me autizëm.

Përballja e prindit me diagnozën e autizmit është stresuese për të, por studimet sugjerojnë

se stresi i lartë i prindërimit mund të mos lidhet aq me diagnozën në vetvete, sesa me ashpërsinë e çrregullimit, karakteristikat e fëmijës dhe sjelljet e tij të vështira që vijnë si pasojë e çrregullimit të autizmit (Ritzema & Sladeczek, 2011; Plant & Sanders, 2007;). Studiuesit (Neece, Green & Baker, 2012; Plant & Sanders, 2007; Sanders & Morgan, 1997) rendisin praninë e një sërë sjelljeve të vështira/sfiduese/problematike apo mungesën e sjelljeve pozitive/përshtatëse të fëmijës si parashikues domethënës të stresit të prindërimit: sjellje sfiduese të vështira për t'u menaxhuar, sjellje vetëdëmtuese, agresivitet, aftësi të varfra vetërregulluese (apo mungesë e tyre), çka shpie në shpërthime emocionale, irritueshmëri, hiperaktivitet, vështirësi apo mungesë komunikimi, verbalizime të përsëritura, vështirësi apo mungesë socializimi, autonomi të vonuar dhe të kufizuar të fëmijës, regjim të çrregullt gjumi, etj. Herring dhe kolegët (2006) kanë gjetur lidhje pozitive domethënëse midis sjelljeve të vështira që shfaqin fëmijët, stresit të prindërimit dhe problemeve të shëndetit mendor të prindërve. Sjelljet e vështira për t'u menaxhuar që shfaqin fëmijët me autizëm dhe nevoja e tyre për vëmendje dhe përkujdesje të veçantë e të vazhdueshme, nevoja për supervizim të vazhdueshëm për sigurinë e vetë fëmijës dhe të motrave e vëllezërve të tij, kërkojnë që të gjitha një intensitet më të lartë përkujdesjeje, më shumë kohë dhe energji nga prindërit. Të gjithë këta faktorë janë gjetur të lidhur pozitivisht, në mënyrë domethënëse, me stresin e prindërimit (Plant & Sanders, 2007). Sipas autorëve, nevoja e vazhdueshme për përkujdesje ishte parashikuesi më i fuqishëm i stresit të raportuar nga prindërit.

Studimet sugjerojnë gjetje të përzjera sa i takon lidhjes midis moshës së fëmijës dhe stresit të prindërimit. Neece dhe kolegët (2012), nuk kanë gjetur lidhje domethënëse midis moshës së fëmijëve dhe stresit të prindërimit. Sipas studiuesve kjo ndodh pasi, edhe nëse reduktohen disa stresorë, gjithmonë dalin në pah stresorë të rinj, me të cilët prindërit duhet të përballen. Ndërkohë, të tjerë (Derguy et al., 2016; Ritzema & Sladeczek, 2011; Osborne & Reed, 2009) kanë gjetur se ashpërsia e çrregullimit kishte një lidhje më të fortë me stresin e përjetuar nga prindërit e fëmijëve të vegjël në moshë (katër vjeç ose më pak) se sa atyre të fëmijëve pak më të rritur.

Studiuesit i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë variablave mediatorë në marrëdhënien midis sjelljeve të vështira të fëmijëve dhe stresit të prindërimit. Mjaft studime janë përqendruar ne hulumtimin e rolit të kognicioneve në marrëdhënie me stresin e prindërimit. Ato janë vlerësuar si një ndër faktorët kryesorë të lidhur ngushtë me stresin e prindërimit (Kartini, Cornish, Kummar, Park, & Golden, 2018) dhe parashikues domethënës të tij (Bohadana, Morrissey & Paynter, 2019). Në kushtet kur individi percepton se ka shumë pak kontroll mbi situata stresuese nëpër të cilat po kalon, perceptimet dhe kuptimi që iu jepet ngjarjeve marrin një rëndësi të veçantë (Paczkowski & Baker, 2008). Vlerësimi kognitiv është trajtuar si një ndër mediatorët kryesorë të stresit nga Lazarus dhe Folkman (1984). Sipas tyre, familjet që arrijnë të zhvillojnë vlerësime pozitive mbi ngjarjen stresuese janë më të suksesshme në përballimin e saj dhe përshtaten më mirë me stresin (Lazarus & Folkman, 1984). Sipas Quine dhe Pahl (1991) perceptimet dhe vlerësimi kognitiv i ngjarjes stresuese ndërmjetëson ndikimin që kanë sjelljet keqpërshtatëse të fëmijëve mbi stresin e prindërve. Disa studiues (Plant & Sanders, 2007; Hastings & Brown, 2002) kane gjetur se vlerësimet kognitive mund të jenë parashikues më të fortë të stresit të prindërve, sesa edhe vetë sjelljet e vështira të fëmijëve. Plant dhe Sanders (2007) kanë gjetur se vlerësimet kognitive luajnë rol të rëndësishëm mediator në ndikimin që ashpërsia e çrregullimit ka mbi stresin e prindërimit. Gjatë viteve të fundit, studiuesit kanë vendosur një theks të veçantë në aftësinë e familjes për të zhvilluar kognicione pozitive në lidhje me çrregullimin e fëmijës, në nevojën për t'i studiuar këto perceptime pozitive, në rolin e tyre në përshtatjen e suksesshme të prindërve, si edhe në përfshirjen e kognicioneve pozitive në punën klinike të zhvilluar me prindërit (Sarria & Pozo, 2015; Burke et al., 2012; Hastings & Taunt, 2002).

Në një studim të realizuar me nëna dhe baballarë të fëmijëve të diagnostikuar me autizëm, Sarria dhe Pozo (2015) gjetën se perceptimet pozitive lidheshin pozitivisht me përdorimin e strategjive aktive të përballimit të stresit për të dy prindërit dhe se ishin parashikues domethënës të mirëqenies psikologjike të të dy prindërve. Edhe studime të tjera në familjet e fëmijeve me nevoja të veçanta kanë gjetur se perceptimet e prindërve luajnë rol mediator mes sjelljeve të vështira dhe stresit të prindërimit (Rose, Nelson & Hardiman, 2016).

Tabela 1: karakteristikat demografike të kampionit (*N=105*)

Karakteristikat demografike	n(%)
Gjinia e fëmijës me autizëm	
Femra	64 (61)
Meshkuj	41 (39)
Mosha mesatare e fëmijëve me autizëm(SD)	7.95 (3.41)
Frekuentojnë shkollën/kopshtin	63 (60)
Nuk shkojnë në shkollë/kopësht	42 (40)
Mosha mesatare e nënave (SD)	38.1 (8.47)
Arsimi I nëvave	
Fillor	25 (23.8)
I mesëm	56 (53.3)
I lartë	17 (16.2)
Master	7 (6.7)
Statusi civil i nënëave	
E martuar	99 (94.3)
E divorcuar	3 (2.9)
E ve	2 (1.9)
Në bashkëjetesë	1 (1.0)
Të adhurat mesatare të familjes (SD)	36.936 lekë (32.24)
Nr. mesatar i fëmijëve në shtëpi (SD)	1.49 (.95)

Qëllimi i studimit: studimi në fjalë ka për qëllim të hulumtojë marrëdhënien midis sjelljeve të vështira të fëmijëve me autizëm, perceptimeve pozitive të nënave mbi fëmijën me autizëm dhe stresit të prindërimit, si edhe të ekzaminojë më tej rolin e mundshëm mediator të perceptimeve pozitive në marrëdhënien midis sjelljeve të vështira të fëmijës dhe stresit të prindërimit.

Pyetjet që udhëhoqën studimin ishin:

1. Cili është niveli i stresit të prindërimit midis nënave të fëmijëve me autizëm?
2. Cili është niveli i perceptimeve pozitive të zhvilluara mbi fëmijën me autizëm mes nënave?
3. A janë parashikues domethënës sjelljet e vështira të fëmijëve me autizëm dhe perceptimet pozitive të nënave, të stresit të prindërimit të raportuar prej këtyre të fundit?
4. A luajnë rol mediator perceptimet pozitive të gjeneruara mbi fëmijën me autizëm, në marrëdhënien midis sjelljeve të vështira dhe stresit të prindërimit?

2. Metodat

2.1 Pjesëmarrësit. Në studim u përfshinë 105 nëna (N=105) të fëmijëve të diagnostikuar me çrregullim të spektrit të autizmit. Kampioni i studimit ishte i qëllimshëm dhe u shtri në zonën jugore dhe qendrore të Shqipërisë**.** U përdor kampioni i qëllimshëm për shkak të vështirësisë për të arritur dhe aksesuar subjektet e popullatës së studimit, si edhe në kushtet e mungesës së një liste të fundme të popullatës (Stoneman, 2007). Kështu, nënat, pjesëmarrëse në studim, u kontaktuan dhe u ftuan për t'u bërë pjesë e studimit përmes organizatave dhe qendrave, ku ato vetë apo fëmijët e tyre marrin shërbime. Përzgjedhja e kampionit kaloi në dy faza. Në fazën e parë u përzgjodhën qendra dhe organizata në 6 qytete të ndryshme të Shqipërisë, të cilat ofrojnë shërbime për familjet apo fëmijët me autizëm, dhe që dhanë miratimin për t'i aksesuar nënat përmes tyre. Më tej, u përzgjodh kampioni i studimit mbështetur në kriteret paraprake të përzgjedhjes së subjekteve në studim. Kriteret përzgjedhëse për kampionin e studimit, të cilat u caktuan mbështetur në studime të mëparshme, të ngjashme me studimin në fjalë, ishin: pasja e një fëmije të diagnostikuar me autizëm; fëmija të jetonte në shtëpi me familjen; fëmija të ishte i moshës 3-17 vjeç. Përfshirja vetëm e nënave në studim u bë për disa arsye: së pari, ato janë më së shumti përkujdesëset parësore për fëmijët e tyre me autizëm; së dyti, studimet tregojnë se nënat përjetojnë nivele më të larta stresi prindërimi sesa baballarët (Tehee et al., 2009).

2.2 Instrumentet: Për hulumtimin e variablave të studimit u përdorën: një pyetësor demografik, PSI-SF, KIPP, ABC-C.

2.2.1 ***Informacioni demografik*** (mosha, arsimimi, të ardhurat, etj) u mor përmes një pyetësori demografik të hartuar nga studiuesja. Karakteristikat demografike të kampionit paraqiten në Tabelën 1.

2.2.2 ***Sjelljet e vështira dhe sfiduese****: Listëkontrolli i Sjelljeve të Pazakonta për Komunitetin* (Aberrant Behavior Checklist-Community – ABC-C; Aman & Sing, 1994) u përdor për të vlerësuar ashpërsinë e sjelljeve të vështira dhe sfiduese të fëmijëve të diagnostikuar me autizëm, të shfaqura këto në shtëpi, shkollë, kopsht. Listëkontrolli përbëhet nga 58 artikuj, të cilët grupohen në pesë fusha të sjelljes 1) Irritueshmëria / Axhitimi / Të Qara; 2) Letargjia / Tërheqja Sociale; 3) Sjelljet Stereotipike; 4) Hiperaktiviteti / Moskomplianca; dhe 5) Probleme në të Folur. Ky

instrument është vlerësuar i përshtatshëm për t'u aplikuar për të gjitha grupmoshat e fëmijëve me autizëm (Aman, 2012, Rojahn et al., 2013; Brinkley et al., 2007). Subjekteve u kërkohet të mendojnë për sjelljet e fëmijëve të tyre përgjatë katër javëve të fundit dhe të vlerësojnë, duke përdorur një shkallë Likert nga 0 (aspak problem) në 3 (përbëjnë një problem të ashpër), nëse ato përbëjnë problem për fëmijën. Pikët e artikujve mblidhen për secilën nënshkallë, si edhe për shkallën në total, duke përftuar, kështu, gjashtë grupe pikësh (Aman, 2012). Pikët e larta të nënshkallëve apo të shkallës në total reflektojnë ashpërsi të problemeve të sjelljeve që ato masin.

2.2.3 ***Perceptimet e prindërve:*** Shkalla e Kontributeve Pozitive në Familje shkëputur nga Inventari i Kanzasit mbi Perceptimet e Prindërve (Kansas Invetory of Parental Perceptions –KIPP; Behr, Murphy & Summers, 1992) u përdor për vlerësimin e perceptimeve të nënave në studim. KIPP është një instrument vetëraportues, i dizenjuar për të matur perceptimet e prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ai është i përbërë nga katër seksione, ku secili prej tyre mund të trajtohet si një shkallë më vete që mat aspekte të ndryshme të një kategorie perceptimesh mbi pasjen dhe rritjen e një fëmije me nevoja të veçanta.
Shkalla e Kontributeve Pozitive e KIPP fokusohet në zhvillimin e perceptimeve pozitive nga ana e prindërve se fëmija me nevoja të veçanta është burim kontributesh/prurjesh pozitive në familje. Kjo shkallë është e ndërtuar nga 9 nënshkallë; *Të Mësuarit përmes Përvojës me Probleme të Veçanta në Jetë, Burim Lumturie dhe Përmbushjeje, Forcë dhe Afrimitet në Familje, Të Kuptuarit e Qëllimit të Jetës, Ndërgjegjësim për Probleme të së Ardhmes, Rritje Personale dhe Maturi, Zgjerim i Rrjetit Social, Rritje Personale/në Punë, Krenari dhe Bashkëpunim.* Pas analizës paraprake të të dhënave, rezultoi se nënshkallët Zgjerim i Rrjetit Social, dhe Krenari dhe Bashkëpunim treguan besueshmëri shumë të ulët, ndaj ato nuk u përfshinë në analizën e mëtejshme të të dhënave. Në total, shkalla e përdorur ka 50 artikuj. Subjekteve u kërkohet të tregojnë nëse dakordojnë ose jo me pohimet e paraqitura, në një shkallë Likert, nga 1 (Nuk jam aspak dakord) në 4 (Jam shumë dakord).

Pikët për secilën nënshkallë sigurohen duke gjetur mesataren e pikëve për artikujt brenda një nënshkalle. Në të njëjtën mënyrë përftohen edhe pikët në total për shkallën. Pikët e larta të përftuara në këtë instrument mund të lidhen me ndërgjegjësim më të lartë të nënave mbi perceptimet e tyre pozitive, me perceptime më të forta apo përdorim më të madh të perceptimeve pozitive (Behr et al., 1992).
Për nënshkallët e shkallës së Kontributeve / Prurjeve Pozitive në Familje, koeficientët e besueshmërisë (alpha e Cronbach) janë raportuar me vlera midis .56 dhe .86, me një mesatare prej .77.

2.2.4 ***Stresi i prindërimit:*** *Indeksi i Stresit të Prindërimit-Forma e Shkurtuar* (Parental Stress Index Short Form – PSI-SF; Abidin, 2012) u përdor për të vlerësuar nivelin e stresit të perceptuar nga nënat brenda rolit të prindit. PSI-SF përbëhet nga 36 artikuj, të cilët vlerësohen në një shkallë Likert nga 1 (Aspak Dakord) në 5 (Jam Shumë Dakord). PSI-SF përbëhet nga tre fusha*: Distresi nga Roli i Prindit* (vlerëson stresin që vjen nga prindërimi dhe që u detyrohet faktorëve personalë që lidhen direkt me prindërimin, p.sh., kompetencat në prindërim), *Ndërveprimi Jofunksional Prind-Fëmijë* (reflekton pakënaqësinë e prindit nga ndërveprimi me fëmijën dhe perceptimin e sjelljeve të fëmijës si të papranueshme), dhe *Fëmija i Vështirë* (mat perceptimet e prindit mbi aftësitë vetërregulluese të fëmijës, dhe reflekton stresin që përjeton prindi nga vështirësia për të menaxhuar sjelljet e vështira të fëmijës).

Sa i takon pikëzimit, vlerat e përgjigjeve për PSI-SF mblidhen sipas nënshkallëve dhe shkallës në total për të përftuar pikëzimin e përgjithshëm të stresit të prindërimit, duke përftuar, kështu, katër grupe pikësh. Pikët më të larta tregojnë nivel më të lartë stresi. (Abidin, 2012).

Instrumenti ka gjetur një përdorim shumë të gjerë në studime të ndryshme mbi stresin në familjet e fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit (Manning, Wainwright, Bennett., 2011; McStay, Trembath & Dissanayake, 2014; Pozo & Sarria, 2014).

2.3 Procedurat dhe analiza e të dhënave

Autorët e instrumenteve të përdorura në studim janë kontaktuar dhe është marrë leja e tyre për përdorimin e instrumenteve për qëllimet e studimit. Instrumentet iu nënshtruan procesit të dyanshëm të përkthimit, nga gjuha angleze në shqip, dhe më pas nga shqipja në gjuhën angleze, për të siguruar kujdesin e përkthimit të tyre në gjuhën shqipe. Instrumentet u pilotuan në një kampion të nënave (N=15) të fëmijëve me autizëm.

Të gjithë subjektet u informuan mbi qëllimin e studimit, përdorimin e të dhënave, ruajtjen e konfidencialitetit dhe u mor leja e miratuar për përfshirjen e tyre në studim. Pjesëmarrja në studim ishte vullnetare.

2.3.1 Statistikat përshkruese

Për analizën e të dhënave u përdor Paketa Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS), versioni 23. Statistika përshkruese u përdor për përshkrimin e kampionit dhe veçorive demografike të tij. Për prezantimin e përgjithshëm të variablave të studimit u përdorën frekuencat, mesataret, devijimet standarde.

Analiza korrelacionale bivariate u përdor për hulumtimin e marrëdhënies midis variablave në studim.

2.3.2 Regresioni linear: Analiza e mediacionit

Regresioni linear u përdor për të parashikuar nivelin e stresit të prindërimit bazuar në sjelljet e vështira të fëmijëve dhe perceptimet e tyre pozitive mbi fëmijën. Po ashtu, regresioni linear u përdor për realizimin e analizës së mediacionit për të shqyrtuar nëse perceptimet pozitive luanin rol mediator në marrëdhënien mes sjelljeve të vështira dhe stresit të prindërimit. Analiza e mediacionit u krye duke përdorur qasjen e Baron dhe Kenny (1986). Analiza post-hoc u zhvillua përmes testit të Sobel-it (Preacher, 2015) për të testuar nëse ndikimi i variablit mediator në marrëdhënien mes dy variablave të tjerë ishte domethënës statistikisht.

Për të gjitha analizat e kryera, niveli i domethënies statistikore u caktua < 0.05 (Field, 2000).

3. Gjetjet

Për të gjitha instrumentet e administruara u përllogaritën statistikat përshkruese (mesataret, devijimet standarde, dhe intervalet e pikëve). Për të gjitha nënshkallët dhe shkallët në total u llogaritën koeficientët alfa të Cronbach, për të vlerësuar besueshmërinë përkatëse të tyre. Besueshmëria e të tre instrumenteve varioi nga e mirë, në shumë e mirë.

Rikodimet e artikujve, pikëzimi i nënshkallëve dhe i shkallëve në total, të ndara në nivele u bë sipas udhëzuesve përkatës të secilit instrument.

3.1 Të dhënat përshkruese

Stresi i prindërimit: Rezultoi se 16.2 % e nënave kanë raportuar stres prindërimi brenda vlerave normale, 58% e tyre raportuan nivel të lartë të stresit të prindërimit, dhe 25.7% raportuan stres në nivele shumë të larta, i quajtur ndryshe në nivel klinik, ku ndërhyrja dhe mbështetja profesionale është shumë e nevojshme. Sa u takon nënshkallëve të stresit të prindërimit, duket se perceptimi i fëmijës si i vështirë dhe stresi i lidhur me vecori të vetë prindit janë kontribuesit kryesore në stresin e prindërimit në total (përkatësisht M=39.00 SD=10.8; M=38.86, SD.10.5) të pasuara më tej nga stresi që vjen nga sjelljet disfunksionale të fëmjiës (M. 35.93, SD 9.1)

Sjelljet e vështira/të pazakonta të fëmijëve: Një pjesë e konsiderueshme(72.4%) e nënave në studim raportuan se fëmijët e tyre shfaqnin probleme të ashpra të sjelljeve të pazakonta 21.9% raportuan se fëmijët shfaqnin sjellje të vështira/të pazakonta në një nivel të moderuar, dhe më pak nëna (5.7%) raportuan probleme të lehta të sjelljeve të pazakonta të shfaqura nga fëmijët. Duket se shfaqja e sjelljve impulsive dhe hiperaktive nga fëmijët perceptohej më problematike nga nënat krahasuar me fushat e tjera të sjelljeve të vështira/të pazakonta (M.= 20.49, SD.=9.96), ndërkohë që vështirësitë në komunikim perceptoheshin si problemet më pak të ashpra ndër sjelljet e vështira të shfaqura nga fmëijët.

Perceptimet e prindërve: Pak më shumë e gjysma e nënave, 57.1%, raportuan një nivel të lartë të perceptimeve pozitive mbi përvojën e pasjes së një fëmije me autizëm, 41% një nivel moderuar perceptimesh pozitive, dhe 1.9% raportuan se përdornin një nivel të ulët perceptimesh pozitive.

3.2 Analiza korrelacionale

Për të eksploruar marrëdhënien mes tre variablave të marë në studim, fillimisht u realizua analiza korrelacionale bivariate e Pearson. Siç vihet re në Tabelën 2, rezultoi se sjelljet e pazakonta/të vështira të fëmijës me autizëm shfaqën një lidhje të moderuar, pozitive, me domethënie statistikore me stresin e prindërimit të raportuar prej nënave. Kjo do të thotë se, me rritjen e ashpërsisë së problemeve të sjelljeve të vështira të shfaqura nga fëmijët, nënat tentojnë të përjetojnë nivele më të larta të stresit të prindërimit.

Tabela 2. Analiza Korrelacionale midis Shkallëve në Studim

	ABC-C Tot	PSI-SF Tot
ABC-C Tot	-	**.501*****
KIPP Tot	**-.286***	**-.370*****
KIPP- MësonNgaProbl.	-.075	-.191*
KIPP-LumturiPërmbushje	**-.307****	**-.445*****
KIPP-BurimForce	-.131	-.225*
KIPP-KuptimJetës	-.050	-.241*
KIPP-Ndërgjegjësim	**-.322****	-.256**
KIPP-RritjePersonale	-.247*	-.378***

KIPP-RritjeKarriere	**-.329****	-.276**

*p< .05, **p<.01***, p<.001

Lidhje e moderuar, negative, me domethënie statistikore, rezultoi midis gjenerimit të perceptimeve pozitive dhe stresit të prindërimit. Gjenerimi i më shumë perceptimeve pozitive në lidhje me fëmijën me autizëm shoqërohet me ulje të stresit të prindërimit.

Midis sjelljeve të vështira/të pazakonta të fëmijëve dhe perceptimeve pozitive të gjeneruara nga nënat rezultoi një lidhje e dobët, negative (r= -.286*), por me domethënie statistikore. Kjo gjetje mund të sugjerojë se, sa më shumë sjellje të vështira të shfaqin fëmijët, aq më pak të prirura janë nënat për të zhvilluar perceptime pozitive në lidhje me situatën stresuese ku gjenden.

Nuk rezultuan marrëdhënie domethënëse midis karakteristikave demografike (mosha e nënës, mosha e fëmijës, të adhura mesatare të familjes) dhe tre variablave kryesorë të marrë në studim.

3.3 Analiza e mediacionit / Rezultatet e regresionit linear

Mbështetur në qasjen e Baron dhe Kenny (1986) u realizuan 4 regresione lineare për të testuar nëse marrëdhëniet midis të tre variablave ishin domethënëse.

Sjelljet e vështira si parashikues të stresit të prindërimit. Analiza e regresionin linear ku PSI-SF ishte variabli i kriter dhe ABC-C variabël parashikues, tregoi se sjelljet e vështira të fëmijës janë parashikuese domethënëse statistikisht të stresit të prindërimit të nënave, dhe shpjegojnë 25.1% të variancës së stresit të prindërimit, me një koeficient β=.501, p=.000. Kjo do të thotë se stresi i prindërimit rritet me .501% pikë për çdo përqindje që rritet ashpërsia e sjelljeve të vështira të fëmijëve.

Sjelljet e vështira si parashikues të perceptimeve pozitive. Sjelljet e vështira të fëmijëve me autizëm parashikuan në mënyrë doemethënëse statistikisht, 0.8% të variancës së përceptimeve pozitive të nënave. Ato rezultuan parashikues domethënës negativë të perceptimeve pozitive (β=-.286, p=.000).

Perceptimet pozitive si parashikues të stresit të prindërimit. Perceptimet pozitive rezultuan parashikues domethënës negativë të stresit të prindërimit, ku perceptimet pozitive shpjegojnë 13.7 % të variancës së stresit të prindërimit (β=-.370, p=.000).

Sjelljet e vështira dhe perceptimet pozitive në total si parashikues të PSI-SF, analizë e regresionit të shumëfishtë. Analiza e regresionit të shumëfishtë tregoi se sjelljet e vështira (β=.430, p= .000) së bashku me perceptimet pozitive (β= -.247, p=.000) janë parashikues domethënës të stresit të prindërimit të raportuar nga nënat dhe, së bashku, arrijnë të shpjegojnë 30.7% të variancës së tij.

Vihet re se efekti i sjelljeve të vështira të fëmijëve mbi stresin e prindërimit reduktohet -- ku β ndryshon nga 0.501 në 0.430 -- kur variabli i perceptimeve pozitive mbi fëmijët mbahet konstant. Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me mediacion të pjesshëm të perceptimeve pozittive në marrëdhënien mes dy variablave të tjerë në studim. Testi i Sobel konfirmoi se ndikimi i perceptimeve pozitive mbi fëmijët (variabli mediator) në marrëdhënien mes dy variablave të tjerë ishte domethënës (z=2.07, p <.05).

4. Diskutim

Qëllimi i këtij studimi ishte të kuptohej më shumë mbi stresin e prindërimit të nënave të fëmijëve me autizëm, duke hulumtuar rolin që luajnë sjelljet e vështira të fëmijëve dhe gjenerimi i perceptimeve pozitive nga ana e nënave. Një kampion i qëllimshëm prej 105 nënash plotësuan instumentet e PSI-SF, KIPP, dhe ABC-C.

Në përputhje me studime në kontekste të tjera (Pozo & Sarria, 2014; Davis & Carter, 2008) rezultoi se një pjesë e mirë e nënave raportuan nivele të larta dhe nivel klinik të stresit të prindërimit. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e nënave raportuan se perceptonin sjellje problematike te fëmijët e tyre. Midis dy variablave, ashtu sikurse edhe në studime të tjera (Herring et al., 2006; Plant & Sanders, 2007), rezultoi një marrëdhënie pozitive domethënëse, çka do të thotë se me rritjen e shfaqes së sjelljeve problematike e sfiduese për prindërit, nivelit i stresit të prindërimit tenton të rritet gjithashtu. Sipas McStay, Dissanayake, Scheeren, Koot dhe Begeer (2013) lidhja midis disa sjelljeve të vështira të fëmijëve, të tilla si: hiperaktiviteti, irritueshmëria, impulsiviteti apo moskomplianca, dhe stresit të prindërimit të nënave mund të ketë shpjegimin se nënat ndihen përgjegjëse për sjelljet e fëmijëve të tyre në publik, akoma më tepër duke qenë edhe kujdestaret parësore të tyre. Ato mund të ndihen të paragjykuara në aftësitë e tyre të prindërimit apo mbi mungesën e perceptuar te aftësive për të menaxhuar sjellje sfiduese e të papërshtatshme të fëmijëve të tyre në publik (McStay et al., 2014; Paynter, Riley, Beamish, Davies, Milford, 2013).Ndërhyrja mbështetëse e prindërve, me qëllim uljen e nivelit të stresit të prindërimit është fokusuar shpesh në trajnimin

dhe aftësimin e prindërve për të menaxhuar më mirë sjelljet e vështira dhe sfiduese të fëmijve. Mbështetja profesionale përmes këshillimit mund të jetë, gjithashtu, ndihmuese për prindërit, duke rritur burimet e suportit që ata marrin.

Studimi tregoi se me përjashtim të një pjese të vogël të nënave, (1.9%), pjesa tjetër e tyre arrinin të gjeneronin perceptime pozitive mbi fëmijën e tyre me autizëm, në nivel të lartë apo të moderuar. Kjo është një gjetje me rëndësi për punën klinike me nënat. Po ashtu, perceptimeve të kontributeve pozitive të fëmijës në familje rezultuan parashikues negativë domethënës të stresit të prindërimit, sikurse raportohet edhe në studime të tjera (Hastings & Taunt, 2002; Kayfitz, Gragg & Orr, 2010; Trute, Hiebert-Murphy, Levine, 2007).

Gjenerimi i perceptimeve pozitive mbi fëmijën rezuloi të kishte një efekt mediator domethënës, por të vogël mbi stresin e prindërimit. Kjo gjetje mbështetet nga studime të mëparshme, të cilat kanë treguar se zhvillimi i perceptimeve pozitive ka aftësinë ta mbrojë familjen nga stresi dhe të reduktojë ndikimin negativ të çrregullimit të fëmijës në familje (Hastings & Taunt, 2002; Pozo, Sarria & Brioso, 2014).Kjo gjetje na sugjeron se, nëse do të punohej në drejtim të riformulimit kognitiv dhe rritjes së gjenerimit të perceptimeve pozitive të nënave, pavarësisht sjelljeve të vështira që shfaqin fëmijët, ato mund të dobësojnë marrëdhënien mes sjelljeve të vështira dhe stresit të prindërimit të nënave, duke ndihmuar në lehtësimin e këtij të fundit.

Përzgjedhja e instrumenteve ne studim është një pikë e fortë e tij, pasi janë përzgjedhur instrumente ndër më të përdorurit në këtë fushë dhe që kanë rezultuar me të suksesshëm në matjen e variablave në studim, duke shfaqur, gjithashtu, vlera të mira psikometrike. Kufizim përbën fakti që, ashtu si pjesa më e madhe e instrumenteve psikometrike, ata nuk janë validuar për t'u përdorur në kontekstin shqiptar. Përmasat e kufizuara të kampionit, si edhe strategjia e kampionimit mund të përbëjnë një kufizim të studimit. Po ashtu, studimi shqyrtoi vetëm ndikimin e sjelljeve të vështira/të pazakonta në stresin e prindërimit. Të tjerë faktorë si, ashpërsia e çrregullimit, karakteristika të tjera të fëmijëve, mund të hedhin një tjetër dritë mbi stresin e prindërimit.

5. Konkluzione

Njohja dhe të kuptuarit e faktorëve që mund të mbrojnë prindërit nga efekti i padëshiruar i stresorëve, që mund të reduktojnë stresin e prindërimit të lidhur me rritjen e një fëmije me autizëm u vjen në ndihmë profesionistëve në zbatimin e ndërhyrjeve të hershme tek prindërit dhe në mbështetjen e tyre për të zhvilluar strategji pozitive dhe efikase të përballimit të stresit. Jo vetëm sjelljet sfiduese e të vështira të fëmijëve ndikojnë në përjetimin e niveleve më të larta të stresit të prindërimit, por duket se edhe ky i fundit, në mënyra të ndryshme ndikon në shfaqjen e më tepër sjelljeve sfiduese nga fëmijët (Paynter et al., 2013). Puna e profesionistëve në mbështetje të zhvillimit të fëmijës me autizëm është e domosdoshme, por jo e mjaftueshme. Lipset që puna e profesionistëve të përfshijë në mënyrë aktive edhe prindërit, të cilët kanë nevojë të aftësohen dhe fuqizohen më tepër në marrëdhënien e tyre me fëmijën me autizëm, në menaxhimin e stresit të prindërimit dhe përmirësimit të shëndetit të tyre mendor.

6. Referenca

Abidin, R. R. (2012). Parenting Stress Index Professional Manual (4th ed.). Lutz, FL: PAR.

Aman M.G., & Singh, N.N. (1994). The Aberrant Behavior Checklist-Community. East Aurora, NY: Slosson Education Publications, Inc.

Aman, M.G. (2012b, June Update). Annotated Biography on the Aberrant Behavior Checklist(ABC). Unpublished Manuscript. Columbus, OH: The Ohio State University.

Behr, S., Murphy, D. & Summers, J. (1992). User's manual: Kansas inventory of parental perceptions (KIPP). Lawrence: Beach Centre on Families and Disability.

Baron, R. M., & Kenny, D. A. (1986). The moderator-mediator variable distinction in social psychological research: Conceptual, strategic, and statistical considerations. Journal of Personality and Social Psychology, 51, 1173-1182.

Bohadana, G., Morrissey, S., & Paynter, J. (2019). Self-compassion: A Novel Predictor of Stress and Quality of Life in Parents of Children with Autism Spectrum Disorder. Journal of Autism and Developmental Disorders. https://doi.org/10.1007/s10803-019-04121-x

Brinkley, J., Nations, L., Abramson, R.K., Hall, A., Wright, H.H., Gabriels, R., . . . Cuccaro, M.L. (2007). Factor analysis of the Aberrant Behavior Checklist in individuals with autism

spectrum disorder. Journal of Autism and Developmental Disorders, 37, 1949-1959.

Burke, M., Fisher, H., Hodapp, M. (2012). Relations of Parental Perceptions to the Behavioral Characteristics of Adolescents with Down Syndrome. Journal on Developmental Disabilities, 18(2), 51-58.

Castejón, O.J., Galindez, P. T. IA., Villasmil, A., Grudbasum, E., Castejon, E.M. & Salones, de Castejón M. (2019). Autism Spectrum Disorder in a Developing country. A Clinical and Descriptive Study of 75 Infant and Young Patients. Biomedical Journal of Schientific and Technical Research. 19(4).

DOI: 10.26717/BJSTR.2019.19.003321

Davis, N.O., Carter, A.S. (2008). Parenting stress in mothers and fathers of toddlers with autism spectrum disorders: Associations with child characteristics. Journal of Autism and Developmental Disorders, 38(7), 1278–1291.

Derguy, C., Bailara, K., Michel, G., Roux, S., & Bouvard, M. (2016). The need for an ecological approach to parental stress in autism spectrum disorders: The combined role of individual and environmental factors. Journal of Autism and Developmental Disorders, 46(6), 1895–1905. https://doi.org/10.1007/s10803-016-2719-3.

Field, A. (2000). Discovering Statistics Using SPSS for Windows: Advanced Techniques for Beginners. Thousand Oaks, CA: Sage Publications, Inc.

Hastings R.P., & Brown, T. (2002). Behavior problems of children with autism, parental self-efficacy, and mental health. American Journal on Mental Retardation, 107, 222-232. doi:10.1352/0895-8017(2002)107<0222:BPOCWA>2.0.CO;2

Hastings, R.P., & Taunt H.M. (2002). Positive Perceptions in Families of Children With Developmental Disabilities. American Journal of Mental Retardation, 107(2), 116–127.

Hayes, S. &Watston, S.L. (2012). The Impact of Parenting Stress: A Meta-analysis of Studies Comparing the Experience of Parenting Stress in Parents of Children With and Without Autism Spectrum Disorde. Journal of Autism and Developmental Disorders 10(3). 10.1007/s10803-012-1604-y

Herring, S., Gray, K., Taffe, J., Tonge, B., Sweeney, D., & Einfeld, S. (2006). Behavior and emotional problems in toddlers with pervasive developmental disorders and developmental delay: associations with parental mental health and family functioning. Journal of Intellectual Disability Research, 50, 874-882.

Kartini, I., Cornish, K., Kummar, A. S., Park, M. S. & Golden, K. J. (2018). Parenting Stress and Resilience in Parents of Children With Autism Spectrum Disorder (AUTIZWM) in Southeast Asia: A Systematic Review. Frontiers in Psychology , 9 , 280. DOI=10.3389/fpsyg.2018.00280

Kayfitz, A.D., Gragg, M.N., & Orr, R.R. (2010). Positive Experiences of Mothers and Fathers of Children with Autism. Journal of Applied Research in Intellectual Disabilities,23, 337–343. http://dx.doi.org/10.1111/j.1468-3148.2009.00539.x

Kring, S.R., Greenberg, J.S., & Seltzer, M.M. (2008). Adolescents and Adults with Autism with and without Co-morbid Psychiatric Disorders: Differences in Maternal Well-Being. Journal of Mental Health Research in Intellectual Disabilities, 1(2), 53-74, doi: 10.1080/19315860801988228.

Lazarus, R.S, &Folkman, S. (1984). Stress, appraisal, and coping. New York: Springer.

Manning, M., Wainwright, L., Bennett, J. (2011). The Double ABCX Model of Adaptation in Racially Diverse Families with a School-Age Child with Autism. Journal of Autism and Devevelopmental Disorders, 41(3),320–331. doi:10.1007/s10803-010-1056-1

McStay, R.L., Dissanayake, C., Scheeren, A., Koot, H.M., & Begeer, S. (2013). Parenting stress and autism: The role of age, autism severity, quality of life and problem behavior of children and adolescents with autism. Autism. 1(9). doi: 10.1177/1362361313485163

McStay, R.L., Trembath, D., &Dissanayake, C. (2014). Stress and family quality of life in parents of children with autism spectrum disorder: parent gender and the Double ABCX Model. Journal of Autism and Developmental Disorders,44 (12), 3101-3118. doi: 10.1007/s10803-014-2178-7.

Neece, C.L., Green, S.A. , Baker, B.L. (2012). Parenting Stress and Child Behavior Problems: A Transactional Relationship Across Time. American Journal on Intellectual and Developmental Disabilities, 117(1), 48–66. doi: 10.1352/1944-7558-117.1.48

Osborne, L.A. & Reed, P., (2009). The Relationship between Parenting Stress and Behaviour Problems of Children with Autistic Spectrum Disorders. Exceptional children, 76(1), 54-73. doi: 10.1177/001440290907600103

Paczkowski, E., Baker, B., L. (2008). Parenting children with developmental delays: The role of positive beliefs. Journal of Mental Health Research in Intellectual Disabilities, 1(3), 156-175. doi: 10.1080/19315860801988392

Paynter, J., Riley, E., Beamish, W., Davies, M., & Milford, T. (2013). The double ABCX model of family adaptation in families of a child with an autism spectrum disorder attending an Australian early intervention service. Research in Autism Spectrum Disorders, 7(10), 1183-

1195. doi: 10.1016/j.rasd.2013.07.006, http://dx.doi.org/

Plant, K.M., & Sanders, M.R. (2007). Predictors of care-giver stress in families of preschool-aged children with developmental disabilities. Journal of Intellectual Disability Research, 51(2), 109-124. doi: 10.1111/j.1365-2788.2006.00829.x

Pozo, P., & Sarria, E. (2014). A global model of stress in parents of individuals with autism spectrum disorders (ASD). Anales de psicologia.30(1), 180-191. doi:/10.6018/analesps.30.1.140722

Pozo, P., Sarriá, E., & Brioso, A. (2014). Family quality of life and psychological well-being in parents of children with autism spectrum disorders: A Double ABCX model. Journal of Intellectual Disability Research, 58(5), 442-458. doi:10.1111/jir.12042

Preacher, K.J. (2015). Calculation for the Sobel Test. Shkarkuar nga http://quantpsy.org/sobel/sobel.htm

Quine, L., & Pahl, J. (1991). Stress and coping in mothers caring for a child with severe learning difficulties: a test of Lazarus' transactional model of coping. Journal of Community and Applied Social Psychology, 1, 57–70.

Ritzema, A.M., & Sladeczek, I. E. (2011).Stress in parents of children with developmental disabilities over time. Journal on Developmental Disabilities, 17(2), 21-34.

Rojahn, J., Schroeder, S.R., Mayo-Ortega, L., Oyama-Ganiko, R., LeBlanc, J., Marquis, J., & Berke, E. (2013). Validity and Reliability of the "Behavior Problems Inventory," the "Aberrant Behavior Checklist," and the "Repetitive Behavior Scale--Revised" among Infants and Toddlers at Risk for Intellectual or Developmental Disabilities: A Multi-Method Assessment Approach. Research in Developmental Disabilities: A Multidisciplinary Journal, 34(5), 1804-1814.

Rose, J., Nelson, L., & Hardiman, R. (2016). The Relationship Between Challenging Behaviour, Cognitions and Stress in Mothers of Individuals with Intellectual Disabilities. Behavioural and Cognitive Psychotherapy, 44(6),691-704. doi:10.1017/S1352465816000242

Saloviita, T., Itälinna, M., & Leinonen, E. (2003). Explaining the parental stress of fathers and mothers caring for a child with intellectual disability: a Double ABCX Model. Journal of Intellectual Disability Research, 47, 300-312. doi: 10.1046/j.1365-2788.2003.00492.x

Sanders, J.L., & Morgan, S.B. (1997). Family Stress and Adjustment as Perceived by Parents of children with autism or Down syndrome: Implication for intervention. Child and Family Behavior Therapy, 19(4), 15-32. doi: 10.1300/J019v19n04_02

Sarriá, E., & Pozo, P. (2015). Coping Strategies and Parents' Positive Perceptions of Raising a Child with Autism Spectrum Disorders, Autism Spectrum Disorder, Nga M. Fitzgerald (Ed.), Recent Advances, Itech. doi:10.5772/58966. http://www.intechopen.com/books/autism-spectrum-disorder-recent-advances/coping-strategies-and-parents-positive-perceptions-of-raising-a-child-with-autism-spectrum-disorders

Stoneman, Z. (2007).Disability Research Methodology Current Issues and Future Challenges. Nga S.L. Odom, R.H. Horner, M.E. Snell, J. Blacher (Eds.), Handbook of Developmental Disabilities (fq.35-54). The Guilford Press, NY

Tehee, E., Honan, R., & Hevey, D. (2009). Factors contributing to stress in parents of individuals with autistic spectrum disorders. Journal of Applied Research in Intellectual Disabilities, 22(1), 34–42. doi:10.1111/j.1468-3148.2008.00437.x.

Trute, B., Hiebert-Murphy, D., & Levine, K. (2007). Parental appraisal of the family impact of childhood developmental disability: Times of sadness and times of joy. Journal of Intellectual & Developmental Disability, 32(1), 1–9. doi: 10.1080/13668250601146753

Zablotsky, B., Bradshaw, C. P., & Stuart, E. A. (2013). The association between mental health, stress, and coping supports in mothers of children with autism spectrum disorders. Journal of Autism Developmental Disorders, 1380–1393.

https://doi.org/10.1007/s10803-012-1693-7

GJUHËSI - ALBANOLOGJI

Arritje dhe probleme në tekstet e gjuhës shqipe në arsimin 9-vjeçar*

Dr. Artan XHAFERAJ

Abstrakt

Në këtë kumtesë jemi përqendruar në disa arritje dhe probleme të reformës së altertekstit në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin 9-vjeçar. Kumtesa tërheq vëmendjen për uljen e numrit të teksteve alternative të gjuhës shqipe deri në 2-3 për çdo klasë. Përkrahet mendimi që të ndahet gjuha shqipe nga leximi duke filluar nga klasa e pestë. Kjo ndarje nuk e pengon integrimin e këtyre lëndëve me njëra-tjetrën. Propozohet gjithashtu që në ciklin fillor t'i lihet më tepër vend anës praktike; të ketë më shumë tema dhe ushtrime për drejtshkrimin e drejtshqiptimin, rrokjen etj. Edhe në ciklin e lartë të arsimit 9-vjeçar duhet t'u kushtohet rëndësi ushtrimeve për leksikun, morfologjinë, sintaksën dhe punëve me shkrim. Kjo është e domosdoshme sepse, gjatë të shkruarit, tek nxënësit e shkollave në arsimin parauniversitar vërehen mjaft shkelje të normave drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore e të pikësimit. Një vend të rëndësishëm zënë edhe vërejtjet për gabimet gjuhësore dhe shkencore në tekstet e gjuhës shqipe, të cilat kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm për njohjen dhe ngulitjen e shqipes standarde.

Fjalë kyçe*: reformë, altertekst, gjuhë shqipe, lexim, integrim, gabime gjuhësore.*

1. Reforma e altertekstit

Reformimi i sistemit arsimor parauniversitar u përqendrua, krahas të tjerave, edhe në reformën e botimeve shkollore. Në sistemin e botimeve shkollore u përfshi edhe reforma e altertekstit. Për përgatitjen e teksteve shkollore u përfshinë shumë aktorë: autorët, vlerësuesit, redaktorët, ilustruesit e botuesit.

Në qendër të reformës së altertekstit është botuesi. Konkurrenca e lirë në tregun e librit shkollor solli një aktivizim të shtëpive të ndryshme botuese dhe për rrjedhojë botimin e një numri të konsiderueshëm të teksteve alternative për çdo lëndë mësimore.

Në qendër të përzgjedhjes së teksteve është mësuesi, sepse ai punon me tekstin në klasë. Tekstet duhet të përzgjidheshin duke u mbështetur në plotësimin e 11 kërkesave që lidheshin me cilësinë e përmbajtjes, me karakteristikat teknike dhe me çmimin. Mësuesit gjatë përzgjedhjes duhet të përqendroheshin në përputhjen e përmbajtjes së tekstit me tematikën e programit lëndor, në përmbushjen e objektivave të programit lëndor, në përshtatjen e gjuhës së tekstit me moshën e nxënësve, në shkallën e vështirësisë e në sasinë e njohurive sipas moshës, në mundësitë e aftësimit të nxënësve për punë të pavarur e për të nxënit në grup, në mundësitë e tekstit për të nxitur të menduarit logjik, kritik, krijues e zbulues, në edukimin te nxënësit të ndjeshmërisë për barazinë ndaj gjinive, racave, feve, kombësive e pakicave. **Por, a është përfshirë realisht mësuesi në procesin e përzgjedhjes së teksteve?**

Procedurat e përzgjedhjes së teksteve ndryshuan: ato (tekstet) janë përzgjedhur në bazë shkolle, në bazë komune a bashkie ose me grup-shkollash për zona të caktuara. Megjithëse procedurat deri në përzgjedhjen përfundimtare të teksteve kanë qenë të rregullta dhe në dukje "transparente" në çdo hallkë, përvoja ka treguar të kundërtën. Në shumicën e rasteve ndërhyrjet nga MASH-i, nga Drejtoritë Arsimore Rajonale, nga Zyrat Arsimore dhe nga drejtuesit e shkollave ndaj mësuesve kanë qenë të zakonshme. Këto kanë bërë që të mos përzgjidhet gjithnjë teksti më i mirë, por teksti i diktuar. "Reforma e 'Altertekstit' është deformuar në mënyrë të atillë, saqë nuk vendos më teksti më i mirë, që rezulton nga konkurrimi që është bërë, të jetë teksti më i përthithur në shkolla, por rezulton që të jetë teksti më i

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore *"Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë në prag të reformës"* (29 mars 2014), Universiteri "Ismail Qemali", Vlorë.

tërhequr, ai që vendosin drejtorët e drejtorive arsimore në bashkëpunim me shtëpitë botuese, të cilat vendosin marrëdhënie, ndonjëherë pse të mos e themi, futet në atë që quhet trysni, në trysninë e politikës ose në trysninë e korrupsionit. Në të dyja rastet është korrupsion"[1]

Por gjithashtu numri i madh i teksteve alternative e bën të vështirë përzgjedhjen, sepse mësuesve nuk u del koha që t'i studiojnë këto tekste para se t'i zgjedhin. Përveç kohës së pamjaftueshme, vitet e fundit shtëpitë botuese nuk kanë dërguar tekste në çdo shkollë për t'i studiuar mësuesit e për t'i ruajtur në bibliotekën e shkollës. Sipas katalogut të teksteve të vitit shkollor 2013-2014, numri i teksteve alternative që janë botuar për lëndën e gjuhës shqipe në arsimin 9-vjeçar është 46.[2] Mendojmë që dy-tri tekste alternative për çdo lëndë është zgjidhja e duhur, në mënyrë që të rritet cilësia e përmbajtjes dhe konkurrenca të jetë më e madhe.

Megjithatë tekstet e gjuhës shqipe, në kontekstin e teksteve alternative, siç ka theksuar M. Gjokutaj, kanë pësuar ndryshime të ndjeshme. Lënda e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e saj është freskuar. Tekstet dhe njësitë mësimore brenda tyre shoqërohen me ushtrime me karakter të theksuar krijues; është rritur së tepërmi pjesëmarrja e nxënësve në veprimtari të gjera *të foluri*, *të shkruari*, *të lexuari*. Njohuritë nga fusha e gramatikës dhe e drejtshkrimit jepen në mënyrë aplikative dhe të shoqëruara me shumë ushtrime formimi gjuhësor[3]. Edhe ne mendojmë se në ciklin fillor duhet t'i kushtohet më tepër rëndësi anës praktike: të ketë më shumë tema dhe ushtrime për ndarjen e fjalëve në rrokje, për drejtshkrimin e drejtshqiptimin, normën gramatikore, futjen e koncepteve të fonologjisë metrike etj. Në këto tekste duhet të përfshihen të gjitha llojet e diktimeve. Kjo është e domosdoshme sepse nxënësit e shkollave në arsimin parauniversitar shkruajnë me shumë gabime drejtshkrimore e pikësimi.

Gjithashtu, në ciklin e lartë të arsimir 9-vjeçar, krahas aspektit teorik, duhet t'u kushtohet rëndësi punëve më shkrim; është e domosdoshme që të praktikohen më shumë modele analizash në morfologji e sintaksë, për arsye se nxënësit kanë vështirësi në dallimin e klasave të fjalëve, në përdorimin e tyre në përgjigjet me gojë e me shkrim, në lidhjen e fjalëve në sintagma sipas rregullave të shqipes, në mënjanimin e ndërtimeve të huaja sintaksore, si dhe në përcaktimin e funksioneve sintaksore.

Një e metë e teksteve të gjuhës shqipe është se në to mungojnë lehtësuesit teknikë që ndihmojnë përdorimin e tekstit, pra në shumë nga këto tekste nuk ka hyrje apo parathënie që të japë një përfytyrim për tekstin.

Lidhur me anën figurative, këto tekste janë bërë shumë tërheqëse. Ilustrimet janë të sakta dhe cilësore. Edhe lexueshmëria e shtypjes është e kënaqshme. Shkronjat janë të lexueshme për nxënësit; ato janë të përmasave të ndryshme për titujt, nëntitujt, tekstin dhe ushtrimet. Larmia e karaktereve *stilet, madhësitë, theksimet, hapësirat, zgjedhja e ngjyrave* përgjithësisht janë të përshtatshme me mësimet, pa marrë parasysh ndonjë rast[4] ku lloji i gërmës apo shkrimi me ngjyra të ndryshme i çdo shkronje të fjalëve vështirëson lexueshmerinë gjuhësore.

Për sa i përket integrimit të gjuhës me leximin, përvoja e deritanishme ka provuar se nuk është i domosdoshëm që të bëhet në një tekst të vetëm. Ky integrim mund të bëhet edhe në dy tekste të veçanta: një për gjuhën shqipe dhe një për leximin. Në këtë mënyrë ruhet edhe

[1] Shih: Shezai Rrokaj, *Një 'altertekst' bashkëkohor për arsimin shqiptar*, gazeta *Telegraf*, 10.06. 2013.

[2] Për lëndën e gjuhës amtare (abetares) në klasën e parë janë botuar 4 tekste alternative nga shtëpitë botuese: SHBLSH e Re, Shkronjë pas Shkronje, Mediaprint dhe abetarja mbarëkombëtare nga Pegi e Dukagjini; për gjuhën shqipe 2 u botuan 5 tekste alternative nga shtëpitë botuese: Albas, SHBLSH e Re, Mediaprint, Pegi dhe Morava; për gjuhën shqipe 3 u botuan 6 tekste nga shtëpitë botuese: SHBLSH e Re, Albas, Shkronjë pas Shkronje, Mediaprint, Pegi dhe Morava; për gjuhën shqipe 4 u botuan 7 tekste alternative nga shtëpitë botuese: Grafon, Morava, Sejko Infoservice, Shkronjë pas Shkronje, Albas, Pegi dhe Albtipografia; për gjuhën shqipe 5 u botuan 5 tekste alternative nga shtëpitë botuese: Shkronjë pas Shkronje, Pegi, Morava, Albas dhe Albtipografia; për gjuhën shqipe 6 u botuan 6 tekste alternative nga shtëpitë botuese: Shkronjë pas Shkronje, Vitrina 100, Morava, Albas, SHBLSH E e Re dhe Uegen; për lëndën e gjuhës shqipe 7 u botuan 3 tekste alternative nga shtëpitë botuese: Shkronjë pas Shkronje, Albas dhe Albtipografia; për lëndën e gjuhës shqipe 8 u botuan 5 tekste alternative nga shtëpitë botuese: Shkronjë pas Shkronje, Albas, Albtipogrfia, Erik dhe Uegen; për lëndën e gjuhës shqipe 9 u botuan 5 tekste alternative nga shtëpitë botuese: SHBLSH e RE, Arbëria 07, Shkronjë pas Shkronje, Albas dhe Uegen.

[3] Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 38.

[4] Shih titujt e mësimeve: B. Çerraga; E. Gjikaj, *Gjuha shqipe 2*, Mediaprint, 2008.

pavarësia e çdo teksti duke u përqendruar më mirë vëmendja edhe te gjuha shqipe, edhe te leximi, mbasi kalimi i herëpashershëm nga temat e gjuhës shqipe tek ato të leximit i shpërqendron nxënësit. Për këto arsye mendojmë që ndarja e kësaj lënde në dy tekste të veçanta, që në klasën e pestë, është zgjidhja e duhur.

2. Norma drejtshkrimore në tekstet e gjuhës shqipe

Tekstet e gjuhës shqipe, sidomos ato të shkollës 9-vjeçare, kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm për njohjen dhe ngulitjen e normës së gjuhës standarde. Gjuha shqipe e përdorur në këto tekste duhet të përbëjë modelin gjuhësor, i cili ndikon në formimin gjuhësor të nxënësve. Për të parë zbatimin e normës drejtshkrimore shqyrtuam disa nga tekstet e gjuhës shqipe të klasave II-IX. Norma drejtshkrimore, përgjithësisht zbatohet mirë, megjithatë është e nevojshme që të bëhet një redaktim gjuhësor më i kujdesshëm, që të mënjanohen të meta të tilla, si:

1. Gabime në përdorimin e zanores *ë*, kryesisht pastheksore, fundore ose në kufij morfemash: *Fjalët… **shumërrokshe** ndahen…* [duhet: fjalët …. Shumërrokëshe ndahen …(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f. 36.*)]; *Nëna dje ka blerë **bojra** të reja.* [duhet: Nëna dje ka blerë bojëra të reja. (*Gjuha shqipe 2, Progres, f. 117.*)]; *Mirela po hekuros **gryksen.*** [duhet: Mirela po hekuros grykësen.(*Gjuha shqipe 2, Progres, f. 187.*)]; *Sot është **e dielë**.* [duhet: Sot është e diel.(*Gjuha shqipe 2, Progres, f. 117.*)]; *Ndaj pjesën në **paragraf**…* [duhet: Ndaj pjesën në paragrafë…(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f. 82.*)]; *Cilët janë personazhet **kryesor**? Plaku ishte **i mpreht.*** [duhet: Cilat janë personazhet kryesore? Plaku ishte i mprehtë. (*Gjuha shqipe 2, Progres, f. 97.*)]; *A kishte vepruar **drejtë** djali…* [duhet: A kishte vepruar drejt djali…(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f. 141.*)]. Për më tepër, fjala **rrobaqepësja** është shkruar herë më **ë**, herë pa **ë** në të njëjtën faqe.*(Gjuha shqipe 2, Progres, f. 69.).*

2. Përdorimi i gabuar i numërorit *tre* për gjininë femërore: *Formo **tre** fjali…* [duhet: Formo tri fjali… (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f. 50.*)]; *Krijo **tre** pyetje….*[duhet: Krijo tri pyetje…(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f.61.*)]; *Zgjidh **tre** fjalë tek vjershat…*[duhet: Zgjidh tri fjalë tek vjershat… (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f. 122.*)]; ***Tre** ditë më vonë…* [duhet: Tri ditë më vonë…(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,*f. 114.)]. Madje, në të njëjtin tekst kemi hasur edhe përdorimin e formës së gabuar *tri* për gjininë mashkullore: *Shkruaj **tri** emra të gjinisë femërore dhe **tri** emra të gjinisë mashkullore. Gjej **tri** mbiemra që fillojnë me pa dhe krijo fjali* [duhet: Shkruaj tre emra të gjinisë femërore dhe tre emra të gjinisë mashkullore. Gjej tre mbiemra që fillojnë me pa dhe krijo fjali (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f. 143, 204.*)].

3. Përdorimi i gabuar i përemrit pyetës *kush* për *cili*: ***Kush** është personazhi yt…* [duhet: Cili është personazhi yt…(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 56-57.)]; *Sa stinë ka viti? Po **kush** janë ato?* [duhet: Sa stinë ka viti? Po cilat janë ato? (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 123.)].

4. Përdorimi i gabuar i trajtës kohore të së ardhmes dhe të së ardhmes të së shkuarës së dëftores pa pjesëzën *të*: *Çfarë **do bësh** me shokët?* [duhet: Çfarë do të bësh me shokët? (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 75.)]; ***Do** e **kem** kujdes unë….* [duhet: Do ta kem kujdes unë…(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 152.)]; ***Do doje** dhe ti motër dhe vëlla…* [duhet: Do të doje dhe ti motër dhe vëlla…(*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 165.)]

5. Përdorimi i gabuar i trajtës kohore të së pakryerës së dëftores së foljes së parregullt *them*: *Ata **thonin** se Plaku i Krishtlindjes…* [duhet: Ata thoshin se Plaku i Krishtlindjes… (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 114.)].

6. Përdorimi i gabuar i grupit zanor *-ie-* tek forma veprore dhe joveprore e së tashmes, si edhe te pjesorja e foljes *ndiej*, madje temës së pjesores i është shtuar gabimisht flektivi *ë*: *Përshkruaj atë që **ndjen** kur lexon këtë vjershë. Pse poeti **ndjen** mall për Shqipërinë?*; *Si **ndiehesh**?; Nëse po, si je **ndjerë**?*; *A **ndiehet** shpesh e lumtur në klasë mësuesja? A **ndiehesh** më i rritur?* [duhet: Përshkruaj atë që ndien kur lexon këtë vjershë. Pse poeti ndien mall për Shqipërinë?; Si ndihesh?; Nëse po, si je ndier? A ndihet shpesh e lumtur në klasë mësuesja? A së kryerës së thjeshtë të dëftores së kësaj foljeje shkruhen me *-je-* dhe jo me *-ie-,* siç jepen në fjalinë e mëposhtme: *Çfarë **ndieve** kur lexove këtë pjesë?* [duhet: Çfarë ndjeve kur lexove këtë pjesë? (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 192.)].

7. Mospërdorimi i apostrofit pas përemrit pyetës *ç* dhe përdorimi i gabuar i tij tek përemri i pacaktuar *çdo* dhete nyja e përparme *të* me kuptim pronor në rasën kallëzore: ***Çpo** ndodh?; **Ç'do** mëngjes unë shkoj në shkollë.* [duhet: Ç'po ndodh? Çdo mëngjes unë shkoj në shkollë (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 154, 161.)]; ***Ç'farë** tregojnë fjalët e mëposhtme?* [duhet: Çfarë tregojnë fjalët e mëposhtme? (*Gjuha shqipe 4, Pegi, 2007, f.183.)*]; ***Ç'farë** ndjeu Harri?* [duhet: Çfarë ndjeu Harri? (*Gjuha shqipe 5, albPAPER, f. 102.*)]; *Çfarë e pyeti vajza **t'atin**?*[duhet: … e pyeti vajza të atin? Madje, edhe pyetja është formuluar gabim. Duhet: Për

çfarë e pyeti vajza të atin? *(Gjuha shqipe 2, Progres, f. 179.)*].

8. Përdorimi i gabuar i gjinisë së përemrit vetor të vetës III, shumës: *Gjej, tek pjesa, pesë* ***emra*** *të përgjithshëm… dhe ktheji* ***ato*** *në numrin shumës.* [duhet: Gjej, tek pjesa, pesë emra të përgjithshëm… dhe ktheji ata në numrin shumës. (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint, f. 153*.)].

9. Mospërshtatja në gjini e një grupi emëror me lidhje përcaktore: *Çfarë gjinie janë* ***këto emra****?* [duhet: Çfarë gjinie janë këta emra? (*Gjuha shqipe 2, Mediaprint,* f. 145.)].

10. Ndarja e gabuar e fjalëve në fund të rreshtit:

a. Janë ndarë gabimisht dyshkronjëshat: *të da**l**-**l**ojë, si**n**-**j**ali* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 209.), *ra**d**-**h**ë* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 206.), *shko**l**-**l**ës* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 162.), tme**r**-**r**ohem (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 155), *të ma**r**-**r**ësh* (Gjuha shqipe 2, Progres, f. 6), përkë**d**-**h**elte (Gjuha shqipe 5, Pegi,f.180.), *u**d**-**h**ëzime* (Gjuha shqipe 2, Progres, f. 5.)

b. Bashkëtingëllorja e vetme, mes dy zanoresh, nuk ka shkuar me zanoren që vjen pas: *pikë**r**-isht* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 187.), *sigu**r**-isht* (Gjuha shqipe 2, Progres, f. 7.), *të ana**l**-izojnë* (Gjuha shqipe 2, Progres, f. 7), *mo**d**-ern* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 168.), *Du**k**-agjini* (Gjuha shqipe 8, Shkronjë pas shkronje, f. 82.), *she**k**-ulli* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 79.), *maki**n**-eri* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 79), *njëmbë**dh**-jetë* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 98.).

c. Bashkëtingëllorja *j* e ndjekur nga një bashkëtingëllore tjetër shkon me zanoren që i prin dhe jo me zanoren që vjen pas: *shpe-**j**tësi* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 209.), *gje-**j**më* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 57.).

ç. Janë ndarë gabimisht grupet *nd, mb, ng*: *kamu**n**-**d**ur* (Gjuha shqipe 8, Pegi, f. 82.), *falemi**n**-**d**erit* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 184.), *po mu**n**-**d**oheshin* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 102.), *me**n**-**d**imet* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 74.), *e ë**m**-**b**ël* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 180.), *për she**m**-**b**ull* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 25.), *ti**n**-**g**ull* (Gjuha shqipe 5, Pegi, f. 74.). Në gjuhën shqipe këto grupe shqiptohen bashkë, edhe në ndarjen e rrokjeve shkojnë bashkë, kështu që edhe në fund të rreshtit nuk duhet të ndahen.

d. Është lënë gabimisht në fund të rreshtit një shkronjë e vetme: ***Sh****-kodrës* (Gjuha shqipe 8, Pegi, f. 82.).

11. Përdorimi i gabuar i shumësit të emrit *bri – brinjë* për *brirë* (Gjuha shqipe 4, Albas, f. 177.).

12. Vendosja e gabuar e parafjalës *nën* në grupin e ndajfoljeve të vendit (Gjuha shqipe 4, Albas, 2007, f. 93.).

Duke përfunduar, e ndiejmë të nevojshme të theksojmë se mangësitë e sipërpërmendura në tekstet e gjuhës shqipe, pavarësisht përpjekjeve të vijueshme të gjuhëtarëve, janë si pasojë e moskujdesit të duhur të autorëve, redaktorëve shkencorë dhe korrektorëve gjuhësorë, të cilët duhet ta bëjnë me përgjegjësi punën e redaktimit. Gjithashtu, duke qenë se në qendër të reformës së altertekstit është botuesi, shtëpitë botuese, të cilat kanë përgjegjësinë kryesore, duhet të bëjnë një punë më të organizuar e në mënyrë shkencore, të organizojnë trajnime me autorët e teksteve dhe mësuesit, si dhe të bashkëpunojnë ngushtë me departamentet e gjuhës shqipe dhe Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, për rritjen e cilësisë së teksteve të gjuhës shqipe dhe përmirësimin e shqipes standarde në këto tekste.

Literatura:

- *Dodi, A. Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004.*
- *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973.*
- *Gjokutaj, M. Didaktika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2009.*
- *Gjuha shqipe 2, Mediaprint, 2008.*
- *Gjuha shqipe 2, Pegi, 2008.*
- *Gjuha shqipe 2, Progres, 2008.*
- *Gjuha shqipe 3, Shkronjë pas shkronje, 2007.*
- *Gjuha shqipe 4, Albas, 2007.*
- *Gjuha shqipe 4, Morava, 2007.*
- *Gjuha shqipe 4, Pegi, 2007.*
- *Gjuha shqipe 4, Shkronjë pas shkronje, 2007.*
- *Gjuha shqipe 5, albPAPER, 2008.*
- *Gjuha shqipe 5, Pegi, 2008.*
- *Gjuha shqipe 7, Morava, 2006.*
- *Gjuha shqipe 8, Shkronjë pas shkronje, 2007.*
- *Gjuha shqipe 9, Shkronjë pas shkronje, 2008.*
- *Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore, ISP, Tiranë, 2003.*
- *Kazazi, Nj. Në gjurmët e një didakti, Tiranë, 2005.*
- *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet,ISP, Tiranë, 2003.*
- *Likaj,E; Çabej,M. Morfologji e shqipes standarde, Tiranë, 2013.*
- *Memushaj, R. Fonetika e shqipes standarde, Tiranë, 2011.*
- *Strategjitë e të mësuarit, ISP, Tiranë, 1995.*
- *Studime Albanologjike II, Gjuhësi, Tiranë, 2011.*

Veçori të fjalëformimit në prozat e Kadaresë "Darka e gabuar" dhe "Aksidenti"

Dr. *Evis Hudhëra*
evishudhera@gmail.com
evis.hudhera@univlora.edu.al

Abstrakt

Gjuha është guri që përdor një shkrimtar, për të ndërtuar veprën e tij. Ky mjet i rëndësishëm përdoret nga shkrimtari në stile të ndryshme, për ta bërë fjalën sa më të veçantë dhe më tërheqëse. Në veprën e çdo shkrimtari hasim fjalë e mjete të ndryshme stilistike të cilat përbëjnë anën më të rëndësishme të një vepre. Me anë të stilit dhe gjuhës, shkrimtari krijon fjalë e shprehje të ndryshme, krijon neologjizma me ngjyrime të larmishme leksikore. Ashtu si muratori që ndërton një mur duke gdhendur gurin edhe shkrimtari ndërton veprën duke përzgjedhur fjalën. Fjala e bukur shqipe zë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e Kadaresë. Fjalëformimet janë të shumëllojshme dhe të veçanta në letërsinë shqipe, çka e bëjnë veprën e tij tepër tërheqëse si nga ana leksikore stilistike. Gjithashtu, përdorimi dhe përzgjedhja e frazeologjizmave, antitezave dhe antonimeve janë ana më e rëndësishme e stilit të një shkrimtari. Interesi për të trajtuar dy elemente të rëndësishme të një vepre siç janë gjuha dhe stili, është i madh, dhe ngjall një kureshtje të pafundme pas çdo fjale e çdo shprehje. E gjithë tema e trajtuar mbi këto dy çështje, është fund e krye një vepër e ngritur mbi punën dhe veprën e një gjeniu të letrave shqipe siç është Kadareja. Bota e pasur gjuhësore, me mjete e forma të ndryshme leksikore e stilistike, ka qenë dhe do të mbetet e pafund për këdo që do të dojë të marrë përsipër një studim të tillë. Nuk mjafton një temë e vetme për të trajtuar të gjitha këto veçori, të cilat kanë fusha të gjera studimi. Jo vetëm gjuha dhe stili të marra në kuptim të drejtpërdreta na japin të plotë veçoritë e një vepre, por të gjithë nënelementët që përbëjnë gjuhën dhe stilin na hapin horizonte të reja studimi, për trajtimin e këtyre veçorive.

Fjalët kyçe: *gjuhë, stil, neologjizmë, semantikë, fjalëformim, leksikologji, frazeologji, antonim, antitezë, analizë gjuhësore*

Abstract

Language is a writer who uses the stone to build his work. This important tool used by the writer in various styles to make speech more unique and attractive. In his words every writer in the face of various stylistic devices which constitute the most important side of a work. With the style and language, the writer creates different words and phrases, creates neologisms with diverse lexical semantics. Mason as building a stone wall engraved with the writer builds work selected word. Albanian word occupies a significant place in Kadare's creativity. His word formation are diverse and specific in Albanian literature, which make his work more attractive by the lexical and stylistic. Also the use and selection of frazeologjizmave, antithesis and antonyms are the most important part of a writer 's style. Interest to address two important elements of a work such as language and style is great, and evokes an endless curiosity behind every word and every phrase. All topics addressed on these two issues, the top end is a work built on the work and the work of a genius of Albanian as Kadare. The world 's rich language, by means of various forms of stylistic lexical, has been and will remain endlessly to anyone who wants to undertake such a study. There is just a single topic to address all these features, which have a wide field of study. Not only the language and style made in terms of direct agricultural give us full particulars of an offense, but all sub-items that make up the language and style we study open up new horizons for the treatment of these features.

Keywords: *language, style, neologisms, semantics, word formation, lexicology, phraseology, antonym, antithesis, linguistic analysis*

Hyrje: Krijimtaria letrare e Ismail Kadaresë përbën një pasuri të veçantë për artin, kulturën, letërsinë, gjuhën e trevës jugore, por edhe gjuhën shqipe në tërësi. Kadare është njëkohësisht autoritet i zëshëm në letërsinë shqipe, sepse ai është shkrimtari i parë shqiptar i nominuar për çmimin Nobel. Ai shpalos në veprën e tij botën shpirtërore, zakonet, traditat, mjedisin shqiptar, por mbi të gjitha, përmes gjuhës artistike, mjeteve të shumta gjuhësore, ai e ngriti gjuhën dhe letërsinë shqipe në majat më të larta. Kadareja e mbledh me kujdes e me vullnet të jashtëzakonshëm nektarin e gjuhës shqipe, duke e bërë të pavdekshme për të gjithë brezat. "*Kadareja i dha një fytyrë moderne prozës shqipe, në të gjithë përbërësit e vet. Ai flaku prej saj rutinën dhe mjetet e harxhuara, theu skemat e strukturave të mendimit, të formave dhe të ligjërimit artistik, i solli asaj dimensionin filozofik e universal, e futi pra atë në shtratin e prozës moderne".*[1]

Metodologjia: I gjithë punimi ynë u mbështet mbi veçoritë gjuhësore dhe stilistike, ku në bazë të metodës shpjeguese dhe shteruese arritëm të japim një vështrim të hollsishëm mbi veprat e I. Kadaresë. Të gjitha veçoritë gjuhësore dhe stilistike i trajtuam në fushën, leksikore, fjalëformuese dhe atë semantike.

Qëllimi: Studimi i anës gjuhësore në aspektin fjalëformues në disa prej veprave të Kadaresë, kryesisht të atyre veprave të botuara prej autorit në vitet 2000. Ismail Kadare është një shkrimtar i veçantë që ka gjuhën e tij karakteristike, e cila të krijon mundësi të shumta studimi dhe interpretimi. Në studimin tonë kemi nxjerrë në dukje disa aspekte e veçori

1. Prurjet gjuhësore të Kadaresë, neologjizmat, formimet vetjake etj.

2. Veçori semantike në sistemin ndajfoljor, sidomos në ndajfoljet me prapashtesa.

1. Prurjet gjuhësore të Kadaresë, neologjizmat, formimet vetjake.

1.1. Neologjizmat në veprën e Ismail Kadaresë *Për të plotësuar kërkesat shprehëse, stilistike dhe sintaksore ne gjuhë lindin fjalë të reja, që quhen neologjizma".*[2] Ismail Kadare është një mjeshtër i krijimeve të fjalëve të reja, duke i dhënë gjuhës shqipe një rëndësi të veçantë në mënyrën e shprehjes. E veçanta e këtij shkrimtari të madh qëndron në lëmin e gjuhës shqipe, në këtë lëmë ku ai përzgjedh fjalën e bukur shqipe, për t'i dhënë një vlerë tjetër në veprat e shkruara prej tij. Ky shkrimtar i madh di ta përdorë fjalën shqipe duke iu përmbajtur rregullave të gjuhës shqipe, në fjalëformim, fjalëkrijime apo në rrafshin morfologjik dhe sintaksor. "*E veçanta e Ismail Kadaresë, pra, mbetet pikërisht në fushën e fjalëve dhe ka të bëjë me "lëndën" që zgjedh dhe përdor ai, me hapësirat prej nga vijnë prurjet leksikore dhe mjetet fjalëformuese, por edhe me atë proces shoshitjeje e shqyrtimi të përhershëm të këtij krijuesi për të shtuar ato lloje fjalësh e shprehjesh që u shkojnë përshtat dhe mëtimeve të tij krijuese dhe tematikës që ai trajton në veprat e veta".*[3] Kadareja ka mbajtur qëndrime të hapura ndaj gjuhës shqipe, duke përdorur metoda gjuhëpastruese dhe gjuhëpasuruese në të gjitha veprat që ai ka shkruajtur. Në këto vepra hasim shumë fjalë reja, të cila nuk i gjejmë në FGJSH. "*Një nga arsyet e asaj morie fjalësh që nuk i ka FGJSH është se Kadareja parapëlqen dhe përzgjedh për indin e veprave të tij edhe shumë fjalë të trevave anësore, fjalë të bukura me ngjyresë të këndshme, që sjellin hijeshi e larmi shprehjeje, që e njomin dhe e këngëzojnë prozën kadareiane, paçka se shumë syresh mund të jenë edhe fjalë a forma fjalësh të gegërishtes. Ai kërkon dhe nuk rresht së qëmtuari e së thithuri fjalën e dhënë bukur në popull e në letërsinë paravajtëse, prandaj ai merr dhe drejtpërdrejt nga të folmet popullore të gegërishtes, sidomos nga kosovarishtja dhe shkodranishtja".*[4] Ismail Kadareja ka krijuar një përvojë të veçantë në krijimin e veprave të tij, duke shfaqur një "vetiakësi" në përzgjedhjen e fjalëve që përdor, apo në mënyrat fjalëformuese që përzgjedh. Në çdo vepër të Kadaresë lexuesi has një numër të konsiderueshëm fjalësh, të cilat autori i përdor për të mënjanuar fjalët e huaja apo dhe fjalët vjetra në gjuhën shqipe. Me anë të neologjizmave të tij, Kadareja e kthen realen ne surreale, te huajën arrin dhe e kthen në kombëtare, duke e ruajtur tabanin popullor të pastër, ashtu siç janë veprat e tij të paarrira. Ismail Kadare i përdor të gjitha mjetet, mënyrat e fjalëformimit, për krijimin e fjalëve të reja

Formime parashteso-prapashtesore

Një mënyrë fjajalëformimi aktive është parashtesimi dhe prapashtesimi. Në veprën e

[1] J. Bulo, *"Magjia dhe magjistarët e fjalës"*, Tiranë, 1998, f. 178.
[2] Po aty, f. 267.
[3] T. Çaushi, *"Kadareja dhe fjala shqipe"*, Albas, 2004, f. 7
[4] Gj. Shkurtaj, *"Pesha e fjalës shqipe"*, UFO Press, 2009, f. 163.

Kadaresë gjëjmë përdorime të këtyre mjeteve fjalëformuese, të përdorura nga autori për krijimin ë fjalëve të reja.

a) Fjalë të formuara nga parashtesa sh-/ç-

Një shtrirje të gjerë ka parashtesa "sh-/ ç-". Me anë të këtyre parashtesave Kadareja formon fjalë të reja antonimike me fjalën temë. Të gjitha rastet e përdorimit të këtyre parashtesave janë janë aktive në leksikun që përdor Kadareja në veprat e tij.

Me anë të këtyre parashtesave janë përdorur fjalë të tilla si psh.: *shnjoh, shtrajtuar, çnderim, të çmeritur, ç'pres, çngrirë etj.*

b) Fjalë të formuara nga parashtesa për-

Ashtu si në mbarë shqipen edhe në veprën e Kadaresë, parashtesa "*për-"* del mjaft prodhimtare. Me këtë paarshtesë Kadareja formon fjalë të reja si psh.: *përndezje, përligjje, përvujtni, përbetar, përhumbje etj.*

c) Fjalë të formuara nga parashtesa mos-

Kjo lloj parashtese është tepër e përdorur nga Kadareja për krijimin e fjalëve të reja, me kuptimin e kundërt të fjalës rrënjë. Parashtesa "*mos-"* është tipke në stilin e Kadaresë, duke sjellë në veprën e tij fjalë të tilla si psh.: *moszbulim, mosndërhyrje, mosputhje, (i,e) mosmundshme, (i,e) mosrrokshme, mosditje, mostelefonim etj.*

d) Fjalë të formuara nga parashtesa stër-

Parashtesa "*stër-"* nuk ka përdorim të shpeshtë në gjuhën shqipe, por në krijimtarinë letrare të I. Kadaresë e hasim në disa formine, kryesisht në ato mbiemërore, foljore apo dhe emërore si psh.: (*i, e) stërerrët, stërmort, stërkthej etj.*

e) Fjalë të formuara me prapashtesat –th, -thi

Të tilla fjalë Kadareja i përdor për efekte stilistike, por nga ana tjetër edhe për efekte zvogëluese, psh.: *jetimth*, *kalendarth*, *hajthëm (i,e)*, *hotelth*, *libërth etj.*

f) Fjalë të formuara me prapashtesën –najë

Kjo lloj prapashtese është e përdorur dendur nga Kadareja, duke i dhënë frazës në të cilën ai e përdor një ngjyrim stilistik të veçantë dhe një hijeshi në ligjërim. "*Në qoftë se deri vonë në shqipen e shkruar dihet vetëm fjala akullnajë, si term i gjeografisë dhe i gjeologjisë, nëpërmjet prozës së Kadaresë marrin udhë e shtrijnë përdorimin edhe shumë fjalë të tjera".*[5]

Në veprat e marra në studim kemi shkëputur falë të tilla si: *gjithnajë, bornajë, fundajë, gjithkahnajë etj.*

1.2. Formime situacionale apo fjalë tipike kadareiane

Në veprën e këtij shkrimtari hulumton një numër të madh fjalësh të reja, të krijuara për nevoja pasuruese apo për nevoja pastruese të gjuhës letrare shqipe. Kadareja nuk rresht dhe së kërkuari sa më shumë fjalë nga tabani popullor, apo dhe nga të folmet krahinore. Lidhur me këtë drejtim, na duhet të përmendim dhe një vlerësim ndaj I. Kadaresë, të bërë nga GJ. Shkurtaj se "*Hulumtimi i pandërprerë, vjelja dhe përfshirja, e fjalës së bukur popullore nga Kadareja ka mëtime të thekshme gjuhëpastruese, gjuhëmbrojtëse dhe sidomos gjuhëfisnikëruese".*[6] Fjala që Kadareja përdor nuk përsëritet më shumë se një apo dy herë. Ai për çdo situatë krijon në fjalë të re.

divnes:

*"Që të kryhej **divnesa,** domethënë të dilnin fjalët e kolonelit të vdekur..."* Kadare, I., "Darka e gabuar" Onufri, 2008, f. 190

Kjo fjalë nuk gjendet në fjalorët e gjuhës shqipe, por është një fjalë e krijuar rishtas nga Kadareja, me qëllim që ta përshtat në situatën ku ai e përdor.

humbameno:

*"Qyteti nuk ishte ndonjë **humbameno** që të habitej prej vizitave."* Kadare, I., "Darka e gabuar" Onufri, 2008, f. 116

Një formim situacional i krijuar nga Kadareja është dhe fjala humbameno. Kjo fjalë është tipike e këtij autori, e cila nuk gjendet në FGJSH. Në këtë rast kjo fjalë përdoret me kuptim figurativ, ku autori na jep nocionin e një qyteti të humbur, i cili nuk ka parë kurrë kaq shumë njerëz.

paqtoj:

[5] T. Çaushi, *" Kadareja dhe fjala shqipe",* Albas, 2004, f. 67.
[6] Gj. Shkurtaj, "*Pesha e fjalës shqipe*", UFO Press, 2009, f. 164.

*"Një burrë i thinjur, kinse njohës i ligjeve e i paanshëm, rrekej më kot t'i **paqtonte**".* Kadare, I., "Darka e gabuar" Onufri, 2008, f. 90

Fjala *"paqtoj",* tipike kadareiane e cila përdoret veçanërisht në veprat e tij, duke i dhënë fjalës shqipe një ngjyrim tjetër stilistikor dhe duke e përshtatur me rrethanën në të cilën ai e përdor.

pseh:

*"Megjithatë, ne nuk e dimë gjer në fund **psehin** e trillit".* Kadare, I., "Darka e gabuar" Onufri, 2008, f. 167

Formim situacional, i krijuar nga Kadareja në vend të fjalës pse, duke krijuar një fjalë tjetër (psehin), domethënë për të gjetur përgjigjen, (psehin) e trillit.

zhartier:

*"Barku i bardhë i së fejuarës, i përzishëm si gjithçka, mes **zhartierash** dhe sëmbimit..".* Kadare, I., "Darka e gabuar" Onufri, 2008, f. 194

është një fjalë e përdorur nga Kadareja si formim situacional. Ky krijim i çastit duket se ka kuptimin e diçkaje të nxehtë, përvëluese.

2. Veçori semantike në sistemin ndajfoljor, sidomos në ndajfoljet me prapashtesa.

Nga studimi që kemi kryer kemi dalluar se Kadareja i përdor thuajse të gjitha llojet e ndajfoljeve, të gjitha parashtesat, prapashtesat që marrin pjesë në formimet ndajfoljore. Shumëllojshmëria e ndajfoljeve të përdorura nga Kadareja e bëjnë veprën e tij tepër të pasur si semantikisht dhe leksikografikisht. Elementi më i përgjithshëm kuptimor i ndajfoljeve është shprehja e cilësisë së veprimit, që ato mbartin, duke futur këtu dhe rrethanën. Por nga ana tjetër, ndajfoljet kanë edhe vlera sinonimike, duke i mbartur nga lidhja sintaksore brenda fjalisë ku ato marrin pjesë. Në studimin tonë i kemi lënë vendë anës teorike, lidhur me vlerat semantike të ndajfoljes. Meqenëse vetë ndajfolja ka kuptim të përgjithshëm, ky kuptim del në funksion të njësisë gjuhësore, nga këtej vërejmë lidhje të ngushta me mbiemrin, emrin, përemrin dhe foljen.

2.1. Ndajfolje me prapashtesën –as/-azi

"Sikundër tipi fjalëformues me prapashtesën –thi, tipi me prapashtesën –as/-azi ka tërësisht ngjyrim popullor, por ndryshe prej tij, nuk ka atë ngjyrim të fortë dialektor. Prandaj edhe shtrirja e ndajfoljeve të këtij tipi në përdorim është më e gjerë, stilistikisht më pak e kufizuar".[7]

Ndajfoljet me grupim tematik e semantik të ngushtë, njihen si ndajfolje që vijnë prej emrash: *thonjaz, fytas, gjarpazi* etj. Kjo është një pasqyrë përmbledhëse të disa ndajfoljeve:

ftohtazi:

*"Ashtu e dëgjoi edhe, **ftohtazi..."*** Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 179

Ndajfolje, me kuptim e dëgjon ftohtë, pa interes, pa respekt. E formuar prej mbiemrit i ftohtë kjo ndajfolje ka një ngjyrim të dukshëm figurativ;

heshturazi:

*"U ngrit dhe **heshturazi** eci drejt banjës".* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 184

Ndajfolje me kuptimin e veprimit që ndodh në heshtje në qetësi, pa u ndier;

ngrirazi:

*"Sytë e të dyve **ngrirazi** vështronin fytyrën e të burgosurit".* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 184

Kjo fjalë nuk ekziston në FGJSH të 1980 dhe 2006. Është një krijim i ri i Kadaresë, që përdoret në këtë fragment. Kjo ndajfolje formohet prej mbiemrit i ngrirë. Ndajfolja ngrirazi është sinonimike me ndajfoljen ftohtazi.

përpiktas:

*"Ndoshta po aq **përpiktas** jepeshin orët e mërzisë, shkaktuar së shumti pas bisedave nervoze të tij në telefon..."* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 39

Ndajfolje e gegërishtes verilindore, kryesisht e të folmes së Kosovës, ka të njëjtin kuptim si fjala përkatësisht. Kadareja e përdor këtë fjalë për të zëvendësuar fjalën e huaj respektivisht;

rrëshqitazi:

[7] J, Thomai, "*Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe''* Tiranë, 2004, f. 33.

*"Nga mënyra si ajo ngrihej, duke i hedhur një vështrim **rrëshqitazi..."*** Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 24

Diçka ndodh kalimthi, tërthorazi pa u vënë në dukje. *fig.* e shikon fshehurazi;

verbtazi:

*"E shihnin se ishin tërhequr **verbtazi** në këtë histori..."* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 38

Ndajfolje e formuar nga mbiemri "*i verbët"*, ka kuptim të figurshëm në fjalinë e përdorur. Veprimi ndodh në mënyrë të padukshme, ndodh verbërisht.

2.2. Ndajfolje me prapashtesën –thi

Një tjetër tip fjalëformues në gjuhën shqipe e përbëjnë ndajfoljet me prapashtesën "*–thi"*. Kjo lloj prapashtese ka ngjyresa të dukshme popullore, sidomos të dialektit geg.

kryengulthi:

*"Ajo shfaqje, **kryengulthi**, e gjithçkaje, herë i jepte një çlirim dehës..."* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 56

Ndajfolje e gurrës popullore, përdoret në dialektin gegë, por që Kadareja e përdor në veprat e tij duke e standardizuar disi këtë fjalë. Kuptimi i kësaj ndajfolje është që diçka ndodh në krahun e kundërt, me kokë poshtë.

lëndimthi:

*"E mbuloi prapë, po aq **lëndimthi**, dhe pa orën"*. Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 62

Fjalë e përdorur nga Kadareja me ngjyrim figurativ, duke e bërë frazën tepër të veçantë. Kjo ndajfolje ka kuptimin e kryerjes së një veprimi ngadalë e me kujdes, duke mos u ndier.

lingthi:

*"Ikte **lingthi** për të çuar urdhrin".* Kadare, I., "Kështjella" Onufri, 2003, f. 77

Një ndajfolje e formuar nga prapashtesa –thi, është tipike për kafshët, të cilat ikin me shpejtësi, fjalë të cilën Kadareja e merr nga folklori.

ngutthi:

*"Nën atë pirg të ngritur **ngutthi** u strehuan ushtarët..."* Kadare, I., "Kështjella" Onufri, 2003, f. 81

Përsëri një ndajfolje e formuar nga prapashtesa "-thi", e cila tregon se një veprim ndodh me shpejtësi, ngutas, me ngut.

rrëshqanthi:

*"Rojat hoqën **rrëshqanthi** dy njerëz të lidhur".* Kadare, I., "Kështjella" Onufri, 2003, f. 185

Ndajfolje e përdorur nga Kadareja me nuanca të dukshme stilistikore, e cila tregon se diçka tërhiqet me forcë, sinonimike me fjalët zvarrë, rrëshqitas.

vetëtimthi:

*"Iu duk se në qelqet e ngrehinave kapi **vetëtimthi** gjithë mërinë dhe ndërgjegjen e vrarë të qytetit"*. Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 116

Ndajfolja vetëtimthi përdoret me kuptimin aty për aty, sa hap e mbyll sytë, shumë shpejt si vetëtima në mënyrë të rrufeshme. Përveç kuptimit semantik mbart edhe ngjyrimin emocional të habisë.

2.3. Ndajfolje me prapashtesën –isht

Ndajfoljet e formuara me prapashtesën *"–isht",* përbëjnë tipin më të ri fjalëformues në gjuhën shqipe. *Prapashtesa "–isht"* në formimet ndajfoljore ka kuptimin e mënyrës së kryerjes së veprimit. Këto lloj ndajfoljesh në ditët e sotme janë shtuar tepër në ligjërimet librore, kjo për shkak të shkurtisë së frazës, dhe veçorive stilistike të përdorura nga autorë të veçantë. Tek ndajfoljet me prapashtesën *"–isht",* vërejmë karakterin intensiv të veprimit a gjendjes. Kjo lloj prapashtese në ligjërimin libror quhet prapashtesë e zgjeruar, ku bashkohet kryesisht me tema emrash dhe mbiemrash

butësisht:

*"Kur padroni doli, sytë e të dyve u ndeshën **butësisht."*** Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 160

Ndajfolje, e cila tregon se diçka ndodh me të butë, me një qetësi të "ëmbël".

dinakërisht:

***"Dinakërisht** u paraqitën thjeshtë si këngë grarishte."* Kadare, I., "Darka e gabuar" Onufri, 2008, f. 108

Kjo ndajfolje ka kuptimin e një dredhie, kur një veprim ndodh në mënyrë dinake, në këtë rast diçka fshihet në mënyrë dhelpërore.

dëshpërimisht:

*"Do të të dua gjithë jetën. **Dëshpërimisht** e jotja."* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 65

Një fjalë e re e cila nuk gjendet në FGJSH, e krijuar nga autori me qëllime stilistike dhe gjuhëpasuruese. Kjo ndajfolje e re në gjuhën shqipe ka kuptimin e diçkaje dëshpëruese, e një veprimi në dëshpërim.

ftohtësisht:

*"Ai ma ktheu **ftohtësisht** se edhe ai më kishte dhënë, gjithashtu, pjesën më të thyeshme të jetës së vet prej burri."* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 70

Ndajfolje me ngjyrim figurativ të dukshëm, e përdorur nga Kadareja për të treguar një sjellje indiferente të një personi, një qëndrim i ftohtë, mospërfillës.

gjakftohtësisht:

*"Kurse, me ç'kam kuptuar unë, ai e bën këtë pa nerva, **gjakftohtësisht.**"* Kadare, I., "Aksidenti" Onufri, 2010, f. 42

Fjalë e krijuar nga Kadareja, një ndajfolje e re në FGJSH. Kjo fjalë është sinonimike me fjalën me gjakftohtësi. Me një theks dhe stil të veçantë kjo ndajfolje jep një ngjyrim në ligjërim.

lumturisht:

*"Dallimin mes dy kohëve po e humbiste **lumturisht** tani*." Kadare, I., "Spiritus", Onufri, 1996, f. 69

Është e vështirë për të gjetur një ndajfolje tjetër që të zëvendësoj atë lumturisht. Ndoshta do të mund të shpreheshim kështu: Ishte i lumtur që dallimin mes dy kohëve po e humbiste tani, gjë që një mënyrë e tillë të shkruari nuk i shkon stilit të Kadaresë.

Përfundimet:

A. Në këtë punim arritëm të paraqesim një tablo të gjuhës dhe çështje që i takojnë anës krijuese të autorit. Sollëm modelet tipike në strukturat fjalëformuese të përdorura nga Kadareja. Të gjitha këto struktura i studiuam në rrafshin fjalëformues dhe në atë semantik. Aty gjejmë fjalë të reja të cilat nuk hasen në FGJSH, psh.: divens, këngëtim, paqtoj, mbrapshtor, senjoral, humneroj, etj..

B. Vëzhguam përdorim të gjithanshëm të leksikut në vepra të Kadaresë. Neologjizmat zënë një vend të veçantë në këtë pjesë. Duke u ilustruar me shembujt përkatës, arritëm të japim një tablo të veçorive leksikologjike të Kadaresë. (formimet parashtesore e ato prapashtesore *mosditje, mostelefonim stërkthej*, *çngrirë etj..*

C. Sollëm veçoritë e semantikës ndajfoljore në vepra të I. Kadaresë. Lidhjen mes semantikës ndajfoljore dhe individualitetit krijues të autorit. Me interes të veçantë ishte paraqitja dhe lidhja mes anës semantike dhe asaj stilistike. Ndajfoljet i trajtuam kryesisht si formime të reja me anën e prapashtesave, *zbehtësisht, trupërisht, tinëzisht, rrëshqanthi, ngutthi, rrëshqitazi, përpiktas, etj..*

Bibliografi

1. *Agalliu, F., "Gjuha e Nolit në veprat e tij origjinale", TOENA, Tiranë, 1999.*

2. *Bulo. J, "Magjia dhe magjistarët e fjalës", Tiranë, 1998*

3. *Çaushi. T, "Kadareja dhe fjala shqipe", Tiranë, 2004*

4. *Elezi. G, "Gjurmime gjuhësore e interpretime të shqipes 1", Shkup, 2012*

5. *Gramatika e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.*

6. *Lloshi, Xh., Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Tiranë, 2005.*

7. *Thomai, J., Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006*

8. *Thomai. J, " Prejardhja semantike në gjuhën shqipe", Tiranë, 1989*

9. *Thomai. J, " Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe", Tiranë, 2004*

10. *Islamaj, Sh, "Gjuha e Jakov Xoxës. Veçori leksiko-semantike dhe stilistike". Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë 2000, 420 p.*

11. *Islamaj. Sh, "Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe", Prishtinë, 1985*

12. *Samara. M, "Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe", Tiranë, 1985*

13. *Shkurtaj, Gj. "Pesha e fjalës shqipe", Tiranë, 2009.*

14. *"Fjalor i gjuhës shqipe", Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2006.*

Burimet

I. Kadare, "Kështjella", Onufri, 2003

I. Kadare, "Darka e gabuar", Onufri, 2008

I. Kadare, "E penguara", Onufri, 2009

I. Kadare, "Aksidenti", Onufri, 2010

Sjellja sintaksore e kryefjalës dhe kallëzuesit në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe

Dr. Merita ISARAJ
Universiteti i Gjirokastrës

Abstract

This paper focuses on a comparative study of the subject and object and their characteristics in imperative sentences in English and Albanian language. Although the subject in these sentences is absent in most of situations it is seen that a variety of subjects are possible in these sentences. The subject in imperative sentences is not a trace of Wh-movement and has an imperative operator which acts to these sentences, but the context is essential in the subject interpretation in these sentences.

The position of object and its movement in the sentences have made some scholars emphasize the imperative sentences are the same as declarative sentences concerning inner characteristics of VPh. Movement of the object is one of these common features. Another disctinctive feature is its hidden appearance different from declarative sentences

Verbs in English are more sensitive in terms of valence. In declarative sentences, a transitive verb can be turned into intransitive. In imperative sentences the absence of subject in most cases, it causes the search for verbs to change the valence, passes one or two valences, because, apart from the subject even the object may not also be expressed.

Key words: *imperative sentences, subject, object, valency, syntactic structure.*

Në këtë punim kemi bërë objekt studimi tiparet dhe sjelljen sintaksore të kryefjalës dhe kundrinorit në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze krahasuar me gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Në studimet gjenerative mbi fjalitë nxitëse sjellja e kryefjalës është një dukuri interesante që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve. Një nga veçoritë dalluese të fjalive nxitëse në shumë gjuhë indoevropiane është mungesa e kryefjalës. Kryefjala e pashprehur nga ana formale është gjithmonë një kryefjalë e nënkuptuar [*you* (ti)]. Në punimet tradicionale kryefjala e fjalive nxitëse është parë si një gjymtyrë që gjithmonë mungon te këto fjali. Në studimet e mëvonshme, ky konkluzion është kundërshtuar, duke vërejtur se një mori kryefjalësh janë të mundshme në fjalitë nxitëse-dëshirore. Vërejmë shembujt:

1) *You do that for me!*

   (Ti bëje këtë për mua!)

2) *Someone call the police!*

   (Dikush t'i telefonojë policisë!)

3) *The tallest of you sit at the back!*

   (Më i gjati të ulet në fund!)

Karakteristikë e kryefjalës në fjalitë nxitëse është roli tematik i saj, që dallohet dhe në fjalitë dëftore. Ky rol tematik është veprues *(agentive)*, i interpretuar si *intended agent (vepruesi i parashikuar)*. Në thelb fjalitë nxitëse kanë rol tematik të vepruesit. Kjo do të thotë që situata e shprehur nga fjalia nxitëse presupozon një veprues, i cili ka përgjegjësinë për të kryer

një veprim (përveç rasteve kur fjalia nxitëse përdoret për të shprehur një dëshirë). Edhe pse ajo mungon, kryefjala nënkupton një veprues që përmbush një kumtim të caktuar, p.sh. të mbajë shënim një adresë.

4) Write down the home address.

(Mbaj shënim adresën.)

Për të analizuar sjelljen sintaksore të kryefjalës në këndvështrimin gjenerativist dhe pozicionin e saj në projeksionin e fjalisë, po bëjmë një analogji të shkurtër të strukturës së fjalisë nxitëse, pozicionit të kryefjalës dhe ndryshimeve që ajo ka pësuar në periudhat e kahershme të gjuhës angleze e deri në periudhat bashkëkohore.

Në anglishten *e vjetër*, folja në fjalinë nxitëse paraprin kryefjalën dhe është e pozicionuar në K° (C°).

5) Be you in haste.

(Folja jam ti - kryef. - me nxitim)

Edhe në anglishten e *kohës së mesjetës* folja zë të njëjtin pozicion në fjalitë nxitëse pohore, kurse në fjalitë nxitëse mohore kryefjala vendoset midis foljes në pozicionin nistor dhe pjesëzës mohuese *not*.

6) Help you me.

Folje + kryef. + you - kund. mua

7) Depart you not from me.

Folje + kryef. + pjes. moh. + kund.

Ndihm + kryef. + folje + kund.

Në anglishten *e kohëve moderne,* në fazat e para kemi pothuajse strukturë të njëjtë të fjalisë me anglishten e mesjetës, por në këto fjali shfaqen edhe strukturat me ndihmësen *do*.Si folja ndihmëse, ashtu edhe folja bazë e paraprijnë kryefjalën në fjali dhe zënë pozicionin K° (Komplementuesi).

8) Do you have mercy on us.

(Kini mëshirë për ne. / Na mëshironi.)

Në anglishten bashkëkohore, ndihmësja *do* me funksionin përforcues dhe *don't* me funksionin mohor të kumtimit të fjalisë nxitëse, gjenden në fillim të strukturës së fjalisë dhe folja leksikore paraprihet nga kryefjala. Në fjalitë nxitëse me kryefjalë të shprehur, kryefjala duhet të paraprijë foljen-kallëzues. Vërejmë shembujt e mëposhtëm:

9) Do somebody read this handwriting.

Folja ndihm. + kryef. + folje...

(Dikush të lexojë këtë shkrim.)

10) Don't you bother.

Folja ndihm. + nuk + kryef. + folje.

(Mos u mërzit.)

11) You write on the board!

(Ti shkruaj në dërrasë!)

Te fjalitë 9, 10, 11 vërejmë se folja ndihmëse *do* zë pozicionin fillestar, pra vendoset në pozicionin K°(C°), kurse folja leksikore kalon në një pozicion më të ulët në pemën strukturore në fjali. Krahasuar me të dyja periudhat (anglishtja *e vjetër* dhe e periudhës *së mesjetës*), në anglishten moderne folja në fjalitë nxitëse me foljen ndihmëse *do* vendoset në pozicionin më të ulët të pemës strukturore të kësaj fjalie.

Përcaktimi i pozicionit dhe natyrës së kryefjalës të fjalisë nxitëse, si një kategori boshe, është çështje që i ka drejtuar gjuhëtarët në qasje të ndryshme. Me termat e gramatikës gjenerative, kategoria bosh në pozicionin e kryefjalës së fjalisë është emërtuar si *pro* ose *Pro* nga studiues të ndryshëm, edhe pse kanë një dallim mes tyre. Në projeksionin e një fjalie në një gjuhë T (Koha), koka e ST ka një tipar të veçantë: të gjitha fjalitë duhet të kenë kryefjalë. Por ky kusht nuk përputhet me strukturën sintaksore të disa gjuhëve, si frëngjishtja, italishtja dhe shqipja, gjithashtu, ku vepron parametri i kryefjalës zero. Në këto gjuhë kryefjala nuk mund të përshkruhet si plotësisht kategori zero. Asaj i mungojnë vetëm tipare të interpretueshme në ndërfaqësin fonetik, ndërkohë që ajo përmban tipare të interpretueshme në ndërfaqësin

semantik. Kjo do të thotë që nuk kemi prishje të semantikës së fjalisë, kuptimi i saj është i plotë. Në mënyrë konvencionale, kategoria bosh e pozicionit të kryefjalës është shënuar si *pro* gjatë fazës historike të gramatikës gjenerative. Kushtëzimi i pranisë së *pro* ose jo në fjali janë tiparet e kohës T, të eptimit foljor. Jo gjithmonë kemi një përputhshmëri të këtij kushti të domosdoshëm me realitetin gjuhësor të gjuhëve. PRO tregon "kryefjalën e nënkuptuar", veçori e gjuhëve pa eptim, del në fjalitë e pashtjelluara dhe merr një rasë zero. Ndërsa kategoria *pro* është kryefjala e pashprehur e fjalive që kanë folje të shtjelluara. Pra, kategoria *pro* është veçori e gjuhëve me eptim.

A është kryefjala në fjalitë nxitëse një gjurmë e *wh-movement* (lëvizja - wh), *pro* ose *PRO* apo thjesht një kategori tjetër bosh që krijohet si rezultat i veprimit të një rregulle të veçantë fshirjeje? Beukema dhe Coopmans-i[5] kanë hedhur idenë se kryefjala e pashprehur në fjalitë nxitëse është gjurma *wh* e një operatori bosh të vendosur në pozicionin nistor të kësaj fjalie. Duhet të theksojmë se *pro-drop* është parametri *çomskian* që i ndan gjuhët në gjuhë pro-drop

(gjuhët ku kryefjala në fjali mund të bjerë, si shqipja) dhe gjuhë *non-pro-drop* (gjuhët ku zakonisht në fjali nuk mund të hiqet kryefjala, si anglishtja).

Platzack-u dhe Rosengren-i (1997)[6] mendojnë se fjalia nxitëse nuk ka një kryefjalë sintaksore të vërtetë, por një argument veprues bosh në [Spec,VP]. Ch. Han (2000) i trajton këto hipoteza si të papërshtatshme për fjalinë nxitëse, sepse konkluzione të tilla e veçojnë rastin e kategorisë bosh vetëm në fjalitë nxitëse. Sipas saj, statusi sintaksor i kryefjalës bosh është PRO dhe referimi i saj mund të kundrohet nga tiparet interpretuese të operatorit urdhërues[7]. Chan-i propozon ekzistencën e një *operatori* urdhërues në sintaksën e gjuhëve, i cili përfshin një grup tiparesh morfo-sintaksore.

Operatori urdhërues karakterizohet nga tipari [*directive*], i cili i jep një forcë *ilokutore* shprehëse drejtuese dhe tipari [*irrealis*][8], i cili shënon modalitet. Ky modalitet ndihmon në përftimin e kuptimit se një gjendje e caktuar nuk është realizuar. Pra, forca ilokutore shprehëse na jep një urdhër a një udhëzim dhe dëshirën që folësi kërkon të plotësohet nga dëgjuesi apo personi, e cila merr kumtimin e caktuar. Forma logjike e urdhërores e përfshin këtë *operator urdhërues*. Gjithashtu, forca ilokutore drejtuese është si një udhëzim për dëgjuesin për të ndryshuar a pasuruar një modul të caktuar. Chan-i e emërton këtë modul si *plani i kërkesave* \ *detyrave* (*Plan set)* dhe Postdam-i si *lista* e *kërkesave* (*To-do-list)*. Ky modul *i dëgjuesit* (the listener) përmban një sërë qëllimesh, gjendjesh, çështjesh, të cilat ai dëshiron t'i kryejë dhe t'i plotësojë.

Potsdam-i përqafon përfundimet e Chan-it dhe thekson se struktura e frazës së fjalive nxitëse në anglisht ka ngjashmëri me strukturën e frazës së fjalive pyetëse. Chan-i *nuk e pranon veprimin e forcës shprehëse në fjalitë nxitëse duke u bazuar në aspektin pragmatik, pra në kontekstin pragmatik a ligjërimor të fjalisë nxitëse*[9]. Këto hipoteza bien ndesh me disa studiues të rrymës së semantikës gjenerative, të cilët e vënë theksin te forca shprehëse e koduar nga forma logjike e saj.

2. Pozicioni i kundrinorit në fjalitë nxitëse në gjuhën angleze dhe gjegjësit në gjuhën shqipe

Rizzi (1997) i përcakton strukturat e fjalive nxitëse dhe dëftore përkatësisht si struktura me foljen në fillim ("verb first") dhe ("verb second"), ku folja vjen e dyta, gjë që vë në dukje dallimet strukturore të dukshme mes periferisë së majtë të dy tipave të fjalive. Njëkohësisht theksohet dhe pozicioni bosh i kryefjalës te fjalitë nxitëse. Për sa i përket periferisë së djathtë të fjalive nxitëse, prania ose jo e kundrinorit është dukuria që i ka drejtuar studiuesit drejt qasjeve të ndryshme. Koopman, në analizën krahasuese të topikës së fjalive nxitëse dhe dëftore në gjuhën holandeze, arrin në përfundimin se fjalia nxitëse nuk mund të ketë një topikë të dukshme a të shprehur, nuk mund të ketë një përemër dëftor të shprehur dhe lejon fshirjen e temës (*topic drop)*. Vërejmë shembullin:

12) *<u>dat</u> leg even neer dat

boekje That put adv down

that book

13) leg even neer dat

boekje Put adv <u>down that</u>

<u>book</u> (Vendose poshtë atë libër.)

Nga shembulli vërejmë se duhet të kemi fshirjen e temës te fjalitë nxitëse.

Për sa i përket periferisë së djathtë, pozicion që zihet nga kundrinori, propozimi i Den Dikken-it parashikon një kundrinor të mundshëm në krahun e djathtë të fjalisë nxitëse. Sipas Koopman-it, nëse një gjuhë lejon si zhvendosjen në të djathtë dhe rënien e temës apo klitikut (*topic* ose *clitic drop*), atëherë kundrinori i pozicionuar në krahun e djathtë është i mundshëm.

14) Place *<u>it</u> on the table, that book.

(Vendose *atë* mbi tavolinë, *atë libër*.)

Në shembullin 14, te gjegjësi në shqip kundrinori është rimarrë si enklitik dhe nuk mund të ketë edhe formën e përemrit vetor në rasën kallëzore, edhe SE *atë librin.*

Pozicioni i kundrinorit dhe lëvizja e tij në fjali i kanë nxitur disa studiues të theksojnë se fjalitë nxitëse janë njësoj si fjalitë dëftore në lidhje me tiparet e brendshme të SF (VP). *Zhvendosja e kundrinorit* në fjalinë nxitëse përbën një prej këtyre tipareve të përbashkëta. Një tipar tjetër që e dallon kundrinorin në fjalitë nxitëse, nga ai në fjalitë dëftore, është shfaqja e tij në një formë jo të dallueshme (i fshehur). Haegeman-i për pozicionin e kundrinorit ngre pyetjen: *Çfarë kategorie bosh është kundrinori?* Sipas saj, *null objects* në fjalitë nxitëse janë ndryshore që lidhen nga një temë boshe. Pra, elementet kundrinore bosh mund të analizohen si gjurmë të elementeve të pashprehura të topikalizuara.

Një veçori e kundrinorit në fjalitë nxitëse në gjuhën shqipe është dhe *rimarrja e kundrinorit*, pra shprehja e tij si me formën e plotë emërore ose përemërore, ashtu edhe me një trajtë të shkurtër. Sh. Demiraj rimarrjen e kundrinës e sheh si *një dukuri të përgjithësuar, e shprehur me anë të formave të theksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para, pavarësisht nga topika e tyre para apo pas foljes kallëzue.* Dyfishimi i kundrinës shfaqet në gjuhët romane perëndimore dhe si dukuri sintaksore. Kjo është trajtuar si një ballkanizëm. E gjejmë në greqisht, shqip, spanjisht. *Gjuha shqipe dhe gjuha greke janë dy gjuhë me rend të lirë dhe fleksion të pasur; ato kanë klitikë përemërorë si për rasën kallëzore, ashtu edhe për rasën dhanore. Në fjalitë nxitëse në greqisht klitikët në funksionin e kundrinorit ndjekin kryefjalën; në shqip mund të vendosen para, në mes dhe pas foljes kallëzues*.

3. Valenca e foljes-kallëzues në fjalitë nxitëse

Si një kategori sintaksore gramatikore, koncepti i valencës shtjellohet si aftësia e një lekseme - atomet e sintaksës[13] - për të lidhur një numër të caktuar elementesh në një konstrukt apo strukturë gramatikore. Teoria e valencës është trajtuar jo shumë në gjuhësinë angleze. Modeli i valencës së foljes kushtëzohet nga karakteristikat e foljes për gjuhën nëfjalë dhe valenca, si teori, është më e përshtatshme te gjuhët flektive. Gramatikat tradicionale kanë pranuar shumë kohë më parë se forma e shtjelluar e foljes është pothuajse në mënyrë universale i vetmi element në një fjali dhe mund të konsiderohet si "*glue*", pra që i mban të gjitha elementet së bashku. Teorinë e valencës do ta vërejmë te folja-kallëzues e fjalisë dëftore krahasuar me një fjali nxitëse: *John bought Sara a house.*

Foljet në gjuhën angleze janë më të ndjeshme për sa i përket valencës. Një folje kalimtare mund të kthehet në jokalimtare.

15) *He moves.*

(Ai lëviz.)

He moves the car.

(Ai lëviz makinën.)

Në shumë gjuhë të tjera, ndryshe nga anglishtja, ndryshime të tilla të valencës nuk janë tëmundura. Folja duhet të marrë fleksionin e duhur për të ndryshuar valencën.

16) *You go!*

(Ti shko!)

17) *You go to your house!*

(Ti shko në shtëpinë tënde!)

Në gjuhën angleze kryefjala në fjalitë dëftore nuk mund të hiqet, ndryshe nga struktura e fjalive nxitëse në gjuhën shqipe apo angleze. Në rastin e fjalisë së përmendur më lart, folja kallëzues është trivalente, sepse rreth saj qëndrojnë përbërësit e fjalisë si: kryefjala - kundrinori i zhdrejtë - kundrinori i drejtë.

18) I bought *him* a book.

19) (Unë i bleva atij një libër.)

Ndërsa në fjalitë nxitëse mungesa e kryefjalës në të shumtën e rasteve bën që e njëjta foljetë ndryshojë valencën, kalon në një ose dy valente, sepse, përveç një kryefjale të munguar, edhe kundrinori në fjalitë nxitëse në mjaft raste mungon.

Bibliografi:

Ch. Han, The structure and interpretation of imperatives, Garland publishings, Inc, 2000, f. 140.

D. Kallulli, Direct object clitic doubling in Albanian and Greek, Oxford Studies in Comparative Syntax, 2001.

Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.

Haegeman, L., Introduction to government and binding theory, Cambridge University Press,1991

Han, The structure and interpretation of imperatives, Garland publishings, Inc, 2000, f. 142-145.

Mita, Hyrje në sintaksën gjenerative, Shpresa, Prishtinë, 2005, f. 78-79.

Quirk, R., Greenbaum, S., Leech, G., Svartvik, J., A comprehensive Grammar of the English Language, Longman, 1985.

Sh. Demiraj, Gjuhësi ballkanike, Logos, Shkup, 1994, f. 127-146.

The Causes of Miscommunication in Conversations between People from Different Cultures

Prof. As. Dr Kozeta Hyso
Department of Foreign Language
Faculty of Humanities
University of Vlora.
kozetahyso1@gmai.com

Abstract

Ever since our ancestors uttered their first grunts, miscommunication has been a part of our daily lives.

A customer misreads a policy, a colleague misinterprets a to - do, a couple clashes over a misunderstanding of who was supposed to pick up the kid. One would have thought that miscommunication would drop with the advancement of technology. Alas, this hasn't been the case. We're more connected than ever, yet we seem to stray only further from mutual understanding.

How does speaking a second language influence an individual's sense of social identity? In this paper, I will clarify some points of miscommunication which often stems from a misalignment of explicit and implicit meaning between the sender and receiver. Some people are straightforward; others expect you to read between the lines.

Phrasing your messages in an explicit manner prevents miscommunication. This is especially recommended in high-stake circumstances or when you don't know the other person well. If you're a service rep dealing with a new customer, for example, you'd better err on the side of explicitness.

Key words: *Communication, language acquisition, miscommunication inter language variation social identity etc.*

Introduction

Miscommunication often stems from a misalignment of explicit and implicit meaning between the sender and receiver. Some people are straightforward, others expect you to read between the lines.

Phrasing your messages in an explicit manner prevents miscommunication. This is especially recommended in high-stake circumstances or when you don't know the other person well. If you're a service rep dealing with a new customer, for example, you'd better err on the side of explicitness.

There's a tension between politeness and directness here. To make questions or commands more polite, we wrap them in indirectness. *"Give me your phone number",* turns into, *"would you mind giving me your phone number?".* You couldn't skip this process entirely, but it helps to be aware of its implications.

SLA researchers have by and large adopted the methods of mainstream sociolinguists and two very different approaches appear in their research according to the individual researcher's view of social context. Such a division in interpreting context is understandable: Context is an easy word to use but a very difficult concept to define. The notion of context involves a fundamental juxtaposition of two entities:

- A focal event
- A field of action within which that event is embedded

For sociolinguists, the focal event is language and the field of action is whatever else the researcher

is interested in. For the purposes of this review, I will note just one important way in which traditions differ. On the one hand, in most research in language variation and interactional sociolinguistics, context is taken as a given and is described in terms of categories that exist in advance of the focal instance of language use and endure throughout it. In this view, the setting of language use, as well as participants' cultural background, first language, second-language proficiency, gender, social status, and other social categories can be described independently of language use. On the other hand, the predominant approach taken by ethno methodologists and conversational analysts studying face-to-face communication is that pre-existing social categories are relevant in understanding a focal instance of language use only to the extent to which participants orient themselves to those categories in interaction. In this contrasting view, context is emergent and dynamic, and participants do not bring categories with them to an interaction but rather they are negotiated through interaction.

Implicit vs explicit communication

Sometimes we mean exactly what we say. *"Hand me a lemonade, please."* But sometimes our explicit message doesn't fully concur with our intention. *"Could you pass me that lemonade?" "Yes, I could,"* my friend replies, as he grabs and eats it himself.

Simple messages can be stuffed with implicitness. *"Enjoy that apple pie"* could be a neutral message. But I could also say it in a way that makes my friend feel guilty, or makes him wonder whether this particular apple pie has a special ingredient he didn't know about.

Phrasing your messages in an explicit manner prevents miscommunication. This is especially recommended in high-stake circumstances or when you don't know the other person well. If you're a service representative dealing with a new customer, for example, you'd better err on the side of explicitness.

There's a tension between politeness and directness here. To make questions or commands more polite, we wrap them in indirectness. *"Give me your phone number",* turns into, *"would you mind giving me your phone number?".*

Competitive conversational forms.

Many of our conversations take on counterproductive forms in which each side is merely out to seek status. In *"12 Rules for Life"* , Jordan B. Peterson discusses a few of such forms he encountered in his career as a psychologist and which you'll be sure to recognize.

- The stronger story. One person tells a good story. Instead of simply appreciating it, the other person only tries to top it. If the original storyteller returns the favor, such dialogues can quickly spin out of control to increasingly improbable storylines.

- Waiting to make your point. Instead of listening fully to what the other person is saying, you're just thinking about how you can jump in to make your own point.

- Victory for the point of view. Most discussions develop into this one. Instead of discussing to learn something new, people discuss with the sole purpose of claiming victory of the other person's point of view.

The conversational forms like these ones is that they prevent us from getting closer to understanding . If your ego is invested in your argument, you're not able to change your mind without losing your face

Written vs verbal

The message on mobile, or the chat, is another common cause of miscommunication. Verbal channels like phone or voice mail are better carriers for implicit meaning, while written channels like email or live chat are better for explicit communication.

There's an infinite number of ways to pronounce the word *"no."* In written communication the interpretation is fully left to the receiver, making miscommunication easier.

Poor listening skills

Julian Treasure argues that we're rapidly losing our listening skills. Our apps have thrown us in a constant state of distraction our headphones lock us in a private bubble.

Indeed, plenty of today's miscommunication can be blamed on the receiver's inability to focus. If you want to sharpen your listening skills, Treasure offers a few exercises to improve this one of the most 4 important skills of the language acquisition.

Cross cultural communication

In the past five years, several book-length studies and anthologies have been published that adopt a discourse approach to cross-cultural communication. The traditional practice of referring to one participant in an interaction as "native" and the other as "non-native" has been symptomatic of the way in which a bilingual's linguistic performance is viewed as problematic as and less acceptable than the native interlocutor. In recent years, however, there has been greater emphasis on cross-cultural communication as an accomplishment of both parties in a conversation and on a bi-directional interpretation of communication difficulties that takes both interlocutors' perspectives into account

More recently, however, a number of studies of communication strategies have examined the use of strategies to attain pragmatic or relational goals. In keeping with this approach, many of the studies reviewed here focus not on the communication of referential meaning but on interpersonal dynamics, the presentation of self, the multiple functions of a situated utterance, and the ways in which inter subjectivity is jointly constructed through interaction. As mentioned above, the dominant research methodology in the analysis of cross-cultural communication has been hermeneutic and qualitative.

The qualitative studies have generally shown that the communication of referential information in cross-cultural communication is not as problematic as might be believed.

Cross-cultural miscommunication may have negative social consequences for the bilingual participant, particularly in gate-keeping encounters where a native speaker controls the non-native speaker's access to some desired outcome. For instance, Albanians interviewees often respond minimally to questions posed by the interviewer. In contrast, Americans speaking Albanian sometimes fail to acknowledge the interviewer's higher status and provide more information than is required, a style that results in a low assessment of their proficiency in Albanian.

In the context of widespread racial and economic discrimination, cross- cultural miscommunication can have serious and damaging social consequences. The increasing hostility between individuals, as each side's negative judgment of the other's communicative style confirms and reinforces their initial prejudices.

Several researchers, however, have criticized explanations of cross- cultural miscommunication that rely solely on the different preferred cultural values and conversational styles prevalent in the two cultures. The critics point out that, in modem societies, individuals' identities are complex and fluid, ideologies about a particular group may influence individuals to be tolerant or intolerant of communication difficulties, and there is a great deal of diversity and conflict within any one culture.

Poor speaking skills

Similarly, often time's miscommunication can be blamed on poor speaking skills. Some people express themselves so incoherently that they're near impossible to follow.

One powerful communication tip is to speak with structure – for example by using a *what - so what - now what* approach. Start talking about the what. Then about why it's relevant. Then what the next steps should be.

Mental models

The above causes of miscommunication are about an actual misinterpretation of the explicit/implicit meaning of the message. But a larger type of miscommunication exists – one in which people are actually talking about the same things, but *differ on what these things mean*.

Such misunderstanding derives from differing mental models.

It'd be nice if we'd all see the world the same way. But we don't. In *"What? Did you really say what I think I heard?"* Sharon Morgan explains that our brains delete, misconstrue and misinterpret according to filters–biases, triggers, assumptions, beliefs, habits and mental models.

There's actually an ongoing epistemological debate between intelligent people over whether objective reality even exists. We won't reach a conclusion here, but that fact alone underlines the weight of mental models.

Conclusion

Sociolinguistics has become an increasingly important and popular field of study, as certain cultures around the worlds expand their

communication base and intergroup and interpersonal relations takes on escalating significance. Language use symbolically represents fundamental dimensions for social behavior and human interaction. The notion is simple, but the way in which language reflects behavior can often be complex. A slightly different concern with language and society focuses more closely on the effect of particular kinds of social situations on language structure. The study of language in its social context tells us quite a bit about how we organize our social relationships within a particular community. It is based on simple vocabulary choice but about the relationship and social position of the speaker and addresses. Sociolinguistics thus offers a unique opportunity to bring together theory, description, and application in the study of language.

References

- *Bachman, L. F. 1990. Fundamental considerations in language testing. New York: Oxford University Press.*
- *Canale, M. and M. Swain. 1980. Theoretical bases of communicative approaches to second language teaching and testing. Applied Linguistics.*
- *Douglas, D. and L. Selinker. 1985. Principles for language tests within the 'discourse domains' theory of interlanguage: Research, test construction and interpretation. Language Testing.*
- *Eckman, F. R. 1994. The competence-performance issue in second-language acquisition theory: A debate. In E. E. Tarone, S. M. Gass and A. D. Cohen (eds.) Research methodology in second-language acquisition. Hillsdale, NJ: L. Erlbaum.*
- *Ellis, R. 1985. Sources of variability in interlanguage. Applied Linguistics.*
- *Ferguson. In C. B. Paulston and G. R. Tucker (eds.) The early days of sociolinguistics: Memories and reflections. Dallas, TX: Summer Institute of Linguistics.*
- *Hall, S. 1992. The question of cultural identity. In S. Hall, D. Held and T. McGrew (eds.) Modernity and itsfutures. Cambridge: Polity Press in association with the Open University*.

SHKENCAT E EDUKIMIT

Metodat bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve të huaja.Teoria e James Asher mbi perdorimin e tyre

Phd.C.ELIONA NAQO
eliona.naqo@univlora.edu.al
eliona.naqo@gmail.com

Abstrakt

Detyra e klasifikimit dhe përshkrimit të metodave për mësimin e Gjuhëve të huaja,është veçanërisht komplekse. Eshtë e vështirë për t'iu përgjigjur pyetjeve: "Cilat janë metodat dhe qasjet kryesore, më të njohura ose më të njohura domethënëse, të cilat kanë karakterizuar historinë e mësimdhënies së gjuhës së huaj? "," Cilat janë kriteret më të rëndësishme efektive për të qenë në gjendje t'i përcaktojë ato? ".Studimi i evolucionit të metodave të mësimdhënies së gjuhës është një fushë magjepsëse hetimi,edhe pse veçanërisht 'i rrëmbyeshëm', siç e përcakton Stern (Stern, 1983: 452).Gjatë shekullit të njëzetë metodat u klasifikuan sipas skemave të ndryshme, bazuar në teoritë shkencore dhe psikologjike që qëndrojnë në themel të tyre, te kategoria e tyre tipologjike, te instrumentim i përdorur prej tyre dhe sipas periudhës në të cilën ato u zhvilluan dhe u përhapën (Chiapedi, 2009: 12).Në përputhje me natyrën ndërdisiplinore të mësimdhënies së gjuhës së huaj është e mundur të "lundrojmë" në evolucionin e metodave duke ndjekur kritere të ndryshme, secila bazuar në një element të veçantë për të nxjerrë në pah metoden më frytdhënëse. Disa nga kriteret më domethënëse për adresimin e "*navigimit"* mund të korrespondojnë, për shembull, me krahasimin e qasjeve dhe *metodave në bazë të përgjigjeve që u ofrojnë pesë pyetjeve "klasike",* të cilat shpesh përdoren për t'u adresuar, në mënyrë koncize dhe gjithëpërfshirëse, një pyetje veçanërisht domethënëse: *Kur? Si? Pse Kush dhe çfarë? dhe ku?*

Fjalëkyçet: *klasifikim, metodë, gjuhë e huaj, studim, efektivitet*

Abstract

The task of classifying and describing methods for learning foreign languages is particularly complex. It is difficult to answer the questions: "*What are the main, most well-known or well-known significant methods and approaches that have characterized the history of foreign language teaching?",* "What are the most important effective criteria for being able to define them? ".Studying the evolution of language teaching methods is a fascinating field of inquiry, though particularly 'captivating', as Stern defines it (Stern, 1983: 452).During the twentieth century the methods were classified according to different schemes, based on the scientific and psychological theories underlying them, on their typological category, on the instrumentation used by them and according to the period in which they were developed and spread (Chiapedi, 2009: 12). Consistent with the interdisciplinary nature of foreign language teaching it is possible to "*navigate*" the evolution of methods by following different criteria, each based on a specific element to highlight the most fruitful method . Some of the most significant criteria for addressing "*navigation*" may correspond, for example, to the comparison of approaches and methods based on the answers they provide to the five "classic" questions, which are often used to address, concisely and comprehensive, a particularly significant question: *When? how?Why? Who and what? and where?*

Keywords: *classification, methods, foreign language, study, effectiveness*

Hyrja

Mesimdhenia është kategori themelore e didaktikës dhe gjithashtu veprimtari dhe proçes i organizuar që ka për qëllim arsimimin dhe edukimin e nxënësve. Ajo paraqet një aspekt të rëndësishëm shoqëror. Proçesi i mësimdhënies është shumë kompleks pasi përfshin raporte dhe marrëdhënie të cilat duhet të gërshetohen dhe harmonizohen njëkohësisht dhe vazhdimisht. Veprimtaria e mësimdhënies kryhet kryesisht në institucionet pedagogjike dhe është e orientuar drejt zhvillimit të përgjithshëm të nxënësve ,edukatorëve, studentëve, etj.Mësimdhënia është veprimtari e organizuar, sistematike, krijuese e interaktive, institucionale ose joinstitucionale me qëllim të zotërimit të përmbajtjeve të përcaktuara, përvetësimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive, dhe aftësimin e nxënësve për punë të mëtejshme dhe të vazhdueshme. Qëllimi i mësimit është zhvillimi dhe krijimi i një personaliteti të nxënësit kritik, të lirë, të pavarur, kreativ, human, të arsimuar, multikulturor dhe shumëkonfesional, i cili është i hapur për të gjitha ndryshimet progresive aktuale dhe në të ardhmen, si për dhe në vetvete ashtu edhe në shoqërinë në të cilën jeton dhe vepron. Komponentët e këtij sistemi janë:

- Nxënësi (nxën dituri, fiton përvojë relevante, d.m.th. edukohet dhe promovohet)
- Mësuesi (arsimon, d.m.th. aktiviteti i tij është i orientuar drejt optimizimit të mësimit)
- Përmbajtja mësimore (përfaqëson bazën mbi të cilën mbështetet mësimi)
- Kushtet objektive (hapësirat dhe pajisjet mësimore ndikojnë direkt dhe indirekt në mësimdhënie)
- Marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të mësimdhënies janë një faktor me rëndësi për sukses

Metodat e mësimdhënies

Mësimdhënia më e mirë është ajo gjatë se cilës përmbushen objektivat, aktivizohet nxënësi, nxitet ndërveprimi, përdorën pyetje të niveleve më të larta, ku nxënësi është në qendër të mësimdhënies, zhvillohen aftësitë, të menduarit kritik e krijues, bëhet reflektimi dhe nxënësi aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur. Pra mësimdhënia është një proces i cili planifikohet, drejtohet, organizohet nga mësimdhënësi sipas stileve të të nxënit dhe me pjesëmarrjen aktive të nxënësve, ku përvetësohen njohuri, përdoren metoda, teknika ndërvepruese, zhvillohen aftësitë, shkathtësitë, formohen shprehitë si dhe ndodhë formimi tërësor i personalitetit të nxënësve.

Me mësuesin në qendër

Me këtë qasje vëmendja e të gjithë nxënësve është e drejtuar drejt mësuesit. Mësuesi flet dhe nxënësit dëgjojnë. Gjatë aktiviteteve nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, bashkëpunimi ndërmjet nxënësve nuk inkurajohet. Gjatë kësaj qasjeje, nxënësit heshtin, mësuesi ka kontroll të plotë mbi klasën dhe të gjitha aktivitetet në klasë. Ka raste kur kjo përkthehet në një klasë të disiplinuar. Mësuesi drejton të gjitha aktivitetet.

Me nxënësin në qendër

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton të nxënit aktiv, të menduarit në mënyrë kritike, krijuese dhe të nxënit me nxënësin në qendër. Në këtë rast, mësuesi dhe studenti ndajnë rolin kryesor. Nxënësit dhe mësuesit komunikojnë në të njëjtën mënyrë, promovohet puna në grup dhe nxënësit mësojnë të bashkëpunojnë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin.

Përgjigja totale fizike

Përgjigja totale fizike (Total Physical Response - TPR) është një metodë mësimi gjuhësore e zhvilluar nga James Asher, një profesor i psikologjisë në Universitetin Shtetëror të San José. Ajo bazohet në koordinimin e gjuhës dhe lëvizjes fizike. Në TPR, instruktorët i japin komandat studentëve në gjuhën e synuar me lëvizjet e trupit, dhe nxënësit i përgjigjen me veprime.Metoda është një shembull i qasjes së kuptimit të mësimit të gjuhës. Dëgjimi dhe reagimi (me veprime) shërben për dy qëllime: Është një mjet për të kuptuar shpejt kuptimin në gjuhën që mësohet dhe një mjet për të mësuar pasivisht strukturën e vetë gjuhës. Gramatika nuk mësohet në mënyrë të qartë, por mund të mësohet me anë të praktikës. TPR është një mënyrë e vlefshme për të mësuar fjalorin, veçanërisht shprehjet idiomatike, p.sh., foljet frazale.Asher zhvilloi TPR si rezultat i përvojave të tij duke i vëzhguar fëmijët e vegjël të mësonin

gjuhën e tyre të parë. Ai vuri re se bashkëveprimet midis prindërve dhe fëmijëve shpesh merrnin formën e fjalës nga prindërit, të pasuar nga një përgjigje fizike nga fëmija. Asheri bëri tre hipoteza bazuar në vëzhgimet e tij: *së pari*,se gjuha mësohet kryesisht duke dëgjuar; së *dyti,* se mësimi i gjuhës duhet të angazhojë hemisferën e duhur të trurit; *dhe së treti,* se gjuha e të mësuarit nuk duhet të përfshijë stres.

Përgjigjja totale fizike përdoret shpesh së bashku me metodat dhe teknikat e tjera. Është më e përhapur me fillestarët dhe me nxënësit e rinj, edhe pse mund të përdoret me nxënësit e të gjitha niveleve dhe të gjitha grupmoshat.

Njohuri të përgjithshme

James Asher zhvilloi këtë metodë si rezultat i vëzhgimit të zhvillimit të gjuhës së fëmijëve të vegjël. Asheri pa se shumica e ndërveprimeve që përjetojnë fëmijët e vegjël me prindërit ose të rriturit e tjerë kombinojnë aspektet verbale dhe fizike. Fëmija përgjigjet fizikisht ndaj fjalës së prindit, dhe prindi përforcon përgjigjet e fëmijës nëpërmjet fjalimit të mëtejshëm. Asheri gjithashtu vërejti se fëmijët e vegjël zakonisht kalojnë kohë të gjatë duke dëgjuar gjuhën përpara se të përpiqen të flasin dhe se ata mund të kuptojnë dhe reagojnë ndaj fjalëve që janë shumë më komplekse sesa ato që mund të prodhojnë vetë.Nga përvojat e tij, Asher përshkroi ***tre hipoteza kryesore rreth mësimit të gjuhëve të dyta.***

1. **E para** është se truri është i predispozuar natyrshëm për të mësuar gjuhën përmes dëgjimit. Në mënyrë të veçantë, Asher thotë se nxënësit më së miri e përvetësojnë gjuhën kur ata përgjigjen me lëvizje fizike në futjen e gjuhës. Asher hipotizon që e folura zhvillohet natyrshëm dhe spontanisht pasi nxënësit e përvetësojnë gjuhën e synuar përmes praktikës dhe se nuk duhet të detyrohen te flasin.

2. **Hipoteza e dytë e Asherit është se mësimi efektiv** i gjuhës duhet të angazhojë hemisferën e duhur të trurit. Lëvizja fizike kontrollohet kryesisht nga hemisferën e djathtë dhe Asheri e sheh lidhjen e lëvizjes me kuptimin e gjuhës si çelësin e mësimit së gjuhës. Ai thotë se mësimi me anë të hemisferës së majtë duhet të shmanget.

3. **Hipoteza e tretë e** Asherit është se mësimi i gjuhës nuk duhet të përfshijë stres, pasi stresi dhe emocionet negative pengojnë procesin natyror të mësimit të gjuhës. Ai e konsideron natyrën stresuese të shumicës së metodave të mësimdhënies gjuhësore si një nga dobësitë e tyre kryesore. Asheri rekomandon që mësuesit të përqendrohen në kuptimin dhe lëvizjen fizike për të shmangur stresin.

Kur duhet të përdoret?

Kjo metodë mund të përdoret për të mësuar dhe praktikuar shumë gjëra si:

- Fjalor i lidhur me veprimet
- Kohët e foljes: e kaluara / e tashmja / e ardhmja (Çdo mëngjes pastroj dhëmbët, rregulloj shtratin tim, ha mëngjesin.)
- Gjuhën e përdorur në klasë (Hapni librat.)
- Urdhrat (Ngrihuni, mbyllni sytë)
- Tregim historish/përrallash

Mund të përshtatet për të gjitha llojet e situatave mësimore, vetëm duhet të përdoret imagjinata.

Pse duhet të përdoret në klasë ?

1. Është shumë zbavitëse, nxënësit argëtohen dhe mund të jetë një nxitës i vërtetë në klasë. Ngre ritmin dhe humorin.

2. Ndihmon nxënësit të kujtojnë frazat ose fjalët.

3. Është një metodë e mirë për nxënësit kinestetikë, të cilët duhet të jenë aktivë në klasë.

4. Mund të përdoret në klasa të mëdha apo të vogla.

5. Nuk kërkon shumë përgatitje apo materiale. Për aq kohë sa mësuesi është i qartë se çfarë do të praktikojë (një provë paraprakisht mund të ndihmojë), nuk do t'i duhet shumë kohë për t'u përgatitur.

6. Është shumë efektive me adoleshentët dhe të rinjtë.

Parimet e metodës TPR :

1. Të zhvillohet fillimisht kuptimi i gjuhës së re para të folurit. Nxënësit mund të qëndrojnë në heshtje.

2. Lëvizja e trupit ndihmon ruajtjen e gjuhës.

3. Mënyra urdhërore përdoret për të drejtuar nxënësit

4. Vëzhgimi dhe kryerja e veprimeve janë të dobishme.

5. Rutinat fikse nuk janë të dobishme.

6. Risia është argëtuese, kështu që mësuesi duhet të jetë sa më kreativ dhe inkurajues.

7. Gjuha e folur preferohet të jetë e të njëjtës formë me atë të shkruarën.

8. Nxënësit do të flasin kur të ndihen gati dhe jo me detyrim.

Roli i mësuesit

Mësuesi luan një rol aktiv dhe të drejtpërdrejtë në Reagimin e Plotë Fizik. "Mësuesi është drejtues i një shfaqje në të cilën studentët janë aktorë". Është mësuesi që vendos se çfarë të mësojë, që modelon dhe paraqet materialet e reja dhe që përzgjedh materiale mbështetëse për përdorim në klasë. Mësimdhënësi inkurajohet të jetë i përgatitur dhe i mirë-organizuar në mënyrë që mësimi të vijojë pa probleme. Asher rekomandon plane të hollësishme të mësimit: "*Është efektive të shkruani shprehjet e sakta që do të përdorni dhe veçanërisht komandat e reja sepse veprimi është i shpejtë dhe zakonisht nuk ka kohë për të krijuar komanda në mënyrë spontane." Ndërveprimi në klasë është me në qendër mësuesin dhe jo nxënësin.* Edhe kur nxënësit bashkëveprojnë me nxënës të tjerë, zakonisht është mësuesi që lejon dhe komandon ndërveprimin:

Mësuesi: Maria, merrni kutinë e orizit dhe ia dorëzoni Miguelit dhe i kërkoni Miguelit të lexojë çmimin.

Megjithatë, Asher thekson, se roli i mësuesit nuk është aq shumë për të mësuar, sa për të ofruar mundësi për mësim. Mësuesi ka përgjegjësinë të ofrojë llojin më të mirë të ekspozimit ndaj gjuhës në mënyrë që nxënësi të mund të përvetësojë rregullat themelore të gjuhës së synuar. Kështu mësuesi kontrollon inputin e gjuhës që nxënësit marrin, duke siguruar lëndën e parë për "hartën njohëse" që nxënësit do të ndërtojnë në mendjet e tyre. Mësuesi duhet gjithashtu të lejojë aftësitë e të folurit, për ta zhvilluar atë sipas ritmit të nxënësve.Në dhënien e komenteve për nxënësit, mësimdhënësi duhet të ndjekë shembullin e prindërve. Në fillim, prindërit korrigjojnë shumë pak, por kur fëmija rritet, prindërit thuhet se tolerojnë më pak gabime në shqiptim. Në mënyrë të ngjashme, mësuesit duhet të përmbahen nga shumë korrigjime në fazat e hershme dhe nuk duhet të ndërpresin të korrigjojnë gabimet, pasi kjo do të pengojë nxënësit. Megjithatë, me kalimin e kohës, pritet më shumë ndërhyrje nga mësuesit, pasi e folura e nxënësve bëhet më e saktë dhe e rrjedhshme .Asheri i paralajmëron mësuesit rreth problemeve që ai mendon se mund të pengojnë zbatimin e suksesshëm të parimeve të TPR. Së pari, ai paralajmëron kundër "iluzionit të thjeshtësisë", ku mësimdhënësi nënvlerëson vështirësitë e përfshira në mësimin e një gjuhe të huaj. Kjo rezulton në ecjen me një hap tepër të shpejtë dhe dështimin për të siguruar një kalim gradual nga një fazë mësimore në tjetrën. Mësuesi duhet gjithashtu të shmangë të pasurin e një tolerancë shumë të vogël për gabimet në të folur.Si fillim, duhet pasur një tolerancë të madhe për gabimet e të folurit të nxënësve, por ndërkohë që mësimi përparon, toleranca ngushtohet .... Mos harroni se ndërsa nxënësit përparojnë në të nxënë,më shumë njësi të vëmendjes janë të lira për të përpunuar reagimet dhe vërejtjet nga mësuesi. Në fillim, pothuajse asnjë njësi vëmendjeje nuk është në dispozicion për të dëgjuar përpjekjet e mësuesit për të korrigjuar gabimet në shqiptim. Gjithë vëmendja është e drejtuar për të shqiptuar shprehjet. Prandaj nxënësi nuk mund të marrë pjesë në mënyrë efikase në korrigjimet e mësuesit.

Roli i nxënësve

Nxënësit në Reagimin e plotë Fizik- *Total Physical Response*, kanë rolin kryesore të dëgjuesit dhe interpretuesit. Ata dëgjojnë me vëmendje dhe i përgjigjen fizikisht komandave të dhëna nga mësuesi. Nxënësve u kërkohet t'u përgjigjen individualisht dhe kolektivisht. Nxënësit kanë pak ndikim mbi përmbajtjen e të mësuarit, meqë përmbajtja përcaktohet nga mësuesi, i cili duhet të ndjekë formatin e domosdoshëm për mësimet. Nxënësit gjithashtu

pritet të njohin dhe t'i përgjigjen kombinimeve të reja të artikujve të mësipërm:

Thëniet e reja janë kombinimet e përbërësve që keni përdorur drejtpërsëdrejti në mësim. Për shembull, ju i udhëzuat nxënësit me komandat 'Shkoni drejt tryezës'! dhe 'Uluni në karrige!'. Këto janë të njohura për nxënësit pasi ata janë praktikuar të reagojnë ndaj këtyre komandave. A do të kuptojë një nxënës nëse i jepni një komandë të re me një shprehje të panjohur që keni krijuar duke ri-kombinuar elementet e njohura (p.sh. "Uluni në tryezë!").

Nxënësve u kërkohet gjithashtu të prodhojnë kombinime të reja. Nxënësit monitorojnë dhe vlerësojnë progresin e tyre. Ata inkurajohen të flasin kur ndihen të gatshëm të flasin - domethënë, pasi një pjesë e mjaftueshme e gjuhës është përvetësuar.

Aktivitete që Mësuesi i Gjuhës duhet të dijë kur përdor metodën Reagim i Plotë Fizik .

- *Total physical response*
- Tregimi i një historie TPR (TPR Storytelling Session)

Duhet të tregohet një histori për të gjithë klasën. Mund të jetë për çdo gjë: përrallë, aventurë, madje edhe histori e frikshme dhe komedi. Duhet të tregohet me shumë gjeste dhe veprime, të cilat duhen përsëritur shpesh. (Kjo është mënyra TPR!)Një histori TPR ndan të gjitha elementet e një përrallë të madhe: një personazh i rëndësishëm, një komplot magjepsës dhe një fund që shpërblen dëgjuesit. Por përveç këtyre, një mësues i gjuhëve të huaja që përdor TPR duhet të kujtojë se historia është përdorur për t'u mësuar kuptimin. Pra, një histori e TPR duhet të përmbajë një përzierje të mirë të gjuhës amtare të nxënësve dhe gjuhës së synuar. Sidomos për fillestarët, mund të përdoret një dozë e konsiderueshme e gjuhës amtare të nxënësve, me një sasi më të vogël të gjuhës së synuar.

Simon thotë (Simon Says)

Një lojë e orientuar drejt fjalorit si Simon Says është analoge me procesin që ndodh kur fëmijët përfitojnë gjuhën e tyre të parë. Të rriturit shpesh japin udhëzime për fëmijët, *si "hidh topin" "hajde këtu" ose "haje ushqimin*". (Nëpërmjet përsëritjes dhe gjesteve, fëmijët janë në gjendje të kuptojnë se çfarë kërkohet nga mami.)Në këtë aktivitet, organizohet klasa në dy grupe. Çdo grup dërgon një përfaqësues për çdo raund. Ata duhet të qëndrojnë në pjesën e pasme të klasës, pranë murit, me sytë e tyre të fiksuar mbi mësuesin.Kur luan "Simon Says" duhet të përdoren komanda dhe veprime krijuese të cilat do të "aktrohen" nga nxënësit. Pra, në një klasë ku mësohet frëngjisht mund të thuhet, "Sautez trois fois!" (Kerce tri herë) ose "Pleurez!" (Qaj). Nxënësi që jep përgjigjen e saktë ka të drejtë të bëjë një hap përpara drejt "Vijës së Finish". Arritja e vijës së finishit sa më parë nga nxënësit e secilit grup, u jep 1 (një) pikë për ekipin. Ekipi i cili merr 5 pikë më shpejt fiton ndeshjen.

Gara e mrekullueshme (The Amazing Race)

"The Amazing Race- është një shfaqje televizive.

Por me këtë aktivitet, nuk do dërgohen nxënësit në një udhëtim emocionues nëpër botë. Nxënësit duhet të dërgohen për të përmbushur ndonjë detyrë ose komandë, ose për të treguar që të kuptojnë duke kryer komandat e përshkruara. (Me TPR, gjithmonë mund të kontrollohet nëse nxënësit të kanë kuptuar, sepse mund të dallohen veprimet e tyre.)Klasa mund të ndahet në katër ose pesë skuadra. Do të ishte ideale nëse ekipet do të përbëheshin nga tre deri në katër lojtarë. Detyrat që mund të zgjidhen për t'u dhënë nxënësve nuk kanë limit.Komandat ose detyrat duhet të jepen verbalisht.Për shembull, një detyrë mund të jetë një skenar "bring me" dhe mund t'iu kërkohet ekipeve në klasën tuaj të gjuhës angleze që t'ju sjellin një objekt yellow (të verdhë). Ose mund të kërkoni që klasa të yell (bërtasë) ngjyrën e tyre të preferuar.Ky aktivitet mund të zhvillohet dhe në oborrin e shkollës. Me "The Amazing Race" si një nga aktivitetet , nxënësit do të garojnë për përvetësimin e gjuhës.

Të kënduarit me të gjithë klasën

Këngët janë një aktivitet ideal për metodën TPR. Ato janë mjetet e përsosura të kujtesës që mund të ngulitin në mënyrë efektive gjuhën dhe lëvizjet në kujtesën afatgjatë.Të kënduarit së bashku si një klasë është një mjet i duhur për forcimin e kujtesës.

1. Së pari, duhet të përcaktohen fjalët e rëndësishme në këngë. Pra, fjalët që duhet të mbahen mend nga nxënësit.

2. Së dyti, duhet të zgjidhen gjestet e duhura shoqëruese për fjalët e përzgjedhura. Veprimi duhet të jetë i dukshëm për fjalët si "jump" (hidhu), "look" (shiko), "laugh" (qesh), etj.

Nuk është e nevojshme të mësohen këngët përmendësh dhe mirë do të ishte që tekstet e këngëve të shpërndahen. Qëllimi këtu nuk është që nxënësit të mësojnë përmendësh tekstet, është që ata të kuptojnë atë për të cilën po këndojnë : pra, qëllimi është të kuptuarit.

Perfundime

Mësimdhënia është një detyrë e ndërlikuar dhe me shumë aspekte për t'u marrë në konsideratë. Një listë e metodave apo teknikave për mësimdhënie do të përfshinte shumë ide e shembuj, dhe një diskutim i plotë për to do të zinte volume të tëra. Megjithatë, është e mundur që t'i grumbullojmë ato në disa fusha të përgjithshme të metodave, teknikave dhe përqasjeve të mësimdhënies që janë thelbësore për mësimdhënien e efektshme.Mësuesit para se të vendosin se cilat metoda do të përdorin në mësimdhënie, është e rëndësishme të kujtojnë se metodat dhe teknikat janë vetëm hapa për të arritur një qëllim, dhe jo një qëllim në vetvete. Të kujtuarit e qëllimit për përdorimin e një teknike ose metode të veçantë do t'i ndihmojë mësuesit ta zbatojnë atë në një mënyrë më kuptimplotë. Gjithashtu është e rëndësishme që të mbahet mend se pa përqëndrimin dhe vullnetin për të mesuar nga ana e nxënësve, edhe metodat dhe përqasjet më të efektshme të mësimdhënies nuk do të kenë sukses.

Literatura

- *Alex Thornton, Nichola J. Raihani: The evolution of teaching. In: Animal Behaviour. Band 75, Nr. 6, 2008, ISSN 0003-3472, S. 1823–1836.*
- *T. M. Caro, M. D. Hauser: Is There Teaching in Nonhuman Animals? In: The Quarterly Review of Biology. Band 67, Nr. 2, 1992, S. 151–174.*
- *Lisa K. Son, Dominic A. Simon: Distributed Learning: Data, Metacognition, and Educational Implications. In: Educ Psychol Rev. 24, 2012, S. 379–399.*
- *Bruner, J. S. (1966). Toward a Theory of Instruction. Cambridge, Massachusetts: Belkapp Press.*
- *Al Harrasi, K. S. (2014). Using "Total Physical Response" With Young Learners in Oman. Childhood Education, 90(1), 36-42. doi:10.1080/00094056.2014.872513*
- *Arshad, Z., Abdolrahimpour, M., & Najafi, M. R. (2015). The Use of L1 as a Consciousness-raising Tool in Teaching Grammar to Beginner and Upper-intermediate EFL Students. Journal Of Language Teaching & Research,6(3),633638.doi:10.17507/jltr.0603 .21*
- *Brown, H.D. & Lee, H. (2015). Teaching by principles: An interactive approach to language pedagogy (4th ed.). Toronto, ON: Pearson ELT.*
- *Han-Kwang, C. (2012). Efficient Analysis of Cognitive and Eclectics English learning approaches from the Perspective of Era of Knowledge-Economy--an Experimental Study of Preschool Education-. Journal Of Human Resources & Adult Learning, 8(1), 63-70.*
- *Jafari, S. M., Shokrpour, N., & Guetterman, T. (2015). A Mixed Methods Study of Teachers? Perceptions of Communicative Language Teaching in Iranian High Schools. Theory & Practice In Language Studies, 5(4), 707-718. doi:10.17507/tpls.0504.06*
- *Kelly, N., & Bruen, J. (2015). Translation as a pedagogical tool in the foreign language classroom: A qualitative study of attitudes and behaviours. Language Teaching Research,-19(2),-150-168. doi:10.1177/1362168814541720*
- *Mocanu, M. r. (2012). HUMANISTIC METHODS IN FOREIGN LANGUAGE TEACHING. Euromentor, 3(3), 71-79.*
- *Tehrani, A. R., Barati, H., & Youhanaee, M. (2013). The Effect of Methodology on Learning Vocabulary and Communication Skills in Iranian Young Learners: A Comparison between Audiolingual Method and Natural Approach. Theory & Practice In Language Studies, 3(6), 968-976. doi:10.4304/tpls.3.6.968-976*

- *Young, R. (2000). Silent Way. In , Routledge Encyclopedia of Language Teaching & Learning (pp. 546-548).*

Moduli shkencor, dija digjitale dhe cilësia në Universitet

Prof. dr. Nexhip Mërkuri
Fakulteti i Shkencave Humane
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
E-mail: nexhip_merkuri@yahoo.fr

Abstrakt

Autori pasqyron kërkimet disavjeçare për marrëdhëniet mes një nxënësi, studenti dhe një mësuesi, lektori në një klasë, auditor, duke i shtrirë më tej në marrëdhëniet me institucionet deri tek zgjerimi i këndit të nxënies. Është kërkuar variant rezultativ për këto marrëdhënie të suksesshme si moduli shkencor, mjetaplikacioni si pjesë e gjetshme konkrete e përdorshme në çdo njësi mësimore. Kërkimi gjerësohet tek kompetenca digjitale më të studiuara tek nivelet e shkollimit, në Universitet, lëndë të planit mësimor të cilat vijnë si eksperimente të realizuara, module. Mëshohet tek performanca e realizuar e qortuar edhe tek puna e pavarur në kohën e lirë për rritjen e cilësisë në Universitet, kërkesë, sfidë kryesore e vitit dhe e viteve të ardhshme për nxënës dhe studentë të suksesshëm.

Fjalë kyçe: *modul shkencor, aplikacione si mjete didaktike, dija digjitale, neurolinguistikë, formulë e re e të nxënit afatgjatë.*

Abstract

The resultant variant for these successful relationships has been sought as the scientific module, the application tool as a concrete findable part usable in each learning unit. The research expands to the most studied digital competencies at the levels of education, at the University, curriculum subjects which come as realized experiments, modules. It is emphasized in the realized performance and reprimanded in the independent work in the free time for the increase of the quality in the University, demand, the main challenge of the year and of the next years for successful pupils and students.

Keywords: *scientific module, applications as didactic tools, digital knowledge, neurolinguistics, new formula of long-term learning.*

Sistemet e edukimit e ndiejnë si domosdoshmëri informacionin sesi ngjiten shkallët e të mësuarit, apo të nxënies afatgjatë tek nivele të ndryshme shkollimi. Kanë marrë shtysë të re duke u mbështetur tek kërkimet neurolinguistike për rritjen e performancës në lëndën e gjuhës shqipe dhe module të tjera. Ka një thirrje sot, platformë globale, kërkesë, sfidë kryesore e vitit dhe e viteve të ardhshme për nxënës dhe studentë të suksesshëm. Kahet që duhet mëshuar më shumë: tek gjuha amtare, gjuha shqipe; por mund të vazhdohet edhe module të tjera në nivelet e shkollimit në Universitet.

Kërkimet për "*përgatitjen e brezave për epokën digjitale*" apo "*prurjet e revolucionit digjital*" koncepti "*shkollë digjitale*", sapo kanë trokitur tek secili në tri nivelet universitare. Artikujt e profesorëve me përvojë të gjatë në arsim, (Musai,2020 dhe Karameta,2020) citohen për rritjen e argumenteve. Profesorët si njohës shumë të mirë të treguesve në sistemin tonë arsimor kanë nisur hullinë me drejtimet e duhura të mundshme sot. Hulumtimi për të ngjitur shkallë të reja në renditje kombëtare për vlerësimin e zbatimit praktik të njohurive të ndërtuara nga nxënësit, studentët (kompetencat, performancat). Botime për " *kompetencën digjitale të nxënit me situata*" në nivelin parauniversitar nga studiues të IZH A-ës duke u nisur edhe nga treguesit e arritur në nivelet e arsimit tek lëndë me shumë orë në planin mësimor.

Studiues të tjerë përdorin edhe termin "*reading literacy*" me kuptimin: përdorimin, reflektimin dhe angazhimin në tekstet e shkruara. Nxënësi, studenti të arrijë qëllimet, të zhvillojë njohuritë dhe potencialin e tij dhe të marrë pjesë në shoqëri duke përmbushur kërkesat e kohës. Ky konceptim përfshin një rreth të gjerë të kompetencave njohëse, që nga deshifrimi deri te njohja e fjalëve të reja në vite shkollimi, gramatika, strukturat tekstuale dhe gjuhësore më të gjera të lëndëve, moduleve që parashikon plani mësimor i një klase apo i një niveli arsimi.

Suksesin e kërkojnë tek *të nxënit afatgjatë* si sinonim i plotë i *kujtesës afatgjatë* për të ndërtuar, dhe zbatuar njohuri të reja në situata të jetës që ndryshon. Duke reflektuar tek tregues të ndryshëm, në lëndën e gjuhës amtare, arsimi fillor apo në nivele më të larta: në lëndë, module tepër ballafaquese, kërkojnë të jemi të suksesshëm ashtu si edhe thirrja e Bankës Botërore. Fillohet në klasat e shkollës fillore që duhet t'i kushtojmë më shumë kohë nxënies së organizuar dhe të udhëhequr nga mësuesi me mjete didaktike për dijen digjitale; e më tej varësisht niveleve të nxënësve e studentëve. Hulumtime nëse mund të jetë një fillesë e pasuruar duke matur suksesin për veprimtarinë ushtruese dhe nxëniet afatgjatë.

Ndryshimet e kërkuara në vite për mësimdhënien dhe mësimnxënien kanë vijuar dhe vijojnë të jenë fushë e kërkimit shkencor edhe për gjuhën shqipe, module të tjera në nivele të ndryshme shkollimi gjatë 30/35 javëve të vitit shkollor dhe akademik. Hulumtimi mund t' u jap përgjigje me argumente pyetjeve të ndryshme:

Si të memorizohen kompetencat gjuhësore për çdo nivel shkollimi, pra një *nxënie që e aftëson* nxënësin, studentin ? A duhet të shpjegojë realizimin e situatës jetësore, gjuhësore, për një temë mësimi dhe të integruara ? Argumentohet ora e mësimit për nxënien e realizuar edhe jashtë mureve të klasës, auditorit me teknologjinë e kohës si mjete didaktike? Ka të gjitha semat, përbërësit kuptimorë fjala e re, "*nxënia afatgjatë*" që është futur në përdorim në vend të "*kujtesës afatgjatë*"? *Të nxënit* dhe *të mësuarit* sot a përdoren si sinonime, kur flitet shkruhet për nxënës dhe student të suksesshëm apo kërkon më tej të saktësohen kuptimet e secilës fjalë ?Duhet zgjeruar këndi i nxënies që prindi i cakton fëmijës si mjete të përhershme: fjalorë atlas, libra ushtrimesh veç teksteve bazë (Kraja,2009) ? Si do të përzgjidhen teoritë shkencore e të nxënit, rrjedhojat e rezultateve në nivelet e shkollimit ? Çfarë mund t'i shtosh skemës të nxënit : *të dëgjuarit, të lexuarit, të shënuarit, riprodhimi i pavarur, diskutimi, zgjedhja e problemave* (Kraja, 2009) ?

Përvoja në vite e mbi 50 vjet e profesorëve në Universitete mund të mëshohet tek nënvizimi i autorëve, kur flitet për të mësuarit zbulues dhe nënndarjen *Vlerësim formativ. Kërkimi.* Programet e rinj të gjuhës shqipe për klasat I-VIII, IX... e më tej u shoqëruan pas viteve 1990-të, me zhvendosje të madhe të kërkimeve në fushën e



neurolinguistikës. Me zhvillimin e teknologjisë, studiuesit mundën të studiojnë sesi truri i folësve normalë proceson gjuhën dhe si proces neurolinguistik. Në këtë mënyrë problemet marrin zgjidhje shumë të mira hapësinore të vendndodhjes së zonave të dëmtuara të trurit.

Gara e suksesshme e kompanive, sistemeve kompjuterike *Android* dhe *iOS*, kanë mundësuar hulumtuesit të gjurmojmë aktivitetin e trurit. Ç'ndodh tek truri i nxënësit, studentit, kur *lexon, dëgjon, flet, shkruan* ? Si mund të rritet *kujtesa, nxënia afatgjatë*, si kërkesë e çdo ore mësimi ?

Kjo mundësi hulumtimi në vite me ndihmën e programeve kompjuterike ku përfshihen informacioni i gjuhës, përpunimi i gjuhës, strukturat e trurit, si edhe neurofiziologjia, e cila kontribon në patologjinë e gjuhës, për dijen digjitale. Studimet e hershme të Paul Broca-s dhe Vernicke-s hetojnë vendndodhjen e moduleve specifike të gjuhës brenda trurit. Hulumtimi përfshin rrugën që ndjek informacioni gjuhësor përmes trurit pasi ai përpunohet. Nëse fusha të veçanta specializohen në përpunimin e llojeve të veçanta të informacionit, dhe si qendrat e trurit ndërveprojnë me njëri- tjetrin në përpunimin e gjuhës për *nxënien afatgjatë*. Pyetjet e lindura gjatë hulumtimit ishin të shumta për të zgjidhur, por do të ndalemi tek aplikacionet e mundshme, si mjete didaktike për dijen digjitale, fillesa, baza, evolimi dhe çfarë zgjidh, si rritet performanca e realizuar për nivelet e shkollimit.

Evolimi i mjeteve didaktike deri tek ato *smart* për dijen digjitale si sfidë për gjuhën amtare, e më shumë edhe si mjete të munguara vijnë vetëm pas kërkimit shkencor në vite të ndryshme shkollimi dhe madhësi të ndryshme njohurish të reja për të nxënit afatgjatë. Hedhja e hapit të sigurt me këto mjete didaktike na afron më shumë me popullsinë shkollore e kolegët e tjerë europianë. Zbatuesit e guximshëm: metodistë, profesorë të universiteteve, të cilët i prekin treguesit në rritje, shkruajnë se ka shumë përparësi përdorimi i teknologjisë në klasë, në auditorë, në shtëpi dhe komunitet gjatë kohës së lirë për zgjerimin e këndit të nxënies për module të ndryshme.

Alternativë për performancën e synuar *për matjen e njohurive, aftësive,* për nxënësin për klasën e dytë, të tretë, të katërt, të pestë dhe në vijim për gjithë lëndën e gjuhës shqipe të arsimit 9-vjeçar,dhe moduleve në vite shkollimi. Pra, mjete didaktike bashkëkohore si edhe gjuhët e përparuara, të cilat paraqiten në skemën e mëposhtme*:*

Hulumtim tek synimi i mundshëm që programi kompjuterik mundëson ndërtimin e mjeteve didaktike për dijen digjitale dhe arritjen te formula e re e *të nxënit afatgjatë* si arritje kombëtare për të gjitha modulet e shkollimit. Mjete didaktike me pyetje përgjigje të shumëfishtë *duke e* pasuruar me kërkimin, si pjesë e moduleve, të cilat mëshojnë si lloji më fleksibël i pyetjes objektive. Ato mund të përdoren për të testuar çdo lloj shprehie: *njohja, të kuptuarit, zbatimi dhe analiza*, pa lënë mënjanë *vlerësimin formues* dhe *kërkimin për modulet shkencore.*

1. Përcaktimi shkencor i konceptit " modul " në tekstin mësimor

Tri nivelet e studimit në universitet e kanë të domosdoshme përcaktimin e saktë të modulit si: *brendia e domosdoshme, madhësia, shtrirje në javë*. Për herë të parë u përcaktua si term në *Vendimin e Këshillit të Ministrave*: "Modul një pjesë e programit të lëndës, i cili përmbledh në mënyrë të logjikshme të vazhduar të rregullt dhe të organizuar tematika të ngjashme që ndërtohet mbi një numër të kufizuar objektivash mësimorë-akademikë që priten të realizohen nga studenti."

Po në këtë vendim hidhet hap më tej për rezultatet e të nxënit në bazë të objektivave të lëndës, kompetencave që ka secila lëndë: "Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit(përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat janë synime që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës." (Vendim Nr.41, datë 24.1.2018.f.5-7)

Temat e lëndës që përcakton vendimi të shpjeguar në një paragraf të detajuar për çdo leksion të shoqëruar me literaturën përkatëse janë një hap

drejt përcaktimit të mëtejshëm të modulit me: "Objektiva formues dhe kompetenca profesionalë", bashkësia e dijeve, aftësive e kompetencave specifike të fushës që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit."

Mundësi kërkimi që ky vendim të jetë i zbatueshëm për cilësi më të lartë në Universitet. Rrugë e gjatë për arritjen tek moduli duke lënë mënjanë dispensat, maketet e lëndëve, draftleksionet. Debati i trupës akademike në departamente do të ngjiste këtë shkallë tek tri nivelet e studimit në Universitet. Përkufizimi i dhënë në vendim dhe përkufizimi i dhënë në *Pedagogji* mund t'i jepnin afri me përcaktimin shkencor: "Termi "*modul*" ende nuk ka një përcaktim shkencor, përdoret për të treguar një njësi mësimore, një segment mësimor, apo një kurs mësimor autonom me një finalitet të përcaktuar mirë zakonisht në trajtën e kompetencave akademike dhe profesionale të caktuara fitimi i të cilave është i vërtetueshëm me anë të një vlerësimi funksional dhe mund të çertifikohet në mënyrë të pavarur nga i gjithë sistemi."(Kraja,2009, : 241)

Debati i shkencor i trupës akademike për modulin digjital do të mënjanonte leksionin duke lexuar në foltore para studentëve dhe do të pasuronte me sema të reja fjalën *leksion*. Mund të sillte mëshimin tek ato sisteme që kanë tregues më të lartë. "Në disa sisteme i vihet rëndësi e madhe specifikimit të atyre elementeve që kanë të bëjnë *me rezultatet e të mësuarit*, kurse në të tjerat elementeve që lidhen me *proceset e të mësuarit*." (Kraja,2009, : 241)

Tradita e vogël e departamenteve në shumë Universitete kërkon që vendimi të shkonte më tej. Mund të hapte hullinë duke nënvizuar ato objektiva të një formati të madh dhe sfidat të vështira për t'u përballur, "*digjitalizimin e dijeve*", apo siç është shkruar për të "*prurjet digjitale në arsim*" për studentë të suksesshëm, lektorë të suksesshëm.

Rezultatet e të mësuarit, të nxënit nga module të ndryshme të planit mësimor të një dege, profesioni mbyllen me një raport të hartuar nga Universitet. Ky raport korrekt ka domosdoshmëri të shkruhet edhe për një anë, e cila ka shumë për të bërë dhe diskutuar dhe debatuar. Ky debat shkencor i departamenteve do të sillte hartimin e projekteve të përbashkëta me disa universitete, gjermane, polake, suedeze, koreane, kineze, për "*prurjet digjitale në arsim*", duke nënvizuar *nxënien afatgjatë të një moduli, e tërësi modulesh.* Bashkëpunimi, projektet disavjeçare do të plotësonin natyrshëm zgjedhjen si term *të nxënit* kundrejt *të mësuarit* si koncepte duhen shkruar dhe përparësitë me semat e duhura për të arritur të *nxënia afatgjatë* dhe sinonimi *kujtesa afatgjatë*.

Të mësuarit përkufizohet me dy ose më shumë kuptime. Profesori francez *i Pedagogjisë Gaston Mialaret* shkruan se ky koncept ka dy ose më shumë kuptime. *O.Rebuel* i jep këtij koncepti tri përkufizime të ndryshme:

Marrja e një informacioni të ri.
Proces të të mësuarit e një shprehie.
Një mësim që çon te të kuptuarit.

Robidas numëron disa përkufizime sipas Fjalorit *" Larousse*", të mësuarit është një proces që të çon në fitimin e njohurive ose studimin".

Afron si sinonime koncepti i *të nxënit* me *të mësuarin* duke nënvizuar se individët nxënë me rrugë dhe shpejtësi të ndryshme: "Të nxënit është një proces, nëpërmjet të cilit çdo njëri fiton njohur, shkathtësi dhe shprehi...Njeriu mëson.. sipas planeve dhe programeve të përcaktuara nga organizmat kompetente për një vëllim të caktuar informacioni njohurish dhe arrin në përvetësimin e mënyrave të reja të zgjidhjeve të kuptuarit, zbatimit të tyre në praktikë.*"*

Sinonimia bëhet më dukshme kur shkruan*: "Të mësuarit dhe të nxënët kanë të bëjnë dhe me veprimtarinë e drejtpërdrejtë të nxënësit për të përvetësuar dijë të thella dhe të qëndrueshme."* (Kraja, Pedagogjia .f.216)

Po ky autor jep në këtë libër edhe skemën e të nxënit. Ndoshta në këto vite mund të shkruhet edhe me fjalë të tjera si sinonime edhe fjalë të mëtejshme saktësuese për lexuesin dhe vepruesin e të nxënit: *"*Skema e thjeshtë e të nxënit*: të dëgjuarit, të lexuarit, të shënuarit , riprodhim i pavarur, diskutimi, zgjedhja e problemave.."* (Kraja, *Pedagogjia.* f.250)

Afrojmë një përgjigje deri në fund të shkrimit si variant për zgjerime të këndit të nxënies që prindi i cakton fëmijës si mjete të përhershme: fjalorë, atlas, libra ushtrimesh veç teksteve bazë për studentin. Zgjedhjen si term *të nxënit* kundrejt *të mësuarit* si koncepte duhen shkruar dhe përparësitë me semat e duhura për të arritur të *nxënia afatgjatë* dhe *sinonimi kujtesa afatgjatë. Z*gjerimi i këndit të nxënies e kërkojnë edhe treguesit e anketës së mëposhtme me student që mbarojnë masterin shkencor në mësimdhënie...në Fakultetin e Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali",Vlorë dhe mësues të shkollave, Vlorë.

1. Cilën disiplinë e emërtoni "*modul të suksesshëm*" për vitet e shkollimit?
2. Termi " *të nxënit afatgjatë*" a zëvendëson plotësisht termin" *kujtesë afatgjatë*"?

3.Çfarë u sugjeroni të tjerëve për *të nxënit afatgjatë* në mbarim të një ore mësimi?
4. Si i dalloni këto dy fjalë: *të mësuarit* dhe *të nxënit* ?
5.Mjete didaktike për të *nxënit afatgjatë* si konceptohen për gjuhën shqipe apo module ?
6. Kualifikim, trajnim për të nxënit afatgjatë si është realizuar?
7. Veçoni një mjet didaktik për të *nxënit afatgjatë* që u ka sjell sukses:
8. Mjete didaktike si aplikacione për gjuhën shqipe në tabletë, ajpedë (iPad), celularët android dhe iOS ,gjatë 30/35 javëve të vitit sa janë të dobishme tek tavolina, këndi i të nxënit ?
9.Cilin mjet didaktik të gjuhëve të ndryshme për të nxënit afatgjatë do të dëshironit për ta përshtatur për gjuhën shqipe edhe module të tjera?
10. Neurolinguistika sa njihet si term për *të nxënit afatgjatë*?

80% e studentëve, mësuesve mëshojnë tek kërkesa e modulit të suksesshëm, me mjete didaktike të integruara në të mirë të *nxënies afatgjatë*. Secila nga pyetjet e anketës do të përmirësonte më tej tregues e moduleve në Universitet. Jo vetëm kaq, po do të kërkonte trajtime të mëtejshme dhe të gjera në të ardhmen.

Do të mëshojmë tek *"prurjet digjitale në arsim*" me një alternativë, mjet didaktik bashkëkohor, si pjesë e integruar e modulit shkencor, tekstit, i cili rrit treguesit e *të nxënit afatgjatë* nga klasa e dytë deri tek marrja e licencës për mjaft profesione. *Pra,* mjete didaktike si aplikacione për gjuhën shqipe e module të tjera në tabletë, ajpedë (iPad), celularët android dhe iOS ,gjatë 30/35 javëve të vitit shkollor dhe akademik. Mjetet/instrumentet didaktike të vlerësimit, përfshijnë pyetjet me zgjidhje të shumëfishta, diskutimet, kërkimin, vlerësimin për orët: *flasim, veprimtarinë e nxënësit në klasë, projekte, pra* ndërtojnë portofolin dhe japin të plotë performancën e nxënësit, të studentit. Këto instrumente vlerësimi sigurojnë të dhënat mbi atë çka nxënësit, studentët dinë dhe janë në gjendje të bëjnë si rezultat i mësimdhënies/nxënies afatgjatë.

Hulumtimi në disa vite paraqet mundësi të tjera duke e pasuruar më tej si veprimtari ushtruese dhe për të realizuar të plotë formulën e paraqitur më poshtë. Kjo veprimtari ushtruese për situata të ngjashme si : përzgjedhje ë alternativës së saktë është e mundshme me kërkesa, e vërtetë e rremë, e saktë e gabuar, me përzgjedhje konceptesh, për plotësimin e vendeve bosh, informacioni i duhur, për një përkufizim, zëvendësim, zgjedhje për një situatë reale, me përgjigje të zgjeruar ose e ndërsjella, vlefshmërinë e një situate të duhur, kërkimi për përgjigjen e duhur janë mundësi për tregues më të lartë të moduleve në Universitet. Pra, përmirësim, pasurim i testeve me zgjedhje të shumëfishtë si pjesë e brendisë së moduleve, por edhe konceptim shkencor të termit *modul, në tekstin mësimor me organizim didaktik* siç kërkon shumica e anketuesve për lëndë të ndryshme të një plani mësimor në një nivel studimi.

2. *Aplikacioni "Teste me disa zgjedhje, gjuhë shqipe 2, 3,4,5..." e module si alternativë e eksperimentuar për dijen digjitale*

Ka më shumë se një gjysmë shekulli që nga autorë amerikanë punohet dhe eksperimentohet për të mësuarit e programuar si pjesë e moduleve. Jo vetëm që punohet, por kanë ndërtuar edhe parimet e të mësuarit të programuar. Këto parime janë mishëruar në një metodë që quhet *Instruksioni i Sistemit të Personalizuar* (ISP). Sipas kësaj metode, nxënësi dhe studenti e përvetëson materialin mësimor të përbërë nga njësi më të vogla. Çdo nxënës apo student duhet ta përvetësojë materialin e paraqitur në një njësi dhe t'u përgjigjet disa pyetjeve para se të kalojë në njësinë tjetër gjuhësore. Është shkruar se është metodë shumë efektive për arsye të pjesëmarrjes aktive dhe rezultatit tek njësitë e vogla në një kohë shumë të shpejtë duke e motivuar. Informacioni i menjëhershëm dhe i ndërsjellë që ai merr (feedback) dhe përforcimi (Reiser, 1984; Gage dhe Berliner, 1988) e bëjnë të admirueshëm për përdorim. Po kolegët e tyre shkruajnë më tej se kompjuterët mund të përdoren për të paraqitur materialin mësimor dhe për ta ndihmuar nxënësin a studentin që të mësojë me anë të teknikave të ndryshme, siç janë testet me disa zgjedhje. (Pettijohn,1985). Duke vijuar më tej, shkruajnë se përmes të mësuarit të programuar zbatohen në procesin mësimor në shkolla disa prej parimeve themelore të kushtëzimit veprues (Kulik, Klik dhe Gangert-Drowons, 1985).

Pas viteve 1990- të u bënë përkthime nga autorë të suksesshëm perëndimorë në fushën e psikologjisë dhe të strategjive të të mësuarit. U përqendruan më shumë tek përvoja amerikane sidomos e autorëve: Donald C. Orlich, Robert J. Harder, Richard C. Callahan, Constance H. Kravas, Donald H. Kauchak, R. A. Pendegrass, Andrew J. Keogh me librin "*Strategjitë e të mësuarit*". Nga kjo përvojë sjellim për citim nënvizimin e autorëve, kur flitet për të mësuarit zbulues dhe nënndarjen *Vlerësim formativ. Kërkimi.*

Një teknikë kërkimi për përdorimin e disa mjeteve do të ndihmonte për të nxjerrë idenë:

a) Demonstrimi i një leksioni duhet të bëhet gjithmonë para se nxënësit të prekin instrumentin.
b) Nxënësi duhet të dinë rregullat e përdorimit të instrumentit para se ta përdorin atë.
c) Një trajtim induktiv i ndihmon nxënësit të bëjnë zbulime dhe përgjithësime që mund të mbahen mend.

d)Instrumentet janë kaq komplekse, saqë planet e zgjeruara të mësimit dhe teknikat e mësimit duhet të përgatiten më parë.(Përgjigja jepet në vijim, theksi është në *pjesëmarrje.*)

Po autori që u zgjodh dhe u përkthye për shkollat shqiptare pas viteve 1990, ishte amerikani Terry F. Pettijohn, i cili ka eksperimentuar për një kohë të gjatë të mësuarit me ndihmën e kompjuterëve për të ndihmuar nxënësit, studentët, mësuesit dhe të tjerë për depozitimin e informacionit për një kohë të gjatë.

Faqet e librit janë shumë të vlefshme edhe për *kujtesën afatgjatë*. Po ky autor ka shkruar sesi ta përmirësojmë më tej kujtesën, si ta depozitojmë informacionin që mësohet në mënyrë që mund të merret dhe të përdoret më vonë. Hapi i parë, procesi i futjes së informacionit në sistemin e kujtesës. Por për të mbajtur mend duhet të *jemi të motivuar*. Procesi i radhës është riprodhimi, nxjerrja e informacionit nga sistemi i kujtesës. Rruajtja matet duke i kërkuar individit të përdorë informacionin e mësuar më parë.

Një element tjetër i rëndësishëm është *kujtesa rindërtuese*, e cila ka të bëjë me kombinimin e hollësive të caktuara të ngjarjeve me informacione të tjera që mbushin boshllëqe. Nxënësit, studentët përdorin mjete ndihmëse të kujtesës së jashtme, si marrja e shënimeve apo të pyeturit e dikujt më tepër se mjete ndihmëse të kujtesës së brendshme, përsëritje mendore dhe imazhet për t'u përgatitur për provim. Sa më shumë ta përsëritim materialin pasi ta kemi mësuar, aq më e gjatë do të jetë koha që do ta mbajmë mend atë material.

Alternativa e zgjedhur e afron e parapërgatit, fiton përvojë për provimet e marrjes së licencës dhe provimet e ndërmjetme,finale, përfundimtare. Alternativa ka shtrirje në shumë universitete të ndryshme nga profesorë që hulumtojnë për tregues më të lartë të përvetësimit të moduleve.

Vitet e përdorimit të teknologjisë u kanë dhënë mundësi shumë autorëve të eksperimentojnë dhe të ndërtojnë një alternativë duke filluar nga vite më të ulëta shkollimi, për zgjerimin e marrjes së informacionit të një teme të parashikuar për atë klasë shkollimi në lëndën e gjuhës, duke rritur procesin e të nxënit afatgjatë. Është pasqyruar kjo prirje te botimet e IZHA-ës ku shkruhet se përdorimi i pajisjeve kompjuterike mbështet metodat e të nxënit, *nxënien afatgjatë* edhe për nxënës me aftësi ndryshe. Kështu, përdorimi i tyre ndihmon nxënësit me aftësi ndryshe konceptore si dhe nxënësit me nevoja të veçanta në përthithjen më të shpejtë të koncepteve të reja gjuhësore gjatë një teme çfarëdo mësimi në lëndën e gjuhës shqipe dhe module të tjera.

Për çdo orë mësimi, sado i paktë të jetë informacioni që jepet për një temë gjuhësore, ndihet shqetësimi dhe gëzimi njëkohësisht. Çfarë ka mësuar nxënësi, studenti në nivele të ndryshme shkollimi? Shqetësim për mësuesin, drejtuesin, lektorin dhe prindërit për atë orë mësimi dhe në vazhdimësi. Për ndërtimin e aplikacioneve si mjet didaktike, kemi pasur në vëmendje vlerësimin, i cili mund të jetë: *përmbledhës* (përmbledh atë që nxënësit kanë mësuar në fund të një ore mësimi, ose për disa orë mësimi), *formues* (ndodh gjatë gjithë kohës) ose *diagnostikues* (i paraprin një mësimi si një mënyrë për të matur atë që nxënësi paraprakisht di.).

Mjetet/instrumentet didaktike të vlerësimit, PAET përfshijnë pyetjet me zgjidhje të shumëfishta, diskutimet për orët: *flasim, veprimtarinë e nxënësit në klasë, projekte, pra ndërtojnë portofolin dhe japin të plotë performancën e nxënësit, të studentit*. Këto instrumente vlerësimi sigurojnë të dhënat mbi atë çka nxënësit, studentët dinë dhe janë në gjendje të bëjnë si rezultat i mësimdhënies/nxënies.

Hulumtimi në disa vite paraqet mundësi të tjera. Provat u realizuan në nivele të ndryshme shkollimi, në arsimin parauniversitar duke filluar nga klasa e dytë fillore dhe tre nivelet e shkollimit në Universitet. Hulumtimi u realizua me vëllim të vogël njohurish : *një faqe, disa faqe, faqet e një moduli deri tek puna e pavarur, provimi përfundimtar.*

Është shkruar për qasjen e re kurrikulare dhe se portofoli i të nxënit merr një vend të posaçëm, pasi mbështet zbatimin e kurrikulës të bazuar në kompetenca; krijon qëndrueshmëri në procesin e realizimit të saj; ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e cilësisë së zbatimit të kurrikulës dhe të rritjes së të nxënit afatgjatë. Është shkruar nga autorët eksperimentues që si mjete të teknologjisë që mbështesin procesin e vlerësimit, dhe vlerësimin e nxënësve, studentëve janë: *testet, pyetje me zgjedhje të shumëfishtë* e pasuruar më tej me kërkimin.

Në dokumentet e reja kurrikulare të hartuara në kuadër të rishikimit dhe zbatimit të kurrikulës aktuale për sistemin tonë arsimor, *kompetenca digjitale* është një ndër shtatë kompetencat kyçe të kurrikulës. Ajo bazohet në shkathtësimin e përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion, si dhe për të bashkëpunuar në distancë. Zbatimi ofron rritjen e cilësisë së mësimnxënies dhe shtimin e dijeve afatgjata për nxënësit, studentët.

Mund të punohet sipas mundësisë së nxënësit, studentit, mësuesit dhe prindërve me tri nënndarjet sipas skemës së mëposhtme për gjuhën shqipe 2,3, 4, 5,...Kjo skemë mund të përdoret edhe për module në nivele të tjera të arsimit.

Pas parathënies drejtuar mësuesve dhe prindërve të nxënësit, lektorëve kemi hartuar nënndarjen kryesore: ***Shfleto testin!***

Mjetet didaktike tërësore vjetore, sipas kohës së zgjatjes së modulit e ndihmojnë nxënësin studentin të ndërtojë fillimisht vetëdijen metagjuhësore, e cila ka të bëjë me reflektimin e tij mbi gjuhën, në veprime të tilla si: përmirësimi i shqiptimit të fjalëve, lidhjeve gramatikore të fjalëve në ndërtime të ndryshme sintaksore, gabimeve semantike gjatë përzgjedhjes dhe përshtatjes së fjalëve sipas kuptimit që bartin dhe realizojnë në lidhje me fjalët e tjera, etj. Këto reflektime nxënësi i pasqyron jo vetëm te shprehjet dhe shprehitë e tij gjuhësore, në përgjigjet e sakta që shënohen në aplikacionin gjuhësor për rritjen e të nxënit, por edhe tek ato të bashkëbiseduesve të tjerë, të popullsisë shkollore apo më të rriturit.



Nënndarja e dytë e vendosur në faqen e parë: ***Sfido shokun****! Punë me grupe.*

Sfidë e re, sfidat, gjatë ditës perceptohen si dy duar. Çdo ditë ka një provë për vete dhe për shokë ose shoqe(2-5 sfidantë, nxënës, studentë). Duke u vënë në garë me shokun pasqyron performancën gjuhësore, intuitën gjuhësore, që sipas Çomskit (Chomsky), shpjegohet si pjesë e ndonjë përbërësi të lindur të mendjes, i njëjti përbërës me të cilin shpjegohet shpejtësia e përftimit dhe mësimit të gjuhës nga nxënës të ndryshëm, studentë. Aftësia e tij për të formuar thënie të reja, nxënie afatgjatë mbi bazën e një përvoje gjuhësore të copëzuar dhe të kufizuar për atë orë mësimi sipas moshës shkollore kërkon kohë jo të njëjtë.

Mund të konceptohet edhe si *një lojë gjuhësore, garë ditore vlerësimi*, por më tepër mëshohet në rimarrjen e informacionit, kur është e domosdoshme, duke e zgjeruar përveç mësuesit dhe tekstit. Ka mundësi e rrit të nxënit nga prindi, më i rrituri i familjes, por edhe nga shoku/shoqja gjatë punës në grup. Pra, realizon 3 R (rimerr, përsërit, thotë me gojë). Mund të shfrytëzojë edhe orët e lira, kur shkolla është qendër komunitare, në



bibliotekë elektronike.

Vendosja e përgjigjes për temën e re gjuhësore apo të një moduli në vitet e shkollimit, shërben si rimarrje e informacionit jashtë orës së mësimit, duke e rihapur debatin për temën e re apo të rimarrë dhe motivim për realizim tërësor. Është një mundësi që përmirëson të nxënit afatgjatë.

Në pak minuta nxënësit, studentët rishikojnë të nxënit i formësuar në kohë të ndryshme përmes *vlerësimit me notë nga aplikacioni*, duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët. Njohuritë gjuhësore, të cilat saktësojnë në faqe të mjetit didaktik kanë të bëjnë si me përvojat njohëse, ashtu edhe me ato gjuhësore, të cilat fitohen bashkërisht dhe në marrëdhënie reciproke me njëra-tjetrën, gjatë

ndërveprimit të vazhdueshëm të nxënësit me folës të ndryshëm, në ligjërime të ndryshme dhe skema të larmishme komunikimi.

Me këto mjete didaktike, formulimi gjuhësor trajtohet hap pas hapi gjatë një procesi mendor, që fillon: me *receptimin e shëndetshëm, tërësor ose jo, perceptimin, kuptimin dhe përmbyllet me prodhimin gjuhësor*. Ky prodhim gjuhësor kërkohet simestror, gjithëvjetor, u referohet mesazheve që synon të përçojë nxënësi, studenti dhe që bëhen të ditura, kur komunikohen me gojë a me shkrim. Ky proces funksionon nëpërmjet disa mekanizmave dhe proceseve mendore që përmirësohen vazhdimisht gjatë punës së pavarur,kohës së lirë me mjete didaktike.

Në fushat e sotme të dijes, dijes digjitale, për nxënësit, studentët është normë të bashkohen dhe të ndërtojnë dijen që u duhet menjëherë, në kontekstin e situatave plotësisht të ngjashme me diçka tjetër, të ndërlikuar dhe specifik ose që e gjurmojnë, plotësojnë së bashku. Pra, ajo që vlen të aftësohesh, të nxësh dhe të përdorësh dije të informacionit të marrë në klasë,auditor. Sot, këtë e bën shumë më mirë dhe më lehtë me mjetet didaktike të eksperimentuara, PAET apo edhe me programe të tjera të konsoliduar në gjuhësinë gjermane.Për prindërit, përdorues të tjerë është kohë e vlefshme, pasi sigurojnë mundësi që të diskutojnë, të shkëmbejnë përvoja për rezultatet e pritshme nëpërmjet pjesëmarrjes në moderimin e vlerësimit për fëmijën a të afërmin. Gëzohen për ligjërimin e pasqyruar në përgjigjet, edhe funksionimin i rregullt të qendrës së *Paul Brokës* dhe qendrës së *Karl Vernikut*. Realizimi i plotë për 30/35 javët, *çdo temë mësimore* dhe në vijim, shikon, kontrollon për gjuhën tri zona : *zona e Brokës, zona e Vernikut* dhe *zona suplemtare*, e cila ndodhet në pjesën e sipërme të trurit. Në këto tri zona janë përkatësisht qendra e të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit dhe të domosdoshme për t'i përmirësuar vazhdimisht edhe kompetencën digjitale të të nxënit afatgjatë.

Nënndarja e tretë: **Kampionët**

Konceptohet me dy krahë: Arritjet vetjake dhe lista e kampionëve, duke formuar një portofol kombëtar për gjuhën shqipe 2, 3,4,5... dhe në vijim apo për module të tjera në nivele të tjera arsimimi. Vështirësitë e aplikacioneve të detyrojnë që të zgjedhësh një fjalë që të jetë motivuese, duke shërbyer si portofol i vlerësimit vjetor për nxënësin, studentin ose përdoruesin.

Nënndarja e tretë në aplikacion ka synim kryesor të mbikëqyrë përparimin e nxënësit, studentit gjatë procesit të të nxënit dhe të mbledhë informacion për të lehtësuar dhe për të ndihmuar marrjen e vendimeve për ta përmirësuar këtë proces. Regjistrimi i vlerësimit për çdo orë të zhvilluar përcakton arritjet në përfundim të temës gjuhësore për atë ditë, përcakton arritjet e kapitullit, semestrit, të vitit shkollor, duke ruajtur njohuritë dhe për të certifikuar nxënësit, studentin për nxënie të mëtejshme.

Mësuesit e klasës së dytë, të tretë, të katërt, të pestë e në vijim mund t'i përdorë të dhënat e portofolit për qëllime të ndryshme, duke përfshirë nxitjen e të mësuarit të vetëdrejtuar; krijimin e një panorame të qartë të asaj që është mësuar nga nxënësi, studenti; demonstrimin e progresit të bazuar në rezultatet e regjistruara nga aplikacionet si mjete didaktike. Nxënësit kampionë mund të jenë pjesëmarrësit e mundshëm në PI S A apo në konkurrime të tjera ndër universitare.

Krijimi i portofolit të të nxënit si proces vjetor me koleksionimin e kontributeve ditore të nxënësit, studentit dhe paraqet përpjekjet, progresin dhe arritjet e tij në lëndën e gjuhës shqipe 2, 3,4,5 e në vijim për module të tjera. Siç e ka përcaktuar Diane Hart, portofol: "Një enë që mban evidencën e njohurive, të ideve, interesave dhe arritjeve"; ne e shohim për nxënësin e klasës, studentin, por edhe mund të shpallim fituesit kombëtarë e me tej. Duke shpallur kampionët nga portofoli i vlerësimit, kemi mundësi të hedhim hap tjetër për motivimin e nxënësit, përtej dorëzimit të fletëlavdërimit apo fletënderit edhe para klasës dhe shkollës. Për çdo test që ka një temë mësimi, nota maksimale është shoqëruar edhe me një mesazh e kupë të animuar: *"Ju përgëzojmë! Të gjitha përgjigjet e sakta!"*

*3.**Performancë më e rritur me formulën e re të të nxënit afatgjatë si kërkesë kombëtare për module të ndryshme***

Rritja e performancës në lëndën e gjuhës shqipe dhe module të tjera është e lidhur ngushtë me motivacionin e shoqërisë së kohës. Teoria motivacionale e kompetencës na tregon se nxënësit, studentët janë të motivuar të bashkëveprojnë suksesshëm me shokët, punojnë

në grup, familjen e gjithë shoqërinë. Nota e marrë në aplikacion do të nxitë përpjekjet për realizimin e kompetencës gjuhësore dhe do ta motivojë nxënësin, studentin për të vazhduar përpjekjet për të dalë me arritje progresive të shkëlqyera.

Arritjet progresive realizohen edhe duke zbatuar teorinë e John Atikson, i cili përpunoi një model për të kuptuar motivacionin për të ecur përpara me formulën: T = M x P x SH që është zbatuar. Tendenca për të arritur sukses (T) është e barabartë me motivin për të arritur sukses (M), shumëzuar me probabilitetin e suksesit (P), shumëzuar me vlerën shtytëse të suksesit (SH).

Kërkimi për një kohë të gjatë na sjell në përmirësimin e formulës së John Atikson me një elemente kryesorë të nënvizuar më poshtë:

Këta nxënës që arrijnë të dalin kampionë kombëtarë, vlerësim maksimal në provimet që parashikon moduli, të kuptojnë se kupa pas çdo vlerësimi me notën *pesë* apo *dhjetë* nuk është e vetme me mesazhin shoqërues, por duhet të besojnë se kanë një shans për sukses dhe se shoqëria, e cila është e interesuar, do ta vlerësojë portofolin e arritur në fund të çdo klase apo nivele shkollimi, apo nivele të Universitetit deri në marrjen e licencës.

Kur fitojmë mirënjohjen e të tjerëve, vëmendjen e atyre me pozitë të lartë, ne plotësojmë nevojat për vlerësim dhe ndihemi të rëndësishëm e me besim në vetvete, siç ka shkruar autori i teorisë së motivacionit Abraham H. Maslow (1987). Po ky autor shkruan se duhet ta shohim nxënësin, studentin si një të tërë dhe pjesëtar i shoqërisë, i cili formësohet nga një hierarki nevojash. Kur plotësohen në mënyrë të kënaqshme, bëjnë që nxënësi, studenti ta realizojë plotësisht potencialin e vet në vitet e shkollimit dhe nesër si pjesëtar i rritur i shoqërisë. Është plotësisht e mundur që kampionët e shpallur nga portofoli i aplikacionit të shpërblehen me dhurata, si: *tabletë apo smartfonë* dhe, kur ka më shumë se dy, klasa mund të marrë një *smart board* etj. Stimuj mund të jepen nga bashkëpunëtorë apo nga fondi i Ministrisë së Arsimit apo i Drejtorive rajonale, Universiteti, Bashkia etj.

Përveç rritjes së të nxënit afatgjatë në lëndën e gjuhës shqipe si proces normal neurolinguistik, kurohen me shumë sukses ata nxënës që preken nga afazia motore(e Brokës), pësojnë dëmtime në sistemin fonologjik. Nxënësit e prekur nga *anomia* kanë vështirësi në gjetjen e fjalëve si gjatë të folurit dhe për të emërtuar objektet(fjalë e reja në çdo faqe të teksteve të gjuhës shqipe, module) që tregohen edhe si shenjë gjuhësore në një tekst të caktuar. Individët me afazi *ndijore dhe receptive* (afazia e Vernikut), të cilët kanë dëmtime të përbërësve semantikë dhe sintaksorë përmirësohen. Diagnostikohen për vendosjen e marrëdhënieve të njësive të ndryshme gjuhësore, lidhjen e saktë gjuhësore në njësi më të mëdha gjuhësore si fjalia e periudha, tekst më të gjerë sipas kërkesave të programit, apo situatës gjuhësore etj.

Të nxënit afatgjatë shtohet edhe kur nxënësi rimerr njohuritë gjuhësore së bashku me shoqen shokun, ose në grup, me prindërit, me të rriturit. Për rrjedhojë, nuk lejojnë shkatërrimin e qelizave të trurit në nivelet e shkollimit.

Hulumtimi për një kohë të gjatë na sjell në përmirësimin e formulës së John Atikson me elemente kryesorë. Teknika e studimit tashmë e njohur : SQ3R (Survey "bëj sondazh" + Question "pyet" + Read "lexoj" + Recite "thuaj me gojë" + Review "përsërit"), e hartuar nga Fransis Robinson duhet thjeshtuar e plotësuar më tej për ditët e sotme.

Siç shkruajmë më lart, teoria e John Atikson, i cili përpunoi një model për të kuptuar motivacionin për të ecur përpara me formulën e riformuluar si më sipër: T = M_{sh} x P x SH. (*M_{sh}=motivimi nga shoqëria e kohës)* ka edhe elemente të tjerë rinovues për shekullin e ri dhe vendin e veçantë pas këtyre 30 viteve të emërtuara "*tranzicion"*. Riformulimi i mësipërm T = M_{sh} x P x SH. (*M_{sh}=motivimi nga shoqëria e kohës)* ka edhe elemente të tjerë rinovuese si rrjedhojë eksperimentimit në nivele të ndryshme shkollimi. Rritja e të nxënit afatgjatë ka edhe si element thelbësor(M_{sh}) vlerën shtytëse nga shoqëria e kohës ku jeton.Vendosja në formulë M_{sh} gjatë hulumtimit në disa vite kemi pasur në konsideratë mësimin e Aristotelit se të edukosh mendjen pa edukuar zemrën nuk është aspak edukim. Pra,konceptim më i gjerë për motivimin e shoqërisë (M_{sh}) si element kryesor i formulës së përmirësuar.



E riformuluar në këndvështrimin neurolinguistik paraqesin të nxënit afatgjatë të

kërkuar nga çdo nxënës apo student dhe e gjithë shoqëria:

NA(Nxënia afatgjatë)= 3R (Read "lexoj" + Recite "thuaj me gojë" + Review "përsërit"+rimarrje) **x** 3 S **(** tri situata të ngjashme të përshkallëzuara të formimit e aftësive për njësi gjuhësore të sistemit gjuhësor, modulit) similar situations x P_n**(** shumëzuar me probabilitetin e të nxënit)) **+** M_{sh} (*motivimi nga shoqëria e kohës)*

Pra, kërkimi dhe eksperimentet e realizuara në vite për të nxënit afatgjatë në lëndën e gjuhës shqipe e module përveç 3R**,** kërkon rimarrje plus ushtrim në tri situata të ngjashme të përshkallëzuar për secilën temë, për secilën njësi gjuhësore në lëndën e gjuhës shqipe gjatë 30/35 javëve të vitit shkollor të orëve: *flasim, shkruajmë, njohuri për gjuhën, drejtshkrim* me mjete didaktike bashkëkohore si popullsia shkollore europiane.

Tri situatat e ngjashme të përshkallëzuar për çdo temë mësimore në tekste shkollore apo modulet universitare formësojnë për dy qendrat e trurit njohuritë reja, termat e reja që të kenë denduri të lartë përdorimi. Shton argumentet edhe studiuesja E. Kapia**(**Kapia,2018) , e cila citon disa studiues të cilët kanë eksperimentuar lehtësinë e ndërtimit sintaksor. Po kjo gjuhëtare u referohet një pjesë e madhe studimesh(Skott e al , 2013...) Këta studiues kanë sugjeruar që struktura që ndikohen sintaksorisht prodhohen më shpejt se ato që nuk ndikohen sintaksorisht. Autorja ka shkruar me kujdes për prirjen për ta lidhur prodhimin gjuhësor me aftësinë njohëse dhe nxënien afatgjatë.

Sipas kësaj qasje kur një strukturë sintaksore ndërtohet në trurin e nxënësit e studentit qëndron në kujtesë për pak kohë duke lënë një gjurmë në të, e cila mundëson dhe lehtëson ndërtimin e një strukture të ngjashme në ligjërimin që vijon. Ndërtimi i situatave të ngjashme të përshkallëzuar rritin dendurinë e përdorimit të termit gjuhësor, të termave të tjerë, rritin lehtësimin për t'u përdorur në ndërtimet sintaksore në fjali me një gjymtyrë e me disa gjymtyrë, periudhë apo tekst më të gjerë si provimet përfundimtare. Prodhimi gjuhësor për situatën e caktuar jetësore në këtë mënyrë i kalon tri fazat: *kodim i fjalës, formulim, vetëkontroll* edhe sipas shumë studiuesve të tjerë (Garnham ,2013), cituar nga autorja e lartëshkruar.

Sipas rregullit të gramatikës gjenerative **f**ormula neurolinguistike e suksesshme, nxënia afatgjatë, e çdo niveli shkollimi për 30/35 javët e vitit shkollor apo akademik realizohet: NA=3R x 3 S(ngjash.) x P_n x M_{sh} **.**

E skematizuar me aplikacionin PAET mjeti didaktik si pjesë e modulit për dijen digjitale:





NA(Memory long-term)= 3R x 3 S(situata të ngjashme)(similar situations) x P_n x M_{sh} **.**

Eksperimentet e zhvilluara në nivele të ndryshme shkollimi, periudhë kohore, zgjatje të shkallëzuar për të fituar denduri përdorimi njohuritë e reja për dy qendrat e trurit na japin mundësinë të rishkruajmë se janë të domosdoshme 3 situatat e ngjashme të

përshkallëzuar në mjetet didaktike, aplikacionet për rritjen e njohurive të qëndrueshme të orëve: *flasim, shkruajmë, njohuri për gjuhën, drejtshkrim*, apo njohuri të moduleve, të cilat rritin *kujtesën afatgjatë(memory long-term), apo NA.* Formulimi gjuhësor pyetjet me përgjigje të shumëfishtë trajtohen hap pas hapi, gjatë një procesi mendor, që fillon me receptimin, perceptimin, kuptimin dhe përmbyllet me prodhimin gjuhësor, i cili kërkon funksionimin shumë të mirë të hemisferës së majtë dhe hemisferës së djathtë të trurit, zona suplementare (motorit corteks) tek secili nxënës apo student edhe për 3 S**(** similar situations).

Këto mjete didaktike për gjuhën shqipe që përdoret në klasa të ndryshme, e bën nxënësin, studentin më të interesuar në temën mësimore,



zvogëlon kohën e të mësuarit si dhe ofron mundësi për të mësuar në mënyrë krejt ndryshe, dhe motivohet për të gjatë punës së pavarur me shumë kujdes edhe me P_n x M_{sh}.

Kompetenca digjitale dhe rritja e treguesve të të nxënit afatgjatë për gjuhën shqipe e module kërkon përdorimin e mjeteve didaktike efektive të eksperimentuara, si aplikacionet, mjete didaktike gjuhësore, duke zgjeruar këndin e të nxënit duke mos e lënë vetëm mësimnxënien me tekstin e nxënësit, gjuhën shqipe 2, 3,4,5... Mësuesi, lektorët duke zotëruar kompetencat e përcaktuara në dokumentet zyrtare të UNESCO-s për teknologjinë në arsim, moduli 4 në konferencën e UNESCO-s, rrit treguesit e të nxënit afatgjatë.

Pra, kërkimi dhe vendosja e përgjigjes në mjetet didaktike për temën e re gjuhësore, në module, në vite shkollimi shërben si rimarrje e informacionit edhe jashtë orës së mësimit, duke e rihapur debatin për njësinë mësimore të një ore mësimi ose disa orëve, 3R x 3 S(ngjash.) dhe motivim, për realizim tërësor, të kompetencës digjitale si proces neurolinguistik normalizues dhe diagnostikues, në harmoni me P_n x M_{sh}.



Realizimi për 30/35 javët e vitit shkollor apo akademik i çdo teme mësimore sjell suksesin, nxënien afatgjatë dhe kulturën gjuhësore kombëtare të synuar edhe me *dijen digjitale* të kërkuar sot në sistemet arsimore, nivelet arsimore të Universitetit.

Përvoja hulumtuese në dy dekada edhe nga kolegë

në universitete të tjera, na ka dhënë mundësinë të shkruajmë se përdorimi i teknologjisë në klasë dhe auditorë gjithashtu ka një efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve dhe studentëve, pasi ata ndihen më të suksesshëm, më të motivuar për të mësuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim. Ngjitja e këtyre shkallëve kërkon realizim mjete didaktike bashkëkohore si edhe popullsia shkollore europiane.

Mëshojnë tek kërkesa e anketuesve, studentë, mësues, politikat shtetërore për modulin shkencor të suksesshëm, të zgjeruar me mjete didaktike në të mirë të *nxënies afatgjatë*. Debati dobiprurës për konceptimin shkencor të termit *modul, me organizim didaktik* për lëndë të

ndryshme të një plani mësimor në një nivel studimi, mëshimi tek nxënia afatgjatë si realizim i njësive mësimore, si performancë e kërkuar janë si dy duar që duhet të ecin paralel gjatë vitit shkollor dhe akademik.

Cilësia nis nga performanca e arsimit parauniversitar dhe ngjit tre nivelet e arsimit universitar, pra, kërkon konceptim të ri të modulit shkencor me brendi me mjete didaktike për të nxënit afatgjatë. Formula për *Kujtesën afatgjatë(memory long-term), apo Nxënien afatgjatë*, e zbatuar me kujdes sjell rritjen e notës mesatare kombëtare, e cila do të pasqyrohet më tej në konkurset ndërkombëtare, pjesëmarrësit e mundshëm në PI S A, konkurse të tjera që mund të zhvillohen çdo vit shkollor, akademik. Rritja e cilësisë kërkon reflektim të mëtejshëm me modulet shkencore si prurje e re, dhe zbatim i formulës së re neurolinguistike të suksesshme për dijen digjitale për çdo nivel shkollimi : në nivelin e parë, nivelin e dytë dhe të tretë në Universitet. Hedhim hap me rëndësi për përgatitjen e popullsisë shkollore dhe universitare për epokën digjitale si edhe kombet e tjera për tregues cilësor shkallëngjitjeje.

Bibliografi:

- Bandler, R., & Grinder, J. *Ssecrets of Communication: change without pain.* 1982.
- Bandler, R., Grinder, J., Andreas, S., Olivier, F., & Olivier, F. *Reframing: transformation of reality perception with NLP*. InterEditions, 1999.
- Common European Framework of Reference for Languages. Tiranë,; Cadre Européen 2010. Instituti i Zhvillimit të Arsimit, *Të nxënit me situata konstruktivizmi dhe teknologjia*. Tiranë, 2015.
- Gjini, Z. Janaqi, G. Andoni,M. Todhe,I.; Zisi,Z *Portofoli i të nxënit. Tregues i arritjes së kompetencave*. 2016.
- Kraja, M. *Pedagogjia.* Tiranë, 2009,
- Terry Petttijohn *Psikologjia*. Tiranë, 1996.
- Programi për zhvillimin profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të gjuhës shqipe dhe letërsisë...të arsimit fillor 2020.
- Hickock, Gregory; David Poeppel. "Opinion: The cortical organization of speech processing". Nature Reviews Neuroscience, 2007.
- Embick, David; Alec Marantz; Yasushi Miyashita, Wayne O'Neil, Kuniyoshi , Sakai, L. A syntactic specialization for Broca's area , 2000.
- Donald C. Orlich, Roberrt J. Harder, Richard C. Callahan, Constance H. Kravas, Donald H. Kauchak, R. A. Pendegrass, Andrew J. Keogh në librin "Strategjitë e të mësuarit" Tiranë, 1995
- Kuadri i Përbashkët Europian i Referencave Për Gjuhët. Filara. Tiranë, 2010; Cadre Européen Commun de Référence Pour Les Langues: Apprendre, Enseigner, Evaluer; Common European Framework of Reference For Languages: Learning, Teaching, Assessment; Quadro Comune Europeo di Riferimento Per le Lingue: Apprendimento, Insegnamento, Valutazione. www. coe.int/lang-CEFR.
- UNESCO-Bangkok Office» Education» ICT in Education»
- Themes»Training of Teachers»
- Guidelines»Teachers' role and needs in the ICT environment UNESCO-Bangkok Office» Education» ICT in Education» Themes»Training of Teachers»Guidelines»Teachers' role and needs in the ICT environment [UNESCO (2011). [UNESCO (2011). UNESCO ICT competency framework for teachers (ICT CFT). IITE Conference Teacher Competencies in Knowledge Society: Policy, Pedagogy.
- www.nexhipmerkuri.com (2020)
- Vendim KM Nr.41 datë 24.1.2018.

Mësimi online dhe perceptimi i studenteve të vitit të parë në Fakultetin e Shëndetit gjatë COVID – 19

Msc. Emirjona Kiçaj
Msc. Rudina Çerçizaj
Msc. Stiliana Brokaj
Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali Vlorë*emirjona.kicaj@univlora.edu.al; rudina.cercizaj@univlora.edu.al; stiliana.brokaj@univlora.edu.al*

Abstrakti

Hyrje: Mësimi online në vetvete është një sistem mësimi virtual i cili përdor internetin në procesin e të mësuarit dhe të mësimdhënies. Kjo metodë mësimdhënie siguroi vazhdimësinë e realizimit të programeve akademike në fakultetin e Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë"

Qëllimi i studimit: Vlerësimi i perceptrimeve të studnetëve të vitit të parë akademik në nivelin bachelor të Fakultetit të Shëndetit rreth mësimit online gjatë pandemisë Covid – 19.

Materiale dhe metoda: Ky është një *studim cross sectional*, i realizuar gjatë periudhës *Shkurt – Mars 2021*. Në këtë studim morën pjesë *214 studentë* të Fakultetit të Shëndetit që ishin në vitin e parë Bachelor në degët Infermier i përgjithshëm dhe Infermier - Mami. Për realizimin e këtij studimi është marë një pyetësor i cili është i bazuar në studime të ndryshme të ngjashme të realizuara në botë.

Rezultate: Në studimin e realizuar morën pjesë 214 studentë ku 76.6% e tyre ishin studentë të degës Infermieri e Përgjithshme. 74.1% e studentrëve kanë përdorur celularin si mjet kryesor për të mundësuar ndjekjen e orëve të mësimit. 54.7% e studentëve mendojnë që gjatë semestrit të dytë ky mësim të vazhdoj të realizohet në auditoret e universitetit megjithëse 79.9% e studentëve referuan se ishin të kënaqur me përdorimin e plkatformës Google Classroom në klasat online.

Konkluzione: Mësimi online gjatë periudhës së pandemisë ishte një zgjidhje ideale për të mos penguar vazhdimësinë e programeve akademike. Duke u bazuar në studimin tonë 46.3% e studentëve kanë referuar perceptime negative në drejtim të mësimdhënies online kundrejt 43% me perceptime pozitive.

Fjalët kyçe: *mësimdhënia online, studentët infermierë, perceptime pozitive , perceptime negative, pandemia e Covid – 19.*

Abstract

Introduction: Online learning is a virtual learning system which uses the Internet in the learning and teaching process. This teaching method ensured the continuity of the implementation of academic programs at the Faculty of Health, University "Ismail Qemali" Vlora "

Aim of the study: Evaluation of the perceptions of the first academic year students at the bachelor level of the Faculty of Health about online learning during the Covid-19 pandemic.

Materials and methods: This is a cross sectional study, conducted during the period February - March 2021. In this study

participated 214 students of the Faculty of Health who were in the first year Bachelor in General Nursing and Nursing - Midwifery. For the realization of this study a questionnaire was taken which is based on various similar studies conducted in the world.

Results: In the study participated 214 students where 76.6% of them were students of General Nursing. 74.1% of students have used the mobile phone as the main tool to enable attending classes. 54. 7% Of students think that during the second semester this lesson will continue to be realized in the university auditors, although 79.9% of students reported that they were satisfied with the use of the Google Classroom platform in online classrooms.

Conclusions: Online learning during the pandemic period was an ideal solution to not hinder the continuity of academic programs. Based on our study 46.3% of students referred negative perceptions towards online teaching versus 43% with positive perceptions.

Keywords: *online teaching, nursing students, positive perceptions, negative perceptions, Covid pandemic - 19.*

Hyrje

Covid – 19 ka patur një ndikim shumë të madh jo vetëm në shëndetin e popullatës por në të njëjtën kohë edhe në stilin e jetesës, ekonominë ashtu sikurse dhe në sistemin arsimor. Ky ndikim ka ardhur si rezultat e marjes së masave shpesh herë drastike për të parandaluar përhapjen e tij në popullatë [1], [2], [3], [4].

Dhe në Shqipëri tashmë kemi një numër të konsiderueshëm të të infektuarve me COVID – 19. Sipas njoftimit të Ministrisë së datës 12.03.2021 janë diagnostikuar 116123 pacientë pozitiv me Covid – 19, të shëruar 79131 dhe në total 2018 persona të cilët kanë humbur jetën [5].

Sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020 – 2021 u këshillua që mësimi në sistemin Universitar të realizohet online. Universiteti i Vlorës dhe Fakulteti i Shëndetit konkretisht është duke përdorur platformën online Google Classroom për të realizuar mësimin online në të gjitha programet akademike bachelor dhe të masterit Profesional dhe Masterit Shkencor. Ky mësim online në vetvete është një sistem mësimi virtual i cili përdor internetin me procesin e të mësuarit dhe të mësimdhënies [6]. Mësimdhënia online e përdorur tashmë dhe në universitetin e Vlorës përveç përfitimeve që ka sjellë në lidhje me vazhdimësinë e realizimit të programit mësimor ka një sërë faktorësh që ndikojnë në negativisht në në përdorimin e saj aq më shumë në programet e infermierisë ku rol të rëndësishëm kanë kontakti i studentëve tanë me institucionet shëndetësore edhe pse mund të themi që realizimi i praktikës mësimore ka qënë prezent edhe në këto kohë të pandemie [7].

Si barriera në përdorimin e mësimit online në programet e infermierisë mund të përmendim:

- kostoja e internetit,
- të paturit të mjeteve adekuate për të realizuar mësimon online prej studentëve
- pamundësia e trajnimit paraprakt të studentëve dhe stafit akademik për përdorimin e platformave online
- trajnim jo adekuat i stafit akademik
- mungesë e njohurive në përdorimin e mjeteve elektronike
- mungesa e kontaktit me pacientin etj

Studime të ndryshme janë bërë kudo në botë për të vlerësuar perceptrimin e studentëve ndaj mësimit online. Ndaj një studim i tillë u duk tepër interesant për të parë dhe vlerësuar perceptimet e studentëve infermierë ndaj mësimit online të përdorur në Fakultetin e Shëndetit.

Qëllimi i studimit: Vlerësimi i perceptrimeve të studnetëve të vitit të parë akademik në nivelin bachelor të Fakultetit të Shëndetit rreth mësimit online gjatë pandemisë Covid – 19.

Materiale dhe metoda: Ky është një ***studim cross sectional***, i realizuar gjatë periudhës ***Shkurt – Mars 2021***. Në këtë studim morën pjesë ***214 studentë*** të Fakultetit të Shëndetit që ishin në vitin e parë Bachelor në degët Infermier i përgjithshëm dhe Infermier - Mami. Responding rate është 214/300. Pra në këtë studim morën pjesë rreth 70% e studentëve të vitit parë në këtë fakultet. Për realizimin e këtij studimi është marë një pyetësor i cili është i bazuar në studime të ndryshme të ngjashme të realizuara në botë. Nëpërmjet këtij pyetësori u morën informacion në lidhje me të dhënat demografike të pjesmarësve dhe klasat online. Gjithashtu ky pyetësor siguroi informacion dhe në lidhje me perceptimin e studentëve në lidhje me mësimin online që ata kanë ndjekur gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020 – 2021.

Rezultatet

Në studim morën pjesë 214 studentë që ndjekin studimet në vitin e parë bachelor në dy programet e Fakultetit të shëndetit Publik nga 300 studentë gjithsej në këtë vit.

Grafiku 1.



Pjesa më e madhe e studentëve që morën pjesë në studim ishin studentë të degës Infermier i përgjithshëm.

Përsa i përket grupmosëh 47.2% ishin studentë 19 vjecar dhe 32.2% studentë 18 vjecarë.

Studentët e përfshirë në studim kishin një shpërnadrje të barabartë midis banimit në qëndrat rurale dhe ato urbane.

Grafiku 2.



U kërkuam studentëve të referojnë sipas perceptimit të tyre se cilës shtresë social ekonomike u përkasin. Shikojmë se kemi dominim me 82.7% të studentëve të cilët referojnë se i përkasin shtresë së mesme social ekonomike.

Edhe pse në popullatën e përfshirë në studim kishim studentët e vitit të parë iu kërkuam informacion nëse ata kanë marë pjesë më parë në mësim online dhe 70% e tyre referuan se kishin marë pjesë më parë në mësim online në platforma të ndryshme interneti. Ndërsa 30% referuan se kryesisht më parë mësimin e kishin realizuar nëpërmjet whatsup-it.

Tabela 1 Klasat online dhe informacion ne lidhje me mjetet qe kanë përdorur studentët për të ndjekur këto klasa

Variablat	Numri i studentëve	%
Mjeti që keni përodrur për të ndjekur mësimin online		
Celularin tim	157	74.1%
Celularin e familjarit	11	5.2%
Laptop/ kompjuter	13	6.1%
Celular+laptop/kompjuter	31	14.6%
Burim interneti për të ndjekur mësimin online		
Wifi	86	40.2%
Ofertat mujore të internetit në celular	52	24.3%
Kombinim i wifi dhe ofertave mujore të celularit	76	35.5%

Pjesa më e madhe e studentëve tanë kanë ndjekur mësimin online nëpërmjet aparateve të celularit, konkretisht 79.3% e tyre (celularëve personal apo dhe të familjarëve të tyre).

Për të bërë të mundur ndjekjen në kohë të mësimit online studentët tanë kryesisht kanë përdorr burimet statike të internetit në ambjentet e shtëpisë konkretisht 40.2% wifi dhe 35.5% e tyre kanë përodrur si ëifi dhe ofertat mujore të celularëve.

Tabela 2. Klasat online dhe informacion ne lidhje me pëlqyeshmërinë e mësimit online

Variablat	Numri i studentëve	%
Mësimi online (leksionet dhe seminaret) të vazhdojnë në këtë situatë pandemike dhe gjatë semestrit të dytë		
Po	97	45.3%
Jo	117	54.7%
Sa të kënaqur jeni me përdorimin e platformës Googler clasroom të përdorur në Universitetine Vlorës për realizimin e programit mësimor		
Shumë të kënaqur	50	23.4%
Të kënaqur	121	56.5%
Pak të kënaqur	36	16.8%
Aspak të kënaqur	7	3.3%

Edhe pse sipas raportimeve të realizuara prej cdo pedagogu për pjesmarjen e studentëve në orët online ishte vërtet e kënaqshme shikojmë se 54.7% e studentëve kërkojnë rikthimin në auditorë për vazhdimin e semestrit të dyte. Përsa i përket vlerësimit se sa të kënaqur janë studentët me përdorimin e platformës Google classroom shohim se 79.9% e studentëve janë të kënaqur me atë që ofron kjo platformë dhe përdorimin e saj në mësimdhënie.

Tabela 3. Perceptrimi i studentëve në lidhje me mësimin online

	Aspak dakort	Disi dakort	Se di	Dakort	Shumë dakort
Përdorimi i mësimit online ndihmon studentin në drejtim të fleksibilitetit të zgjedhjes së orës se kur do të ndjeki videot mësimore në momentin kur nuk ka mundur të jetë online	20	92	30	56	16
Mësimi online nuk kërkon parapërgatitje specifike	93	67	27	23	4
Klasat online janë të lehta për tu përdorur	18	94	6	68	28
Mësimi në klasat online (leksionet + seminaret) janë njësoj sikur të realizoheshin në audiore	122	48	12	26	6
Diskutmi në klasat online është i lehtë	43	102	12	39	18
Kërkohet vetdisiplinim prej studentit gjatë mësimit online	14	50	18	90	42
Pyetjeve që u kam dërguar pedagogëve gjatë mësimit online u kam marë përgjigje	9	56	11	84	54
Pjesamarja e studentëve në klasat online mendoj se është e vogël	32	53	79	39	11

Ndërveprimi midis pedagogut dhe studentëve në klasat online mendoj se duhet të jetë më e mire	31	61	40	66	16
Gjatë orëve të mësimit online dominojnë gati të njëjtë studentë	30	62	27	65	30
Mendoj se mësimi online nuk ndikon pozitivisht në përgatitjen time profesionale	31	60	19	47	57
Gjatë mësimit online është shumë e lehtë të humbasësh vëmendjen	38	61	13	53	49
Rregjistrimi i leksioneve në formatin video prej stafit akademik është praktike për studentin	26	61	13	75	39

Pas një analizimi të kujdesshëm të pyetësorëve të plotësuar prej studentëve mund të dalim në konkluzion se 46.3% e tyre kishin perceptime disi negative në drejtim të mësimit online kundrejt 43% të cilët referuan perceptime pozitive. Dhe këto perceptime negative nuk kishin ndryshim midis studentëve të degës së Infermierisë dhe studentëve të degës Infermieri mami. Nga tabela e mësipërme perceprimet negative konsitonin kryesisht në :klasat online për ta nuk kanë qënë të lehta për tu përdorur, mësimi online kërkon përgatitje specifike prej tyre, mësimi online nuk është i njëjtë me mësimin në auditore, diskutimi në klasat online nuk është i lehtë. Përsa i përket perceptimeve pozitive shikojmë se studentët tanë referojnë përdorimin e videove të rregjistruara të mësimit si element pozitiv sashtu sikurse ndërveprimin me pedagogun në orën e mësimit apo dhe marrjen e përgjigjeve të shpejta nga pedagogu gjatë orëve të mësimit. Iu drejtuam pyetje studentëve në lidhje se sa ndikon mësimdhëa ne auditor dhe online rritjen e njohurive teorike. Si mund ta shihni dhe në grafikun 3 nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm për sa i përket perceptimit të studentëve. Të dy format e studimit kanë ndikim efikas në rritjen e njohurive.

Grafiku3.



Por programet mësimore që ofron Fakulteti i Shëndetit kanë si qëllim të përgatisin profesionistë të aftë për të ofruar kujdesje shëndetësore. Për të mundësuar këtë përgatitje rol të rëndësishëm kanë edhe praktikat mësimore që ndjekin studentët në institucionet e shërbimit shëndetësor. Iu kërkuam studentëve të vlerësojnë ndikimin e mësimit në auditor dhe online në rritjen e aftesive të tyre teknike. Në këtë rast studentët referuan se prezenca në auditor ka shumë më tepër efikasitet në rritjen e tyre të aftësive teknike në krahasim me mësimin online (grafiku 4)

Grafiku 4



Pra mund të themi se të mësuarit prej pacientëve të vertetë është shumë e rëndësishme për studnetët e infermierisë dhe mësimdhënia online nuk e zëvendëson dot atë [8.

Limitet e studimit: Ky studim u realizua jo me të gjithë studentët e vitit të parë të studimit. Ky studim ishte një vetraportim i studentëve. Do të ishte interesante të nxirnim në pahë faktorët që mund të kenë ndikuar në perceprimin negativ të studentëve në lidhje me mësimin online.

Konkluzion

Mësimi online i realizuar në Universitetin e Vlorës dhe fakultetin e Shëndetit Publik mundëson vazhdimësinë e programeve akademike në këtë kohë pandemie. Duke u bazuar në rezultatet e studimit gati 46.3% e studentëve kanë referuar se kanë perceptime negative ndaj mësimit online dhe 54.7% e tyre referojnë se ky mësim online mos të vazhdoj dhe gjatë semestrit të dytë.

Referencat

1. *Giuseppe Lippi, Camilla Mattiuzzi. (2021) SARS-CoV-2 positive tests efficiently predict pressure on healthcare system. Journal of Medical Virology **93**:4, 1907-1909*
2. *Chopra, S., Ranjan, P., Singh, V., Kumar, S., Arora, M., Hasan, M. S., Kasiraj, R., Suryansh, Kaur, D., Vikram, N. K., Malhotra, A., Kumari, A., Klanidhi, K. B., & Baitha, U. (2020). Impact of COVID-19 on lifestyle-related behaviours- a cross-sectional audit of responses from nine hundred and ninety-five participants from India. Diabetes & metabolic syndrome, 14(6), 2021–2030. https://doi.org/10.1016/j.dsx.2020.09.034*
3. *https://www.worldbank.org/en/news/feature/2020/06/08/the-global-economic-outlook-during-the-covid-19-pandemic-a-changed-world*
4. *Di Pietro, G., Biagi, F., Dinis Mota Da Costa, P., Karpinski, Z. and Mazza, J., The likely impact of COVID-19 on education: Reflections based on the existing literature and recent international datasets, EUR 30275 EN, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2020, ISBN 978-92-76-19937-3 (online), doi:10.2760/126686 (online), JRC121071.*
5. *https://shendetesia.gov.al/covid19-ministria-e-shendetesise-942-te-vaksinuar-3340-testime-872-te-sheruar-681-raste-te-reja-dhe-16-humbje-jete-ne-24-oret-e-fundit/*
6. *Lebenicnik M., Istenic Starcic A. (2018) The Online Learning Resources Definition and Students' Use in Higher Education Across Disciplines. In: Ëu TT., Huang YM., Shadiev R., Lin L., Starčič A. (eds) Innovative Technologies and Learning. ICITL 2018. Lecture Notes in Computer Science, vol 11003. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-99737-7_40*
7. *Dipti Koirala[1]*, Muna Silwal[1], Sunita Gurung[1], Muna Bhattarai[1] and Vikash Kumar KC[2] Perception toëards Online Classes during COVID-19 among Nursing Students of a Medical College of Kaski District, Nepal Journal of Biomedical Research & Enviromental Sciences. 2020 October 30;1(6):249-255. Doi: 10.37871/Jbres1151.*
8. Gaman MA, Ryan PM, Bonilla-Escobar FJ. To stay at port or to go to sea: are clinical clerkships a double-edged sword during the COVID-19 pandemic? Where do we go from here? Int J Med Students 2020;8:92–5.

Early Childhood Education through Art based Methods

MSC. Arber Bejkosalaj

Department of Education
Faculty of Humanities
University of Vlora.
a.bejkosala@gmail.com

Abstract

This paper argues that research involving children and young people is more effective if they are required to express their ideas and feelings via arts-based methods. I m trying to argument this idea throughout my own recent and previous experiences as a teacher of art and freelance painter.

According to Eisner (1972) "artistic learning and aesthetic experience are among the most sophisticated aspects of human action and feeling" (p. 1). It has also been noted that the arts play a vital role in the development of the child. Before children learn to read and write they draw, sing and dance (Kress, 1997).Young children in this learning stage are often curiosity about many things. Instilling reasonable beliefs about early childhood art education will promote the aesthetic development of young children at this stage. In fact *McArdle and Wright (2014)* believe that the arts are children's first literacies. Kress (1997) highlights how certain paths to literacy involve ways in which children make meaning; real or imagined.

All my opinions are based on the various kinds of experiences in the different countries in the world's children programs.

Key Words: *Children's art program, experiences on drawing and painting, aesthetic developments, early childhood education.*

Introduction

Early childhood education is the foundation of all basic education and plays an important role in individual development. Thus, it has an important impact on the future. There is less academic pressure at the learning stages of early childhood than at any other stages. As such, this stage is an important period in which to perform childhood art education. Much research identifies the importance and benefits of the arts in young children's lives (Ewing, 2010; Twigg & Garvis, 2010; Twigg, 2011a, 2011b; Wright, 2012). According to Eisner (1972) "artistic learning and aesthetic experience are among the most sophisticated aspects of human action and feeling" (p. 1). It has also been noted that the arts play a vital role in the development of the child. Before children learn to read and write they draw, sing and dance (Kress, 1997).Young children in this learning stage are often curiosity about many things. Instilling reasonable beliefs about early childhood art education will promote the aesthetic development of young children at this stage. In fact McArdle and Wright (2014) believe that the arts are children's first literacies. Kress (1997) highlights how certain paths to literacy involve ways in which children make meaning; real or imagined. This paper argues that research involving children and young people is more effective if they are required to express their ideas and feelings via arts-based methods.

The Importance of Early Childhood Art Education

Value of Young Children's Art As we all know, young children are very interested in art and art creation. Why is this so? In addition to serving as presents for parents and decorations for the home refrigerator, art serves as a natural vehicle for young children to present their creative ideas and express their inner feelings

These beneficial influences include:

- Physical development through hand-eye coordination and fine-motor skills acquisition and refinement

- Social interaction through experiences of sharing resources, assuming different roles in the art making process, and helping others, differentiating one's work from others, questioning, considering, evaluating and appreciating the work of others
- Cognitive development through arts specific language use, exploring and connecting concepts and objects to symbols, making choices over subject matter, different media, materials, and methods to produce art
- Expressive qualities including the ability to communicate concepts and ideas young learners may not have language to describe sufficiently but experience nonetheless
- Imagination, creativity and experimentation through trialing techniques, methods and materials and sequencing them in ways meaningful to the early learner, as well as linking one's own behaviors and actions with creative results and
- Problem solving skills which are often embedded in arts education such as producing a play, working out what colors or medium to use in visual arts, or deciding what sounds work together in a performance (Kindler, 1997; Lowenfeld & Brittain, 1970; Mace, 1997).

Arts-based research has been an accepted method of research in educational settings since its inception in the early 1990s by Elliot Eisner. This was developed further with Tom Barone. According to Barone and Eisner (2012) ABER accepts that meaning can be represented in multiple ways, not just discursive. Eisner (1991) explains that ABER allows the use of resources that are not just text such as visual images, music and dance, poetry and literature. These resources, he argues, allow children to grasp what cannot be revealed in text alone. According to Barone and Eisner (2012) ABER explores: "the potentialities of an approach to representation that is rooted in aesthetic considerations and that, when it is at its best, culminates in the creation of something close to a work of art" (p. 1).

The examples of arts-based educational research with young children

Next we will explore a number of research studies that have used ABER with young children within different contexts. Research with children on arts engagement. Tthe first explores the work of Margaret Barrett (2002), as well as her research with Heather Smigiel (2003, 2012). Their research design: "…sought to build on children's knowledge and experience, and to value their engagement as co-researchers in exploring the research questions. Through the lens of narrative inquiry we sought to access children's stories concerning their engagement with the arts" (Barrett & Smigiel, 2003, p. 4).

Both Barrett and Smigiel were concerned that much research on the importance of the arts in children's lives failed to respect young children's perspectives. In 2000, a national report entitled Australians and the arts: What do the arts mean to Australians? Purported that perspectives of young children could be gained through adults such as their parents (Costantoura, 2000). This discounted the fact that young children could very much talk about their own experience, but additionally express these ideas through art itself. Barrett's (2002) work with early years' children on their music engagement for example, showed the capacity of children as being researched 'with' rather than researched 'on'. In her article Invented notations and mediated memory (2002) she shares the work on two children's approach to expressing ideas on music through the use of image or 'invented notation'. Here the children were asked to explore ways in which to express music they heard through drawing and image. This research highlighted how children were capable of representing sound and music via their own symbolic methods. Some 10 years later Barrett, Everett and Smigiel (2012) share findings from children aged 5-8 years. This research was participatory research where the children were asked to share their perceptions of the arts. Barrett, et. al. (2012) state that the children were at the center of the investigation and as such, were treated as co-researchers. They were, according to the researchers "knowledgeable informants in respect to the phenomenon under investigation-their understandings and experience of the arts" (p. 187).

Consequently, any intervening or mediating between adults was not necessary. This study focused on what the arts 'do' for children rather than their own meaning-making in arts practice. It referred to children's perspective through both conversation (language) and their drawing and photography (visual imagery). The visual image was present to provoke this discussion. The participants (140 children from up to 14 early childhood settings) were guided to: 1. Take as many photos as they like that represent the arts and select eight of them and 2. Name these

photos (p. 181). They were also asked to do a 'Draw and Tell' task and talk in small focus groups about the ways in which they participated in the arts; both in and out of school.

The 'Draw and Tell' task, according to Barrett and Smiegel (2012), was an important strategy for the children to express their ideas that their arts engagement is cognitively, emotionally, socially, physically and aesthetically fulfilling. This, the authors contend should inform the development and continuation of arts practice and policy within Australian schools and arts organizations. In considering implications for early childhood research the researchers recommended that in order to engage children in research productively then the processes and practices of the arts should be employed.

Conclusions

For young children, opportunities to talk about and express their experiences via multimodal means is important, according to Barrett et. al. (2012) as it can: "build their current understandings; increase their evident appreciation for and capacity to analyses their experiences; make connections between their experience of the arts in and beyond school; foster their wellbeing; and stimulate their capacity for creative thought and activity" (p. 200). This information is useful for early childhood researchers because if the children in this study were not asked about their perspectives and involvement in the arts the outcomes would be limited in understanding a deep meaning such participation. Parents for example, may have a pre-conceived idea about what benefits as well as other implications for children's participation in the arts. Similarly, if Barrett and Smiegel had only got the young participants to talk about these experiences there would be a risk of not receiving information that the children may not be able to articulate through words and also the children may have only provided the information they thought the researchers would require (see also Barton & Bahr, 2013).

References:

- *Eckman, F. R. 1994. The competence-performance issue in second-language acquisition theory: A debate. In E. E. Tarone, S. M. Gass and A. D. Cohen (eds.) Research methodology in second-language acquisition. Hillsdale, NJ: L. Erlbaum.*
- *Ellis, R. 1985. Sources of variability in interlanguage. Applied Linguistics.*
- *(Ewing, 2010; Twigg & Garvis, 2010; Twigg, 2011a, 2011b; Wright, 2012).*
- *Barton & Bahr, 2013). Perspective on schooling from early childhood times.*
- *Barrett and Smiegel (2012),*
- *Heather Smigiel (2003, 2012).*

BULETINI SHKENCOR | ISSN 2310-6719 Numri 4, Volumi1, 2021 | UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Mësimdhënia me në Qendër Studentin: A mund të vlerësohet si një metodë e sukseshme në Universitetetin "Ismail Qemali", Vlorë?

Irena Toshkallari[1], Rezarta Sinanaliaj[1]

[1]Universiteti " Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri

Abstract

Increasing the quality of teaching and learning through the application of innovative methods, is one of the strategic objectives set out in the Strategy of Development of University of Vlora "Ismail Qemali. The implementation of these innovative methods is a process ëhich is supported not only at the micro level by lecturers but also at the macro level through the drafting of policies, strategic documents, guidelines and manuals on the development and use of these methods. This paper is an attempt to evaluate the effectiveness of the student-centered teaching method at the Faculty of Public Health during the academic year 2018-2019, through a quantitative comparative approach betëën the results of student questionnaires for the evaluation of the quality of teaching, respecting ethics in data processing. Of course, in addition to the method implemented by the lecturers, the quality of teaching in a study program is influenced by a number of other factors such as didactic and laboratory tools, investments in infrastructure and others. This paper analyzes the results of student responses ëhich directly assess instruments such as encouraging dialogue/discussion in classroom, critical thinking. Comparing the results of students' responses of the teaching quality assessment questionnaire during the academic year 2017-2018 and 2018-2019, ëe can conclude that the implementation of Student Centered Learning method, at the Faculty of Public Health of University "Ismail Qemali" Vlore, has bën effective and identified as a good practice.

Keywords: *innovative, teaching methods, quality teaching, student, effectiveness, questionnaire.*

Abstrakt

Rritja e nivelit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes aplikimit të metodave inovative, dixhitale dhe mjeteve teknologjike, është një prej objektivave strategjikë të parashikuara në Skenarin Nr. 2 të Strategjisë së Zhvillimit të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë. Implementimi i këtyre metodave bashkëkohore është një proçes i cili mbështetet jo vetëm në nivelin mikro prej pedagogëve por edhe në nivel makro nëpërmjet hartimit të politikave, dokumentave strategjik, udhëzuesve dhe manualeve mbi zhvillimin dhe përdorimin e këtyre metodave. Një prej metodave inovative e cila ka filluar tanimë të implementohet, në mënyrë të institucionalizuar si prioritet strategjik në Fakultetin e Shëndetit pranë UV-së është mësimdhënia me studentin në qendër. Ky punim është një përpjekje për të vlerësuar efektivitetin e modelit të mësimdhënës me në qendër studentin në Fakultetin e Shëndetit gjatë vitit akademik 2018-2019, nëpërmjet një qasje krahasuese sasiore ndërmjet rezultateteve të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies gjatë dy viteve akademike të njëpasnjëshme. Sigurisht që në cilësinë e mësimdhënies së një programi studimit përpos metodës së implementuar prej pedagogëve ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë të tillë si mjetet didaktike dhe laboratorike, invesitmet në infrastrukturë etj... Gjatë përpunimit të dhënave janë analizuar rezultatet e përgjigjeve të studentëve që vlerësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë disa prej indikatorëve mbi metodën e mësimdhënies si inkurajimi diskutimit dhe dialogut në klasë, mendimit kritik, bërjen e mësimit interesant etj. Duke krahasuar rezultatet e përgjigjeve të studentëve në pyetësorin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies gjatë vitit akademik 2017-2018 dhe 2018-2019, mund të arrijmë në përfundimin se implementimi i metodës së mësimdhënies me studentit në qendër, në Fakultetin e Shëndetit pranë

Universitetit " Ismail Qemali", ka rezultuar efektiv duke u evidentuar si një praktikë e mirë.

Fjalët Kyç: *metodat inovative të mësimdhënies, vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, mësimdhënia me në qendër studentin, efektivitet, pyetësor.*

Hyrje

Ideja se studentët i ndërtojnë më mirë njohuritë kur marrin pjesë aktivisht gjatë këtij proçesi, është bërë gjithnjë e më popullore në gjysmën e dytë të shekullit të 20, duke hedhur bazat për Mësimdhënien me në Qendër Studentin (prej këtej e në vazhdim MQS, shënim i yni).[1] Mësimdhënia me në Qendër Studentin nisi si një lëvizje progresive për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e cila synon që të shtrihet dhe të kthehet në një lëvizje të gjerë arsimore, në të cilën të përfshihen specialistët e të gjitha niveleve të arsimit shqiptar[2]. Megjithëse një koncept i përdourur gjerësisht në literaturën që ka për objekt të sajin studimin e metodave të mësimdhënies, ende nuk ka një përkufizim të pranuar universalisht se çfarë është MQS, megjithatë studjuesit bien dakort se filozofia e kësaj qasje mësimdhënëse është: *studenti është në zemër të proçest të të mësuarit*. [3]

Referuar studimeve europiane mbi metodat inovative të mësimdhënies Sistemi i Bolonjës kërkon në mënyrë të domosdoshme për të *shkuar drejt qasjes së MQA*.[4] Për të implementuar këtë metodë mësimdhënëse janë ndëmarrë një sërë hapash prej vendeve të ndryshme si: ridizenjimi i kurrikulave dhe krijimi i hapsirave legjislative për ti bërë më të lehta proçedurat e ndryshimeve të programeve, ndryshimi i syllabuseve, trajnimi i stafit, sigurimi i materialeve didaktike etj. Një prej angazhimeve të Shoqatës Europiane të Institucioneve të Arsimit të Lartë është inkurajimi dhe ndihma ndaj vendeve anëtare të saj për të zhvilluar një qasje të përgjithshme në mësimdhënie ku MQS të jetë në themel. *"Vizioni jonë për 2020 është një Zonë Europane e Arsimit të lartë ku kalimi tek MQS do të jetë realizuar në të gjitha shtetet ku aplikohet sistemi i Bolonjës (ESU, 2015).* [5] Në implementimin praktik të qasjes MQS mund të përfshihen një sërë komponentësh si: punime në grup, të mësuarit mbi bazën e problemeve, të mësuarit në bazë të burimeve, përdorimin e metodës së rastit (veçanërisht e njohur në mjekësinë dhe infermierinë), lojëra me role, seminare në klasë, prezantime në grupe, dhe përdorimin e regjistrave të të mësuarit ku studentët shprehin opnionin e tyre mbi përvojën e tyre arsimore. [6] Sipas disa studjuesve kalimi në MQS ndikon në rritjen e cilësisë dhe përgatitjes së studentit; përvoja tregon që edhe pedagogët ndihen më të kënaqur; studentët janë më aktivë dhe më të kënaqur.[7]

Në Shqipëri pas firmosjes së Kartës së Bolonjës në vitin 2003, institucionet e arsimit të lartë nisën proçesin e përshtatjes së kurrrikulave, ku në mënyrë të pashmangshme edhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, e nisi këtë proçes që prej vitit 2005 me disa programe studimi, dhe tanimë të gjitha programet e studimit ofrohen në përputhje me sistemin e Bolonjës. Nga sa më sipër për implementimin praktik të MQS *është e nevojshme që në qasjen e intitucioneve të arsimit të lartë të ketë një zhvendosje të fokusit nga stafi akademik tek studentët*.[8] Në kuadër të kësaj të fundit në Universitetin e Vlorës në linjën Strategjike Nr.1, një prej objektivave të parashikuar në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2018-2024, është rritja e nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes aplikimit të metodave inovative, dixhitale dhe mjeteve të teknologjisë. Veçanërisht Fakulteti i Shëndetiti (FSH) e ka institutitucionalizuar këtë metodë mësimdhënëse duke e parashikuar si një prej prioriteteve të Planit të saj Strategjik:"Fuqizimi i sistemit akademik duke vendosur studentin në qendër„ [9].

Një elemenet i rëndësishëm gjatë proçesit të implementimit dhe institucionalizimit të një metode të re mësimdhënse eshë edhe vlerësimi i efektivitetit të metodës si një kriter i përcakuar njëkohësisht edhe në Kodin e Cilësisë së Arsimti të Lartë në Repblikën e Shqipërisë: "Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë ". (Kriteri, Standardi III).[10] Sikurse u përmend edhe më sipër FSH është një prej njësive kryesore e cial tanimë e ka institucionalizuar përdorimin e kësaj metode prej stafit të saj akademik. Por a ka rezultuar efektiv implementimi i kësaj metode? A mund të vlerësohet ajo si një praktikë e mirë për t'u aplikuar në mënyrë të suksesshme në Universitetin e Vlorës?

Për të vlerësuar efektivitetin e një metode mësimdhënëse mund të përdoren një sërë instrumentash si realizmi i fokus grupeve me stafin akademik ku ndahen eksperiencat mësimdhënesë, vlerësimi i arritjeve akademike të studentëve, vlerësimi i kurrikulave dhe sylabuseve të lëndëve përkatëse. Një tjetër metodë është nëpërmjet vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet grupeve të vlerësimit të brendshëm ose

të jashtëm duke marrë në konsideratë aplikimin e standardeve të cilësisë etj.

Sipas Kamber një prej 5- komponentëve për**I.**të vlerësuar dhe promovuar sistemin e MQS është vlerësimi i programit prej studentëve e cila konsiston në realizimin e pyetësorit, ku studentët të kenë mundësi të shprehin opinionin dhe perceptimin e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies. Në Universitetin " Ismail Qemali", Vlorë, si një detyrim që rrjedh edhe prej Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, në fund të çdo semestri studentët e të gjitha cikleve të studimit vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies për të gjitha lëndët e programit të studimit që kanë ndjekur gjatë semetrit përkatës. Pikërisht nëpërmjet analizimit të rezultateve të këtij pytësorit do të mund ti kthehet përgjigje pyetjeve të mësipërme kërkimore. Risia e këtij punimi konsiston në analizimin e perceptimit të studentëve si përfituesit kryesor të metodës së mësimdhënies me në qendër studentin, në Fakultetin e Shëndetit, në Universitetin „ Ismail Qemali", Vlorë. Qëllimi i këtij punimi qëndron jo vetëm në vlerësimin e efektivitetit të implementimit dhe insitucionalizimit të MQS në FSH por edhe në vlerësimin e mundësisë për ta implementuar më tej këtë metodë në mënyrë të institucionalizuar në njësitë e tjera kryesore në UV.

Dëshirojmë të sjellim në vëmëndje njëkohësisht se mënyra se si studentët reagojnë ndaj një qasje mësimdhënëse ndikohet nga një sërë faktorësh si eksperienca e mëparshme të mësimdhënies, aftësië e tyre, tipologjia e lëndës, disiplina ku implimentohet metoda, përmbajtja e programit të studimit, preferencat personale, nevojat, aftësitë, etj. [11] Shumësia e këtyre faktorëve mund të përbëjë një prej pikave të dobëta të këtij punimi(vlen të theksohet se duke qenë se periudha krahasimore i përket dy viteve të njëpasnjëshme gjykojmw se disa prej faktorëve mbeten të pandryshuar). Një tjetër mangësi e këtij punim i konsiston në analizimin vetëm të pyetjeve të mbyllura të studentëve dhe jo në krahasimin midis pyetjeve të hapura. Krahasimi vetëm midis rezultateve të dy viteve akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 është një tjetër limit i këtij punimi.Mund të vileshin të dhëna më të plota nëse rezulatatet e përgjigjeve të studentëve për vitin akademik 2017-2018 do të krahasoheshin edhe me rezulatet e përgjigjeve të studentëve për vititn akademik 2016-2017, ku nuk ka qenë e institucionalizuar MQS. Por duke qenë se në UV, pyetësori i studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies u implementua për herë të parë gjatë vitit akademik 2017-2018 ishte e pamundur që të sigurohej ky informacion. Këto limite të këtij mund të gjenerojnë ne të ardhmen studime të tjera në të ardhmen për vlerësimin e efektivitetit te MQS –së në UV.

Metodologjia

Në këtë pjesë të punimit shpjegohet në mënyrë të hollësishme rrugëtimi metodologjik për të arritur në qëllimin e parashtruar më sipër, duke i dhënë kështu kredibilitetin e mjaftueshëm punimit për tu validizuar dhe riaplikuar edhe prej studjuesve të tjerë në të ardhmen si proçesi i grumbullimit të të dhënave edhe i gjenerimit të rezultateve. Ky punim është një studim longitutinal, një rast studimor, duke qenë se janë analizuar rezulatet e dy vitve akademike me një rast studimi. Në një kontekst të veçant, midis shumë strategjive metodologjike, single case study, cilësohet si një prej strategjive më të përshtatshme për një studim të thellë të fenomenit, për ti dhënë domethënie se çfarë individët thonë dhe bëjnë në situatën reale.[12]

Instrumenti i përdorur për të mbledhur të dhënat, është pyetësori i studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të cilin studentët e plotësojnë në llogarine e tyre personale në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (UVMS). Databaza e të dhënave gjenerohet automatikisht prej sistemit UVMS duke ruajtur anonimatin e studentëve pjesëmarrës. Pyetësori është i përbërë prej 16 pyetjeve, 14 të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura të organizuara në dy seksione [14]. Respodentëve, nëpërmjet sistemit të vlerësimit me 5 - shkallë Likert (totalisht dakord, dakord, sjam dakord, sjam aspak dakord, pa përgjigje) ju jepet mundësia për të zgjedhur midis disa përgjigjeve me qëllim shprehjen e opinionit të tyre mbi disa qëndrime që kanë të bëjën në mënyrë të drejtëpërdrejtë me cilësinë e mësimdhënies. Një numër i konsiderueshëm i pyetjeve të pyetësorit shërbejnë si indikatorë matës i cilësisë së mësidhënies, pikërisht këto pyetje janë bërë objekt analizimi, të cilat në seksionin në vijim pasqyrohen hollësisht.

Njëkohësisht në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 ndryshuar me ligjin nr.48/212 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", gjatë përpunimit të të dhënave dhe publikimit të rezultateve është respektuar liria dhe etika akademike duke pasqyruar rezulatatet si mesatare aritmetike e përgjigjeve të studentëve në nivel Cikël Studimi në Fakultetin e Shëndetit Publik. Për përpunimin e të dhënave dhe rezulateteve të pyetësorë është marrë leja etike prej Fakultetit të Shëndetit me Shkresë

nr.174/4 Prot, datë 17.11.2020, Vendim Dekanati Nr. 8, Për miratimin e lejes për kërkim shkencor.

Analiza dhe Rezultatet

Nëpërmjet një qasje krahasuese sasiore janë analizuar rezultatet e **8792** pyetësorëve, të studentëve që ndjekin Ciklin e Parë të Studimeve në "Infermieri të Përgjithshme" dhe në "Infermieri Mami", për dy viteve akademike, 2017-2018 dhe 2018-2019 respektivisht **2711** dhe **6081** pyetësor. [1] Ndërkohë që përqindja e pjesëmarrjes së studentëve në studim krahasuar me numrin e studentëve të rregjistruar në program studimi për vitin akademik 2018-2019 është 97%[2] dhe për vitin 2017-2018 është 68.5%, duke i bërë kështu gjetjet e këtij punimi domethënës dhe gjithpërfshirës.

Në këtë pjesë të punimit praqiten rezulatetet e pyetësorëve të analizuara statistikisht në të dy nivele të cilat përkojnë njëkohësisht edhe me nënseksionet e mëposhtme. Së pari për të vlerësuar efektivititetin e implementimit të MQS-së në FSH janë janë krahasuar rezulatetet e përgjigjeve midis dy viteve akademike në nivel cikli studimi. Së dyti për të identifikuar se si institucionalizimi i metodës MQS dhe aplikimi i saj prej të gjithë stafit akademik ka ndikuar në perceptimin e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies janë krahasuar edhe rezulatet midis lëndëve të ndryshme në dy vite të ndryshme akademike.

Krahasimi i rezultateve midis dy viteve akademike

Në Tabelën.1 janë krahasuar rezultatet e pergjigjeve të studentëve që janë përgjigjur Totalisht Dakord ndaj qëndrimeve:"Mësimi ishte Interesant"; "Qëllimi i mësimit u shpreh qartë"; "Pedagogu ishte i qartë"; "Pedagogu e bën lëndën interesante"; "Pedagogu inkurajonte dialogun/ diskutimin në klasë"; "Pedagogu inkurajonte mendimin kritik" si dhe "Pjesëmarrja në mësim ishte e vlefshme për plotësimin e dijes me njohuri të papërfshira në tekst".

Tabela 1: Rezultatet e përgjigjeve të studentëve

Qëndrimet e Vlerësuara	**Përqindja e studentëve që janë Totalisht Dakort**		Diferenca
	2017-2018	**2018-2019**	
Mësimi ishte Interesant	65.4%	69.7%	+ 4.3%
Qëllimi i mësimit u shpreh qartë	65.1%	69.5%	+ 4.4%
Pedagogu ishte i qartë	59.0%	70.8%	+ 11.8%
Përmbajtja e mësimit ishte shumë e vështirë	35.1%	34.7%	- 0.4%
Pedagogu inkurajonte dialogun/ diskutimin në klasë	53.5%	58.4%	+ 4.9%
Pedagogu inkurajonte mendimin kritik	51.0%	54.1%	+ 3.2%
Pedagogu e bën lëndën interesante	64.3%	65.7%	+1.4%
Pjesëmarrja në mësim ishte e vlefshme për plotësimin e dijes me njohuri të papërfshira në tekst	51.9%	57.6%	+ 5.7%

Gjatë analizimit të të dhënave rezulton se krahasuar me vitin e mëparshëm akademik, gjatë vititi akademik 2018-2019 është rritur përqindja e studentëve të cilët ishin totalisht dakord me qëndrimin. Diferencë e cila i përket intervalit nga 1.5% deri në 11.8% . Sigurisht një prej qëllimeve të pedagogëve gjatë proçesit të mësimdhënies me studentin në qendër është lehtësimi i proçesit të të

[1] Vlen të përmendet se çdo student plotëson një pyetësor të ndryshëm për të gjitha lëndët që ka ndjekur gjatë vitit akademik, pra shifrat e mësimpërme nuk tregojnë numrin e studentëve të rregjistruar në programet e studimit.

[2] Përqindja e pjesëmarrjes së studentëve është përllogaritur si mesatare aritmetike e përqindjes së pjesëmarrjes së studentëe për çdo lëndë të programit të studimit. (kjo e fundit si përllogaritje e numrit të studentëve të rregjistruar në lëndën përkatëse dhe numri i pyetësorëve të plotësuar).

nxënit tek studentët, nga analizimi i rezultateteve të përgjigjeve të studentëve konstatohet se krahasuar me vitin e mëparshëm akademik gjatë vitit akademik 2018-2019 kemi një rënie me 7.6% të studentëve të cilët ishin totalisht dakord dhe dakord me qëndimin:" Përmbajtja e mësimit ishte e vështirë".

Njëkohësisht krahasuar me vitin e mëparshëm akademik në 2018-2019 studentët e kanë vlerësuar më pozitivisht "Mësimin në Përgjithësi";"Përmbajetjen e Leksioneve" si dhe " Pedagogun e lëndës" krahasuar me vitin e mëparshëm akademik. Në grafikun 1 shihen dy tendenca nga njëra anë është rrtiur përqindja e studentëve që i vlerësonin shumë mirë të tre aspeketet e mësipërme dhe nga ana tjetër konstothet rënie e përqindjes e studentëve që i vlerësonin mirë.



Grafik 1: Si e vleresojnë studentët permbajtjen e leksionit, pedagogun dhe mësimin në përgjithësi.

Më konkretisht nëse për vititn akademik 2017-2018, rritet përqindja e studentëve që e vlerësojnë shumë mirë përmbajtjen e leksionit nga 78.2% në 81.4%, po në të njëjtën nivel bie përqindja e studentëve që e vlerësojnë mirë përmbajtjne e nga 19.5% në 16.1%. Pra nëse një vit më parë studentët e vlerësonin mirë mësimin në përgjithësi, pedagogun e leksionit dhe përmbajtjen e leksionit të programit të studimit për vitin akademik 2018-2019 i vlerësojnë shumë mirë.

Krahasimi i rezultateve midis lëndëve të ndryshme

Në rezulatetet e përgjigjeve të studentëve vihet re se në disa prej lëndëve vlerësimi i studenëvë ishte pozitiv ashtu sikurse kishte lëndë të cilat student i vlerësonin më pak pozitivisht. Në vijim *duke marrë në kosideratë përkufizimin se mësimi dhe mësimdhënia me në qendër studentitn luan një rol të rëndësihëm në stimulimin e motivimit*, vetë-reflektimit dhe angazhimit të studentëve në proçesin e të mësuarit, janë analizuar përgjigjet e studentëve për dy prej qëndrimeve:" Pedagogu Inkurajonte mendimin Kritik" dhe „Pedagogu inkurajonte diskutimin/ dilogun në klasë". Në grafikët e mëposhtëm sikurse mund të evidentohet edhe prej legjendës janë pasqyruar përqindja e studenëve që janë totlaisht dakord dhe dakord me qëndrimet e sipërcituara për të gjitha lëndët e ciklit të parë të studimit që ofrohen në FSH, për dy vitet akademike.



Grafik 2: Krahasimi për lëndë të ndryshme brenda të njëjtit vit akademik

Gjatë krahasimit të rezulateve për midis lëndëve për vitin akademik 2017-2018 (linja1) si dhe 2018-2019 (linja 2) jo vetëm që është rritur përqinjda e studentëve që janë totalisht dakord dhe dakord me qëndrimin „Pedagogu Inkurajonte mendimin Kritik", në nivel cikël studimi (për më tepër seksioni mësipërm) por janë zvogëluar edhe diferencat midis lëndëve me njëra tjetrën, sikurse vihet re dukshëm edhe grafikisht ku Linja 2 është më pak e lakuar se Linja 1. Në po të njëtin përfundim arrijmë edhe gjatë krahasimit të përqindjes së studentëve që ishin totalisht dakord dhe dakord me qëndrimin „Pedagogu Inkurajonte diskutimin në klasë" kështu nëse gjatë vitit akademik 2017-2018, diferandat midis lëndëve i përkisnin intervalit nga 32%- 2% ndërkohë që për vitin akademik 2018-2019 kjo difenrëncë i përket intervalit nga 11% deri në 1%. Duke ritheksuar edhe një herë se institucionoalizimi i kësaj metoda ka ndikuar pozitivisht në

përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për një numër të konsiderueshëm të lëndëve të programit të studimit.

Mësimdhënie bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të të mësuarit dhe të nxënësit, me qëllimin kryesor, lehtësimin e të nxënit. Në një prej pyetjeve të mbyllura të pyetësorit studentët vlerësojnë vështirësine e lëndëve specifike, nga analizimi i rezultateteve të përgjigjeve të studentëve në nivel cikël studimi konstatohet se krahasuar me vitin e mëparshëm akademik gjatë vitit akademik 2018-2019 kemi një rënie me 7.6% të studentëve të cilët ishin totalisht dakord dhe dakord me qëndrimin **"Përmbajtja e mësimit ishte e vështirë**". Në grafikët që vijojnë janë paraqitur rezultatet e përgjigjve të studentëve për të gjitha lëndët e Bachelor në FSH.



Grafik 3: Shprëndarje e % së studentëve që ishin totalisht dakord me qëndrimin **"Përmbajtja e mësimit ishte e vështirë**".



Grafik 4: Shprëndarje e % së studentëve që ishin totalisht dakord me qëndrimin **"Përmbajtja e mësimit ishte e vështirë**".

Sikurse mund të shihet edhe prej krahasimit të grafikëve nga viti në viti kemi një zhvendosje të përqndrimit më të madhë të përgjigjeve të studentëve që ishin totalisht dakord dhe dakord me qëndrimin nga fasha 60%-80% në fashën 50%-70%, megjithatë këto shifra janë ende të larta, e tregojnë që ka ende nevojë për përpjekje më të mëdha prej stafit akademik. Njëkoëshisht dëshirojmë të theksojmë edhe një herë që metoda e mësimdhënies është vetëm një prej faktorëve që ndikon në proçesin e të nxënit tek studentët.

Përfundime

Qëllimi këtij punimi ishte vlerësimi efektiviteti të Metodës së Mësimdhënies me në Qendër Studentin të implementuar në mënyrë të institucionalizuar në Fakultetin e Shëndetit, nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies prej studentëve. Nëpëmjet një qasje krahasuese të analizmit të rezulateteve të 8792 pyetësorëve të studentëve të Ciklit të Parë të studimit në këtë fakultetet, u përpoqëm që ti jepnim përgjigje pyetjes kërkimore të këtij punimi nëse aplikimi i kësaj metode ka ndikuar pozitivisht në perceptimin e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies së programit të studimit.

U konstatua një rritje që i përket intervalit prej 1.5 - 11.8 në përqindjen e studentëve që ishin totalisht dakord me qëndrimet: "Mësimi ishte Interesant"; "Qëllimi i mësimit u shpreh qartë", "Pedagogu ishte i qartë"; "Pedagogu e bën lëndën interesante", "Pedagogu inkurajonte dialogun/ diskutimin në klasë; "Pedagogu inkurajonte mendimin kritik" si dhe"Pjesëmarrja në mësim ishte e vlefshme për plotësimin e dijes me njohuri të papërfshira në tekst".

Karahasur me vitin akademik 2017-2018, gjatë vitit akademik 2018-2019 vihet re se po aq sa është rritur përqindja e studenëve që vlerësonin shumë mirë programin e studimit, përmbajtjen e leksionit dhe mësimin në përgjithësi po aq është zvogëluar përqindja e studentëve që i vlerësonin mirë këto aspekte, duke treguar njëkohësisht një rritje të përqindjes së studentëve që i vlerësojnë shumë mirë programin e studimit, përmbajtjen e leksionit dhe mësimin në përgjithësi.

Me isntitucionalizimin e kësaj metode në vitin akademik 2018-2019, pas krahasimit të rezultateve midis lëndëve të ndryshme me vitin e mëparshëm akademik konstatohet se pothuajse në të gjitha aspektet e vlerësuara krahas përmirësimit të

perceptimit të studentëve në nivel cikël studimi është zvogëluar intervali i diferenacve të përgjigjeve të studentëve për lëndë të ndryshme, duke treguar se edhe lëndë të cilat vlerësoheshin më pak pozitivisht në vitin akademik 2017-2018 për vitin akademik 2018-2019 vlerësohen më pozitivisht.

Si përfundim referuar rezultateve të mësipërme thuajse në të gjitha aspektet e vlerësuara nëpërmjet pyetësorit konstatohet përmirësim i perceptimit të studentëve mbi cilësisën e mësimdhënies së programeve të studimit të ciklit të parë të studimit të ofruara prej Fakultetit të Shëndetit.

Vlerësimi i cilësisë së mësmidhënies së programeve të studimit dhe metodave mësimdhënese është gjithnjë në fokus të veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Studentët janë aktorët kyç në këtë proçes, duke u përfshirë jo vetëm në rolin pasiv të përfitimit të drejtpërdrejtë por edhe aktiv të vlerësimit të këtyre metodave. Sikurse është përmendur në këtë punim, Mësimdhënia me në Qendër Studentit është një prej metodave që në UV po implementohet gjerësisht prej stafit akademik dhe Fakulteti i Shëndetit është një prej njësive kryesore nismëtarëve në institucionalizimin e saj, proçes i cili referuar rezultateve të mësipërme ka ndikuar pozitivisht në rrijten e cilësisë së mësimdhënies.

Duke marrë në konsideratë praktikën pozitive të FSH në implementimn në mënyrë të efektshme të MQS-së sugjerojmë që edhe njësitë e tjera kryesore në UV të përfshijnë dhe parashikojnë në mënyrë të institucionalizuar aplikimin e kësaj metode, duke filluar që prej vendoses si objektiv strategjik, parashikimit të komponentëve praktik të MQS në programet lëndore etj. Sigurisht që këto përpjekje duhet të ecin paralelisht me mbështetjen institucionale për sigurimin e bazës materiale dhe instrumentave të nevojshëm, trajnimin e stafit akademik mbi MQS etj.

Bibliografi

[1], [3],[4], [6], [8], [11] Attard. A, Ioio. E, Geven. K, Santa. R. (2010). Mesimdhënia me në Qendër Studentin. Një Hyrje në Teori dhe Praktikë. ESU: Bukuresht fq.31; 8, 24, 17, 6, 33.

[2] Dushku. V, (2017). Format bashkëkohore të punës mësimore. Marrë prej: https://edukimi.uni-gjk.org/upload/dokumentet/85584-Valentina%20Dushku%20-%20Punim%20diplome.pdf . (Parë për herë të fundit 07.11.2020)

[5] European Students' Union (2015). Përmbledhje mbi mësimdhënien me në qendër studentin ne arsimin e lartë në Europë. ESU: Bruksel . fq. 31

[7] Bidaj.F, Paparisto. A, Sh. F."Mësimdhënia: Studenti në qendër dhe roli ICT." Marrë prej: http://erasmusplus.al/wp-content/uploads/2017/07/Seminar-Vlore-HERE-finale-Erasmus-Inovacioni-dhe-modernizimi-i-mesimdhenies-ne-IAL.pdf . (Parë për herë të fundit 10.11.2020)

[9] Strategjia e Zhvillimit 2018-2024, Universiteti "Ismail Qemali", Vlore. Linja Strategjike Nr. 1, Objektivi Nr.1. fq. 57.

[10] Vendim i Këshillit të Ministrave. Nr. 531, datë 11.09.2018. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë.

[12] Qutoshi, Sadruddin & Poudel, Tikaram. (2014)."Qasja Mësimdhënëse me Studentin ne Qendër: Ccfarë do të thotë për komunitetin e stakeholsersave në Karachi, Pakistan? „Journal of Education and Research. Vol. 4.

[13] Vendim i Senatit Akademik Nr.21, datë 08.05.2018 "Për procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësisë e mësimdhënies për lëndët e cdo programi studimi në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

[14] Vendim i Senatit Akademik të Universiteti " Ismail Qemali", Vlorë nr. 52 datë 20.04.2017.

[15 – 16] Agaj. F." Implementimi dhe impaktini i metodave inovative të mësimdhënies, në Kosovë" fq. 47. (Punimë doktorate)

Strategjia e Zhvillimit së Zhvillimit 2017-2024 të Fakultetit të Shëndetit Publik, Universiteti „ Ismail Qemali", Vlorë.

Heick. T. (August 2020) "15 examples of student-catered Teaching". Teaching Thoughts. Aviable at: https://www.teachthought.com/pedagogy/15-examples-student-centered-teaching/

Burime Interneti: *.*

Enago Academy. Si tee shkruajmee metodologjinee e njee artikulli shkencor. Marrë prej:https://www.enago.com/academy/how-to-write-the-methods-section-of-a-scientific-article/ . (Parë për herë të fundit 05.11.2020)

Teach. Com: Teacher-Centered Approach to Learning. Marrë prej:https://www.teach.com/what/teachers/know/teaching-methods/(Parë për herë të fundit 02.11.2020)

Teach English Advocad. What is student centered teaching. Marrë prej: https://www.i-to-i.com/tefl-faq/what-is-student-centred-teaching.html .(Parë për herë të fundit 02.11.2020)

HISTORI

TOPONIMIA E QYTETIT TË VLORËS SIPAS REGJISTRAVE OSMANË NË FUND TË SHEK.XIX DHE FILLIM TË SHEK.XX

Dr. Elsajed Rexhaj
elsajed.rexhaj@univlora.edu.al
Prof.Asoc.Aleks Trushaj
aleks.trushaj@univlora.edu.al/atrushaj@yahoo.com

Abstrakt

Vlora gjendet e pozicionuar ne jugperëndim të Shqipërisë me shtrirje veripeërndim-juglindje. Lagja në perëndim dhe jugperendim nga deti Adriatik dhe Jon e bënte qytetin e Vlorës jo vetëm një qendër urbane, por edhe si një qytet tregtar jo vetëm rajonal, por edhe si nyje lidhëse e tregtisë se brendshme me atë përtej detit dhe gjithashtu tregtisë transit , si një nga skelat e Perandorisë Osmane. Bazuar në regjistrat Daimi dhe Jokllama të Perandorise Osmane të fundshekullit t XIX dhe filim shekullit te XX për Vlorën, do të hasen tri trajta të cilësimit administrativ:

Avllonia shehri	–	qyteti i Vlorës
Avllonia kazase	–	kazaja e Vlorës
Avllonia nahijesi	–	nahije e Vlorës

Këto regjistra e japin Vlorën të rrethuar me fshatra ku numërohen rreth 65 të tillë, të cilët mbanin lidhje me qytetin.Të dhnat toponimike janë të pasura ku gjejmë të pasqyruar jo vetëm emrat e lagjeve, por edhe emrat e vendeve dhe të rrugëve të qytetit. Bazuar në të dhënat toponimike mund të gjykojmë dhe për aspektin funksional të qytetit si qendër administrative; qendër ekonomike prodhuese dhe tregtare; entitet me funksione fetare dhe publike, si dhe qendër e zhvilluar urbane. Nga pasqyrimi dhe krahasimi i të dhënave toponimike, rezulton se qyteti i Vlorës është në shvillim e sipër, në shtrirje dhe zgjerim urbanistik, gjë që pasqyrohet në shfaqjen e lagjeve të reja krahas gjashë lagjeve të vjetra të qytetit.

Fjalëkyçet: *Kazaja e Vlorës, Regjistër Osman dhe regjistrim, Daimi dhe Jokllama,Toponimi, ,Tophana, Skela Çadesi*

Abstract

Vlora is loçated on southwest of Albania and its layout is on northwest-southeast. The region on west and southwest of the Adriatiç and Ionian Sea made Vlora çity not only an urban çenter, but also a trading town. It was a regional trading plaçe as well as an important exçhanging route between domestiç and overseas trade, and it was also for transit trade purposes. Vlora was one of the harbors of the Ottoman Empire. Based on Daimi and Jokllama reçords and registrations of the Ottoman Empire period, during 19th çentury and the beginning of 20th çentury, we will notiçe three administrative naming of Vlora çity:

Avllonia shehri	–	Vlora çity
Avllonia kazase	–	Vlora kazaja
Avllonia nahijesi	–	Vlora nahije

These registers show that Vlora çity was surrounded by nearly 65, whiçh kept trading with the çity. The toponymiç data are full of names of neighborhoods, plaçes and streets of the çity. Based on these data we çan also disçuss about the funçtional aspeçt of the çity as an administrative, manufaçturing and trading çenter; an entity full of religious and publiç funçtions as well as an urban development çenter. Taking into çonsideration the indiçation and çomparison of the toponymiç data, it turns out that the çity of Vlora is developing and having a urban expansion. This is shown by the

development of new neighborhoods along with the six old neighborhoods of the çity.

Keywords: *Kazaja of Vlore, Ottoman reçords and Registration, Daimi & Jokllama, Toponymy, Skele Çadesi*

1.Hyrje

Qyteti i Vlorës në fund të shek.XIX dhe fillim te shek.XX ka një pozitë të favorshme gjeografike e çila mundëson zhvillimin e vet. Nga jugu dhe jugperëndimi qyteti është i kufizuar me detin i çili favorizon tregtinë dhe lidhjet me jashtë ndërsa nga veriperëndimi, veriu dhe lindja kufizohet nga kodra dhe një rrjet i gjerë fshatrash, 65 të tillë, të çilët gjithashtu mundësonin dhe ndihmonin në zhvillimin e jetës urbane të qytetit të Vlorës. Parë në ketë këndvështrim, këtij qyteti nuk i mungojnë si të mirat jetësore të çilat siguroheshin prej marrëdhënieve me fshatrat të çilët e rrethojnë , por edhe të mirat të çilat sigurohen prej ekzistençës së detit.

Nga kjo pozitë mund ta shohim qytetin e Vlorës jo vetëm si një qendër urbane, por edhe si një qytet tregtar jo vetëm rajonal, ku fshatrat e kesaj periudhe drejtohen për të plotësuar nevojat e veta, por edhe si nyje lidhëse e tregtisë se brendshme me atë përtej detit dhe gjithashtu tregtisë transit , si një nga skelat e Perandorisë Otomane.

Regjistrat osman Daimi dhe Jokllama të fund shek. XIX dhe fillim shek. XX edhe pse jo të plotë në informaçion, duke u bazuar në të dhënat toponimike, mund të na krijojnë një imazh të mjaftueshëm për të krijuar pamjen urbanistike të qytetit të Vlorës dhe tendençën e tij të zhvillimit urban.

Gjuha shqipe ka qenë në një marrëdhënie intensive me gjuhën zyrtare të Perandorisë osmane, ndonëse në një raport jo të favorshëm për të. Toponimet, duke përfshirë ato të nivelit rajonal-vendor, shfaqen si një ndër vlerat më të qëndrueshme të gjuhës shqipe. Ruajtja e formës vendëse të emërtimit të vendeve, rrugëve, lagjeve, kodrave, është pjesë e qëndresës së kulturës në ruajtje të identitetit të saj burimor. Por ruajtja e formës vendase të toponimise është edhe si pasojë e tolerançës së administratës osmane në mbajtjen e këtij dokumentaçioni.

Në regjistrat Daimi dhe Jokllama, ku regjistrat Daimi fillojnë nga regjistri Daimi nr. 4 i çili daton në vitin 1894 dhe përfundon me regjistrin Daimi nr. 15 viti 1920, ndërsa regjistrat Jokllama prej viteve 1893 – 1910, për Vlorën do të hasen tri trajta të çilësimit administrativ:

a. Avllonia shehri – qyteti i Vlorës
b. Avllonia kazase – kazaja e Vlorës
c. Avllonia nahijesi – nahije e Vlorës

Në 12 regjistrat osman , Daimi, në kryet e faqeve do të përdoret për qytetin e Vlorës toponimia " Avllonia shehri ". Kazaja e Vlorës (Avllonia kaza) në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX si njësi administrative drejtohej nga Kajmekani, ndërsa nahija e Vlorës (Avllonia nahije) drejtohej nga një drejtor.[1]

1.1 Toponimia e fshatrave të Vlorës sipas regjistrave osmanë të kohës.

Në regjistrat osmane të fund shek. XIX dhe fillim shek. XX përfshihen edhe emrat e fshatrave të krahinës së Vlorës dhe rrethinat (Avllonia kazasë) e saj. Fshatrat e kazasë Vlorë janë :Aliban, Ameniçë, Armen (Ermen), Babiçë, Beshishtë, Bishan, Brataj, Bunavi, Budinë, Çerkovinë, Çeprat, Çerkeçi, Drashoviçe, Dukat, Dhërmi, Gerneç, Goriçë, Gorisht, Grabjan, Gjorm, Hoshtimë, Kanina, Karbunar, Kërkovë, Kisbardë (Kishbardhë ose Qishbardhë), Koçul, Kropisht, Kudhës, Lapardha, Lepeniçë, Lëkurës, Llakatund, Malkek (Mallkeq), Mavrovë, Mazhar, Mëkat, Mërtiraj, Mërtish, Mifol, Muris, Nartë, Novoselë, Palasë, Panaja, Penkovë, Peshkëpi, Piçar, Risili, Romës, Skrofotinë, Smokthinë, Shkozë, Tërbaç, Tragjas, Treblovë, Vajzë, Velçë, Vodiçë, Vranisht, Vuno, Xhyherinë, Yç kardes (Trevëllazën), Zekalli, Zvërneç, Radhimë.[2]

Bazuar në regjistrat Daimi dhe Jokllama të kohës , krahina e Vlorës është e pasur me fshatra ku numërohen rreth 65 të tillë, të çilët mbanin lidhje me qytetin e Vlorës jo vetëm të natyrës administrative , por edhe tregtare apo të qarkullimit të mallrave dhe njerëzve.Ekzistença e fshatrave të shumtë përreth qytetit të Vlorës patjetër që ka ndikuar drejtpërdrejt në natyrën ekonomike dhe jetën e banorëve të tij.

1.2 Toponimia e qytetit të Vlorës

1. **Lagjja Tophana**[3]
   Emri i lagjes Tophane vjen prej gjuhës turke dhe do të thotë : vend për prodhimin e topave apo vendosjen e tyre.

2. **Lagjja Çedid (Xhedid)**[4]

Emërtesa e lagjes Çedid (Xhedid në shqip) vjen prej gjuhës turke që do të thotë; e re ose i ri. Siç mund të kuptohet , kemi të bëjmë me një lagje të re në qytetin e Vlorës që dëshmon për rritjen e tij.

3. **Lagjja Gazi Evrenoz**[5]

Emërtesa e lagjes Gazi Evrenoz vjen prej gjuhës turke dhe është bashkim i dy fjalëve turke; Gazi (fitimtar) dhe Evrenoz (një nga komandantet osmanë gjatë sulmeve të para në tokat shqiptare), pra Evrenoz fitimtari.

4. **Lagjja Karabash**[6]

Emërtesa e lagjes Karabash vjen prej fjalës turke :Karabas që do të thotë kokë arap, i zi ose kokëkrisur.

5. **Lagjja Muradije**[7]

Emërtesa e lagjes Muradije vjen prej turqishtes :Muradiye, emër ky i vendosur për nder të sulltan Muratit.

6. **Lagjja Varosh**[8]

   Emërtesa e lagjes Varosh vjen prej fjalës turke : Varos, lagje e një qyteti mesjetar jashtë mureve të kështjellës, zakonisht e veçuar nga pazari.
   Kjo dëshmon gjithashtu vjetërsinë e qytetit të Vlorës dhe rëndësinë e tij në mesjetë edhe si një vendbanim i fortifikuar.

1.3 Mikrotoponimia (vendet) e qytetit të Vlorës

Në regjistrat pranë kadiut të qytetit të Vlorës (Daimi dhe Jokllama) për periudhën 1893 – 1920) gjejmë të pasqyruar jo vetëm emrat e lagjeve , por edhe emrat e vendeve, të çilat janë pjesë e lagjeve të qytetit, por edhe si vende të veçuara prej lagjeve , pjesë e qytetit apo rrethinave të tij. Për të dhënë një pasqyrë sa më të plotë urbanistike të qytetit është e domosdoshme të evidentojmë edhe mikrotoponiminë e tij.
Emrat që përbëjnë mikrotoponiminë e tij janë:

Lagjja Tophana –kemi keto vende:

Abaz kenar (bregu Abazit), kenar turqizëm (breg, bregu i detit, bregu i lumit, liqenit etj),**Ayaz kenari** (bregu Ajazit), **?Ajazi i Vjetër, Aker Mahmud Surdi, Anbar, Bar Bogasi** (Barboasë) { Gryka bar ose bar gryka }, **Baçardak ose Muka Tepesi, BogdanaBregu Muka, Bregu Stefo ,Çairja, Çardak** ose gropa çur, **Gabarab, Gropa Çur ,Inarab, Istrati Bekçi** (shtrati bekçi ose kalldrëm), **Istrati Ikinxhi** (shtrati Inkinxhi), **Kaçanik, Kirmizi Topraği** (toka e kuqe), **Kovaçhani, Kuzbaba ,Küçük Kenari** (bregu i vogël), **Kerçulle, Lakudri, Meçando, Mesovun, Pirinç** (oriz), **Pirinç Tepesi** (kodra, maja e orizit), **Pusi Mekuran** (pusi Mekuran **Ferbetile, Sota Çeludi, Sotir Çikore** { gropa Sotirit },**Stefo Kenari** { bregu Stefo ose bregu Stefos },**Şifa, Şifo Bogazi** { gryka shifo ose shifa }, **Şifo Kenari** (bregu shifo), **Ştuf Kenari** (bregu shtuf ose shtufës), **Şurdhi** (Shurdhi), **Tophana, Tophana Kenari** { bregu Tophana },**Top Kenari** (bregu Top),**Top Kişbarda Kafa** (qafa Top Qishbardha), **Viris, Çundalik** (xhundallëk),**Hyqymet, Varosh, Kala,Pa Krye.**

Lagjja Xhedid-kemi vendet:

Abaz Kenari, Ayaz Kenari (bregu Ajazit), **Anbar, Baçardak, Bregu Muka, Buyuk kenari** (bregu i madh), **Çairja, Çarsi** (çarshe), **Çikmaz** (pa krye), **Dar** (e ngushtë), **Gropa Çur, Gropa Deri, Gurbazdar, Hazir Çikore** (gropa çikore), **Hukumet** (qeverisë ose qeveria) ,**Jahudi tasi** (jahudi tashe - guri i hebreut), **Kaldrim Kafasi** (kalldrëm kafasë - qafa e kalldrëmit), **Kambo Pisa** (këmba e pishës

), **Kapu Çur** (dera çur), **Kirmizi Topragi** (toka ose dheu i kuq), **Kondil, Kovaçhani (** kovaçane), **Kuçur ,Kuzbaba, Kuçuk Kenari** (bregu i vogël),**Lakudri, Lonçi** (llonxhë), **Mekarun Pusi** (pusi mekuran), **Mesovun, Muka Tepesi** (kodra ose maja Muka), **Nar Bogasi** (Nar Boasë - gryka Nar), **Pisa** (pisha), **Pisa ayagi** (pisha ajaë- këmba e pishës), **Pusi Mekuran, Sadra** (fushë), **Sahat, Skela, Sota Çekuri ?, Stefan, Stefo Tepe** (kodra ose maja stefani-it), **Stuf Tepesi** (shtuf tepesi - kodra , maja shtuf), **Syta Çikore** (shyta çikore) ,**Tophana, Viris ?, Çami** (xhami), **Çundalik** (xhundallëk).

Lagjja Gazi Evrenoz-kemi vendet :

Ayaz kenari (bregu Ajazit), **Aker Mahmut Surdi** (Aker Mahmut Shurdhi), **Anbare, Baçardak** (Baxhardak), **Bogdana, Bregu Muka ose Bregu Çinar, Buyuk dere** (lumi , përroi i madh), **Çairja** (livadhi), **Çarsi** (çarshe - tregu) ,**Çeshma Mahmut Aga** (çezma e Mahmut Agait), **Çur Çikore** (gropa çur), **Dar** (e ngushtë), **Eski kasaphane** (thertorja ose kasaphana e vjetër), **Eski Pazar** (eski Pazar - pazari i vjetër), **Evrenoz alti** (Evrenoz alltë), **Grika Pisa** (grika pisha), **Gaz ovasi** (fusha e fitimtarit ose pushtuesit), **Gropa Çur ose Lamatova, Gryka sefa ose sifa, Sega** (gryka shefa ose shifa, shega), **Gurbazdar** (gurbazhdar), **Hazir Çikore** (hazer çikore - gropa çikore), **Hazna** (arka), **Hukumet Sokagi** (Hukumet sokae - sokaku i qeverisë) ,**Inarab ?, Istrat Bekçi** (ishtrat bekçi - shtrati bekçi), **Istrat Ikinçi** (ishtrat ikinxhi - shtrati i dyte), **Jahudi tasi** (jahudi tashe - guri i hebreut), **Kafa Kisbarda** (qafa qishbardha), **Kala ose Çairja, Kasaphani** (kasaphanë - thertore), **Kasaphane Sokagi** (rruga e thertores), **Kirmizi Topragi** (toka dheu i kuq), **Kume** (rërë), **Kuzbaba, Kuçuk Kenari** (kyçyk kenarë - bregu i vogël), **Lamatova ose Bregu Muka, Mahmut Surdi** (Mahmut Shurdhi), **Mekarun Pusi** (pusi mekarun), **Mekra Akra ?, Mesovun, Mesuk ?, Muka Tepesi (** kodra ose maja Muka), **Nar Bogasi** (Nar Boasë - gryka Nar), **Pisa** (pisha), **Pisa ayagi** (pisha ajaë- këmba e pishës), **Prisal ? ose Prithal ?, Syta Çikore** (shyta Çikore - gropa Shyta), **Tepe ayagi** (tepe ajaë - këmba tepe), **Tophana, Top Tepesi** (kodra ose maja Top), **Viris ?, Çundalik** (xhundallëk), **Zogu kol** (zogu koll - krahu i zogut).

Lagjja Karabash-kemi vendet:

Anbar, Baba Osman ose Baçardak, Baçardak ose Bekçi Istrati, Viris ?, Bogdana, Bregu, Muka, Buyuk kenari (bregu i madh), **Dar** (e ngushtë), **Gropa Çur, Gropa Deri, Gryka Sefa ose Sifa, Istrati Bekçi ose Kaldrim** (ishtrati bekçi ose kalldremi), **Kala, Kimba Pisa** (këmba e pishës), **Krua Çuri** (kroi çurri), **Kurçile ose kirçile** (kurçillë ose Kërçillë), **Kuçuk Kenari** (bregu i vogël), **Lakudri ?** (Llakudri), **Mandra, Mekarun pusi** (pusi Mekuran), **Mesovun, Nar Bogasi** (Nar Boasë - gryka Nar), **Niviçë ?, Pisa(** pisha), **Stefo Kenari** (stefo kenarë - bregu Stefo),**Sifa Çikore** (shifa çikore - gropa shifa), **Syta Çikore ose Buyuk Kenari** (shyta çikore ose byjyk kenarë - gropa Shyta), **Tophana, Viris ? ose baçardak** (viris ose baxhardak).

Lagjja Muradije -kemi vendet:

Anbare, Araba kafasi (qafa e Arabasë), **Baba Osman Tepesi** (kodra, maja e Baba Osmanit), **Baçardak, Baçardak Mekarun, Bogdana, Bregu Baba Osman, Bregu Muka ose Lamatova** (Llamatova), **Budak, Buyuk kenari** (bregu i madh), **Çairja, Çakçi (** thikëpunues **), Çerçizi, Çesma** (çeshma), **Çikmaz** (çekmaz - pa krye), **Çole, Gropa Çur, Gropa Deri, Gryka Sefa ose Sifa, Gryka Sega ose Kafa Arpa** (gryka shega ose qafa arpa), **Gurbazdar, Hazir** (hazer - ose gropa), **Hazir Çikore** (hazer çikore - gropa çikore), **Istrati Bekçi** (shtrati bekçi) ,**Jahudi** (jahudi - hebrej), **Jahudi tasi** (jahudi tashe - guri i hebreut), **Kaçanik, Kafa Arpa ose Gruka Sefa** (qafa arpa ose gryka shefa), **Kafa Kara** (qafa e zezë, e thatë), **Kafa Kisbarda** (qafa Qishbardha), **Kala, Kala Çesmasi** (çeshma e kalasë), **Kambo Pisa ose Çinar Kenari, Kasaba Kenari** (bregu kasabasë), **Kasaphani** (thertore), **Kirmizi Topragi** (toka ose dheu i kuq), **Kilisa** (kisha), **Kisbarde** (qishbardhë), **Kriri, Kuzbaba (kuzbaba ose çevize)**, **Kuçuk Kenari** (bregu i vogël), **Lopar, Lamatova** (Llamatova), **Mehmet aga Çesma** (burimi ose çezma e Mehmet agë-s), **Mekarun Pusi** (pusi Mekuran), **Mesovun, Muka Tepesi** (kodra ose maja Muka), **Nar Bogasi** (Nar Boasë - gryka Nar), **Pazar, Pisa** (pisha), **Pisa ayagi** (pisha ajaë- këmba e pishës), **Prisal? ose Prithal?, Pusi Mekarun** (pusi Mekarun), **Sadra, Sahat, Sakat, Skela, Soguk Su** (souk su - - uji i ftohtë), **Sifa, Sifo ?** (gryka shifa, ose Shifa), **Surdha Çikore** (shurdha Çikore - gropa Shurdha), **Syta Çikore** (shyta çikore), **Teferiç, Tophana, Tophana Kenari** (tophana kenarë - bregu tophana), **Top Kafa** (qafa Top), **Top Kafa ve Mahmut Surdi** (top kafa ve Mahmut Shurdhi - qafa top dhe Mahmut Shurdhi), **Top Tepesi** (kodra ose

maja top), **Viris?, Çevize ose Kuzbaba** (xhevize ose kuzbaba).

Lagjja Varosh -kemi vendet:

Anbare, Baçardak ose Pisa (baxhardak ose pisha), **Bregu Muka, Çaire** (livadhë), **Çerkeçi** (çerkexhi), **Çikmaz** (pa krye), **Hazir Çikore** (Gropa Hazir), **Inarab, Jahudi tasi** (jahudi tashe - guri i hebreut), **Kambo Pisa** (kambo pisha -këmba e pishës), **Kilisa Kenari** (bregu i kishës), **Mahkeme sokagi (** rruga e gjykatës), **Mekarun Pusi** (pusi Mekarun), **Pazar, Pisa** (pisha), **Prisal? ose Prithal?, Tophana, Tophana Kenari** (bregu Tophana), **Varosh, Çundalik** (xhundallëk).

Vende të tjera të qytetit të Vlorës

Në regjistrat Daimi dhe Jokllama, përveç vendeve të mësipërm të çilët janë pjesë përbërëse e lagjeve të qytetit , ndeshen rrallë edhe vende të çilat evidentohen më vete, kjo tregon tendençën për zgjerim dhe zhvillim të qytetit në këtë periudhë. Jemi në fazat e para të krijimit të lagjeve të reja, kjo duket më qartësisht , sidomos në emërtesën e vendit **Çedid Tophana.** Këto vende janë;
Seramush(Regj. Daimi nr. 15, fl. 33, nr. 25), **Sevaster (**Regj. Daimi nr. 15, fl. 4, nr. 9 – 20), **Vakf** (Regj. Daimi nr. 12, fl. 150, nr. 1), **Tophana "** Xhedid Tophana **"** (Tophana e Re), (Regj. Daimi nr. 15, fl. 92, nr. 1), **Budak (**Regj. Jokllama nr. 8, fl. 81, nr. 27 – 31), **Agarsi Bregu i Detit (**Regj. Daimi nr. 9, fl. 77, nr. 13-16).

Siç vihet re nga më sipër , qyteti i Vlorës ka një mikrotoponimi të pasur me rreth 146 emra vendesh të çilat hasen në shumiçën e tyre si pjesë e disa prej lagjeve të qytetit. Disa prej tyre janë pjesë e çdo lagjeje të qytetit siç janë vendet: Tophana, Mekarun Pusi, Bregu Muka dhe Anbare. Nga te dhenat e mësipërme, lidhur me mikrotoponiminë, të krijohet ideja per ekzistençën e një sistemi të mirepërçaktuar adresash të çilat lehtësojnë mirë orientimin.

Me një vështrim mbi mikrotoponiminë e qytetit , ne mund të themi se lagjet e tij janë në marrëdhënie të ngushta me njëra- tjetrën , ato janë zhvilluar e zgjeruar në vijim të njëra – tjetrës, kjo duket sidomos në ekzistençën e përbashkët të mikrotoponimisë së lagjeve të Vlorës.

Gjithashtu , mikrotoponimia e qytetit të Vlorës , dëshmon se edhe në fund të shek. XIX dhe fillim shek. XX, kemi të bëjmë me *tipare të një qendre urbane orientale të Ballkanit*[9].

Vendet marrin emërtesën sipas funksionit dhe karakteristikave të veçanta si: publike, ushtarake, sipas funksionit fetar, administrative, ekonomik, për nder të shenjtëve apo individëve të çaktuar apo karakteristikave natyrore , lidhur kjo e fundit me zhargonin popullor që ato kanë apo kanë trashëguar nga kohë më të hershme.
Sipas funksionit publik; Çesma (çezma), Mekarun Pusi (pusi i Mekarunit), Mehmet aga Çesma (çezma e Mehmet agait), Kala Çesmasi (çezma e kalasë), Sahat (orë për publikun), Teferiç (shëtitore vend me hije dhe me ujë), Çardak (për të ndenjur në verë strehë e mbuluar me degët e pemëve).
Sipas funksionit ushtarak; Tophana (vend për prodhimin e topave apo vendosjen e tyre), Tophana Kenari (bregu vendosjes së topave), Çedid Tophana (vend i ri i vendosjes së topave), Kala (kështjellë), Top Tepesi (maja e topave).
Sipas funksionit fetar; Kisbarde (kish bardhë), Kilisa (kishë), Kilisa Kenari (bregu i kishës), Kafa Kisbarda (qafa kishë bardhë), Çami (xhami), Top Kişbarda Kafa (kasha e bardhë në qafën e topave), Vakf (instituçion fetar mysliman vend i shenjtë), Kuzbaba (babai i shenjtë).
Sipas funksionit administrativ; Mahkeme sokagi (kalldrëmi i gjykatës), Hukumet (qeverisë), Hukumet Sokagi (kalldrëmi i qeverisë), Hazna (arke shtetërore), Lonçi (komandanti ushtarak dhe dy ekspertë ose organi udhëheqës i esnafit).
Sipas funksionit ekonomik; Çarsi (treg), Çakiçi (thikëpunues ose biçakçi), Kovaçhani (farkëtari), Kasaphane Sokagi (kalldrëmi i thertorës), Kasaphane (thertore), Pazar (treg drithi ose fruta perime etj), Eski Pazar (tregu i vjetër), Eski kasaphane (thertorja e vjetër).
Sipas funksioneve të tjera (individ apo vende me karakteristika të veçanta); Zogu kol (krahu i zogut), Varosh (lagje e vjetër jashtë mureve të kështjellës), Tepe ayagi (maja ajag(z)i), Stefo Tepe (maja ose kodra e Stefos), Stefo Kenari (bregu i Stefo-s), Soguk Su (uji i ftohte), Stefan, Surdha Çikore (gropa Shurdha), Syta Çikore (gropa Shyta), Stuf Tepesi (maja Shtuf), Sadra (fushe), Pisa ayagi (këmba e pishës), Pisa (pisha), Pirinç Tepesi (maja ose kodra e orizit), Pirinç (oriz ose orizore), Nar Bogasi (gryka Nar), Muka Tepesi (maja Muka), Kumë (rërë), Kuçuk (i vogël), Kuçuk Kenari (bregu i vogël), Krua Çuri (kroi Çuri), Kirmizi Topragi (dheu i Kuq), Kimba Pisa (këmba

e pishës), Kaldrim (rrugë e shtruar me gurë), Kaldrim Kafasi (qafa e kalldrëmtë), Kafa Kara (qafa e zezë ose e trimit), Kafa Arpa (qafa Arpa), Istrat Ikinçi (shtrati i dytë), Istrat Bekçi (shtrati e Rojtarit), Hazir Çikore (gropa Hazir), Grika Pisa (gryka e Pishës), Gazi ovasi (fusha e fitimtarit ose pushtuesit), Dar (e ngushtë), Çairja (livadh), Bregu Stefo(s), Bregu Muka, Bregu Çinar, Bregu Baba Osman, Baba Osman Tepesi (maja Baba Osman), Ayaz kenari (bregu Ajzit), Abaz kenari (bregu i Abazit), Ajazi i Vjetër, Araba kafasi (qafa e Arabasë).

Sipas karakterit etnik; Jahudi (hebrenjte), Jahudi tasi (guri i hebreut).

1.4 Rrugët e qytetit të Vlorës.

Një aspekt tjetër i mikrotoponimisë së qytetit të Vlorës janë gjithashtu edhe emërtesat e rrugëve të çilat flasin shumë si mbi zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor , por edhe për lidhjen, marrëdhënien apo ndikimin e kulturës osmane në toponiminë historike.

Budak, Çami sokagi (xhami sokaë - rruga e xhamisë), **Çarsu sokagi** (çarshu sakaë - sokaku i tregut), **Çaus sokagi** (sokaku i Çaushit), **Çerkeçi sokagi** (çerkexhi sokaë - sokaku Çerkexhi), **Çeshma sokagi** (çeshma sokaë - sokaku i çezmës), **Çikmaz sokagi** (çëkmaz sokaë - rrugë pa krye), **Çur kapu sokagi** (çur kapu sokaë -sokaku i derës Çur), **Dar Sokagi** (dar sokaë - sokaku i ngushtë), **Hamam Sokagi** (hamam sokaë - sokaku i banjos publike), **Hukumet Çadesi** (hukumet xhadesi- xhadja e qeverisë) , **Hùkùmet Sokağı** *Hyqymet Sokagi* (rruga e qeverisë ose sokaku i qeverisë), **Kapudan Sokagi** (kapudan sokaë - rruga kapudan), **Karabash, Kasaphane Sokagi** (kasaphanë sokaë - rruga e thertores), **Kovaçani** (kovaçane-a), **Kursunlu sokagi ose Çesma** (kurshunllu sokaë ose çeshma - rruga e plumbosur), **Mandra, Muradiye sokagi** (sokaku Muradije), **Pirinç Sokagi** (pirinç sokaë -rruga e orizit), **Sahat sokagi** (sahat sokaë -rruga e sahatit), **Skela çadesi** (skela xhadesi - rruge e gjere e skeles), **Sokaku Karabeqar, Varos sokagi** (varosh sokaë - rruga e Varoshit), **Var Pazari i Vjetër.**

Emërtesa e rrugëve të qytetit të Vlorës në fund të shek.XIX dhe fillim shek. XX flet shumë, ajo na tregon se tashmë ky qytet po humbiste tiparet orintale ballkanike, rrugët gjithashtu në mënyrë të natyrshme po humbisnin rëndësinë e veçantë ekonomike dhe po mbusheshin përveç dyqaneve dhe magazinave me shtëpi banimi, *dukuri kjo edhe për qytete të tjera shqiptare* [10].

Ashtu sikundër në qytetet shqiptare të kësaj periudhe, dallohen tri kategori rrugësh: rrugë kryesore, rrugë të dyta dhe të treta [11], edhe në qytetin e Vlorës ekzistojnë rrugët kryesore (xhadesi) të çilat përshkruajnë thuajse gjithë qytetin dhe janë boshti i zhvillimit të tij, rrugët e dyta (sokagi) që lidhin lagjet e banuara me rrugët kryesore dhe qendrat zejtaro-tregtare, dhe rrugët e treta që ndërlidhin lagjet dhe vendet.

Siç mund të vërehet lehtësisht nga tabelat e mësipërme që pasqyrojnë pronat e regjistruara përgjatë rrugëve vihet re lehtësisht se rrugët e dyta (sokaqet) zënë pjesën më të madhe të sistemit rrugor të qytetit, por edhe të zhvillimit ekonomik. Te kategoria e rrugëve të treta mund të çilësohen ato pa krye (Çikmaz sokagi) të çilat duke u nisur prej rrugëve kryesore apo dytësore, përfundojnë në portën apo portat e banesave, gjithashtu në këtë kategori mund të përfshijmë dhe rrugët e ngushta (dar sokaë).

Zhvillimet plot gjarpërime, kthesa të mprehta dhe, në përgjithësi, të papritura të rrjetit rrugor në këto qendra, (dar sokaë) përbëjnë një karakteristikë tipike mesjetare jo vetëm për qytetin shqiptar, por për mbarë qytetin mesjetar europian. [12] Këto karakteristika të rrjetit rrugor , qyteti i Vlorës i ruan pothuaj të pandryshuara edhe për periudhën e fundit të shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX. I gjithë rrjeti rrugor i kësaj kohe u shërben kafshëve të ngarkesës, karroçave dhe këmbësorëve. Rugët dhe rrugiçat e ksaj peridhe të qytetit të Vlorës janë të shtruara me kalldrëm.

Bazur në mikritoponiminë e qytetit të Vlorës kemi 28 rrugë, ndër të çilat dy rrugë të gjera : Hykymet Xhadesi dhe Skela Çadesi, dhe 26 rrugë kryesisht sokaqe (sokagi). Kryesisht, rrugët e gjera vazhdonin me rrugë më të ngushta, si rast më tipik është Hykumet xhadesi dhe vazhdon me Hukumet sokagi, të çilat përshkruanin lagjet në brendësi të tyre, lidhnin vendet me njëri- tjetrin dhe ndonjëherë përfundonin në rrugë pa krye psh. Çikmaz sokagi.

Sipas regjistrave Daimi dhe Jokllama të kësaj periudhe, në rrugët e qytetit të Vlorës evidentohen 11 magazina, 19 dyqane, 115 shtëpi, truall 3, 1 ullishte, 1 bahçe, livadh 2, 2 mulli vaji dhe 3 makineri ulliri që dëshmojnë për hyrjen e teknologjive të reja. Duke analizuar raportin e pronave të regjistrura në rrugët e qytetit të Vlorës, peshën më të madhe tashmë e zënë shtëpitë 115 të tilla, kundrejt 39 pronave me natyre ekonomiko-tregtare. Kjo dëshmon edhe njëherë se tashmë rrugët e kanë humbur funksionin e tyre veçanërisht ekonomiko-tregtar duke i dhënë tashmë qytetit një fizionomi të re.

Toponimia dhe mikrotopnima si e lagjeve , po ashtu dhe e rrugëve na jepet e shkruar shqip me shkronja arabe si psh. : gryka, bregu, qafa, gropa, këmba e pishës etj. Ndonjëherë , një emër ndeshet në disa forma p.sh: pisha ayagi (këmba e pishës) ose kambo pisha, më pak ndeshet kombinimi i formës shqipe me atë turke si psh. kaldrim qafa (qafa e kalldrëmit).[13]

Toponimia si dhe mikrotoponimia e qytetit të Vlorës dhe e fshatrave përreth dëshmojnë se popullsia e vjetër vendase vlonjate ka mundur t'i qendrojë e t'i bëjë ballë asimilimit të pushtuesve të huaj në periudha të ndryshme kohore e të ruajë autentiçitetin e vet. Në toponiminë dhe mikrotoponiminë e shpalosur më sipër, shihet qartë që, ato në shumiçën dërrmuese, janë emra shqiptarë. Bazuar në të dhënat e nxjerra prej mikrotoponimisë , mund të shprehemi sadopak në lidhje me besimin fetar. Aty dëshmohet ekzistença e dy besimeve: atij të krishterë dhe besimit islam dhe, se këto dy besime në qytetin e Vlorës, janë zhvilluar në bashkëjetesë fetare.

Me interes toponimia e qyteti të Vlorës na paraqet ekzistençën e etnonimise hebreje në fund të shek.XIX dhe fillim te shek. XX. Këtu, prania e bashkësisë hebreje jepet me anë të mikrotoponimeve " Jahudi Sokagi" " Jahudi Tashi" dhe Jahudi që hasen të shtrira në lagjet; Muradije, Xhedit, Gazi Evrenez dhe Varosh,[14] një dëshmi e qartë kjo për bashkëjetesën dhe harmonine etnike midis hebrejve dhe popullsisë vendase.

Konkluzion

Qyteti i Vlorës, bazuar në të dhënat toponimike të vendeve dhe rrugëve, në regjistrat Daimi dhe Jokllama, në aspektin funksional pasqyron :

Qytetin si qendër administrative dhe publike, kjo vërehet në toponimet **Mahkeme sokagi** { rruga e gjykatës }, **Hukumet Çadesi** { rruga e qeverisë }, **Hukumet Sokagi** { sokaku i qeverisë }.

Qytetin si qendër ekonomike prodhuese dhe tregtare në toponimet **Çerkeçi Sokagi** { sokaku çerkexhinjve }, **Çarsu sokagu** { sokaku i tregut }, **Kasaphani** { thertore }, **Eski Kasaphani** { thertorja e vjetër }, **Eski Pazar** { pazari i vjetër }, **Çairja** { livadhi }, **Kovaçhani** { kovaçane }.

Qytetin si entitet me funksione fetare dhe publike në toponimet **Çami Sokagi** { sokaku i xhamisë }, **Kilisa kenari** { bregu i kishës }, vendi **Kilisa** { kisha }, **Hamam sokagi** { sokaku i banjos publike }, **Sahat sokagi** { rruga e sahatit }.

Qendër e zhvilluar urbane me të gjithë komponentët e nevojshëm urbanistik, ekonomik, administrativ dhe fetar.

Nga sa u tha më sipër, nisur prej toponimisë së qytetit, mund të themi se ky qytet përbëhët prej 12 (dymbëdhjetë) lagjesh, prej të çilave *6 të mirë evidentuara e me informaçion të bollshëm*; ***Muradije, Gazi Evrenoz, Tophana, Xhedid { Lagje e Re }, Karabash, Varosh*, Seramush, Sevaster, Vakëf, Xhedid Tophana { Tophana e Re }, Budak, Agarsi**. Gjykuar nga të dhënat toponime dhe shpeshëtia që ato hasen në regjistrat Daimi dhe Jokllama, lagjet më të rëndësishme, më të mëdha dhe të zhvilluara në aspektin urban janë sipas renditjes së mëposhtme;

Muradije me 70 vende dhe 15 rrugë prej te çilave 2 janë rrugë të gjera.

Gazi Evrenoz me 52 vende dhe 6 rrugë prej të çilave një rrugë e gjerë.

Tophana me 49 vende dhe 3 rrugë.

Xhedid (Lagje e re) me 47 vende dhe 5 rrugë.

Karabash me 30 vende dhe 2 rrugë.

Varosh me 20 vende, ndërsa emërtesat; **Seramush**, **Sevaster**, **Vakëf**, **Xhedid Tophana** dhe **Budak** shfaqen rrallë në regjistra dhe sipas veprimeve të regjistruara ato figurojnë ose si vende, ose si lagje.

Nga pasqyrimi dhe krahasimi i mësipërm i të dhënave toponimike i lagjeve, rezulton se qyteti i Vlorës është në shvillim e sipër (shtrirje, zgjerim) urbanistik, gjë që pasqyrohet në shfaqjen e lagjeve Seramush, Sevaster, Vakëf, Xhedid Tophana dhe Budak të çilat hasen në regjistrin daimi nr. 12, 15

që datojne pas vitit 1900, pra në fund të shek. XIX dhe fillim shek. XX qyteti i Vlorës është një qytet në rritje.

Nga pikëpamja urbanistike zhvillimi i qytetit të Vlorës është i konsoliduar në pjesën veriore dhe verilindore që përkon edhe me zonën kodrinore të këtij qyteti dhe, ku janë shtrirë lagjet më të vjetra të tij, më pas duket se zgjerimi i tij vazhdon duke zbritur në zonën fushore në drejtim të perëndimit dhe drejt jugut në drejtim të detit me rrugën e gjerë **Skela Çadesi** në lagjen Muradije. Këtë e mbështet edhe faktin se kjo rrugë që daton si toponimi që në regjistrat Daimi dhe Jokllama të fund shek. XIX, në ditët e sotme është edhe boshti kryesor rrugor i qytetit të Vlorës në të cilën është fokusuar zhvillimi urbanistik.

Literatura

[1] PetrikaThengjilli,Toponimia Historike ne Krahinen e Vlores,Tirane,2005, f. 14

[2] Ref. Regj. Daimi dhe jokllama. (1893-1920)

[3] AQSH, fondi nr. 126 Regj. Daimi nr. 4, fl. 3 – 4, , nr. 9, fl. 38, nr. 1-10, nr. 83-93, fl. 53, nr. 17-19, fl.80
Regj. Jokllama nr. 5, fl. 18, nr. 4, 11-13, fl. 94, nr. 1-3, nr. 6, fl. 20, nr. 3, fl. 27, nr. 27-28, fl. 31, nr. 4, fl. 32, nr. 2-5, fl. 34, nr. 11-12, nr. 7, fl. 73, nr. 1, fl. 75, nr. 6, fl. 76, nr. 7-8, fl. 79, nr. 1-2, fl. 126, nr. 3-4, nr. 8, fl. 106, nr. 657-659, fl. 107, nr. 718-720

[4] AQSH, fondi nr. 126 Regj. Daimi nr. 4, fl. 80, daimi nr. 9, daimi nr. 10, fl. 26, , daimi nr. 11, fl. 2, daimi nr. 12, fl. 7, daimi nr. 14, fl. 4, , daimi nr. 15, fl. 123, jokllama nr. 5, fl. 15, jokllama nr. 6, fl. 6, jokllama nr. 7, fl. 2, jokllama nr. 8, fl. 134, nr. 1, fl. 146, nr. 195, 197, 202, fl. 147, 148, nr. 240-241

[5] AQSH, fondi nr. 126 Regj. Daimi nr. 4, fl. 29, daimi nr. 9, fl. 7, daimi nr. 10, fl. 11, daimi nr. 11, fl. 14, daimi nr. 12, fl. 10, daimi nr. 13, fl. 14, daimi nr. 15, fl. 3, jokllama nr. 5, fl. 14, jokllama nr. 6, fl. 6,

. 126 Regj. Daimi dhe Jokllama

jokllama nr. 7, fl. 6, jokllama nr. 8, fl. 113, nr. 13, fl. 114, nr. 19, fl. 115, nr. 33, 35, 39, 41, fl. 116, nr. 46

[6] AQSH, fondi nr. 126 Regj. Daimi nr. 4, fl. 22, daimi nr. 9, fl.14, Daimi nr. 10, fl. 6, Daimi nr. 11, fl. 23, Daimi nr. 12, fl. 7, Daimi nr. 13, fl. 15, Daimi nr. 14, fl. 6, Daimi nr. 15, fl. 6, Jokllama nr. 5, fl. 3, nr. 1-30, 64, 66, 67, fl. 7, nr. 112-118, 121, fl. 8, nr. 133, 147-148, Jokllama nr. 6, fl. 20, Jokllama nr. 7, fl. 6, nr. 1-2, fl. 10, nr. 9-10, fl. 20, nr. 9-10, fl. 31, nr. 5-6, fl. 65, nr. 1-2

[7] AQSH, fondi nr. 126 Regj. Daimi nr. 4, fl. 3, Daimi nr. 9, fl. 6, , Daimi nr. 10, fl. 5, Daimi nr. 11, fl. 10, Daimi nr. 12, fl. 2, Daimi nr. 13, fl. 14, Daimi nr. 14, fl. 8, Daimi nr. 15, fl. 3, Jokllama nr. 5, fl. 18, Jokllama nr. 6, fl. 15
Jokllama nr. 7, fl. 2, Jokllama nr. 8, fl. 425-428
[8] AQSH, fondi nr. 126 Regj. Daimi nr. 4, fl. 8, Daimi nr. 9, fl. 15, Daimi nr. 11, fl. 16-17, Daimi nr. 12, fl. 90, Daimi nr. 13, fl. 40, Daimi nr. 14, fl. 25, Daimi nr. 15, fl. 14, Jokllama nr. 5, fl. 16, nr. 1-3, fl. 20, nr. 3-4, Jokllama nr. 6, fl. 10, nr. 1-3, fl. 47, nr. 20, fl. 62, nr. 1, fl. 66, nr. 25, fl. 83-84, nr.42-43, Jokllama nr. 7, fl. 2, nr. 22, fl. 22, nr. 7, fl. 43, nr. 1-3, fl. 71, nr. 5, fl. 115-124, nr. 1, fl. 119-120, nr. 5, Jokllama nr. 8, fl. 95, nr. 345,347,356, fl. 97, nr. 413-416, fl. 98, nr. 100, 478, fl. 108, nr. 1-7, 9-10, 16-17, fl. 161, nr. 598

[9] Zija Shkodra, Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare,Botim i Akademise se Shkençave e R.P te Shqiperise,Tirane,1984, f. 342

[10] Zija Shkodra, Po aty,f.349

[11] Emin Riza, Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetes se vone,Botim i Akademise se Shkençave e R.P te Shqiperise,Tirane,1991, f.33

[12] Po aty, f.34

[13] Ref. AQSH, fondi nr. 126 Regj. Daimi dhe Jokllama

[14] Ref. AQSH, fondi nr

SHKENCAT NATYRORE

Përcaktimi i mërkurit në mostrat mjedisore me metodën e HPLC-së

Kristiana Capo[1]
Pranvera Lazo[2]
Aurel Nuro[3]
[1]Ish studente e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës
[2]Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës
[3]Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës
kristiana.capo@yahoo.com

Abstrakt

Në këtë punim janë sjellë të dhënat e analizës me kromatografi të lëngët me presion të lartë për 6 tretësirat e komplekseve metalike të përdorura si: Zn, Pb, Cd, Hg, Cu dhe Ni, ku ndër këto tretësira kemi veçuar dhe analizuar kompleksin metalik të mërkurit. Mërkuri ndodhet në gjendje natyrale vetëm në sasi të vogla e cila vlerësohet tek 50-80 ppb të përbërjes së tokës. Ai ekziston në një numër të gjerë formash ku më shpesh haset në formën e sulfureve të ndryshme. Kompleksi i $Hg(DDTC)_2$ i përgjithshëm është analizuar me anë të aparaturës të HPLC i tipit të:"Algilent Technologies, 1200 Infinity Series". Me qëllim që të studiohen interferencat e metaleve të rëndë ndaj kompleksit mërkurik u ndërtuan një seri standartesh të secilit kompleks metalik të kompleksuara me DDTC. Më pas kemi injektuar një sasi prej 50µl të këtyre standarteve në aparaturë. Fillimisht kemi përdorur si eluent (metanolin + ujin) por nga format e piqeve të përftuara pamë se rezolucioni në ndarjen e tyre ishte shumë i ulët, më pas ndryshuam eluent dhe përdorëm përzierjen (ujë+metanol+acid acetik) dhe pamë nga kromatogramat e përftuara një rezolucion mjaft të lartë në ndarjen e piqeve. Tretësirat janë përgatitur në periudhën Qershor-Korrik 2017. Për kompleksin e mërkurit janë kryer disa injektime në përqëndrime të ndryshme të tij për të parë riprodhueshmërinë e metodës. Standarti i kompleksit mërkurik si fillim ka patur një përqëndrim të = 5.37ppm. Si provë e bardhë është përdorur diklor metani dhe rezultoi me një përqëndrim të = 0.00 dhe me një sipërfaqe piku të = 0.00. Për komplekset e mara në studim janë kryer matjet në gjatësitë e valëve të absorbimit përkatëse. Më pas janë kryer injektimet në aparaturë e HPLC-së ku janë studiuar interferencat e komplekseve të metaleve të tjerë ndaj kompleksit të mërkurit, këto përcaktime u bënë me metodën e kromatografisë së lëngët me presion të lartë të ndërtuar nga 4 pompa ku presioni që ushtrohet në secilën pompë është 600 bar, si kolonë të përdorur kemi një kolonë Zorbaks C8 me dimensione (16 cm x 4mm), me dedektor DAD me diodë ku ka të instaluar një llampë UV deuteriumi dhe temperatura brenda tij është mbajtur konstante me 30°C, e përshtatshme për analizën e mërkurit. Solventi i përdorur është përzierja (ujë+metanol+acid acetik) në raportet /(50:50), shpejtësia me të cilën lëviz lëngu nëpër pompa është 1ml/min.

Fjalëkyçe: *kompleksi mërkurik, metoda e kromatografisë së lëngët me presion të lartë, interferencat e metaleve, përgatitja e tretësirave standarte.*

Abstract

In this study are shown the data of analysis by liquid chromatography with high pressure for 6 solutions of metal complexes used as: Zn, Pb, Cd, Hg, Cu and Ni, where among these solutions we have isolated and analyzed the metal complex of mercury. Mercury in his natural state is found only in small quantities which is estimated at 50-80 ppb of soil composition. It exists in a wide number of forms where it is most often encountered in the form of various sulfides. The total Hg complex $(DDTC)_2$ was analyzed by HPLC apparatus of the type: "Algilent Technologies, 1200 Infinity Series". In order to study the interferences of heavy metals to the mercury complex a set of standards of each metal complex complexed with DDTC was constructed. We then injected a quantity of 50µl of these standards into the apparatus. Initially we used as eluent (methanol+water) but from the shapes of the obtained peaks we saw that the resolution in their

separation was very low, then we changed the eluent and used the mixture (water+methanol + acetic acid) and we saw from the obtained chromatograms a fairly high resolution in the separation of the peaks. The solutions were prepared in the period June-July 2017. For the mercury complex several injections were performed at different concentrations of it to see the reproducibility of the method. The standard of the mercury complex as a start had a concentration of = 5.37 ppm. Methane dichloride was used as the white test and resulted in a concentration of = 0.00 and a peak area of = 0.00. HPLC injections were then performed to study the interferences of other metal complexes to the mercury complex, these determinations were made by the method of high pressure liquid chromatography constructed by 4 pumps where the pressure exerted on each pump is 600 bar, Zorbaks C8 column with dimensions (16 cm x 4 mm), with diode detector DAD has a deuterium UV lamp installed and the temperature inside it is kept constant at 30^{o}C, suitable for mercury analysis. The solvent used is the mixture (water +methanol +acetic acid), the speed at which the liquid moves through the pumps is 1 ml / min.

Hyrje

Mërkuri është një element kimik me simbolin Hg dhe numër atomik 80 në gjendje të lëngët, me ngjyrë të argjendtë, ka shkëlqim, është i rëndë, ka qëndrueshmëri kimike dhe është i patretshëm në acid. Ka pikë avullimi te ulët dhe avujt e tij janë toksik. Mërkuri nuk bashkevepron me shumicën e acideve të tilla si: acid H_2S edhe pse me oksiacidet të tilla si acid H_2SO_4 dhe acidi HNO_3 e shpërbëjnë atë për të dhënë sulfate dhe nitrate. Mërkuri metalik është në gjendje të lëngët në temperaturën e dhomës. Komponimet inorganike të mërkurit janë komponime në të cilat ai shfqet një dhe dy valent. Ndër komponimet e mërkurit një valent është oksidi mërkuror (HgO) dhe kloruri mërkuror ($HgCl_2$). Oksidi mërkuror është i paqëndrueshëm dhe lehtësisht zbërthehet në mërkur metalik dhe në oksid mërkuri dy valent. Edhe komponimet e tjera mërkurore mund të dekompozohen me anë të nxehjes duke dhënë mërkur metalik dhe komponime të mërkurit dy valent. Ai ekziston në një numër të gjerë formash ku më shpesh haset në formën e sulfureve të ndryshme. Gjendet më i lidhur me Pb,Cd dhe është element përberës i tokës si metal i rëndë. Depozitat parësore të këtij metali ndeshen praktikisht me prejardhje vullkanike metamorfike ose shkëmbinj sedimentarë në koncentrime që variojnë zakonisht 50-500 ppb. 99% e mërkurit nëntokësor në botë është koncentruar në zonat mërkuro-ferroze të cilat korespondojnë në zonat e Paqësorit Lindor ku perfshihen brigjet perëndimore të Amerikës dhe të pjesës lindore të Azisë dhe Atlantikut. Mërkuri është një substancë toksike e cila nuk ka një funksion të njohur në biokimi ose në fiziologjinë e njeriut. Kjo vjen pasi ai nuk ndodhet në mënyrë të natyrshme në organizmat e gjalla. Emetimi i mërkurit ndodh si pasojë e prodhimit të zhivës, veçanërisht nga korrja e tokës dhe nga emisionet e vullkaneve. Mërkuri është një ndotës globalist dhe gjithashtu është pjesëmarrës në shumë komplekse kimike, shpesh të pazakonshme të ndikuara nga vetitë e tij fizike. Kromatografia e lëngjeve me presion të lartë është metoda kromatografike e përdorur në studimin tonë për analizën e kompleksit të mërkurit. Lehtësia në përdorim dhe mundësitë e shumta që paraqet kjo teknikë kanë gjetur përdorime të shumta në identifikimin dhe izolimin e kompleksit mërkurik. Kjo teknikë është një sistem i mbyllur i automatizuar dhe që lejon ndarjen dhe izolimin e komponimeve në sasi më të mëdha se në teknikat e tjera kromatografike. Ndarja e komponimeve dhe e klasave të ndryshme midis tyre bazohet në bashkëveprimet e tyre me një fazë stacionare të eluuar nga një solvent. Solventi i përdorur është përzierja (ujë+metanol+acid acetik) në raportet /(50:50), shpejtësia me të cilën lëviz lëngu nëpër pompa është 1ml/min.

Tabela 1.1 Vetitë fizike të mërkurit

Masa molekulare	**200.59 gr/mol**
Dendësia	13.5 > se dendësia e ujit
Gjendja fizike	e lëngët
Temp e vlimit	357.3^{o}C
Temp e shkrirjes	-38.9 ^{o}C

Materiali dhe metodat

2.1. Përgatitja e tretësirave standarte

Si fillim morëm metalet e vendosura në 5 enë të vogla kimike dhe me anë të një peshore analitike peshuam masën e metalit sëbashku me enën dhe më pas masën e enës bosh me diferëncë gjetëm masën e kompleksit të metalit përkatës, qëllimi i këtij studimi është përgatitja e tretësirës standarte të kompleksit mërkurik prandaj të gjitha llogaritjet janë kryer vetëm për kompleksin e mërkurit. Sipas formulës :

Masa e metalit=(masa e enës + masa e metalit) - masën e enës bosh.

Të dhenat e masës së secilit metal janë parqitur në tabelën e mëposhtme.

Tab 1.2 Masat e metaleve të rënda

Emri i metalit	Masa e enës + masa e metalit +DDTC (gr)	Masa e enës bosh (gr)	Masa e metalit+DDTC (gr)	Masa e metalit (gr)
Zn	18.6071	18.4023	0.2048	0.626
Pb	19.2801	18.8969	0.3832	0.209
Cd	17.1708	16.8421	0.3287	0.142
Cu	17.887	17.1227	0.7643	0.277
Hg	17.1738	17.1227	0.0155	0.535
Ni	18.4188	18.3856	0.0332	0.094

Llogaritjet i kryhem vetëm për kompleksin e mërkurit, masa e së cilit është sëbashku me DDTC, merret si $Hg(DDTC)_2$ nga matjet eksperimentale rezultoi =0.0155gr ose 15.5 mg M_{DDTC}=579.08mg/mol, ku sasia e mërkurit e pranishme në kompleksin $Hg(DDTC)_2$ është =200 mg. Kryejmë veprimet për gjetjen e përqëndrimit të elementit të mërkurit sipas rregullës së mëposhtme :

579.08mg $Hg(DDTC)_2 \rightarrow$200mg Hg

15.5mg $Hg(DDTC)_2 \rightarrow X$

Ku :

C_{Hg}= 15.5x200 =5.35mg/L

579.08x100

Kjo është sasia e mërkurit që ndodhet në një balonë me volum =100ml. Më pas në balonë shtuam diklormetan deri në shenjë, mbyllëm balonin me tapë tefloni, siguruam që tapat e balonit të jenë mirë të mbylluara sepse diklormetani avullon shumë shpejt. Në këtë mënyrë kemi përgatitur standartin e mërkurit, të njëjtat llogaritje që kemi kryer për kompleksin e mërkurit i kemi zhvilluar për të gjitha komplekset e metaleve të tjerë. Kompleksi mërkurik është një kompleks, i cili absorbon në tre gjatësi vale të ndryshme të paraqitura më poshtë:

χ_1=268.33nm
χ_2=300.356nm
χ_3=452.67nm

Për kompleksin e mërkurit janë kryer disa injektime në përqëndrime të ndryshme të tij për të parë riprodhueshmërinë e metodës. Standarti i kompleksit mërkurik si fillim ka patur një përqëndrim të = 5.37ppm. Si provë e bardhë është përdorur diklor metani dhe rezultoi me një përqëndrim të = 0.00 dhe me një sipërfaqe piku të= 0.00.

Në kromatogramën e mëposhtme paraqitet prova e bardhë.

Fig 1 Kromatograma e provës së bardhë



2.2. Studimi i eluentit

Nga standarti i kompleksit mërkurik të përgatitur më lartë morëm një sasi prej 50 µl me anë të një shiringe dhe e injekjtuam në aparaturë. Si fillim përdorëm si eluent përzjerjen ujë+metanol por nga format e piqeve të përftuara pamë se kjo përzierje jepte rezolucion mjaft të keq në ndarjen e piqeve kjo është paraqitur dhe në kromatogramën e mëposhtme

Ky lloj eluenti nuk mund të përdorej për optimizimin e metodës sepse rezultoi në :

- Rezolucion shumë të ulët në daljen e piqeve, piqet mbivendoseshin me njëri-tjetrin;
- t_R më të madhe, kemi formë mjaft të gjerë të piqeve;
- K <e vogël (tregon shkallën e forcave ndërmolekulare midis analitit dhe fazës stacionare);
- α shumë e vogël (shpreh polaritetin e fazës stacionare), jep një ndarje mjaft të ulët të analitëve;

Më pas ndryshuam llojin e eluentit dhe përdorëm përzierjen (ujë+metanol+acid acetik) (C_M=1mol/ml), nga kjo përzierje u përftuan piqe

me formë më të rregullt dhe me rezolucion më të lartë, kjo tregohet në kromatogramën e mëposhtme: duke ndryshuar polaritetin e eluentit ndryshon dhe:

- Polariteti i fazës stacionare, pra ne kemi një fazë stacionare më polare pra kemi një konstante α më të madhe, një ndarje më të mirë të analitëve;
- K.> më e madhe pra kemi një dalje më të shpejtë të analitëve;
- R> rezolucion mjaftë të lartë, përftojmë piqe të diferencuara;
- t_R më të vogël, formë të piqeve më pak të gjerë;

Fig 2 Kromatograma kur kemi përdorur si eluent përzierjen ujë +metanol



Fig 3 Kromatograma kur kemi përdorur si eluent përzierjen ujë+metanol+acid acetik



2.3. Studimi i interferencave të kompleksëve të metaleve të tjerë ndaj kompleksit mërkurik $Hg(DDTC)_2$

Për komplekset e marra në studim janë kryer matjet dhe janë paraqitur në tabelën e mëposhtme gjatësitë e valëve të absorbimit përkatëse. Më pas janë kryer injektimet në aparaturë dhe janë përftuar kromatogramat e paraqitura më poshtë. Secili kompleks metalik është paraqitur më poshtë vetëm në një gjatësi vale pasi vetëm në një gjatësi vale jep piqe me formë të rregullt dhe me rezolucion shumë të lartë.

Tab 1.3 Paraqitja e gjatësive të valëve të secilit metal

Emri i metalit	Gjatësitë e absorbimit (nm)
Pb(DDTC)2	χ_1=261.92
Cu(DDTC)2	χ_1=280.43 χ_2=449.82
Zn(DDTC)2	χ_1=308.9
Ni(DDTC)2	χ_1=254.09 χ_2=318.9 χ_3=376.5 χ_4=396.44 χ_5=427.05

Janë kryer dhe përzierje midis dy metaleve me njëri-tjetrin për të parë se në cilën prej gjatësive të valëve përftohen piqe me formë më të rregullt dhe me rezolucion më të lartë, pra për të përftuar një metodë sa më të optimizuar. Nga të dhënat e marra nga kromatograma pamë se :

- Secili kompleks metalik absorbon vetëm në një gjatësi vale;
- Jepte piqe me formë të rregullt dhe rezolucioni ishte mjaft i lartë vetëm në një gjatësi vale;
- Secili kompleks metalik jepte pikun e vet të pambivendosshëm me pikun e $Hg(DDTC)_2$;
- Nuk shfaqeshin interferenca apo mbivendosje piqesh midis kompleksëve metalik me njëri-tjetrin;

Fig: 4 Kromatograma që paraqet përzierjen e dy metaleve (Fe+Cu)



2.4. Aparatura dhe analiza me metodën e HPLC. Kromatografia e lëngjeve në presion të lartë është metoda kromatografike e përdorur në studimin tonë. Lehtësia në përdorim dhe mundësitë e shumta që paraqet kjo teknikë ka gjetur përdorime të shumta në identifikimin dhe izolimin e komponimeve organike. Kjo teknikë është një sistem i mbyllur i automatizuar dhe që lejon ndarjen dhe izolimin e komplekseve metalike organike. Si fillim kemi përdorur si solvent përzierjen metanol+ujë / në raporte (50:50) shpejtësia me të cilën lëviz lëngu nëpër pompa është 1ml/min. Pasi pamë që përzjerja ujë+metanol nga format e piqeve të përftuara jepte rezolucion mjaft të keq në ndarjen e piqeve, ndryshuam llojin e eluentit dhe përdorëm përzierjen (ujë+metanol+acid acetik) (C_M=1mol/ml), nga kjo përzierje u përftuan piqe me formë më të rregullt dhe me rezolucion më të lartë dhe duke krahasuar kromatogramat e të dy eluentëve ne vendosën për të përdorur gjatë të gjithë analizës sonë përzierjen (ujë+metanol+acid acetik). Pjesët më të rëndësishme në aparaturën e HPLC janë: **Pompat** të cilat shtyjnë me presion të caktuar një ose disa tretës. Sistemi i përdorur për analizën e këtij studimi është një sistem kuaternar me 4 pompa (A, B, C dhe D), presioni i përdorur në këto pompa është 600 bar. Një sasi prej 50µl të këtyre standarteve të secilit kompleks metalik të: Zn, Pb, Cd, Hg, Cu dhe Ni, u injektuan në aparaturën HPLC e tipit të:"Algilent Technologies, 1200 Infinity Series". Analiti i injektuar shtyhet nga eluati në drejtim të **kollonës**. Kolona e përdorur në studimin tonë është kolonë Zorbaks C8 me dimensione (16 cm x 4 mm), me dedektor DAD me diodë, ku ka të instaluar një llampë UV deuteriumi dhe temperatura brenda tij është mbajtur konstante me 30°C, e përshtatshme për analizën e komplekseve metalike dhe veçanërisht e standartit të mërkurit. Shpejtësia e lëvizjes në kollonë është relativisht e ulët. Shpejtësia me të cilën lëviz lëngu nëpër pompa është 1ml/min.

Rezultatet dhe diskutimi

Për të llogaritur riprodhueshmërinë për kompleksin e mërkurit kemi marrë gjatësinë e valës χ=268.4nm dhe χ=280.4nm për të parë se cilat nga të dhënat që ne kemi marrë për studim janë të përpikëta. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur 6 vlera të përafërta të sipërfaqeve të piqeve në varësi të përqëndrimit të $Hg(DDTC)_2$ në dy gjatësitë e valëve përkatëse.

Tabela 1.4 Paraqitja e përqëndrimit të mërkurit në varësi të sipërfaqes së pikut

Përqëndrimi i Hg(ppm)	Sipërfaqja e pikut (mAu*s) χ_1=268.4nm	Sipërfaqja e pikut (mAu*s) χ_2 =280.4nm
0.0	0.0	0.00
0.002685	8.53658	8.792
0.005370	8.55343	8.3663
0.008055	9.03879	8.0591
0.010745	9.07629	8.5635
0.0134525	9.18379	9.335

Nga tabela e mësipërme përpunuam të dhënat në descriptive statistics dhe morëm këto përfundime:

Tabela 1.5 *Përpunimi i të dhënave me descriptives statistics*

Column1		*Column2*	
Mean	8.877776	Mean	8.62318
Standard Error	0.137948	Standard Error	0.214817
Median	9.03879	Median	8.5635

Standard Deviation	0.308461	Standard Deviation	0.480344
Sample Variance	0.095148	Sample Variance	0.230731
Kurtosis	-3.08268	Kurtosis	0.526876
Skewness	-0.47115	Skewness	0.634739
Range	0.64721	Range	1.2759
Minimum	8.53658	Minimum	8.0591
Maximum	9.18379	Maximum	9.335
Sum	44.38888	Sum	43.1159
Count	5	Count	5
Confidence Level(95.0%)	0.383005	Confidence Level(95.0%)	0.596426

Komenti

Duke krahasuar medianën me mesataren, vlerat e skweness dhe kurtosis si dhe devijimin standart dhe intervalin e shpërndarjes së vlerave me anë të metodës së descriptives statistics arritëm në përfundim që:

$Hg(DDTC)_2$ jep një shpërndarje më të përpiktë të vlerave në kolonën e parë, pra në χ=268.4nm ky kompleks absorbon më mirë dhe jep piqe me formë më të mirë dhe me rezolucion më të lartë në ndarjen e tyre.

Tabela 1.6 Përpunimi i të dhënave me testin Anova

Anova: Single Factor				
SUMMARY				
Groups	*Count*	*Sum*	*Average*	*Variance*
Column 1	5	44.38888	8.877776	0.095148
Column 2	5	43.1159	8.62318	0.230731
ANOVA				

Source of Variation	*SS*	*df*	*MS*	*F*	*P-value*	*F crit*
Between Groups	0.162048	1	0.162048	0.994527	0.347843	5.317655
Within Groups	1.303516	8	0.16294			
Total	1.465564	9				

Komenti
Testi F studion variancën me anë të metodës Anova për këtë nga të dhënat e mësipërme ne krahasojmë vlerën e F_{exp} me F_{crit} nëse $F_{eksp} < F_{crit}$ dhe P>0.05, rezultati ynë pranohet ose të dhënat tona nuk ndryshojnë nga njëra-tjetra.

Nga të dhënat shikojmë se :
F_{eksp}=0.99
F_{crit}=5.31, pra $F_{eksp} < F_{crit}$ të dhënat tona nuk ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra, ne nuk kemi ndryshime sinjifikative dhe rezultati ynë pranohet.

Tabela 1.7 Përpunimi i të dhënave me testin F

F-Test Two-Sample for Variances		
	Variable 1	*Variable 2*
Mean	8.877776	8.62318
Variance	0.095148	0.230731
Observations	5	5
Df	4	4
F	0.412378	
P(F<=f) one-tail	0.205966	
F Critical one-tail	0.156538	

Komenti
Nga të dhënat e marra dhe nga testi F ne shikojme se të dhënat tona nuk kanë ndryshime sinjifikative. Të dhënat midis grupeve nuk ndryshojnë shumë me njëra-tjetrën, por të dhënat e marra në rastin kur χ=268.4nm japin përpikmëri më të mirë dhe për pasojë sjellin një rezolucion dhe ndarje më të mirë të piqeve.

Studimi me metodën e lakores së kalibrimit
Një tjetër analizë që kemi marrë në shqyrtim është studimi i standartit të mërkurit n tre gjatësi vale të

ndryshme dhe në tre përqëndrime të ndryshme me anë të metodës me lakore kalirimi. Për të ndërtuar një lakore kalibrimi marrim 3-5 përqëndrime të ndryshme të kompleksit mërkurik duke nisur nga niveli më i ulët i kapur për sipërfaqe të pikut. Të dhënat i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1.8 Paraqitja e përqëndrimit nga sipërfaqja e pikut

Përqëndrimi	Sipërfaqja e pikut χ_1=268.4nm	Sipërfaqja e pikut χ_2=280.4nm	Sipërfaqja e pikut χ_3=300.4nm
0.00	0.00	0.00	0.00
0.002685	29.3	12.8	20.6
0.00537	38.9	25.9	43.8
0.008055	59.2	58.6	62.5
0.01074	77.5	76.3	88.6
0.013425	91.8	94.5	96.7

Fig 5 Lakorja e kalibrimit në χ=268.4nm.

Komenti

Në këtë rast kemi paraqitur vetëm një lakore kalibrimi të marr nga të dhënat vetëm në një gjatësi të vetme të valës χ=268.4nm.

Ne dimë se ekuacioni i një lakoreje kalibrimi jepet si më poshtë:

Y=a+bx

Shikojmë vlerat e a dhe b

a=4.8857 dhe b=6639, a<<< b në këtë rast nuk kemi prani të interferencave por vlera e a-së ka rezultuar mjaft e madhe gjë që tregon se:

R^2=0.9863, në të vërtetë vlera e R^2=0.9999, por krahasuar me vlerën e R që na del nga lakorja mund të mendojmë për interferencat qe janë të pranishme sepse:

- Mund të vijnë nga zhurmat e aparatit;

- Gabime në përgatitjen e standartit;
- Peshimi i masës së kompleksit të metalit;
- Kohëzgjatje në momentin e injektimit në aparaturë.

Nga lakorja e mësipërme llogaritim:
Limitin e diktimit dhe të përcaktimit për metodën e përdorur. Përcaktimi i kufirit të detektimit dhe të kuantifikimit (LD dhe LP) është bërë sipas kritereve të IUPAC-ut. LOD=k ×sd / m Ku k, është faktor numerik për përcaktim të nivelit të besueshmërisë (k=3 është përdorur për të siguruar 90% nivel i besueshmërisë), sd është devijimi standard i sinjalit dhe m është pjertësia e marrë nga tre përqëndrimet më të vogla të tretësirës standarde. Ndërsa Limiti i kuantifikimit (LP) është llogaritur me anë të të njëjtit ekuacion por dallimi është vetëm në faktorin k (këtu k=10).
LD=3 x sd/m 3*0.0012/

Fig 6 Lakorja e kalibrimit në tre gjatësi vale të ndryshme



Në lakoren e mësipërme kemi paraqitur 3 lakore kalibrimi ku janë marrë sipërfaqet e piqeve në tre gjatësi vale të ndryshme dhe në varësi të përqëndrimit është ndërtuar lakorja e mësipërme, ku nga ekuacioni i lakoreve ne shohim se:
Nga vlerat e r-së në të treja rastet kemi praninë e interferencave ato janë të pranishme por ndjeshmëria e analizës është e mirë, interferencat e pranishme mendohen të kenë ardhur gjatë :

- Përgatitjes së standartit dhe zhurmave të aparatit.

Konkluzione

Komplekset metlike të metaleve të: Zn, Pb, Cd, Hg, Cu dhe Ni, të kompleksuara me agjentin kelatues të dietil ditiokarbamati (DDTC), sëbashku me tretësirën standarte të $Hg(DDTC)_2$ janë studiuar me metodën kromatografike të lëngët me presion të lartë (HPLC). Metoda e ekstraktimit me tretës organik, e përdorur për përqëndrimin e metaleve të rënda në mostrat mjedisore, është një mtodë e shpejtë me një faktor të lartë dhe rendiment të lartë të kompleksimit të metaleve të rënda. Zgjedhja e eluatit përzierja (ujë + metanol+ acid acetik), jep një rezolucion mjaft të lartë në ndarjen e piqeve. Ky lloj eluati jep një rezolucion shumë të lartë dhe midis 2 kompleksëve metalike (Fe+Cu) të ndryshme duke shmangur interferencat dhe mbivendosjen e piqeve. Nga përpunimi statistikor me testin Anova dhe Descriptives Statistics u vu re që kompleksi mërkurik $Hg(DDTC)_2$ në χ=268.4 nm jep përpikmëri më të mirë dhe sjell një rezolucion shumë të mirë në ndarjen e piqeve. Sipas përpunimit të të dhënave me metodën me lakore kalibrimi u arrit në përfundim se kompleksi mërkurik $Hg(DDTC)_2$ në χ=300.4nm arrinte ndjeshmërinë më të lartë të analizës.

Literatura

Doktoratura Sonila Kane, kimi, Fakulteti i Shkenncave të Natyrës, departamenti i kimisë.
Engel, G.T. Mercury Enciklopedia of Chemical Technology.Vol. 13 (John Wilay & Son) New-York 1967
Goldwater, L.J. *Sc.America*. 224. 1971

Jonasson, I. U.S Geological Survey 1970

Minerals Yearbook, USA 1999

Anderson, A. Mercury in the soil *Grunforbattring* 95 English 1967

Camarata, V.A. Mercury in minerals *Yearbooks* USA 1989

Hanson ,A. Man-made sources of mercury. Mercury in Man`s Environ. *Proc. Roy Con.Sympo.* 1972

Keckes, S. Methinen, J.K. Conference on marine pollution Rome 1970
Smart, N.A. *Residue Rev* 1975
Tylor, G. Critical concentracion of heavy metals *Envir. Prot. Agenency* *Report 4078 1992*
Lofroth, G. Duffy, M.E.. *Environment* 11 1969
Libri :"Njohuritë bazë në kemometri", Pranvera Lazo
Libri:"Metodat kromatografike dhe elektroforetike", Elda Marku
Doktoratura Lirim Bekteshi, Fakulteti i Shkenncave të Natyrës, departamenti i kimisë.

Analizat fiziko-kimike të qumështit dhe nënprodukteve të tij

Magdalini Iliadhi[1]
Arta Lugaj[2]
[1]Departamenti i Biologjisë , Fakulteti Shkencave Teknike , Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali".
[2]Departamenti i Bilogjisë , Fakulteti i Shekncave të Natyrës , Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Tema e këtij studimi shkencor i referohet qumështit dhe nënprodukteve të tij. Janë trajtuar në mënyrë të veçantë vetitë fizike, kimike dhe biologjike. Qumështi është një nga pasuritë ushqimore i cili ka rëndësi të madhe përsa i përket vlerave të tij ushqyese. Përbërja e tij varet jo vetëm nga mënyra e jetesës së kafshëve, mjedisi që i rrethon por edhe përpunimi termik dhe mekanik i tij luan rol në ruajtjen e vlerave të tij ushqyese. Metodologjia e këtij studimi u bazua në analiza fiziko kimike për të konstatuar nëse parametrat e përbërjes së tyre janë brenda standarteve të lejuara. Të gjitha analizat janë përpunuar në mënyrë analitike me anë të grafikëve. Duke krahasuar qumështin e deles me atë të lopës edhe dhisë u konstatua sasi më e lartë yndyre , vlera aciditeti më të larta dhe sasi më të vogla të lëndës së thatë pa yndyrë. Mund të themi të njëjtën gjë edhe për nënproduktet e qumështit të deles , ku në vecanti djathi përvec yndyrës shfaqte përqindje të larta të kripësisë. Nga përpunimi i të rezultateve të nxjerra nga kjo punë laboratorike u konstatua se lloji i kafshës , mënyra si ato ushqehen por edhe faktorët e jashtëm mjedisor kanë një ndikim të madh në përbërjen dhe cilësinë e produktit. Në të gjithë produktet e analizuar kishte një shmagie të konsiderueshme nga standarti shtetëror I prodhimit dhe përpunimit të këtyre produkteve me vlera të larta ushqyese.

The topic of this scientific study refers to milk and its sub- products . The physical , chemical and some of the biological properties are treated in this study. Milk is one of the food resources ëhich has a great importance because of his nutritional values . Its composition depends not only on the lifestyle of the animals, the environment that surrounds them but also depends from thermal and chemical processes.

The methodology of this study was based on physico-chemical analyzes to ascertain whether their composition parameters are within the permitted standards. All analyzes ëere analyzed analytically by graphs. Comparing sheep's milk with cow's and goat's milk, the sheep's milk has higher fat , higher acidity values and smaller amounts of fat-free dry matter. The same can be said for sheep sub-products, ëhere in particular cheese in addition to fat showed hight percentage of saltiness. The results obtained from this laboratory work it was concluded that the type of animal, the way they are fed but also the external environmental factors have a great influence on the composition and quality of the product. In all the analyzed products there was a significant deviation from the state standard of production and processing of these products with high nutritional values.

Hyrje

Qumështi konsiderohet si një pasuri ushqimore,për arsye të përmbajtjes që ka si në vitamina ashtu edhe në minerale. Si i tillë ka gjithmonë një burim kryesor ushqimor për popullatën. Kafshët prodhuese të qumështit si lopët, delet, dhitë dhe kuajt prodhojnë peshën e tyre trupore në proteina disa herë gjatë jetës. Qumështi që ato prodhojnë ruhet nëpërmjet fermentimit laktik. Komponentët e qumështit të papërpunuar janë varësisht të ndryshme nga lloji i gjitarit kështu qumështi ndryshon edhe në përbërje por në të gjitha rastet përmban sasi të konsiderueshme të yndyrës së ngopur, proteinave, kalciumi dhe vitaminës C.

Pjesët përbërëse kryesore të qumështit janë: uji, proteinat, yndyrnat, laktoza (sheqeri i qumështit), lëndët minerale, vitaminat, lëndët ngjyruese, gazet, enzimat dhe mikroorganizmat

(*Preka 2019).* Vetitë fizike dhe kimike të qumështit luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e tij.

Disa nga vetitë fizike të tij që merren në konsideratë gjatë përpunimit jane : dendësia, veshtullia, temperature e ngrirjes dhe valimit, tensioni sipërfaqësor, trysnia osmotike etj. Densiteti i qumështit, është tregues shumë i rëndësishëm i cilësisë së tij, pasi vlera e tij lidhet drejpërdrejt me lëndët e thata në qumësht. Densiteti mund të shprehet edhe si gravitet specifik, një tregues kyi cili rrjedh nga raporti ndërmjet densitetit të qumështit dhe densitetit të ujit tëmatur në të njëjtën temperaturë (*Preka 2019").*

Përsa i përket vetive kimike të qumështit aciditeti i qumështit, është vetia kryesore kimike e tij. Kontrolli i lëndëve të para, fillon me matjen e aciditetit. Proteinat e qumështit ndodhen në sasira të vogla në qumësht. Ato kanë një rëndësi të madhe në vlerat ushqyese dhe në procesin teknologjik. Proteinat ndahen në dy grupe kryesore: proteinat e patretshme (kazeina, enzimat, proteinat e cipës mbështjellëse të yndyrës). Është grupi mbizotrues i proteinave në qumësht ku përfshin rreth 78 deri 85% mesatarja është 81% *(Meraku 2019).* Yndyrnat e qumështit përbëhen kryesisht nga trigliceridet (98-99%) dhe pastaj prej substancash të tjera (fosfolipide 0,2%-1%, sterina 0,2%-0,4%). Një nga karbohidratet në sasi të konsiderueshme te qumështi është laktozi(*Frashëri, Bimbashi 1973).* Qumështi përmban dhe sasi të vogla të sheqernave si: galaktozë dhe glukozë.

Qumështi përmban rreth 1% substanca minerale, si kripëra të acideve organike dhe inorganike. Mikroorganizmat në qumësht janë të ndryshëm. Në krahasim me produktet e tjera qumështi është një burim shumë I pasur kalciumi *(Frashëri,Bimbashi 1973).* Mikroorganizmat pranishme në qumësht mund të klasifikohen në dy grupe kryesore: patogjene dhe organizmat përgjegjëse të prishjes, edhe pse disa mund të luajnë një rol të dyfishtë (p.sh. Bacillus cereus). Organizmat patogjene përbëjnë një kërcënim për publikun shëndetësor. Bakteret shumëzohen gjatë prodhimit dhe mbajtjes së qumështit, në varësi të kohës dhe kushtet e magazinimit. Ndryshimet që ndodhin në vetitë fiziko-kimike të qumështit janë rezultat i aktiviteteve të qelizave mikrobike individuale gjatë periudhës së rritjes dhe riprodhimit ose e substancave të prodhuara gjatë aktivitetit të tillë *(Ballata).*

Përbërja kimike e qumështi ndryshon brenda kufijve shumë të gjerë nën ndikimin e një numri të konsiderueshëm faktorësh. Përvec qumështit I cili luan një rol thelbësor në mënyrën e ushqyerjes dhe jetesën tonë, produkte me vlera të mëdha ushqyese janë edhe nënproduktet e tij ku do të përmëndim disa prej tyre si : gjiza, qumështi I thartuar,kosi, kefiri,gjalpi,djathi.

Të gjitha këto nënprodukte të qumështit formohen nga llojet e ndryshme të qumështit si dhe teknologjia e ndryshme e produkteve të bulmetit. Një nga aktivitetet më të mëdha të industrisë ushqimore në ditët e sotme është djathi. Sot njihen mbi 1.400 lloje të ndryshëm të djathrave; ata përgatiten në varësi të tipit të qumështit, llojit të mikroorganizmave të përdorur dhe nën një kontroll shumë të saktë të fermentimit. Detajet e prodhimit të djathrave janë tepër të komplikuara dhe përfshijnë lloje të ndryshme të baktereve, në disa raste kërpudha filamentoze, qumështrave, shtresave të zgjedhura dhe teknikave mjaft të ndryshme të prodhimit. Kulturat bakteriale që përdoren më shumë janë ato të përziera me dy apo më shume lloje, këto prodhojnë jo vetëm acid laktik por edhe substanca tjera që i japin djathit shijen dhe aromën e mirë dhe karakteristike sipas llojit janë këto bakterie që me zbërthimin që bëjnë formohet dioksidi i karbonit që ka rëndësi për krijimin e vrimave kararkteristike në djath *(Zymberaj 2014).*

Llojet e djathrave që prodhohen sot në botë janë disa qindra, por po të merren për bazë parimet themelore të teknologjisë së tyre dhe cilësisë ato mund të përmblidhen në rreth 20 lloje. Mirëpo sot në praktikë djathrat klasifikohen në tre grupe kryesore dhe ato janë: djathrat të butë djathëra gjymë të forte , djathëra të fortë (*Idrizi 2019).*

Të gjithë djathrat prodhohen sipas një standarti dhe sipas paramentrave të duhur, sepse cdo tregues shqisor dhe fiziko – kimik i cili del jashtë standartit mund të sjelli dështim në strukturën e tij por edhe në cilësi.

2. Materiale dhe metoda

Kryerja e këtyre analizave përfshin eksperimente dhe metodika të ndryshme të analizave fiziko kimike të qumështit dhe disa prej nënprodukteve të tij. Këto produkte u nënshtroheshin disa analizave si: përcaktimi i dendësisë, yndyrës,lëndës së thatë,kripësisë,aciditetit dhe lagështirës.

2.1 Analiza fiziko kimike të qumështit

Analiza fiziko-kimike e qumështit përfshinte përcaktimin e dendësisë së tij, yndyrës, lëndës së

thatë dhe aciditetit. Një rëndësi të vecantë në kryerjen e këtyre analizave ka edhe marrja e mostrës deri në momentin e përcaktimit të gjithë treguesëvë të përmendur.Para marrjes së mostrës qumështi përzihet mirë me anën e trazuesit mesatarisht 10-15 herë. Mostra merret nga cdo shishe në mënyrë propocionale duke formuar mostrën mesatare..Për analizat e zakonshme merren mesatarisht 200-250 ml qumësht. Mostra e qumështit përpara se të analizohet ngrohet në 20-30^{0}C në banjo mari*(Standarte Shtetërore 1989).*

Në qoftë se shpërndarja e shtresës yndyrore bëhet me vështirësi, ngrohet qumështi ngadalë deri në 30-40^{0}C në banjo uji. Kur kjo yndyrë është shpërndarë njëtrajtësisht rregullohet temperatura 20^{0}C. Pastaj lihet në qetësi per 3-4 min.

Përcaktimi i dendësisë

Kjo metodë bazohet në përcaktimin e densitetit me laktodensimetër në 20^{0}C. Laktodensimetri është aerometër në të cilin lexohet direkt grada e qumështit. Laktodensimetri i pastër dhe i thatë zhytet në qumësht ngadalë deri në ndarjen 1.030 dhe lihet të notojë lirisht duke patur kujdes që mos të takojë muret e cilindrit. Temperatura dhe dendësia lexohet afërsisht një minutë mbasi laktodensimetri ka qëndruar në qetësi*(Standarte Shtetërore 1989).*

Përcaktimi i lëndës së thatë

Në një kapsulë më 20-30 gr rërë, të tharë dhe të peshuar paraprakisht, peshohen 2,55-3 g mostër me saktësi 0,001 g. Ngrohet në banjo avulli për 10-15 min në mënyrë të tillë që avujt e nxehtë të prekin sipërfaqen e kapsulës.Pastaj lihen në thermostat në 100^{0}C për 3 orë. Pasi hiqet nga termostati futet ne eksikator për tu ftohur dhe kur ka arritur temperaturën e dhomës peshohet, kapsula futet përsëri në thermostat për 30 minuta, ftohja dhe peshimi përsëriten deri në momentin sa diferenca nëpërmjet dy peshimeve të fundit të jëtë më e vogël se 1 mg. Lihet 30 minuta në eksikator dhe peshohen*(Standarte Shtetërore 1989).*

Përmbajtja e lëndëve të thata të përgjithshme (x) e shprehur në përqindje llogaritet:

$$X= P - P_1 / P - P_0 \times 100$$

P_o – masa e kapsulës me rërë në gram

P_1 –masa e kapsulës me rërë e me mbetjen e tharjes, në gram.

P - masa e kapsulës me rërë e me mostër para tharjes, në gram.

Përcaktimi i aciditetit

Metoda bazohet në asnjëanësimin e acideve të qumështit me trtësirë NaOH me normalitet të njohur në prani të fenolftaleinës si dëftues .

Në një enë konike 250-300 ml hidhen me pipetë 20 ml mostër , shtohen 30-40 ml ujë të distiluar si dhe 2 ml fenolftaleinë dhe titullohet me tretësirë 0.1 N NaOH deri në momentin kur qumështi merr ngjyrë rozë të lëhtë të qëndrueshme për 30 sekonda.Aciditeti I qumështit shprehet me gradë Tjorner, që I përgjigjet sasia e ml të tretësirës 0,1 N NaOH për asnjëanësimin e 100 ml mostër*(Standarte Shtetërore 1989).*

Llogaritet : $a_T = a \times 100 / P$

Aciditeti I qumështit I shprehur në % acid laktik llogaritet : X= a x 0,009 / P x 100

a- Sasia e ml të tretësirës 0,1 N të NaOH të harxhuar për titullimin e mostrës

P- sasia e mostrës që merret për analizë në gram

0.009 – sasia e gramëve të acidit laktik që I përgjigjen 1ml tretësirë 0.1 N NaOH.

Përcaktimi i yndyrës (Metoda Gerber)

Kjo metodë bazohet në përcaktimin e yndyrës së qumështit me matësin e yndyrës. Ndarja bëhet me anë të centrifugimit pas tretjes së proteinave me H_2SO_4.

Maten 100 ml H_2SO_4 dhe hidhen në matësin e yndyrës , hidhet qumështi.

Thithet qumështi me pipetë me kujdes deri lart mbi shenjë.Mbahet pipeta vertikalisht dhe mbështetet fundi në qafën e enës, që mban mostrën, pastaj lihet qumështi të rrjedhë nga pipeta deri sa maja e meniskut të qumështit të përputhet me shenjën. Hiqet nga ena e mostrës vendoset maja e saj poshtë qafës së butirometrit, I cili qëndron vertikalisht duke formuar me të nje këns 45^o, së fundi formohet një shtresë mbi sipërfaqen e acidit.Priten 3 sekonda mbas qëndrimit të tubit të pipetës vihet në kontakt pika e pipetës me fundin e qafës, pastaj tërhiqet pipeta me kujdes, që të mos njomet qafa e butirometrit.Në vazhdim butirometri përzihet dhe rrotullohet deri sa proteinat janë tretur

plotësisht, dmth të mos ketë copëza të bardha. Butirometri vendoset menjëherë në centrifugëme shpejtësi rrotullimi jo më të vogël se 1000 rrotullime për 5 minuta.

Heqim butirometrin nga centrifuga dhe e vendosim në banjo mari në 65^0C për 3-10 minuta. Niveli i ujit duhet të jetë mbi kulmi ne kolonës së yndyrës. Në kohën e leximit butirometri mbahet vertikalisht. Shënohet gjithmonë diferenca mes dy leximeve*(Standarte Shtetërore 1989).*

Përmbajtja e yndyrës të qumështit (x) e shprehur në gram për 10 ml llogaritet: X= B – A

A – vlera e lexuar në pjesën e poshtme të kolonës së yndyrës

B –vlera e lexuar në pjesën e sipërme të kolonës së yndyrës

Përmbajtja e yndyrës së qumështit (x) në gram për 100g llogaritet: X = B – A / d

d-dendësia e qumështit.

2.2 Analiza fiziko-kimike te djathit

Kryerja e analizave fiziko-kimike të djathit ndihmon në përcaktimin e cilësisë së tij, parametrat fiziko-kimik që do të studjohen në këtë rast dhe që vee vecojnë nga parametrat fiziko-kimik të qumështit janë: përcaktimi i lagështirës , yndyrës (metoda Van Gulik) dhe kripës së gjellës.

Për djathtërat e fortë dhe gjysmë të fortë. Mostra merret me anën e sondës e cila futet në formën e e djathit nga periferia deri në qendër. Masa e mostrës duhet të jetë rreth 400 g. Para analizimit të mostrës, djathit i hiqet shtresa e sipërme thërmohet mostra në aparat të përshtatshëm, rende ose thikë dhe perzihet shpejt. Në qoftë se mostra nuk mund të thërmohet përzihet shpejt dhe ngjeshet fort. Temperatura e përzierjes nuk duhet të kalojë 25^0C *(Standarte Shtetërore 1989).*

Përcaktimi i lagështitës

Metoda bazohet në tharjes e mostrës në temperaturë 130^0C deri në masë të paqëndrueshme.

Në pezafiltër me kapak, paraprakisht të tharë e të peshuar , peshohen 2-3g djath me saktësi 0,0002 g. Thahet pjesërisht në banjo uji me dhe pastaj vihen në thermostat në 130^0C.Thahet për 1 orë e 15 minuta me kapak të hequr plotësisht pastaj pezafiltri mbyllet mirë, hiqet nga termostati, ftohet dhe peshohet*(Standarte Shtetërore 1989).*

Përmbajtja e lagështirës në përqindje (W) llogaritet: W= P – P1 / P – P_0 x 100

P_1 - masa në gram e pezafiltrit me mbetjen pas tharjes

P_0 – masa në gram e pezafiltrit bosh

P – masa në gram e pezafiltrit me mostrën para tharjes .

Përcaktimi i yndyrës (Metoda Van Gulik)

Metoda bazohet në ndarjen e yndyrës me anë të centrifugës në yndyrmatës Van Gulik mbas tretjes së proteinave të djathit në mjedis acid sulfurik. Ndarja favorizohet nga shtimi i një sasie të vogël alkool amilik. Përmbajtja e yndyrës merret duke lexuar direkt shkallën e yndyrmatësit.

Peshohet me saktësi 3 g mostër djathi në pajisjen e peshimit të yndyrmatësit të cilës I është përshtatur një tapë. Hidhet acidi sulfurik derisa mbulohet pajisja e peshimit që përmban mostrën , nëpërmjet hapjes së ngushtë të butirometrit dhe mbyllet me tapë. Vendoset butirometri në banjo uji për 5 minuta. E largojme butirometrin nga banjo e ujit dhe përziejme për 10 sekonda. E vendosim përsëri. Këto veprime përsëriten deri në momentin kur proteinat janë tretur plotësisht. Hiqet butirometri nga banjo e ujit dhe përzihet me kujdes shtohet 1 ml alkool amilik nëpër hapjen e ngushtë dhe përzihet menjëherë. Shtohet acid sulfurik deri sa niveli të arrijë 35% të shkallës. Përziejmë butirometrin për 10 sekonda deri sa yndyra të jetë ngjitur në pjesën e shkallëzuar të butirometrit. Vendosim butirometrin në banjo uji për 5 minuta*(Standarte Shtetërore 1989).*

Hiqet butirometri nga banjo e ujit, centrifugohet për 10 minuta. E largojme nga centrifuga dhe e vendosim përsëri në banjo uji për 5 minuta ku niveli i ujit të mbulojë kolonën e yndyrës. Heqim butirometrin nga banjo e ujit dhe e lëmë të ftohet 5 minuta.

Përmbajtja e yndyrës (x) e shprehur në gram për 100 g djathe llogaritet : X = B – A

A-leximi i bërë në skajin e poshtëm të kolonës së yndyrës

B-leximi I bërë në skajin e sipërm

Përcaktimi i kripës së gjellës

Metoda bazohet në aftësinë e joneve të klorit që precipitojnë në mjedis asnjëanës.

Peshohen 2 gram djathe, vendosen në një balonë 100 ml me 40-50 ml ujë të distiluar. Filtrojmë në një filtër të thatë masën e krijuar. Merren 50 ml filtrate, asnjëanësohen me 0,1N NaOH dhe titullohen me $AgNO_3$ 0,1N në prani të kromatit të kaliumit si dëftues deri në ngjyrë të kuqërremtë të qëndrueshme*(Standarte Shtetërore 1989).*

Përmbajtja e NaCl në përqindje llogaritet : % NaCl = a x 0,005845 x 100 / P x 50 x 100

a-sasia e militrave të tretësirës $AgNO_3$ 0,1N të harxhuar gjatë titullimit

p-masa e produktit të marrë për analizë, në gram

2.3 Analiza fiziko-kimike (Gjalp,kos,gjizë)

Përcaktimi i parametrave të këtyre produkteve është i njejtë me përcaktimin e parametrave të qumështit edhe djathit, por materialet dhe teknikat e përdorura në kryerjen e nalizave të këtyre prdukteve është ajo që i dallon.

Mostra e gjalpit merret në sipërfaqe të ndryshme të masës, në sipërfaqe ashtu edhe nga pjesët e brendshme, në thellësi të ndryshme*(Standarte Shtetërore 1989).*

Percaktimi I lagështirës

Metoda bazohet në tharjen e mostrës së gjalpit në temperaturë 100^{o}Cderi në masë të pandryshuar.

Në kapsulë porcelani të tharë në 102^{o}Cdhe të peshuar paraprakisht, peshohen 6 gram mostër. Kapsula vendoset në termostat në temperaturë 102^{o}C dhe lihet për 2 orë. Hiqet nga termostati, futet në eksikator për tu ftohur dhe pasi ka arritur temperaturën e dhomës peshohet me saktësi. Përsëritet tharja, ftohja dhe peshimi derisa diferenca nëpërmjet dy peshimeve të fundit të mos jetë e madhe*(Standarte Shtetërore 1989).*

Përmbajtja e lagështirës llogaritet sipas fomulës : W= Po – P_1 / Po x 100

Përcaktimi i sasisë së yndyrës : X= P_1 – Po / p x 100

P1- masa e kristalizatorit me yndyrën në gram

Po – mostra para tharjes

P_1 - mostra pas tharjes

Përcaktimi i aciditetit

Në një enë qelqi konike 250-350 ml peshohen me saktësi 5 g gjalpë dhe vendosen në banjo uji deri sa të shkrijë plotësisht. Shtojmë nga 30 ml eter etilik dhe alkool etilik si dhe 1 mj fenolftaleinë. Titullojmë me tretësirë 0,1 N KOH deri në ngjyrë rozë të qëndrueshme*(Standarte Shtetërore 1989).*

Numri aciditetit llogaritet sipas formulës : N.A = a x N x 56,1 / P

a- sasia e KOH së shpenzuar për titullim

N- nomaliteti i KOH

P- sasia e mostës së analizuar

Përcaktimi i kripës së gjellës

Peshohen 10 mg mostër e cila hidhet në enë qelqi më pas shtojmë 100 mj ujë të valuar. Lihet të qëndrojë për 5-10 min duke e përzier herë pas here derisa të ftohet në 50-55^{o}C. Shtojmë 2 ml kromat kaliumi dhe titullohet me tretësirë nitrat argjendi 0,1 N deri në ngjyrë të kuqe*(Standarte Shtetërore 1989).*

Përqindja e NaCl = a x 0,00585 / P x 100

a- sasia e mililitrave të nitrat argjendit 0,1N

p- masa e mostës së analizuar

0,00585 – sasia e gramëve të NaCl

Përcaktimi i yndyrës

Metoda bazohet në ekstraktimin e yndyrës me eter etilik dhe eter petroli

Merret gjalpi i tharë nga përcaktimi i lagështirës, ekstraktohet yndyra me eter etilik dhe eter petroli me pikë valimi të vogël duke e mbledhur tretjen në nje kristalizator , paraprakisht , të tharë të peshuar . Tretësi avullohet dhe thahet ekstrakti deri në masë të njëjtë në 100-105^{o}C*(Standarte Shtetërore 1989).*

Po- masa e kristalizatorit bosh, në gram

P – masa e kristalizatorit me mostrën që është analizuar, në gram

3. Rezultate

U realizuan analizat e qumështit të lopës në periudha kohore të ndryshme : Mars, Prill, Maj.

Për secilin nënprodukt të qumështit u realizua një analizë fiziko kimike. Pas kryerjes së analizave laboratorike, rezultatet u vendosën në tabelat përkatëse për secilin produkt dhe u përpunuan analitikisht nëpërmjet grafikëve. Grafikët do të shërbejnë për të krahasuar produktet më njëri tjetrin dhe të kuptojmë sa është shmangia e tyre nga standartet e prodhimit të tyre.

Produktet e analizuara janë produkte të tregut por edhe produktet e freskëta të marra nga fermat.

3.1 Rezultatet e qumështit të lopës



Grafiku 1 : Është paraqitur sasia e lëndës së thatë të qumështit të lopës në të tre muajt : Mars, Prill, Maj 2019 . Vëmë re se në muajin Mars 2019 dhe në muajin Maj 2019 kemi nivele të larta të lëndës së thatë pa yndyrë. Në muajin Prill 2019 sasia e lëndës së thatë bie në nivele të ulëta në disa produkte por në 2 produktet e tjera ka shmangie të vogël nga muajt e mëparshëm.

Qumështi i lopës duhet të ketë sasinë e lëndës së thatë 8,5 %, sipas grafikut 2 produktet e mësipërme Marka A dhe Marka D shfaqin sasi më të larta të lëndës së thatë pa yndyrë. Nivelet e larta të lëndës së thatë lidhen drejtpërdrejt me sasinë e yndyrës, kur sasia e yndyrës është e ulët rriten nivelet e lëndës së thatë pa yndyrë.



Grafiku 2 : Sasia e yndyrës së 4 produkteve në periudhat e ndryshme kohore. Vëmë re një rritje të sasisë së yndyrës në muajin Prill 2019 dhe zvogëlim të saj në muajin Mars 2019. Sasia e yndyrës rritet me uljen e temperatura në mjedisin e jashtëm, rritja e sasisë së yndyrës do të sjellë zvogëlimin e sasisë së lëndës së thatë. Marka A shfaq nivele të larta të yndyrës dhe lëndës së thatë njëkohësisht.



Grafiku 3 : Është bërë paraqitje e (%) së aciditetit. Në tre produktet e para vëmë re se produktet kanë nivele të ulëta të aciditetit më përjashtim të qumështit të markës D i cili shfaq aciditet të lartë në tre periudhat kohore. Të 4 produktet e analizuar janë brenda parametrave të caktuar, aciditeti në qumështin e lopës gjatë kësaj periudhe duhet të jetë deri në 19%. Në aciditetin e qumështit ndikim të madh ka temperatura, mjedisi i jashtëm.

Përsa i përket densitetit gjatë 3 muajve të kryerjes së analizave në të katërt produktet densiteti i qumështit ishte brenda normave të lejuara, densiteti në qumështin e lopës varion nga 1,029-1,034. Nuk u vu re ndryshim në ngjyrën e tyre, erë dhe në shije. Nuk kishte prani të substancave të huaja në përbërjen e tyre.

3.2 Rezultatet e qumështit të deles



Grafiku 4 : Në qumështin e deles gjatë muajit Prill 2019 vëmë re sasi të madhe të lëndës së thatë në të 4 fermat, dhe reduktim të saj gjatë muajit Maj 2019 . Sasia e lëndës së thatë për qumështin e deles duhet të jetë jo më tepër se 8,5 %. Ferma 1 dhe 2 regjistrojnë nivele të larta të lëndës së thatë në të 2 muajt. Sasia e madhe e e lëndës së thatëështë në përpjestim të zhdrejtë me sasinë e yndyrës, që do të thotë se në fermën 1 dhe 2 nivelet e yndyrës do të jenë më të larta.



Grafiku 5 : Vëmë re së sasia e yndyrës gjatë muajit Prill 2019 në tre Ferma është në nivele të larta në ndryshim nga Ferma 1 e cila nuk shfaq ndryshim shumë të madh gjatë 2 periudhave kohore. Sasia e yndyrës për qumështin e deles duhet të 6%.Ferma 3 dhe 4 sasia e yndyrës kryesisht në muajin Prill 2019 është më e lartë se standarti i lejuar. Sasia e yndyrës lidhet ngushtë me mënyrën e ushqyerjes së kafshës, periudhën e laktacionit dhe llojin dhe rracën e kafshës.



Grafiku 6: Në grafikun 6 është bërë një paraqitje e shkallës së aciditetit të qumështit të deles në 4 ferma. Në muajin Prill 2019 regjistrohet sasie lartë e aciditetit kryesisht Ferma 3. Në muajin Maj 2019 ka një rënie të % së aciditetit niveli më i ulët i aciditetit i regjistruar në Fermën 3. Niveli i ulët i aciditetit lidhet me temperaturën, në vjeshtë kur temperaturat janë më të ulëta aciditeti është në vlera të vogla.

Për sa i përket dendësisë të 4 fermat në të 2 muajt shfaqën dendësi brenda standartit të shtetëror. Dendësia e qumështit tëë deles varion nga 1,035-1,039 . Në qumështin e deles nuk u vu re ndryshim i ngjyrës, ose shfaqje e erës së pakëndëshme, nuk kishte prani të substancave të huaja.

3.3 Rezultatet e qumështit të dhisë



Grafiku 7 : Grafiku 7, paraqitje e analizes së qumështit të dhisë në 2 ferma. Në të dy fermat sasia e lëndës së thatë dhe yndyrnave janë përafërsisht në vlera të njëjta, përjashtim ben shkalla e aciditetit e cila është më e lartë në Fermën 1. Të tre parametrat fiziko kimikë janë brenda standartit të lejuar.

Vlerat e përafërta të lëndës së thatë dhe yndyrës i dedikohen llojit të kafshës dhe rracës.

Nëse bëjmë një krahasim të tre llojeve të qumështit do të vëmë re ndryshime të mëdha në vetitë e tyre fiziko kimike. Qumështi i deles ka sasi më të madhe të lëndës së thatë e cila nuk duhet të jetë më pak se 11%, e njëjta gjë edhe me sasinë e yndyrës. Qumështi i deles ka sasinë më të madhe të yndyrës së qumështi i lopës dhe i dhisë, qumështi i deles duhet të këtë një % yndyre jo më pak se 6% dhe shkallë aciditeti jo më pak se 24%. Qumështi i lopës dhe i dhisë kanë vlera më të ulëta të yndyrës, lëndës së thatë dhe aciditetit, vlerat e tyre janë pothuaj identike. Në të tre llojet e qumështit nuk lejohen papastërti dhe substanca të huaja. Qumështi i lopës për konsum vlera e sasisë së yndyrës së tij nuk duhet të jetë më shumë së 3,5 %. Analizat e 4 produkteve që realizuam sasia e yndyrës së tyre ishte me e madhe së 3,5%.

3.4 Rezultatet e djathit të bardhë (lope)



Grafiku 8: Në grafikun 8 është bërë paraqitje e analizave fiziko kimike të djathit të lopës. Janë analizuar 4 produkte të ndryshme. Sasia me e lartë e lagështisë ndodhet në produktin e markës A, dhe vlera më e ulët në Markën B. Për sa I përket lëndës së thatë pa yndyrë produkti i markës C rezulton me (%) më të madhe të yndyrës së 3 produktet e tjera. Niveli I yndyrës më I lartë në produktin e markës D. Niveli i lartë i yndyrës në djathin e lopës ndikohet nga mënyra e ushqyerjes së kafshës. Produkti me nivelin më të ulët të kripësisë është Marka A. Të 4 produktet kanë shmangie të konsiderueshme të vlerave fiziko-kimike kryesisht në nivelin e kripësisë.Standarti I lejuar dhe (%) e kripës në djathin e lopës nuk duhet të jetë më tepër se 1-1,5% të gjithë peoduktet e mësipërme kanë % kripësie 2 herë më tepër se standarti.

3.5 Rezultatet e djathit të bardhë (dele)



Grafiku 9 : Janë paraqitur analizat fiziko-kimike të djathit të deles. Nivelet më të larta të lagështisë dhe kripësisë i përkasin produktit të markës A. Lënda e thatë është pothuaj e njëjtë në të gjithë produktet, vlerat e tyre ndryshojnë shumë pak nga njëra tjetra. Përcaktimi I sasisë së yndyrës është një nga hallkat e analizës fiziko kimike të djathit, vlera më e lartë u konstatua në produktin e markes A e cila kishte një shmangie tepër të madhe nga tre produktet e tjera.Sasia e lartë e yndyrës i dedikohet mënyrës së ushqyerjes dhe periudhës së laktacionit. Në të 4 produktet vlerat

e llogaritura nuk janë brenda parametrave të lejuara.

3.6 Rezultatet e djathit të dhisë



Grafiku 10 : Në të dy produktet u regjistruan vlera të përafërta të lagështisë , lëndës së thatë dhe kripësisë. Përjashtim bën sasia e yndyrës, (%) më e madhe në djathin e markës B. Sasia e lartë e yndyrës lidhet me mënyrën e ushqyerjes së kafshës dhe stilin e jetesës. Të dy produktet nuk kishin ndryshim të ngjyrës, erë të pakëndëshme dhe papastërti në përbërjen e tyre.

Duke krahasuar 3 llojet e djathit me njëri tjetrin dhe duke u bazuar në rezultatet e analizave fiziko kimike. Djathi i deles ka sasi më të madhe të yndyrës dhe kripësisë në përbërjën e tij. Lagështia dhe (%) e lëndës së thatë pa yndyrë është në vlera më të vogla. Djathi i dhisë dhe i lopës ka (%) më të lartë të lagështisë dhe lëndës së thatë, kripësia dhe yndyra në (%) më të vogla se djathi i deles.

3.7 Rezultatet e djathit kackavall (lope)



Grafiku 11 : Në grafikun 11 janë paraqitur rezultatet e analizave fiziko kimike të djathit kackavall të lopës.Në të katërt produktet % e lageshtisë, lëndës së thatë, yndyrës dhe kripësisë janë të përafërta më njëra tjetrën. Vlerat e tyre nuk janë kanë luhatje të madhe dhe nga standarti shtetëror.

3.8 Rezultatet gjiza me kripë



Grafiku 12 : Në grafikun 12 janë paraqitur analizat fiziko kimike të gjizes me kripë. Në të treja fermat produktet e tyre kanë (%) të lagështisë dhe yndyrës sipas standartit të lejuar. Vlerat e tyre midis tre fermave nuk kanë luhatje të mëdha nga njëra tjetra. Për sa i përket (%) së kripësisë duhet të jetë brenda kufijve 1-1,5%. Me përjashtim të fermës I e cila ka vlerë më të lartë se standarti i lejuar 3 fermat e tjera janë brenda parametrave. Sasia e lartë e kripësisë varet nga mënyra e ushqyerjes së kafshës, mënyra e ruajtjes së qumështit dhe realizimi i proceseve të prodhimit të gjizës sipas standarteve të caktuar. Një analizë fiziko kimike është dhe testi i amidonit. Në dy fermat e para prova e amidonit ka dalë pozitive, Ferma 3 dhe 4 prova e amidonit ishte negative.

3.9 Rezultate gjizë pa kripë



Grafiku 13 : Në Fermën 4 u regjistruan vlerat më të larta të lagështise dhe sasisë së yndyrës në krahasim me tre fermat e tjera. Karakteristikë e vecantë në këtë analizë ishte (%) e kripësisë e

cila duhet të dilte 0% për të gjitha fermat. Prova e amidonit rezultoi pozitive në fermën e parë dhe negative në 3 fermat e tjera.

Një nga veçoritë dalluese të gjizës me dhe pa kripëështë % e kripës në përbërjen e saj. Gjiza me kripë ka (%) më të lartë të kripës, dhe njëkohësisht % më të lartë të yndyrës. Në të dyja rastet sasia e lagështirës nuk ka diferenca të mëdha. Prova e amidonit është provë e cila realizohet për të vërtetuar nësë gjatë prodhimit të gjizës janë shtuar sasi të niseshtesë e cila ndihmon në vizkozitetin e produktit, është provëe cila realizohet në të dy rastet.Nuk ndikohet nga përbërja e qumështit ose llojin e ushqimit që kafsha ushqehet por është një fenomen që ndodh rëndom gjatë prodhimit të gjizës në fabrika ose ferma.

3.10 Rezultate të gjalpit



Grafiku 14 : Në të dy produktet nuk kemi ndryshime të mëdha në përbërjen e tyre. (%) e aciditetit që është një nga parametrat më delikatë për sa i përket gjalpit është brenda standarteve të lejuar në të dy produktet. Produkti i markës B është me sasi më të lartë yndyre, ndikon kryesisht përbërja kimike e qumështit, mënyra e ushqimit të kafshës, habitati ku jeton si dhe stili i jetesës.

Studimi i realizuar nga viti 2011 deri më 2014 nga *Dr.Ilirjana Zymberaj "Monitorimi i cilësisë dhe sigurisë të produkteve të bylmetit në tregun e Kosovës"* , do të na ndihmojë për të bërë një krahasim të rezultateve të djathit të bardhë gjatë këtyre viteve me rezultatet e vitit 2019. Në krahasimin e parametrave fiziko-kimikë do të përmendim (%) e lagështisë , në vitin 2012 dhe 2014 (%) e lagështisë ishte më e lartë se në vitin 2019 ku vlera e saj arrinte një mesatare prej 49%. Gjatë vitit 2019 (%) e yndyrës ishte tepër e lartë mesatarisht 49,8% . Këto sasi të larta të yndyrës i dedikohen llojit të kafshës , mënyrës së ushqyerjes dhe një rol të rëndësishëm luajnë kushtet atmosferike. Ulja e temperaturës do të rrisi nivelet e yndyrës në qumësht dhe rrjedhimisht rritjen e sasisë së yndyrës në djathin e bardhë. Këto sasi të larta të yndyrës kanë një shmangie relativisht të madhe nga kufijtë e lejuar , në ndryshim me vitet 2011-2014 ku (%) e yndyrës ishin më të vogla . Kripësia është një tjetër parametër fiziko-kimik i cili lidhet drejpërdrejt me mënyrën e kripjes dhe maturimit të djathit , në të dyja rastet nivelet e kripësisë ishin brenda kufijve mesatarisht 3-4%. Vlera e lëndës së thatë rezulton pak më e lartë gjatë vitit 2011 në krahasim me rezultatet e vitit 2019. (%) e larta të lëndës së thatë , shprehin njëkohësisht dhe (%) të vogla të yndyrës. Rezultatet e vitit 2019 kishin një shmagie nga standarti shtetëror , në ndryshim nga studimi i realizuar nga 2011 deri më 2014 ku të gjithë parametrat fiziko-kimikë ishin brenda kufijve të lejuar.

Në këtë studim u sigurua një larmi produktesh për tju nënshtruar analizave fiziko-kimike.Përvec produkteve të marra nga fermat , janë analizuar dhe produktet e tregut shqipëtar. Janë trajtuar në mënyrë të vecantë të gjithë parametrat fiziko-kimik për secilin product .Është analizuar secili parametër për të nxjerrë në pah edhe shkaktarët kryesorë të cilët ndikojnë në shmangien nga kufijtë e lejuar. Gjithashtu është bërë krahasim midis produkteve në ferma për të kuptuar më qartë ndryshimet që shfaq secili produkt në kushte të ndryshme ruajtje. I njëjti krahasim u realizuar edhe me produktet e tregut në Shqipëri , secili prej tyre u analizua në

mënyrë të vecantë.Analizimi I këtyre produkteve ishte I nevojshëm për të kuptuar se cili product I përmbahej standartit të përpunimit dhe ruajtjes së produkteve. Krahas studimit fiziko-kimik të qumështin dhe nënprodukteve të tij , një pikë tjetër e rëndësishme e cila nuk është trajtuar në këtë studim janë edhe analizat bio-kimike dhe mikrobiologjike. Në studimin bio-kimik të qumështit dhe nënprodukteve të tij do të mund të përcaktonim saktësisht llojet e yndyrnave, karbohidratet , enzimat , vitaminat që I përbëjnë

4. Konkluzione

Nga analizat fiziko-kimike të realizuara është vënë re se gjatë muajit Mars 2019 dhe Maj 2019 ka nje rritje te lëndës së thatë pa yndyrë dhe kjo vjen si shkak I ndryshimit të temperaturës dhe kushteve atmosferike. Ne muajin Prill 2019 ku është konstatuar ulje e temperaturave nivelet e yndyrës në qumësht dhe nenproduktet e tij kanë qenë më të larta se gjatë muajve të tjerë. Ky fenomen ndodh sepse ulja e temperaturave sjell rritjen e sasisë së yndyrës në qumësht dhe rrjedhimisht kjo rritje do të përkthehet në zvogëlimin e sasisë së lëndës së thatë.Ka të dhëna që vërtëtojnë se qumështi gjatë periudhës së dimrit përvec sasisë së lartë të yndyrës ka më tepër proteina dhe substanca minerale.U vu re se në disa produkte nivelet e aciditetit Ishin te larta kjo vjen si pasojë e faktorëve të jashtëm . Rritja e aciditetit në qumësht vjen si rezultat I zhvillimit të mikroorganizmave të qumështit që cojnë gradualisht në prishjen e cilësisë , si rezultat I fermentimit të laktozit . Fermentimi I laktozit sjell rritjen e aciditetit mbi normat e lejuara.Përpos faktorëve të jashtëm të cilët kanë një ndikim të madh në cilësinë ë qumështit dhe nënprodukteve të tij faktorë të tjerë luajnë një rol po aq të rëndësishëm në përbërjen e tij , do të përmendim : llojin e kafshës , rraca e kafshës , mosha ,periudha e laktacionitdhe ushqimi që merr kafsha ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në vetitë organoleptike të qumështit dhe nënprodukteve. Nga rezultatet e analizave u konstatua se qumështi I lopës ka sasi më të vogël të yndyrës dhe aciditetit se qumështi I deles , e njëjta gjë vjen edhe për nënproduktet e tyre . Djathi I deles në ndryshim nga ai I lopës dhe I dhisë përvec sasisë së lartë të yndyrës shfaq edhe nivele të larta të kripësisë e cila vjen edhe si rrjedhoje e përpunimit dhe teknikave prodhuese të tij. Djathi kackavall (%) e lartë e yndyrës dhe kripësisë I dedikohet stazhionimit të tij për një kohë të gjatë por edhe mikroorganizmave që veprojnë në procesin e tij të maturimit .Gjiza me kripë dhe gjiza pa kripë kishin nivele të larta të yndyrës edhe kripësisë, disa prej provave shfaqën edhe prani të amidonit. Prova e amidonit këto produkte . Gjithashtu do të realizohej një analizë më e hollësishme e të gjithë miko dhe makro elementët në përbërje të tij . Nga analiza mikrobiologjike , do të studionim në mënyrë më të detajuar të gjithë llojet e mikroorganizmave të qumështit dhe produkteve të bulmetit , duke dhënë një pasqyrë më të qartë se cili prej këtyre mikroorganizmave , është product I papastërtive nga faktorë të jashtëm dhe cili prej tyre luan rol të vecantë në proceset teknologjike të përpunimit të këtyre produkteve.
realiizohet për të vërtetuar praninë e tij , amidoni e ben produktin më viskoz edhe të qëndrueshëm por ul vlerat e tij ushqyese. Në produktin e gjalpit u konstatua (%) të larta yndyre dhe shkallë aciditeti gati e papërfillshme.

Në të gjithë produktet e analizuar kishte një shmagie të konsiderueshme nga standarti shtetëror I prodhimit dhe përpunimit të këtyre produkteve me vlera të larta ushqyese.

Referenca

1. Albano F.Cerutig "Chimica e tecnologica del latte e dei suoi derivati" , Milano 1966 .
2. Cistiakov "Mikrobiologjia (përkthim shqip) " , Tiranë 1967 .
3. Davis J.G " Adictionary of dairyng " , London 1955 .
4. De Rossi . G " Microbiologia agraria e tecnica " , Rome 1959 .
5. Farrall A.G " Engineering for dairy and food products " , NeW York 1963.
6. Foster E.M " Mikrobiologia molloko (përkthim rusisht) , Moskë 1961 .
7. P.Roks J "Mlekarenstiv vëllimi I dhe II " , Pragë 1964 .
8. Ray G. " Technologie laitiere " Paris 1951 .
9. Secchi H. " I nostril alimenti " Bologna 1967 .
10. M.Frashëri – H. Binbashi " Kimia dhe teknologjia e ushqimeve " , Tiranë 1973 .

11. Fakulteti I shkencave të natyrës , “Vlerësimi I cilësisë dhe përmbajtjes së metaleve në qumështin e freskët të lopës në rrethin e Shkodrës” , Julia Preka.

12. Universiteti I Mitrovicës , Fakulteti I teknologjisë ushqimore , “Hulumtimi I proteinave dhe yndyrës në kosin dhe ajkësn vendore” , Lemane Meraku .

13. Fakulteti shkencave te natyrës , "Vlerësimi i Parametrave të Cilësisë të Produkteve të Pasterizuar (Qumësht i Pasterizuar) Gjatë Periudhës së Ruajtjes" , Amilda Ballata.

14. Fakulteti shkencave te natyrës , “Monitorimi I cilësisë dhe sigurisë së produkteve të bylmetit në tregun e Kosovës” , Ilirjana Zymberaj.

15. “Vlerësimi I teknologjisë së prodhimit të djathit “HIRRË” , Petrit Idrizi.

16. “Manual praktik për prodhimin e djathërave” Jolanda Bracina,Roberto Rubino.

17. Standarde Shtetërore , Veëllimi 11 “Prodhime mishi ,qumështi dhe peshku” , Tiranë 1989.

Parimi i "Gjësë së gjykuar"

Taulant Banushi
Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier

Kuptimi i parimit të "Gjësë së gjykuar"

Kodi i Procedurës Civile nuk jep një përkufizim të "gjësë së gjykuar", ndërkohë që edhe doktrina juridike trajton përgjithësisht elementët dhe efektet e vendimit gjyqësor të formës së prerë, pa dhënë një përkufizim të këtij instituti të rëndësishëm të së drejtës proceduriale civile.

Në nenin 451/a, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet: *"Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*

Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe".

Ndërkohë, në nenin 451, të Kodit të Procedurës Civile janë listuar në mënyrë shteruese të gjitha rastet kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Sipas këtij neni, vendimi gjykatës merr formë të prerë në njërin nga këto raste: **a)** nuk mund të bëhet ankim kundër tij; **b)** nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; **c)** ankesa e paraqitur nuk është pranuar: **ç)** vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.

Do të konsiderohet si "gjë e gjykuar" një prezumim absolut i vërtetë, sipas të cilit, faktet e konstatuara dhe të drejtat e njohura nuk mund të kundërshtohen në të ardhmen, as përpara gjykatës që ka dhënë vendimin, as përpara ndonjë juridiksioni tjetër. Një çështje e gjykuar njëherë dhe e përfunduar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk mund të sillet rrishtazi në gjyq për një gjykim të dytë, përsa kohë vendimi i formës së prerë qëndron në fuqi dhe nuk është cënuar, si rezultat i ushtrimit nga ana e palëve ndërgjyqëse, të mjeteve të ankimit të parashikuara në ligjin procedurial civil. Në një rast të tillë do të jemi përpara institutit të "gjësë së gjykuar" dhe vendimi përfundimtar i gjykatës, duke marrë formë të prerë, i jep fund konfliktit të paraqitur, duke përcaktuar në mënyrë përfundimtare dhe të pandryshueshme raportet juridike midis palëve, në lidhje me të drejtën në konflikt. Ky është një parim i rëndësishëm juridik, i rregulluar njëkohësisht edhe me dispozita të veçanta ligjore.

Në të vërtetë, është e qartë arsyeja e ekzistencës së këtij parimi, i cili buron nga karakteri ekskluziv i vendimit gjyqësor. Nuk mund të mendohet stabiliteti i nevojshëm në marrëdhëniet shoqërore, ekonomike dhe juridike, pa ekzistencën e parimit të "gjësë së gjykuar". Në mungesë të një parimi të tillë, palët do të kishin të drejtë që një konflikt të zgjidhur njëherë me një vendim përfundimtar dhe të formës së prerë të gjykatës, t'a paraqisnin përsëri përpara gjykatës, çka do të sillte si pasojë të parë një ç'orientim total në marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike në përgjithësi, si edhe në raportet e caktuara juridike midis subjekteve të së drejtës në veçanti.

Po kështu, një mungesë e tillë do të sillte si pasojë rrezikun e përhershëm të daljes së vendimeve gjyqësore me disponime të ndryshme, për të njëjtin konflikt gjyqësor, çka do të krijonte vështirësi dhe pamundësi për ekzekutimin e tyre dhe që në fjalë të fundit, do të thoshte se një raport juridik i kontestuar midis palëve ndërgjyqëse, nuk do të merrte asnjëherë një zgjidhje përfundimtare.

Mbrojtja e të drejtave të njohura me ligj dhe sigurimi i ekzekutimit të plotë dhe të rregullt të detyrimeve, nuk mund të arrihen nëse nuk do të pranojmë se një çështje e zgjidhur një herë përfundimisht me vendim të gjykatës kompetente, është në përputhje me realitetin dhe pasqyron të vërtetën, sipas parimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në çështjen *Kehaya and others v. Bulgaria*, është shprehur se, "...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit, një vendim përfundimtar i formës së prerë, është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen

midis palëve me një vendim përfundimtar është një element themelor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, ajo duhet të vendoset një herë e përgjithmonë".

Veprimet dhe vlerësimi i gjykatës

Nga pikëpamja proceduriale, në rastin kur ngrihet pretendimi për "gjë të gjykuar", mbi prapësimin e palës së interesuar, gjykata duhet të verifikojë fillimisht nëse ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, pra nëse vendimi i dhënë mbi kërkesëpadinë e parë, ka marrë formë të prerë, sipas njërit prej rasteve të parashikuara në nenin 451, të Kodit të Procedurës Civile. Vetëm në rastin kur vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, ai mund të bëhet pengesë për gjykimin e një kërkesëpadie të re, me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor, si dhe me të njëjtat palë ndërgjyqëse.

Pas këtij momenti, vendimi gjykatës fiton autoritetin e "gjësë së gjykuar" dhe pasqyron të vërtetën në çështje, ndërkohë që parimisht nuk mund të preket më.

Në lidhje me formën e prerë të vendimit gjyqësor, është e rëndësishme të sqarojmë faktin se, për vetë gjykatën që e ka dhënë këtë vendim, ky i fundit, në kuptimin e ngushtë të fjalës, bëhet i formës së prerë, menjëherë pas dhënies së tij. Pasi ka zgjidhur çështjen përfundimisht, gjyqtari bëhet i huaj për të dhe nuk mund të bëjë asnjë ndryshim të mëvonshëm në vendim, përveç kur është rasti për të proceduar në rrugën e ndreqjes së gabimit, plotësimit të vendimit apo të sqarimit dhe interpretimit të tij.

Në nenin 312, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet: *"Pas shpalljes së vendimit gjykata nuk mund t'a anulojë ose t'a ndryshojë atë. Ajo, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra ne shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit.*

Gjykata, pasi thërret palët, në seancë, e shqyrton kërkesën sipas rregullave të këtij Kodi, jep vendim, i cili i bashkohet vendimit të ndrequr.

Kundër vendimit të dhënë për rastet e parashikuara në paragrafin e dytë të këtij neni, mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit".

Pra, sikurse shihet, këtu bëhet fjalë për gabime që nuk prekin vetë vendimin gjyqësor dhe që ndreqja e këtyre gabimeve nuk e ndryshon përmbajtjen e tij. Këto gabime duhet të jenë të karakterit material dhe nuk duhet të lidhen me mënyrën e disponimit të gjykatës për kërkimet e palëve.

Në nenin 313, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet: *"Secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, mund të kërkojë plotësimin e vendimit, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova.*

Gjykata e shqyrton kërkesën me të njëjtin trup gjykues, pasi thërret palët dhe jep vendim plotësues.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshme".

Edhe në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me ndryshim të vendimit përfundimtar nga gjykata që e ka dhënë, por me plotësimin e këtij vendimi, duke qënë se gjykata nuk i ka dhënë përgjigje të gjitha kërkimeve që kanë bërë palët. Plotësimi i vendimit është i lidhur ngushtë me parashikimin e bërë në nenin 6, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

Po kështu, sipas nenit 314, të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka të drejtë që të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ka dhënë, kur ky i fundit është i errët dhe e kërkojnë palët. Sqarimi apo interpretimi i vendimit nuk cenon në asnjë rast pjesën urdhëruese të tij.

Duhet theksuar se vendimi gjyqësor që ka marrë formë të prerë, megjithëse prezumon të vërtetën, ai reflekton një të vërtetë që i referohet një rasti konkret dhe prandaj ai vlen dhe ka fuqi detyruese vetëm përsa i përket palëve në çështje, trashëgimtarëve të tyre, si dhe personave që heqin të drejta nga palët. Për të gjithë të tjerët, të cilët nuk kanë palë në këtë proces, vendimi gjyqësor është detyrues derisa nuk preken të drejtat e tyre subjektive civile. Për pasojë, një vendim gjyqësor që prek të drejtat subjektive civile të një të treti, i cili nuk ka qënë pjesë e këtij procesi, nuk krijon për të detyrimin që t'i nënshtrohet disponimeve të këtij vendimi dhe nuk e privon atë nga e drejta për të ngritur një padi të veçantë.

Në një rast të tillë, nuk do të ndodheshim përpara "gjësë së gjykuar", sepse të paktën njëri nga elementët e "gjësë së gjykuar" do të ndryshonte, duke qënë se do të kishim të bënim me një ndërgjyqësi të ndryshme nga ajo e para.

Fuqinë e "gjësë së gjykuar" e ka edhe vendimi gjyqësor i formës së prerë, i cili ka zgjidhur me pajtim konfliktin mes palëve ndërgjyqëse. Kjo vjen si rrjedhojë e vetë natyrës juridike të pajtimit gjyqësor, i cili, sipas

rregullave proceduriale civile, përbën njërën nga format e zgjidhjes së konfliktit gjyqësor, të parashtruar nëpërmjet paraqitjes së kërkesëpadisë. Gjykata kontrollon marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e konfliktit dhe nëse kalon testin e ligjshmërisë së saj, kjo marrëveshje sanksionohet me vendimin përfundimtar.

Zgjidhja e mosmarrëveshjes me pajtim është parashikuar në nenin 158/ç, të Kodit të Procedures Civile. Nga përmbajtja e këtij neni rezulton se në çdo rast, gjykata duhet të bëjë përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Këto përpjekje bëhen gjatë veprimeve përgatitore, por edhe në fazat e tjera të gjykimit, palët mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për zgjidhjen e çështjes me pajtim, duke e shoqëruar kërkesën edhe me aktmarrëveshjen përkatëse. Në varësi të momentit procedurial kur arrihet pajtimi (në veprimet përgatitore apo në seancë gjyqësore), ky fakt pasqyrohet në një procesverbal të nënshkruar edhe nga palët ndëgjyqëse ose ne procesverbalin gjyqësor. Gjykata jep vendim për miratimin e marrëveshjes së pajtimit, pasi të ketë vlerësuar se ajo nuk vjen në kundërshtim me ligjin. Palët kanë të drejtë të paraqesin ankim ndaj këtij vendimi.

Vendimi që jep gjykata në këtë rast, është një vendim përfundimtar që zgjidh mosmarrëveshjen mes palëve ndërgjyqëse dhe pasi merr formë të prerë, ai bëhet titull ekzekutiv dhe rrjedhimisht i ekzekutueshëm.

Që të ngrihet pretendimi për "gjë të gjykuar", me anë prapësimi, është e nevojshme që të ekzistojë një vendim gjyqësor i formës së prerë, sepse përndryshe, nuk do të kemi "gjë të gjykuar", por dy kërkesëpadi me objekt, shkak ligjor dhe palë ndërgjyqëse të njëjta, duke u gjykuar njëkohësisht në të njëjtën gjykatë ose në gjykata të ndryshme. Në literaturën juridike, një situatë e tillë proceduriale quhet "litispendencë", ndërkohë që ka gjetur rregullim edhe në nenin 58, të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtij neni, në rastin kur në të njëjtën gjykatë ose në gjykata të ndryshme, shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak dhe të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë.

Litispendenca apo gjyqvarësia ka për qëllim të shmang zhvillimin e dy apo më shumë gjykimeve njëkohësisht dhe që lidhen me kërkesëpadi, të cilat janë të njëjta për nga objekti, shkaku ligjor dhe palët ndërgjyqëse, gjë e cila do të mbarte rrezikun e dhënies së vendimeve gjyqësore të ndryshme. Parashikimi i bërë në nenin 58, të Kodit të Procedurës Civile është në funksion dhe vjen në harmoni të plotë me parimin e "gjësë së gjykuar", si dhe me parashikimin e bërë në nenin 451/a, të po këtij Kodi, për efektet e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Një mosmarrëveshje mes subjeteve të drejtës duhet të shqyrtohet dhe të zgjidhet nga gjykata kompetente dhe nuk mund të bëhet objekt i disa konflikteve gjyqësore njëkohësisht, përpara të njëjtës gjykate apo në gjykata të ndryshme, edhe sikur këto të fundit të jenë kompetente.

Elementët identifikues të parimit të "Gjësë së gjykuar"

Për të qënë në situatën proceduriale të "gjësë së gjykuar" duhet të plotësohen njëkohësisht tre kushte dhe konkretisht: **a)** i njëjti objekt i padisë; **b)** i njëjti shkak ligjor; **c)** të njëjtat palë ndërgjyqëse.

I njëjti objekt i padisë, në funksion të "gjësë së gjykuar", do të jetë atëherë kur objekti i padisë së paraqitur është i njëjtë me objektin e një padie tjetër të mëparshme, e cila është gjykuar dhe është zgjidhur me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Objekti i padisë është pretendimi konkret i paditësit, një send, një veprim ose një e drejtë që paditësi pretendon se i është cenuar ose shkelur nga veprimet e të paditurit. Objekti i padisë është kërkimi i paditësit për vërtetimin gjyqësor të një të drejte, të një raporti juridik të kundërshtuar, vërtetim, nga i cili rrjedh detyrimi i palës tjetër që të njohë, të kryejë ose të mos kryejë një veprim të caktuar. Në fjalë të fundit, objekti është dobia që synon të arrijë paditësi me padinë e ngritur prej tij.

Në rastin kur i padituri prapëson për "gjë të gjykuar", përsa i përket objekti të padisë, gjykata duhet të verifikojë me kujdes cili është kërkimi konkret i padisë, pa iu referuar vetëm mënyrës së formulimit të tij, për shkak se mund të ndodhë që praktikisht të kemi të bëjmë me të njëjtin objekt të padisë, si edhe në padinë e gjykuar më parë, por të formuluar në mënyra të ndryshme. Mënyra e formulimit të objektit të padisë është elementi i parë që jep të dhëna apo tregon sinjalin se mund të jemi përpara një padie me obejkt të njëjtë, me një padi tjetër të gjykuar më parë. Megjithatë, paraqitja formale e objektit të padisë, nuk duhet të konsiderohet asnjëherë e mjaftueshme për të arritur në ketë konkluzion. Për indentifikimin e saktë të objektit të padisë, gjykata duhet të verifikojë kërkesëpadinë në të gjithë përmbajtjen e saj dhe të mos kufizohet vetëm në pjesën hyrëse të padisë, ku formulohet në mënyrë të përmbledhur objekti. Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e

palës të parashtruara në kërkesëpadi dhe për këtë arsye, gjykata nuk duhet të kufizohet vetëm tek pjesa hyrëse e saj, por duhet të verifikojë në tërësi përmbajtjen e këtij akti procedurial.

Përveç objektit të padisë, për ekzistencën e "gjësë së gjykuar", duhet që padia të jetë mbështetur në një shkak ligjor të njëjtë me atë të një padie të mëparshme të gjykuar dhe të zgjidhur me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Shkaku ligjor i padisë është fakti juridik që përbën bazën e të drejtës së pretenduar në gjyq, dispozita konkrete ligjore që pretendohet nga paditësi se është shkelur nga veprimet e të padituri. Shkaku ligjor i padisë nuk është dispozita ligjore që shënohet në padi, por kjo e fundit shënohet për të bërë identifikimin e llojit të së drejtës që paditësi synon të mbrojë në gjykatë. Shkaku i padisë është kombinimi i faktit cënues dhe i së drejtës subjektive mbi të cilën bazohet padia e që ka lidhje me marrëdhënien juridike që është themeli i pretendimit të paraqitur me kërkesëpadi në gjykatë.

Në lidhje me shkakun ligjor të padisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.3, dt.29.03.2012, kanë arritur në këtë përfundim: "Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar".

Elementi i tretë për ekzistencën e "gjësë së gjykuar" është fakti se duhet të kemi të bëjmë me të njëjtat palë ndërgjyqëse në proces. Kjo kuptohet nga vetë efekti relativ që kanë në parim vendimet gjyqësore. Vendimi gjyqësor ka efekt vetëm përkundrejt palëve ndërgjyqëse. Ai zgjidh një mosmarrëveshje të caktuar mes palëve të caktuara dhe nuk mund t'u kundërdrejtohet personave të tretë, të cilët nuk kanë marrë pjesë në këtë gjykim, në cilësinë e palës ndërgjyqëse. Pra, do të kemi "gjë të gjykuar", që vjen si rezultat i të njëjtave palë ndërgjyqëse, vetëm atëherë kur të njëjtat palë marrin pjesë, si në padinë e parë, ashtu edhe në të dytën. Këtu duhet të kihet parasysh se identiteti i palëve nuk vlerësohet në kuptimin fizik. Në funksion të "gjësë së gjykuar", duhet të verifikohet nëse kemi identitet të njëjtë juridik të palëve, domethënë nëse veprohet me të njëjtën cilësi proceduriale në proces.

Pala ndërgjyqëse nuk vepron në gjykim vetëm për llogari të vet, por prezumohet se përfaqëson të gjithë ata persona që heqin të drejta prej saj. Pra, këtyre personave iu prapësohet "gjëja e gjykuar", njësoj si edhe vetë palës nga e cila kanë hequr të drejta. Këta persona, duke mos qënë "persona të tretë", në kuptim të "gjësë së gjykuar", nuk mund të pretendojnë se efektet e vendimit gjyqësor nuk shtrihen mbi ta. Ky vendim iu kundërdrejtohet me të gjitha efektet e tij.

Një kategori personash, të cilët konsiderohen të përfaqësuar nga pala ndërgjyqëse, në kuptimin e "gjësë së gjykuar" dhe që mund t'u kundërdrejtohet vendimi gjyqësor, janë trashëgimtarët e saj, kuptohet brenda kufijve të trashëgimit.

Këto janë tre elementët që duhet të plotësohen për ekzistencën e "gjësë së gjykuar". Këto elementë duhet të ekzistojnë njëkohësisht, pasi mungesa, qoftë edhe e njërit prej tyre, do të sillte si pasojë që të mos ndodhemi përpara "gjësë së gjykuar", por përpara një kërkesëpadie të re, të ndryshme nga padia e parë. Padia e dytë, nëse plotëson kërkesat e ligjit procedurial, duhet të merret në shqyrtim nga gjykata dhe të zgjidhet me një vendim përfundimtar.

Nëse ndodhemi përpara një padie të njëjtë në objekt, shkak ligjor dhe palë ndërgjyqëse, me një padi të mëparshme, të zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjykata duhet t'a rrëzojë atë, përderisa konflikti nuk ekziston më, duke qënë së është zgjidhur tashmë me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Nëse një vendim gjyqësor i formës së prerë, i dhënë për zgjidhjen e një konflikti mes palëve ndërgjyqëse, do te vinte ndesh me një vendim tjetër eventual gjyqësor, i cili mund të jepet mbi shqyrtimin e një padie midis të njëjtave palë ndërgjyqëse, ky fakt, përveç të tjerave, do të përbënte një arsye serioze, e cila duhet të vlerësohet për të arritur në përfundimin se ndodhemi përpara efektit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe "gjësë së gjykuar". Ky do te ishte njëkohësisht edhe një test i rëndësishëm për të verifikuar nëse paditë janë të njëjta për nga objekti, shkaku ligjor dhe palët ndërgjyqëse.

Jurisprudenca unifikuese dhe kushtetuese

Në lidhje me rolin e gjykatës në identifikimin e elementëve të "gjësë së gjykuar", Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.3, dt.29.03.2012, janë shprehur: "Roli i gjykatës në identifikimin e objektit të mosmarrëveshjes paraqet rëndësi për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë

gjykata. Kështu, në rastin e paraqitjes së një padie të re, midis të njëjtave palë, gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, do të bëjë atë që quhet "identifikimi i padive", ku objekti i mosmarrëveshjes paraqitet si një element thelbësor për këtë identifikim (krahas palëve dhe shkakut të padisë). Në këtë rast gjykata do të duhet të shqyrtojë elementët *(pretendimet)* përbërës të objektit të mosmarrëveshjes *(padisë)* së zgjidhur më parë me vendim përfundimtar dhe t'i krahasojë ato me elementët e mosmarrëveshjes së re të paraqitur për shqyrtim. Në rast se gjykata do të konstatojë faktin se ato janë të njëjta, atëherë do të shprehet me vendim për rrëzimin e padisë për shkak të "*gjësë së gjykuar*". E njëjta problematikë paraqitet edhe në rastin e litispendencës (gjyqvarësisë). Edhe në këto raste gjykata do të duhet të bëjë "identifikimin e padive", në mënyrë që të marrë një vendim të drejtë. Gjithashtu "identifikimi i padive" shërben edhe për vlerësimin nëse pretendimet e reja të parashtruara nga palët në proces kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit, apo përbëjnë padi të re".

Një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të interpretimit dhe kuptimit të nenit 451/a, të Kodit të Procedurës Civile, përbën edhe vendimi nr.24, dt.12.11.2008, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka elaboruar më tej konceptin e "gjësë së gjykuar", duke zgjeruar konceptin e saj tej interpretimit literal të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me tre elementët që përbëjnë këtë parim të rëndësishëm. Kështu, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se parimi i "gjësë së gjykuar" përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e të drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.

Sikurse shihet, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se në funksion të një parimi tjetër shumë të rëndësishëm të së drejtës, atë të "sigurisë juridike", do të vlerësohet si "gjë e gjykuar" edhe vërtetimi i një fakti apo zbatimi i se drejtës në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, me kushtin që ky fakt të mos jetë përmendur në mënyrë rastësore, por të jetë bërë në funksion të dhënies së këtij vendimi dhe të jetë pjesë e fakteve apo marrëdhënieve që kanë përbërë objektin e gjykimit, mbi të cilin është dhënë ky vendim.

Në të njëjtin vendim, Gjykata Kushtetuese është shprehur se në harmoni me parimin e "sigurisë juridike', ligji procedurial civil ka sanksionuar edhe parimin e "gjësë së gjykuar", parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën "gjë të gjykuar", është shprehje dhe konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka për qellim t'i japë, jo vetëm qetësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cënimi i parimit të "gjësë së gjykuar" do të çonte në cënimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të garantuara nga neni 42, i Kushtetutës, pra në cënim të vetë sigurisë juridike.

Rishikimi vendimit gjyqësor në funksion të "Gjësë së gjykuar"

Dëshiroj të theksoj edhe një moment të fundit në lidhje me "gjënë e gjykuar". Në nenin 451/a, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se një konflikt që është zgjidhur me një vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Një rast i tillë është ai i parashikuar nga neni 494, i Kodit të Procedurës Civile dhe që lidhet me rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Sipas këtij neni, kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Duhet theksuar se edhe në këtë rast, nuk cënohet parimi i "gjësë së gjykuar", pasi, në eventualitetin qe gjykata do të pranojë kërkesën për rishikim, ajo vendos prishjen e vendimit tërësisht apo pjesërisht dhe vazhdon gjykimin në themel të çështjes. Në këto kushte, pavarësisht se çështja që do të gjykohet do të jetë e njëjtë për nga objekti, shkaku ligjor dhe palët ndërgjyqëse, nuk do të jemi përpara "gjësë së gjykuar", duke qënë se vendimi që ka dalë mbi padinë e parë nuk mund të konsiderohet i formës së prerë, pasi është prishur nga gjykata në njërën nga mënyrat që parashikon vetë ligji procedurial.

Rishikimi i vendimit nuk është një mjet i zakonshëm ankimi, por një mjet i jashtëzakonshem dhe duhet të bëhet vetëm për rastet e listuara në menyrë shteruese në nenin 494, të Kodit të Procedurës Civile. Ky mjet ankimi konsiderohet i jashtëzakonshëm për shkak se mund të çojë në prishjen e një vendimi të formës së prerë, në rastin kur janë ezauruar mjetet e zakonshme të ankimit, si edhe duke vlerësuar shkaqet për të cilat mund të kërkohet dhe që rezultojnë se nuk janë të zakonshme.

Në pamje të parë, duket se rishikimi i vendimit cënon parimin e "gjësë së gjykuar" dhe atë të "sigurisë juridike", por në thelb, nëse i

referohesh rasteve të tij, rezulton se është një mjet i rëndësishëm për të korrigjuar një vendimmarje të gabuar. Thuajse të gjitha rastet e rishikimit kanë të bëjnë me zbulimin e fakteve apo rrethanave të reja, të cilat po të diheshin në momentin e zhvillimit të gjykimit, do t'a çonin gjykatën në një përfundim tjetër.

Madje, rishikimi i vendimit korrigjon edhe situatën kur nuk është respektuar pikërisht parimi i "gjësë së gjykuar". Në nenin 494, paragrafi e, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se rishikimi i vendimit që ka marrë formë të prerë mund të kërkohet kur vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak ligjor.

Qëllimi dhe rëndësia

Parimi i "gjësë së gjykuar", përveçse i detyrueshëm për t'u zbatuar, është edhe mjaft i rëndësishëm, për shkak se sjell qëndrueshmëri dhe stabilitetin e dëshiruar në marrëdhëniet shoqërore, ekonomike dhe juridike në përgjithësi, si edhe në raportet e caktuara midis subjeteve të së drejtës në veçanti.

Ky parim është i lidhur ngushtë dhe vjen në funksion të një parimi tjetër po kaq të rëndësishëm të së drejtës, sikurse është ai i "sigurisë juridike". Marrja për shqyrtim e një padie të re do të mbarte rrezikun e daljes së vendimeve gjyqësore të ndryshme për të njëjtin konflikt, gjë e cila do të krijonte vështirësi në ekzekutimin e tyre, si procesi fundor i vënies në vënd të së drejtës së shkelur apo të cënuar, ndërkohë që do të sillte si pasojë që ky raport juridik i kontestuar mes palëve ndërgjyqëse të mos merrte asnjëherë një zgjidhje përfundimtare. Mbrojtja e të drejtave të njohura me ligj dhe sigurimi i ekzekutimit të plotë dhe të rregullt të detyrimeve, nuk mund të realizohet nëse nuk do të pranojmë se një çështje e zgjidhur një herë me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente, është në përputhje me realitetin dhe pasqyron të vërtetën sipas parimeve të sanksionuara në Kodin e Procedurës Civile.